




Ne može meni bit dobro,
ako je mom susjedu loše

As unë nuk mund të ndihem mirë
nëse fqinji im ndihet keq

Не може мене да ми биде добро,
ако на мојот сосед му е лошо

Ne može meni bit dobro,
ako je mom susjedu loše

As unë nuk mund të ndihem mirë
nëse fqinji im ndihet keq

Не може мене да ми биде добро,
ако на мојот сосед му е лошо

Uredile / Redaktuan / Уредиле
Helena Rill
Ivana Franović

www.nenasilje.org

CENTAR ZA NENASILNU AKCIJU
QENDRA PËR AKSION TË PADHUNSHËM
ЦЕНТАР ЗА НЕНАСИЛНА АКЦИЈА

URED U BEOGRADU

ZYRA NË BEOGRAD

КАНЦЕЛАРИЈАТА ВО БЕЛГРАД

Studentski trg 8, 11000 Beograd, SCG
Tel: +381 11 637-603, 637-661
Fax: + 381 11 637-603
Email: cna.beograd@nenasilje.org

URED U SARAJEVU

ZYRA NË SARAJEVË

КАНЦЕЛАРИЈАТА ВО САРАЈЕВО

Radnička 104, 71000 Sarajevo, BiH
Tel: +387 33 212-919, 267-880
Fax: + 387 33 212-919
Email: cna.sarajevo@nenasilje.org

Ne može meni bit dobro
ako je mom susjedu loše

As unë nuk mund të ndihem mirë
nëse fqinji im ndihet keq

He може мене да ми биде добро
ако на мојот сосед му е лошо

**Ne može meni bit dobro, ako je mom susjedu loše
As unë nuk mund të ndihem mirë nëse fqinji im ndihet keq
Не може мене да ми биде добро, ако на мојот сосед му е лошо**

Uredile Redaktuan Уредиле <i>Helena Rill Ivana Franović</i>	Lektura za albanski Lektor për gjuhën shqipe Лектура за албански <i>Ismet Kallaba</i>
Izdavač Botuesi Издавач <i>Centar za nenasilnu akciju</i>	Lektura i korektura za b/h/s Lektor dhe korrektor (për gjuhën serbe, kroate, boshnjake) Лектура и коректура за б/с/х <i>Zorica Galonja</i>
Prevod s albanskog na b/h/s Përkthyen nga gjuha shqipe në gjuhën boshnjake, kroate, serbe Превод од албански на б/с/х <i>Edina Hasanaga-Çobaj Bernard Çobaj</i>	Lektura za makedonski Lektor për gjuhën maqedone Лектура за македонски <i>Марина Геческа-Василевска</i>
Prevod s makedonskog na b/h/s Përktheu nga gjuha maqedone në gjuhën boshnjake, kroate, serbe Превод од македонски на б/с/х <i>Ана Битољану</i>	Dizajn i prelom Përpunimi grafik dhe thyerja Дизајн и разделување на слог <i>Ivana Franović</i>
Prevod s b/h/s na albanski Përkthyen nga gjuha serbe, kroate, boshnjake në gjuhën shqipe Превод од б/с/х на албански <i>Bernard Çobaj Ismet Kallaba Gjekë Gjonaj</i>	Fotografije Fotografitë Фотографии <i>Nenad Vukosavljević Nedžad Horozović</i>
Prevod s b/h/s na makedonski Përkthyen nga gjuha serbe, kroate, boshnjake në gjuhën maqedone Превод од б/с/х на македонски <i>Ана Битољану Дејан Василевски</i>	Štampa Shtypi Печати <i>Standard 2</i> ISBN: 86-902539-4-7

Objavlјivanje ove knjige pomoglo je Ministarstvo inostranih poslova Švajcarske.
Botimin e këtij libri e ndihmoi Ministria e Punëve të Jashtme të Zvicrës
Објавувањето на оваа книга го помогна Министерството за надворешни работи на Швајцарија.

Parathënie	
13	
Intervistuesit/et	Nuk kanë lidhje se çfarë ka ndodhur, kurse urrejnë
17	<i>Jadranka (Lloznicë)</i>
Falënderimet	252
18	Unë jam kroate më e madhe sepse punoj në të
Faji është kolektiv. Nuk mundet individi ta marrë	mirë të shtetit tim
vetë pushkën dhe të gjuaj.	<i>A. (Knin)</i>
<i>Metodija (Shkup)</i>	258
213	Të ndërpritet cikli i dhunës
Çdo komb e ka nacionalizmin e vet	<i>Mevludini (Gjilan)</i>
<i>Galipi (Shkup)</i>	263
217	Ta shikojmë të vërtetën në sy
Tani jemi në prag të zeros	<i>Peda (Babushnicë)</i>
<i>Seadi (Vakufi i Epërm – Uskople)</i>	267
222	Jemi më të mbrapshtë seç na është thënë
Njerëzit po “e marrin veten” ngadalë edhe pse	<i>Mustafa (Ulqin)</i>
politikanët akoma “kërcënojnë me armë”	273
<i>Gjuroja (Vakufi i Epërm – Uskople)</i>	Në këtë kohë, heronjtë që nuk janë heronj, bëhen
225	të tillë
Hej, a e dëgjon veten se çfarë thua?!	<i>G. (Bijelinë)</i>
<i>Tamara (Sombor)</i>	275
228	Të mos lejojmë që të tjerët të flasin përherë për
Si u preva unë, si u preve ti – i njëjti gjak na	ne
rrjedh nëpër damarë	<i>Fata (Bijelinë)</i>
<i>Esma (Sarajevë)</i>	279
233	Besim e jo të na ruajë ushtria
E atëherë vëlla do të fillojmë nga vetvetja	<i>Nexhati (Gjilan)</i>
<i>Vojoja (Nevesinje)</i>	285
237	T’i pastrojmë gjërat në kopshtin tone
Fenomen planetar	<i>Borisi (Knin)</i>
<i>Edini (Ulqin/Sarajevë)</i>	289
242	Të fillohet biseda gjatë drekës së të dieles
Është tmerrësisht e vështirë të thuash: “Unë kam	<i>Iva (Zagreb)</i>
gabuar”	294
<i>Predragu (Trebinjë)</i>	Si është e mundur të jesh i lumtur në rrethin e
244	fatkeqëve?
Populli duhet ta kuptojë njëherë e përgjithmonë	<i>Junuzi (Vakufi i Epërm – Uskople)</i>
se nuk duhet të ketë urrejtje	299
<i>Vedati (Gjilan)</i>	Të gjithë presim së bashku në radhët e njëjta
248	<i>Olivera (Kamenica e Kosovës)</i>
	301

Si ka ardhur deri te kjo që të kërkojmë tani pajtim? <i>Kosta (Shkup)</i> 304	Nuk ka rënë ai nga qielli, ne e kemi zgjedhur <i>Ivica (Shibenik)</i> 351
Frymojmë lirë, ecim lirë, bisedojmë lirshëm <i>S. (Prishtinë)</i> 307	Dhe të kalohen të gjitha këto, për çfarë! <i>Razija (Sarajevë)</i> 356
Siç më ka dhembur mua, ashtu u ka dhembur edhe shqiptarëve, romëve... <i>Alberti (Podgoricë)</i> 310	Ndihem më mirë kur e di se nuk rri ulur dhe pres <i>Nina (Beograd)</i> 358
Niveli i tretë i fajit: ata që s'kanë dalur në zgjedhje <i>Darkoja (Horgosh)</i> 316	Që fqijun tim mos ta sulmoj, por ta ftoj për kafe <i>Sasha (Sarajevë)</i> 366
Ai, shtëpi të madhe – ti, shtëpi të vogël <i>Petriti (Shkup)</i> 320	Elhamdulilah <i>Dika (Sarajevë)</i> 368
Kemi për çfarë të turpërohem <i>M. (Karlovac)</i> 325	Nëse hesht, ai do të bërtasë, kurse këta të gjithë do të dëgjojnë <i>Aleksandri (Split)</i> 373
Kam frikë nga mungesa e tolerancës dhe diskutimit, kurse kjo është ajo çka na duhet <i>Lubica (Popovaçë)</i> 330	Armiku i njeriut, pra në veten e tij <i>Motër Makrina (Berovë)</i> 378
Secili mendon se ai është viktimë, se të tjerët janë fajtorë <i>M. (Suboticë)</i> 332	Urrejtja ka prodhuar urrejtje <i>Zymreta (Shkup)</i> 381
Janë shumë të rëndësishme disa pajtime të vogla <i>Josipa (Jajce)</i> 337	Njeriu si qenie politike <i>Srgjan (Osijek)</i> 387
Që nga koka deri tek thembra <i>Muhamedi (Shkup)</i> 340	Vitet '90 i kujtoj me njëfarë zemërimi, hidhërimi dhe ndjenje turpi <i>Dejani (Zemun)</i> 391
Na kanë gjetur në rrugë dhe na kanë pranuar në shtëpi <i>Milica (Bijelinë)</i> 342	Koha dhe vullneti <i>Llana (Kotorr)</i> 399
Me vetë faktin që kanë heshtur dhe nuk kanë bërë asgjë, kanë marrë pjesë në tërë atë <i>Ajsha (Podgoricë)</i> 346	Fqinjët i përshëndes ende me "Bok!", kurse komshinjtë me "Zdravo!" <i>M. (Vukovar)</i> 401
	Nacionalizmi është një gjë ngjithëse <i>Vera (Zemun)</i> 407
	Në vend të epilogut: Për dhunën janë thënë kudo shumë gjëra, kurse këtu do të themi diçka për padhunën 411

Para Jush është përmbledhja e intervistave me njerëz nga të gjitha trevat e ish-Jugosllavisë, me njerëz të profileve mjaft të ndryshme: moshave, profesioneve, gjinisë, përkatësive etnike të ndryshme... E përbashkëta e tyre është gatishmëria që të flasin për të kaluarën, të shqyrtojnë të tashmen dhe të kenë shpresa, ankthe dhe dëshira për të ardhmen e bukur dhe të sigurt. Dikush do të thotë se këta janë vetëm “njerëz të zakonshëm”. Ndoshta edhe janë “të zakonshëm” në atë kuptimin se nuk janë në pozita në pushtet, as nuk janë nga radha e personaliteteve të njohura të cilët mund t'i dëgjojmë dhe t'i shohim shpesh përmes mjeteve të informimit publik. Por ata përbëjnë definitivisht, do të guxoja të them – pjesën më të madhe të shoqërive në të cilat jetojmë. Të zakonshëm apo të pazakonshëm, me vete bartin një numër të madh dëshirash, frikash, revoltash ndaj situatës në shoqëri, mendimesh, mërzish, aspiratash dhe shpresash ashtu si edhe shumica prej nesh. Njëkohësisht, këto janë zëra të cilët aq rrallë kemi rast t'i dëgjojmë. Absurde apo jo? Sa shpesh keni pasur rast, nëse keni pasur ndopak, të dëgjoni sesi është ndier gruaja e cila e ka kaluar tërë luftën në Sarajevë ose në Prishtinë, si mendon dikush në Beograd, Shibenik, Shkup, Jajce, çfarë shpreson dhe prej kujt frikohet dikush në Knin, Gjilan, Lloznicë, dikush që ka jetuar si refugjat, dikush që ka marrë pjesë në luftë, dikush që e ka parë luftën në televizion?

Dëshira jonë ka qenë që të mundohemi të gjejmë hapësirë që këto zëra të dëgjojnë. Përvoja shumë-vjeçare në ndërtimin e paqes na ka treguar sesa i kontribuon mirëkuptimit të ndërsjellë dhe ndërtimit të besimit shkëmbimi i këtyre mendimeve për pikat e dhimbshme të shoqërive tona, për shpresat që i kemi, për atë se kush jemi dhe çfarë na mundon, si dhe si do të dëshironim të ishte – siç theksoi një grua në intervistë “Si u preva unë, si u preve ti – i njëjti gjak na rrjedh nëpër damarë”. Mirëkuptimi dhe besimi i ndërsjellë kanë rëndësi thelbësore për ndërtimin e paqes, të asaj paqeje nga mungesa e së cilës shoqëritë tona aq shumë vuajnë.

Mendimet në vijim nuk ecin në kahjen “paqe, paqe, askush nuk është fajtor”. Ka shumë mundësi që disa qëndrime do t'ju shkaktojnë kallo, ndoshta do të vlerësoni se ato në asnjë mënyrë nuk duhet të jenë pjesë e një publikimi i cili pretendon të japë kontributin e vet në ndërtimin e paqes. Unë do thoja – oh, po, puna në ndërtimin e paqes shkakton vërtet kallo duke marrë parasysh se nuk besojmë se në të mund të punohet nëse e lëmë pas dore të kaluarën tragjike që e kemi jetuar dhe të cilën disa prej nesh e jetojnë akoma. Ndërsa nëse e hapim çështjen e së kaluarës dhe e marrim parasysh kompleksitetin e saj – natyrisht se nuk do të pajtohemi për të gjitha çështjet. Pikërisht kjo është madhështia jonë, e njerëzve “të zakonshëm”: të përpiqemi të kuptojmë pikërisht ato qëndrime të cilat dallojnë aq shumë prej qëndrimeve tona (duke përjashtuar qëndrimet fashiste – ato nuk kanë vend këtu, sepse e kanë uzurpuar mjaft hapësirën rreth nesh). Kur të arrijmë t'i kuptojmë gjërat në mënyrë të tillë: pse dikush mendon aq ndryshe prej nesh (kurse ndoshta ajo nuk është aq ndryshe), se ajo nuk është nga urrejtja e verbër dhe e pakuptueshme, por për shkak të njëfarë dhimbjeje, frike, përvoje – atëherë kemi bërë hapin e madh. Ndërsa një njeri i madh “i zakonshëm”, miku ynë Xhevad Budimliq, thotë “Nuk mund të ndihem unë mirë, nëse fqinji im ndihet keq”...

Njerëzit i kemi pyetur dhe ata kanë folur për të gjitha ato nocionet e mëdha që janë bërë shprehje, dhe të cilat, kur i themi – veç dihet se çfarë mendojmë, ndërsa në të vërtetë kuptimi ynë i tyre dallon shumë: pajtimi, e kaluara, ballafaqimi, harresa, faji, përgjegjësia, paqja, e ardhmja, bashkëjetesa, lufta,... – duke u përpjekur që shpjegimet e tyre të bëhen përmes përvojave personale e jo përmes nocioneve tjera të mëdha, në mënyrë që të krijojmë hapësirë që të kuptohemi më mirë.

Nuk kemi pretenduar që ky të jetë hulumtim i realizuar mbi bazën e mostrës përfaqësuese e cila do të tregonte se ku ndodhet opinioni ynë publik (ose në shumës: opinionet tona publike). Në fazën fillestare të kësaj ideje e kemi pasur të qartë se duam cilësi që e bartin me vete përvojat personale, përkundër sasisë që do të ishte mostra përfaqësuese. Po ashtu, siç e thashë, për disa zëra këtu nuk ka vend, për ato më të zhurmshmit dhe më agresivët.

Pasuria që nuk duhet lënë pas dore e këtij libri është numri i gjuhëve në të. Dikush ndoshta do të thoshte se do të ishte më ekonomike dhe/ose praktike që të ekzistonin publikime të veçanta për gjuhën maqedone dhe gjuhën shqipe. Por, neve na ka pëlqyer ideja që çdo gjë të jetë në një vend, e lidhur fort, ashtu siç janë të lidhura edhe fatet tona. Intervistat janë realizuar në periudhën mars-nëntor 2005. Tetëmbëdhjetë intervistues/e (po ashtu nga hapësira e ish-Jugosllavisë) kanë pasur përgjegjësi të zgjedhin bashkëbiseduesit/et dhe e kanë pasur lirinë e zhvillimit të intervistës, por në mënyrë që të jenë të përfshira pyetjet relevante. Intervistat janë zhvilluar në gjuhën shqipe, boshnjake, kroate, maqedone, serbe dhe ndoshta edhe në ndonjë gjuhë tjetër (serbokroate, malazeze, etj.). Në bazë të regjistrimeve në diktafon është bërë transkriptimi i cili është dhënë këtu besnikërisht. Në të vërtetë, disa intervista janë shkurtuar pak në mënyrë që të shmangen përsëritjet e panevojshme, kurse janë bërë ndërhyrje edhe për të “hekurosur zhurmat” e caktuara që lindin gjatë bisedës – në radhë të parë për shkak të leximit dhe kuptueshmërisë më të lehtë se çfarë ka dashur të thotë bashkëbiseduesi/ja. Do t’ju lutem që ta merrni në konsideratë se një numër i bashkëbiseduesve nuk ka folur në gjuhën amtare gjatë intervistës.

Përzgjedhja e bashkëbiseduesit/es nuk ka qenë detyrë e thjeshtë; krahas koordinimit me intervistuesit/et tjerë me qëllim të mbulimit të larmisë së shoqërisë dhe përfshirjes së njerëzve të profileve dhe mendimeve të ndryshme, ka qenë e vështirë të gjenden edhe bashkëbiseduesit/et që janë të gatshëm të flasin publikisht për tema të dhimbshme – një numër jo i vogël ka pasur frikë dhe është ndier keq. Edhe përkundër faktit se kemi vendosur që bashkëbiseduesit/et t’i prezentojmë vetëm me emër, disa njerëz janë ndier më mirë me zgjedhjen që t’ju publikohen vetëm inicialet, kryesisht për shkak të sigurisë personale. E kuptoj plotësisht këtë frikë. Mu ajo na jep pamjen sesa janë sëmure dhe zhytur në baltë shoqëritë tona, por edhe sesa urgjentisht duhet të punojmë të gjithë ne për të arritur ndryshimin aq të pritur shoqëror (i cili nuk përmbledhet vetëm në atë që ka thënë një bashkëbiseduese “se do të kemi paga më të mira”). Nuk mund të durohem pa e cituar këtu Mesha Selimoviqin: “Frikohu dashit, frikohu mutit – kur do të jetosh?”. Dhe pajtohem plotësisht me gruan e cila thotë se ne nuk jetojmë, por *mundohemi* të jetojmë.

Mbetet pyetje e hapur se interesimin e kujt do të zgjojë ky libër. Ne kemi listën tonë të dëshirave dhe sygjërimeve se kujt do të duhej t’i interesonte, një pjesë e tij i përgjigjet realitetit, ndërsa për pjesën tjetër nuk jemi të sigurt. Sidoqoftë, do të ishte i mirëseardhur informacioni kthyes nga lexueset dhe lexuesit, kështu që do t’ju lusim t’i dërgoni kritikën dhe përshtypjet tuaja. Puna me paqen kërkon aksion dhe reagim – në mënyrë që të mund të ndryshojmë veten, e me këtë edhe shoqëritë në të cilat jetojmë.

Intervistat mund (por nuk duhet) t’i lexoni sipas atij rendi që janë të radhitura në këtë publikim, kurse jemi munduar t’i radhisim në mënyrë që të jenë në interaksion reciprok. I jemi shmangur me qëllim radhitjes sipas vathës nacionale, etnike dhe regjionale, në mënyrë që t’i japim kontribut dekonstruktimit të vlerave të çrregulluara të shoqërive tona. Natyrisht, ekzistojnë edhe *n* renditje sipas të cilave mund të lexohen intervistat, duke qenë edhe më tej në interaksion reciprok, pak a shumë të dukshëm. Zgjidhni Ju vetë.

Ivana Franoviq

Intervjueri/ke
Intervistuesit/intervistueset
Интервјуисти

Ана Битољану
iz Skoplja
nga Shkupi
од Скопје

Anita Grabner
iz Gornjeg Vakufa – Uskoplja
nga Vakufi i Epërm – Uskople
од Горни Вакуф – Ускопле

Bojana Jovanović
iz Zenice, živi u Bijeljini
nga Zenica, jeton në Bijelinë
од Зеница, живее во Бјелина

Boris Avram
iz Nevesinja
nga Nevesinja
од Невесиње

Edina Hasanaga–Çobaj
iz Ulcinja
nga Ulqini
од Улцињ

Emina Popović
iz Garešnice, živi u Zagrebu
nga Gareshnica, jeton në Zagreb
од Гарешница, живее во Загреб

Гордана Пирковска Змијанац
iz Skoplja
nga Shkupi
од Скопје

Helena Rill
iz Sombora, živi u Beogradu
nga Sombori, jeton në Beograd
од Сомбор, живее во Белград

Ivana Franović
iz Beograda
nga Beogradi
од Белград

Лидија Ѓокиќ
iz Skoplja
nga Shkupi
од Скопје

Lidija Zeković
iz Podgorice
nga Podgorica
од Подгорица

Lovorka Bačić
iz Zagreba
nga Zagrebi
од Загреб

Milan Colić Humljan
iz Babušnice, živi u Beogradu
nga Babushnica, jeton në Beograd
од Бабушница, живее во Белград

Nexhat Ismaili
iz Medveđe, živi u Gnjilanu
nga Medvegja, jeton në Gjilan
од Медвеђе, живее во Ѓњилане

Sanja Deanković
iz Splita, živi u Sarajevu
nga Spliti, jeton në Sarajevë
од Сплит, живее во Сараево

Tamara Šmidling
iz Beograda, živi u Sarajevu
nga Beogradi, jeton në Sarajevë
од Белград, живее во Сараево

Tijana Gnjidić
iz Sombora, živi u Subotici
nga Sombori, jeton në Suboticë
од Сомбор, живее во Суботица

Vildan Efendić
iz Sarajeva
nga Sarajeva
од Сараево

Zahvale

Zahvaljujemo se svim sagovornicima i sagovornicima na iskrenosti, hrabrosti i volji da glasno kažu ono što misle i osećaju. Zahvaljujemo se intervjuerkama i intervjuerima za veliki posao koji su napravile/i. Zahvaljujemo se prevodiocima: Bernardu Čobaju i Dejanu Vasilevskom, i prevoditeljicama Edini Hasanaga-Čobaj i Ani Bitoljanu (Ani hvala na milionima pitanja i brizi da se slučajno ne potkrade neka greška), i lektorkama i lektoru: Marini Gečeskoj-Vasilevskoj, Zorici Galonja i Ismetu Kalabi. (Zorici posebno hvala na komentarima koji su nas tako radovali i govorili nam koliko aktivno učestvuje u tome da ova knjiga bude to što jeste.) Hvala Švajcarskom Ministarstvu inostranih poslova na finansijskoj podršci i na poverenju u nas da ćemo napraviti nešto dobro i korisno, čak i onda kada ni sami nismo bili sigurni kako će izgledati to što hoćemo da napravimo. Hvala Dejanu Iliću iz "Fabrike knjiga" koji nam je dao korisne savete i smernice i brinuo da sve bude u redu.

Falënderimet

Falënderojmë të gjithë bashkëbiseduesit/et për sinqeritetin, kurajon dhe vullnetin që të thonë haptas atë që mendojnë dhe ndiejnë. Falënderojmë intervistuesit/et për punën e madhe që kanë bërë.

Falënderojmë përkthyesit: Bernard Çobaj, Dejan Vasilevski, Edina Hasanaga-Çobaj dhe Ana Bitolani (falënderojmë Anën për miliona pyetjet dhe kujdesin që rastësisht të mos përvidhet ndonjë gabim), lektorët: Marina Gecëska, Zorica Galonja dhe Ismet Kallaba (posaçërisht e falënderojmë Zoricën për komentet që na kanë gëzuar dhe treguar sesa ajo merr pjesë aktivisht që ky libër të jetë ai që është).

Falënderojmë Ministrinë e Punëve të Jashtme të Zvicrës për mbështetjen financiare dhe për besimin tek ne se do të bëjmë diçka të mirë dhe të vlefshme, bile edhe atëherë kur edhe ne vetë nuk kemi qenë të sigurt sesi do të duket ajo që dëshirojmë të bëjmë.

Falënderojmë Dejan Iliqin nga "Fabrika knjiga" (Fabrika e librave), i cili na ka dhënë këshilla dhe udhëzime të dobishme dhe është kujdesur që gjithçka të jetë në rregull.

Благодарност

Им се благодаруваме на сите соговорнички и соговорници за искреноста, храброста и волјата да го гласно кажат она што го мислат и чувствуваат.

Им се благодаруваме на интервјуистите за големата работа што ја изработија.

Им се благодаруваме на преведувачите: Бернард Чобај и Дејан Василевски и на преведувачките: Едини Хасанага Чобај и Ана Битољану (Ана, ти

благодариме за милионите прашања и грижите случајно да не се провлече некоја грешка) и на лекторките и лекторот:

Марина Геческа-Василевска, Зорица Галоња и Исмет Калаба. (Особено на Зорица за коментарите кои толку многу нè радуваа и ни зборуваа колку активно учествува за оваа книга да биде тоа што е).

Им благодариме на Министерството за надворешни работи на Швајцарија за финансиската поддршка и за довербата во нас дека ќе направиме нешто добро и корисно, дури и тогаш кога ни сами не бевме сигурни како ќе изгледа она што сакаме да го направиме.

Му благодариме на Дејан Илиќ од "Фабрика на книгата", кој ни даде корисни совети и насоки и се грижеше сè да биде во ред.

As unë nuk mund të ndihem mirë
nëse fqinji im ndihet keq

Faji është kolektiv. Nuk mundet
individi ta marrë vetë pushkën dhe të gjuaj.

Gjatë kohës së luftës në ish-Jugosllavi, ti si radioamator ke qenë shumë aktiv. Pas kësaj ka ndodhur konflikti në Maqedoni. Si është reflektuar e gjithë kjo në jetën tënde?

Në Maqedoni ishte evident, le të them, një raport shumë i keq njerëzor ndërmjet njëri-tjetrit. Urrejtjen disi, të paktën sipas meje, e kanë futur partitë politike. Mjaft parti politike dhe urrejtje, ndërsa udhëheqësit e këtyre partive, pikërisht ata sollën konfliktin midis njerëzve. Me pavarësimin e Maqedonisë, kur ka filluar pluralizmi, unë kam menduar se duhet të ekzistojnë dy-tri parti qytetare në mënyrë që të mund të jenë në këto parti edhe maqedonët, edhe serbët, edhe kombësitë tjera. Këtu është gabuar shumë kur pushteti i atëhershëm ka lejuar formimin e partive nacionale, partive nacionaliste dhe kjo ka bërë që tek ne të rritet urrejtja. Unë kam jetuar në Gostivar midis shqiptarëve, turqve dhe popujve tjerë. Kam qenë sportist, e kemi ndarë, siç thuhet, kafshatën bashkë. Kemi luajtur bashkë, jemi shoqëruar. Kjo ka qenë diku gjatë viteve 1948–1949 dhe kurrë nuk kam shpresuar se do të vijë deri tek kjo, pra konflikti. E kam pasur vështirë, sidomos për shkak të pasigurisë kudo që të shkosh. Edhe për shkak të humbjes së besimit reciprok, madje edhe me radioamatorët shqiptarë, të cilët më kanë besuar para konfliktit, kurse pas tij jo.

Si e ke përjetuar lajmin se është nënshkruar Marrëveshja e Ramkovës?

Sipas meje, ka mundur edhe pa Marrëveshjen e Ramkovës. Sikur të ishin ulur në tavolinë, si qytetarë të Maqedonisë, për shembull VMRO dhe PSDM, PPD dhe PDSH etj., nuk do të kishte pasur nevojë për ndërmjetësim. Megjithatë, kjo është situata. Sistemi i madh partiak nacionalist nuk vlen. Pse nuk do të mund shqiptari të jetë në një parti ku ka më shumë maqedonë.

Si të zbuten pasojat?

Po, duhet të mbisundojë arsyeja tek njerëzit. Papunësia kontribuon në lindjen e konflikteve, plaçkitjeve të ndryshme – sepse njerëzit nuk kanë. Edhe droga kontribuon po ashtu që të jetohet në pasiguri. Vetëm arsyeja tek njerëzit mund të ndihmojë, asgjë tjetër. Unë nuk shoh alternativë tjetër përveç që jeta familjare të përmbledhet në atë që fëmijët të edukohen në rregull. Unë mendoj se etika morale duhet të përfshihet në shkollë. Politikanët i keqpërdorin fëmijët për qëllimet e tyre ose, për shembull, e shfrytëzojnë sportin që të nxisin trazira, përçarje, grindje, rrache. Kjo nuk ka ekzistuar më parë. Dihet, simpatizantët simpatizojnë për ekipin e vet, por grindje nuk ka pasur. Ndërsa tani, përkundrazi, shfaqen grindjet nacionaliste. Ja, a nuk e kemi parë në Haraçinë politikën e pastër?

Si të ndryshojë kjo?

E, që kjo të ndryshojë duhet t'i kushtojmë përsëri më tepër vëmendje edukimit, të fillojmë me fëmijët, me shoqërimin e tyre. Ja, kemi, për shembull, shoqëri të ndryshme, lejoje fëmijën të shoqërohet. Por nuk guxojnë të rriturit të bëjnë si kjo që ndodh në Shemshevë, për shembull. Atje maqedonët nuk i lejojnë fëmijët e tyre të

Unë kam jetuar
në Gostivar
midis

shqiptarëve, turqve
dhe popujve tjerë.
Kam qenë sportist, e
kemi ndarë, siç thuhet,
kafshatën bashkë.
Kemi luajtur bashkë,
jemi shoqëruar. Kjo ka
qenë diku gjatë viteve
1948–1949 dhe kurrë
nuk kam shpresuar se
do të vijë deri tek kjo,
pra konflikti. E kam
pasur vështirë,
sidomos për shkak të
pasigurisë kudo që të
shkosh. Edhe për
shkak të humbjes së
besimit reciprok,
madje edhe me
radioamatorët
shqiptarë, të cilët më
kanë besuar para
konfliktit, kurse pas tij
jo.

Duhet të vijë deri te pajtimi midis maqedonëve dhe shqiptarëve dhe kjo do të bëhet duke i ndaluar partitë nacionaliste. Le të ekzistojnë partitë qytetare që të zgjidhin çështjet ndërmjet qytetarëve, maqedonëve, serbëve, romëve dhe shqiptarëve.

mësojnë në shkollë, ndërsa nga ana tjetër, ja, hajde të them shqiptarët, i nxisin fëmijët të bërtasin “uaa” pas fëmijëve maqedonë. Kjo nxitje duhet të ndalohet. Por të moshuarit duhet të kuptojnë se aty duhet të jetohej.

Hajde të kthehemi tek pasojat e luftës dhe si të ndryshohet kjo, si të ecim drejt pajtimit? Çfarë paraqet për ty pajtimi?

Pajtimi do të vijë, unë shpresoj se do të vijë. Nuk mund të mbetet kështu. Tani krijo-hen me qëllim konfliktet vetëm që të mos hyhet në Europë, qoftë nga partitë nacionaliste maqedone apo ato shqiptare. Duhet të vijë deri te pajtimi midis maqedonëve dhe shqiptarëve dhe kjo do të bëhet duke i ndaluar partitë nacionaliste. Le të ekzistojnë partitë qytetare që të zgjidhin çështjet ndërmjet qytetarëve, maqedonëve, serbëve, romëve dhe shqiptarëve.

Kush duhet të punojë për pajtimin?

Sipas meje, tërë populli i të gjitha kombësive. Nuk na duhen këta njerëz të ditur në Kuvend. Populli i zakonshëm do t'i zgjidhë më mirë të gjitha çështjet.

Cila është frika juaj lidhur me pajtimin?

Po, unë do të doja që të jetë qetë, të rregullohet situata, të mund të lëvizësh lirisht, të shkosh kudo. Ja unë si pensionist që kam punuar në hekurudhë pyes: Pse nuk ka akoma tren për Kërçovë? Atje ka, apo jo, popullsi edhe maqedone, edhe shqiptare, kurse trenat nuk shkojnë. Në hekurudhën e Koçanit trenat nuk qarkullojnë për shkaqe ekonomike, për shembull, por deri në Kërçovë trenat kanë qenë të mbushur me udhëtarë, kurse tani nuk ekzistojnë sepse nuk e di se çfarë të pret atje, mund të vdesësh. Këtu qëndron i gjithë problemi, tek frika.

Çfarë do të mund ta pengonte procesin e pajtimit?

Vetëm nacionalshovenizmi mund ta pengojë procesin e pajtimit. Mendoj se nacionalizmi është epidemia më e madhe, e cila nuk e lejon njeriun që të jetë i lirë. Shikojnë vetëm interesat politike.

A e dëshiron, sipas teje, populli pajtimin? A e dëshirojnë njerëzit në Maqedoni pajtimin dhe a janë të gatshëm për këtë?

Unë mendoj se mbi 50 për qind janë për bashkëjetesë. Nuk besoj se në pjesën përfundimtare të Maqedonisë, të them, të gjithë shqiptarët duan të grinden me maqedonët. Ata, ai popull i vuajtur që punon tërë ditën, ai nuk ka interes që të grindet, ndërsa ai që ka punë, por nuk punon, ai nuk ka interes për bashkëjetesë. Këtu ngatërrohen edhe interesat e kontrabandistëve, atyre që merren me drogë etj., kështu që ata do ta pengojnë këtë bashkëjetesë. Populli i ndershmë, populli që punon i çfarëdo kombësie, nuk e përhap urrejtjen nacionale. Edhe një gjë tjetër. Nacionalizmi është i shprehur kryesisht tek maqedonët, serbët dhe shqiptarët. Por, nuk mendon keq i tërë populli. Ky është një grup që tërheq më të dobët. Sidomos tani e shfrytëzojnë shansin, papunësia është e madhe dhe tani me një ndihmë të vogël minimale nxisin konfliktet, parullat... Për shembull, unë nuk e di, flamuri shqiptar shërben si çështje e ashpërsimit. Përmes këtyre dukurive politike ashpërsohet populli dhe ja trazirat. Apo ajo bomba në Kumanovë, ky është vandalizëm.

Kush do të ishte bartës i procesit të pajtimit?

Kryesisht të rinjtë, por të rriturit mos t'i pengojnë të rinjtë, t'i lënë në qetësi. Ju i keni parë fëmijët që vijnë në parada, takime të ndryshme, për shembull, në radioamatorizëm. Në takimet tona nuk ka nacionalizëm. Ne nuk diskutojmë, kemi biseda tjera.

Si do ta ndihmoje ti procesin e pajtimit? Po të tjerët?

Po, unë e ndihmoj në çdo rast. Ja, gjatë kohës së konfliktit në Bosnje, përmes meje kanë kaluar shqiptarët nga Tetova, të cilëve iu kam ndihmuar shumë. Njëri më ka pyetur se çfarë jam nga kombësia. Unë i them: maqedon. Ai më thotë – Bravo, sepse ia kam gjetur familjen në Sarajevë. Përkundrazi, në Gostivar ka qenë radio-stacioni, i cili iu ka paguar shërbimin vetë shqiptarëve që t'i u vendosë radio-lidhjen, kurse unë e kam bërë pa para. Shumë shqiptarë kanë ardhur tek unë për t'i lidhur. Edhe tani ndihmoj. Ka mënyra të ndryshme të krijimit të besimit. Tregëtia mund t'i kontribuojë kësaj, shkolla... Pala shqiptare duhet ta lë politikën anash, populli duhet të jetojë bashkë. Të mos dëgjojnë asnjë politikan, as maqedon, as shqiptar, sepse ata sjellin grindje. Pak nga pak, duhet parashikuar një trase të pajtimit midis maqedonëve dhe shqiptarëve. Në disa vende ka pak maqedonë dhe mund të frikohen ose mund t'i frikësojë shumica. Politikanët fusin frikë kudo. Ndërsa nga ana tjetër, shohim edhe në televizion, fqinjët jetojnë, njerëzit flasin, nuk ka kurrfarë politike.

Çfarë do të ndryshojë për ty kur të ndodhë pajtimi në Maqedoni?

Nëse çdo gjë është qetë, e rregulluar, nuk ka urrejtje, çdokush do t'i besojë Maqedonisë. Kështu askush nuk i beson dhe çdokush tallet me ne. Nëse janë të pajtuar, të gjithë do të jetojnë mirë, do të shoqërohen, ashtu siç kanë jetuar më parë në Bosnje.

Po çfarë të bëjmë me të kaluarën?

Kjo nuk do të fshihet lehtë tek të moshuarit, kurse fëmijët nuk do të dinë për këtë urrejtje. T'i kthehemi të kaluarës. Serbët e vjetër dhe bullgarët e vjetër, secili ka dashur ta gërvishtë Maqedoninë, ta marrë. Tani ajo gjeneratë është zhdukur. Ata kanë udhëhequr politikën për Serbinë e Madhe, Shqipërinë e Madhe, Bullgarinë e Madhe. Unë kam pasur rast të qëndroj në tavolinë me serbët dhe të më thonë: “Çfarë maqedonësh – ju jeni serbë”. Ata kanë udhëhequr politikë të tillë, por tani nuk ka më, ato gjenerata kanë shkuar. Edhe për Shqipërinë nuk ka më. Edhe vetë shqiptarët do të shohin se i kanë mashtruar disa politikanë që të fusin urrejtjen. Ndërsa tani që Shqipëria duhet të hyjë në Europë, duhet të bëjë shumë gjëra. Vetë Shqipëria duhet t'ju thotë: – Pritni, ju jeni në Maqedoni dhe duhet të jetoni atje. Ndërsa si kombësi, jini shqiptarë, por do të jetoni atje. Dhe në këtë mënyrë po ecet. Nuk e di se çfarë do të bëhet tani me qeverinë e re, por deri tani është ndjekur kjo mënyrë, lartë-poshtë.

A duhet të harrojmë dhe pse?

Mjerë ato familje, edhe shqiptare, edhe maqedone, që kanë humbur më të afërmit. Atje ku kanë vdekur fëmijë të pafajshëm... Sigurisht që, për shembull, familja e fëmijës që ka vdekur duke luajtur basketboll nuk do të harrojë. Edhe nga vetë shqiptarët, shumë nuk do t'i harrojnë. Kush nga Egjeu do të lavdërohet me Greqinë? Të dëbuar, iu kanë djegur vatrat, iu kanë marrë fshatin dhe i kanë dëbuar. Ata nuk do të harrojnë. Ai që nuk ka përjetuar diçka të tillë, do të harrojë shpejt për arsye se ndoshta kjo edhe nuk i intereson aq.

A duhet të falim?

Duhet të falim. Falja është e pashmangshme. Ka qenë çfarë ka qenë. Dikush ka qenë i futur në luftë. Nuk ka zgjidhje tjetër. Le të më thotë dikush nëse ekziston.

Ku qëndron sipas teje faji për të gjithë këtë? A është ai individual apo kolektiv?

Faji është kolektiv. Nuk mundet individi ta marrë vetë pushkën dhe të gjuaj. Gjatë kohës së luftës në Bosnje, radioamatorët nga Serbia më kanë penguar. I kam lutur, ju kam thënë: – Kolegë, mos i pengoni mesazhet, këta njerëz kanë hall. Mos e dhasshtë Zoti ta keni këtë hall, sepse atëherë do të shohim se si do të veproni. Në vitin '99 i ka zënë halli dhe e kam të regjistruar në audio sa të kapë frika, grindje, fyerje, midis serbëve dhe shqiptarëve. Dua të them se ne i kemi futur trazirat, vetë populli. Ky është gabim. Vetëm të qetësohet situata sa më shpejt, populli të jetojë lirisht, fëmijët... Ka shumë njerëz të cilëve nuk iu intereson asgjë. Por, kur i zë kjo fatkeqësi... Disa ndoshta janë qeshur derisa unë kam punuar, derisa dikë nga ata nuk e ka zënë lufta. Serbët më kanë penguar, por kur i ka zënë ata lufta, janë sjellë ndryshe. Njëri nga ata, nuk dua t'ia përmendi emrin, ka thënë: – Unë do të shkoj tek Najçeta t'ia hedhë bombën në shtëpi. Por, e ka zënë edhe atë lufta, prandaj shpresoj se tani nuk mendon ashtu, tani kur e kanë dëbuar nga vatra e tij. Është larguar nga Kosova, ka mbetur pa banesë, pa orëndi, fëmijët në rrugë. Njeriu i plogësht nuk do të besojë se çfarë ndodh përreth pa i ndodhur atij vetë.

E kujt është përgjegjësia dhe a ndihesh përgjegjës për tërë këtë që na ka ndodhur në Maqedoni? A ka diçka që çdokush ka mundur ta bëjë?

Nuk është çdokush fajtor. Fajtorët më të mëdhenj duhet të mbajnë përgjegjësi, por përkrah të thatës, edhe e njoma ndezet. Unë për shembull nuk ndihem përgjegjës për luftën sepse nuk kam kontribuar që ajo të nisë, ndërsa kam punuar. E kam dhënë një pjesë të jetës që të bëj mirë.

G. P. Z.

Çdo komb e ka nacionalizmin e vet

A i ndien ende pasojat, katër vjet pas vitit 2001?

Sigurisht që pasojat ndihen. Akoma ka frikë edhe tek fëmijët, edhe tek populli në përgjithësi. Konflikti si konflikt, siç thotë ajo thënia e vjetër: që të vijë deri tek konflikti duhet të grinden dy palë, ndërsa sot grindjet ndodhin për çdo ditë, në secilin hap. Kjo është arsyeja më e madhe e cila çon deri te konflikti. Gjithashtu papunësia, pastaj situata e vështirë materiale. Ata që nuk kanë, sigurisht që nuk mund të jenë të kënaqur. Konflikti është një dukuri e gjerë, por ajo që është më e dhimbshme është se pasojat e luftës i hasim edhe sot. Mendoj se për këtë duhet të mendohet më me seriozitet, sepse kjo mund të përcillet nga brezi në brez. Të rinjtë janë tejet të helmuar me nacionalizëm dhe çdo komb ka nacionalizmin e vet.

Po si mund të ndryshohet kjo? Çfarë duhet të ndodhë që të ndryshojë diçka?

E para dhe themeloria ka të bëjë me prindërit. Ata, për shembull, do të duhej të kujdeseshin më shumë se çka flitet në shtëpi. Ne edhe më parë kemi pasur luftëra, por nga prindërit nuk kemi dëgjuar diçka keq për të tjerët, në aspektin që një komb është i këtillë apo i atillë – diçka keq. Kurse tani, situata është e kundërt dhe prindërit duhet të kenë kujdes, posaçërisht nëse flasin për luftën që na ka ndodhur gjatë viteve 2000–2001. Nuk duhet të flasin, siç ndodh, se lufta ka ndodhur për shkak të shqiptarëve apo për shkak të komandantëve të ndryshëm shqiptarë. Për çdo ditë, edhe në gazeta, edhe në revista, shkruhet kështu ose për ngjarje të ndryshme të cilat na ndodhin, pastaj Kondova, Radusha apo nuk di se çfarë tjetër. Ato ngjarje duhen të zgjidhen më me seriozitet, të kuptohen gjërat, të thirren ata që i bëjnë këto gjëra, të ulen në tryezë dhe në katër sy të flasin për atë se çka i mungon kujt dhe çka i duhet dhe më duket se këto probleme do të mund të zgjidheshin në një mënyrë më të bukur, përmes dialogut, përmes diskutimit.

Si ka ndikuar në ty personalisht fillimi i luftës?

Fillimi i luftës më është dukur si loja e fëmijëve “kamaj”. Por më vonë dikush e ka tepruar, në mënyrë që dikush tjetër edhe sot e kësaj dite të ndiejë dhimbje, sepse t’ia japësh dikujt djalnë në zemër të uritur (për asgjë) nuk është lehtë. Për këtë arsye, edhe ata që janë lartë, pra politikanët, duhet të mendojnë pak për këtë çështje.

A ka pasur viteve të fundit situata që të kanë lënduar? Si i shikon sot këto, a të ka kërkuar dikush falje?

Për pyetje të tilla nuk di çfarë të të them. Në kohën e sotme, në çdo hap mund dikush të të ofendojë, por duhet të dallohet ofendimi prej ofendimit. A ka qenë ai i qëllimshëm, ndoshta nuk ka qenë, duhet të bëhet dallimi i kësaj. Megjithatë, me dialog mund të zgjidhen mosmarrëveshjet. Aty ku unë punoj, personalisht nuk kam pasur mosmarrëveshje të mëdha, përveç kur janë hequr paralelet në gjuhën shqipe. Kjo ka ndodhur gjatë pushtetit të partisë VMRO-DPMNE. Na ka ardhur drejtoresha e re dhe unë e kam lutur si motrën: mos – sepse vazhdimësia e paraleleve duhet të mbahet dhe mos impono, siç thuhet, në terrenin e huaj diçka që

Konflikti është një dukuri e gjerë, por ajo që është më e dhimbshme është se pasojat e luftës i hasim edhe sot. Mendoj se për këtë duhet të mendohet më me seriozitet, sepse kjo mund të përcillet nga brezi në brez. Të rinjtë janë tejet të helmuar me nacionalizëm dhe çdo komb ka nacionalizmin e vet.

është shumë e dhimbshme në kohën e sotme. Por ajo nuk më ka dëgjuar dhe edhe sot e kësaj dite në shkollë, nëse jo për çdo ditë, atëherë çdo të tretën apo të katërtën duhet të ndodhë diçka, ose mosmarrëveshje ndërmjet fëmijëve ose, përsëri, ndërmjet personelit teknik, profesorëve. Këto probleme duhet të zgjidhen, por kjo ecën ngadalë. Situata tani është e tillë.

Po profesorët, gjegjësisht ti personalisht, a ndërmerrni ndonjë gjë në këtë drejtim që situata të ndryshojë?

Është kthyer drejtori i vjetër (sh.im maqedon). Unë kam qenë përgjegjës për paralelet shqiptare 12-13 vjet dhe kurrë nuk kemi pasur mosmarrëveshje, por pasojat e luftës akoma ndihen dhe kjo nuk mund të rregullohet menjëherë. Ka fëmijë që kanë humbur gjatë luftës një të afërm dhe akoma ndiejnë dhimbje.

Gjithmonë kur shoh se ekziston mosmarrëveshje ndërmjet nxënësve të dy palëve, ndërmjet maqedonëve dhe shqiptarëve sepse është shkollë e përzier, menjëherë i thërras në kabinetin tim dhe i uli tensionet. Pse të grinden, dhe i bëj detyrimisht t'i jepet dora atij që ka gabuar, menjëherë në vendngjarje. Nuk i lejoj të dalin derisa të pajtohen dhe nuk guxon të përsëritet më gabimi.

Siç e thashë, për zgjidhjen e këtyre problemeve duhet të organizohen koncerte të ndryshme, lojëra sportive, kampe të ndryshme, ekskursione. Edhe ky kampi veror është një nga mënyrat. Për mua ai është diçka i mrekullueshëm, diçka që njeriu nuk mund ta paramendojë. Kemi ardhur këtu nga qytete të ndryshme, duke nisur nga Kumanova, Shkupi, Tetova, pastaj këtu janë të përfshirë nxënësit e të gjithë nacionaliteteve që jetojnë në këtë shtet, në shtetin tonë, ata shoqërohen, mund të shkëmbejnë mendime të ndryshme. Kjo është për mua shumë e rëndësishme, që në këtë mënyrë zgjidhen këto probleme – vendore, siç thuhet. Vetëm përmes kësaj qasjeje mendoj se zgjidhjet e të gjitha problemeve që kemi në shkollë do të ecin shumë, shumë më mirë.

Çka paraqet pajtimi për ty?

Po pajtimi, dihet edhe nga ajo çfarë thotë vetë Bibla: “Mos gënje, mos vjedh, mos vrit”. Dhe secili njeri, i cili ka ardhur në këtë botë, ka ardhur që të mbijetojë, të zhvillohet dhe në fund, dihet, çdokush do të vdesë. Për këtë mendoj se duhet të qetësohen gjakrat dhe të jetojmë normalisht, çdokush të jetojë në mënyrë normale.

Në çfarë mënyre do të realizohej kjo? Çfarë përbën parakusht për pajtim? Çfarë duhet bërë që të arrihet pajtimi?

Duhet të kuptohen të gjithë njësoj. Të mos ketë ndarje në bazë nacionale. Mendoj se çdokush është diçka për vete. Nuk ka nevojë të ndahemi, unë tash jam shqiptar, ti maqedon, turk, rom, serb apo diçka tjetër. Të gjithë që jemi në këtë shoqëri duhet ta kemi të përbashkët bashkimin. Në çdo vend duhet të bëhet diçka. Mendoj, nëse unë tani punoj në shkollë ku janë të përfshira të gjitha kombësitë, për mendimin tim, fëmijët duhet të jenë të përfshirë në projekte të ndryshme, ekskursione të ndryshme, lojëra të ndryshme sportive, të shoqërohen. Kjo do të mundësojë që të harrohen gjërat e këqija, që të mos flitet se ky është i tillë, ai është i atillë. Mund të bëhen shumë lehtë dhe shumë, shumë, iks gjëra që të arrihet pajtimi.

Kush do të duhej ta bëjë këtë?

Po dihet, kjo mund të bëhet që nga ministria deri tek personeli teknik, që nga ministri i arsimit deri tek personeli teknik i shkollës në të cilën punoj, që të gjithë të jenë të angazhuar.

Çfarë mendon, çfarë mund ta pengojë procesin e pajtimit? A ke ndonjë frikë lidhur me këtë proces?

Në vend të parë unë do ta kisha vënë prindin sepse ai luan rolin kryesor në edukimin e fëmijës, kurse fëmija nëse është i edukuar mund t'i kuptojë në kohë të duhur dhe shumë lehtë gjërat dhe të sillet sikur e din së paku kodeksin e sjelljes dhe të sillet si nxënës.

A e përjeton tani Maqedoninë si mjedis ku mund t'i realizosh të drejtat tuaja?

Tani, sipas ligjit të ri dhe me implementimin e Marrëveshjes së Ohrit mendoj se gjithçka ecën normalisht, edhe pse ka shumë punë për t'u bërë. Të shmangen pasojat e luftës, edhe pse mendoj se shumëçka ka ndryshuar, pozitivisht, ekzistojnë ndryshime të mëdha dhe ndihem i barabartë me të gjithë popujt tjerë që jetojnë në Maqedoni. Për shembull, ndryshimet në shkollë dhe në punësim evidente janë. Gati në çdo fushë ka ndryshime.

Cili është qëndrimi yt për çelësin e 20% të punësimit në institucionet shtetërore?

Mendoj se është realizuar ajo për çka janë marrë vesh me Marrëveshjen e Ohrit. Mendoj se po realizohet normalisht dhe se nuk ka probleme në atë aspekt.

Por është shfaqur revoltë nga pala jo-shqiptare? A mendon se një rregullativë e tillë i kontribuon pajtimit në Maqedoni?

Populli thotë: Dielli nuk mund t'i nxejë të gjithë, ashtu edhe Marrëveshja e Ohrit. Nga ky aspekt thuhet që shqiptarët kanë fituar tani më shumë seç duhet dhe se kanë privilegje të shumta në aspektin e punësimit. Pala tjetër, patjetër që do të jetë e mërzitur në atë pikëpamje dhe do të ketë shumë vërejtje lidhur me këtë çështje, por duhet të respektohen numrat dhe ajo që quhet 20% e punësimit nga pala e shqiptarëve. Sikur kjo do të ishte zgjidhur si duhet me kohë, as që do të kishte ndodhur lufta.

A e dëshirojnë pajtimin njerëzit në Maqedoni?

Po, sipas mendimit tim, nga të dy palët ka shumë njerëz me të cilët kam biseduar dhe që mendojnë se do të duhej dhe duhet të ketë pajtim.

A duhet të kërkohet falje?

Që të pajtohet dikush me dikë duhet të kërkojë gjithmonë falje. Edhe në gjatë jetës së përditshme mund të gabojmë dhe nuk ka njeri, nuk ka person i cili është ideal dhe çdokush mund të gabojë dhe për çdo gabim duhet të kërkohet falje.

Kush duhet kujt t'i kërkojë falje?

Së pari ai që ka gabuar, ai që ka ofenduar dikë: "Më fal të lutem, nuk kam pasur qëllim të të ofendoj".

Çka mund të bëjnë "njerëzit e zakonshëm" në këtë fushë? Si do ta ndihmoje ti, për shembull, procesin e pajtimit?

Po tani, nëse ka persona kokëfortë rreth pajtimit, atëherë duhet gjetur personi i tretë i cili mund të flasë me të dy palët dhe duhet të arrihet pajtimi. Njëra palë duhet të lëshojë pe që të pajtohen.

Cilat dhe çfarë ndryshimesh do të ndodhnin atëherë për Maqedoninë sipas teje?

Populli nuk do të jetojë në frikë për shkak se sot jo vetëm në Shkup, por në çdo

qytet ka ngjarje të ndryshme, vrasje të ndryshme, keqtrajtime të ndryshme, rrëmbime të ndryshme, kështu që njeriu do të jetë i liriuar nga këto tensione.

Para do kohe është miratuar ligji për flamujt rreth të cilit ka pasur mjaft polemika. Sa mund t'i kontribuojë, sipas teje, një ligj i tillë pajtimit në Maqedoni?

Mendoj se flamuri është simbol i çdo populli në këtë rruzull tokësor. Nuk do ta kisha arsyetuar apo sulmuar dikë që mbron identitetin e vet. Nuk ka nevojë që të kemi flamur të ri, në një flamur të vihen të gjitha kombësitë dhe të vendosen në çdo cep të flamurit të huaj. Atëherë do të formohej ajo që në mënyrë patriarkale quhet bajrak cikërrimesh.

Çfarë është ajo që mund të bëjë popullit të cilit i takon ti për arritjen e pajtimit në Maqedoni?

Unë jam shqiptar dhe do të flisja me maqedonët dhe me të gjithë popujt tjerë që jetojnë në Maqedoni që të ulen në një tryezë të përbashkët, të bëjnë një marrëveshje të përbashkët, të themi që të pajtohen, t'i zgjasë dorën çdokush çdokujt. Me diçka të tillë mund të shkohet në Evropë.

Si duhet të sillemi ndaj të gjithë asaj që ka ndodhur? A duhet të harrohet ajo?

Shumë individë do të shkruajnë për të kaluarën, secili për popullin e vet do ta shkruaj historinë. Por do të ketë censurë për publikimin e diçkaje të tillë. Sipas mendimit tim, këto shkrime nuk do të duhej të publikoheshin të paktën 20-30 vjet. Në të kundërt do të ripërtërihen këto gjakra dhe përsëri do të kthehemi në mosmarrëveshje të ndryshme dhe luftëra të ndryshme.

A duhet të harrohet ajo që ka ndodhur?

Po, detyrimisht. Ne duhet të mendojmë për fëmijët tanë. Pak më parë thashë se kjo është shumë, shumë e dhimbshme në raste të caktuara. Atëherë është shumë vështirë që të harrohet, por rrethanat janë të tilla. Kur të pajtohen të dy palët, duhet harruar këto gjëra.

Po të falet?

Po falje, tek ne shqiptarët, ka pasur mjaft. Tradita që kur vritet dikush duhet të vrasësh dikë nga pala tjetër është sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit. Kjo traditë ka ekzistuar, por ka kaluar, është harruar dhe kjo dukuri sot takohet shumë rrallë. Për këtë arsye ata edhe do të falin.

Sa i kontribuon, sipas teje, bashkësia ndërkombëtare pajtimit dhe stabilizimit të situatës në Maqedoni?

Për Zotin, sipas meje bashkësia ndërkombëtare ka ndihmuar mjaft në rregullimin e situatës kur janë grindur dy palë. Është dashur të ndihmojnë edhe në rastin e luftës që ka ndodhur tek ne. Na kanë ndihmuar mjaft edhe nga Bashkimi Evropian duke i ulur të dy palët në tryezën e bisedimeve. Mendoj se ecën kah e mira dhe se do të qetësohen gjakrat dhe se do të pajtohen, nuk ka problem.

A mendon se individi ka faj për atë çka ka ndodhur apo faji është kolektiv?

Individi nuk mund ta grind një shtet të tërë. Nëse shumica thotë se dikush përgatitet për diçka dhe se dikush është i pakënaqur, atëherë kjo duhet të parandalohet menjëherë, siç thuhet në mjekësi: Parandalo që të mos shërosh. Për këtë arsye duhet të reagohet me kohë, të shikohet se çka i duhet dikujt që të bëjë luftë dhe shumë lehtë mund të merren vesh rreth kësaj, e jo me luftë dhe humbjen e njerëzve.

A e sheh diku përgjegjësinë tënde në tërë këtë dhe cila është përgjegjësia yte si profesor në shkollë?

Po, sikur të më kishin pyetur mua se a mund ta bëjmë këtë që ta arrijmë qëllimin, unë para së gjithash do të kisha kërkuar që të bisedohej në mënyrë të rregullt me personat përgjegjës në shtet.

A ekziston në Maqedoni hapësirë që të zhvillohen identitetet e ndryshme duke mos i kërcënuar të tjerët?

Lidhur me këtë çështje unë nuk shoh se pse nuk do të kishte hapësirë për atë që është i aftë të zhvillojë identitetin e tij, me përjashtim që dikush mos t'ia imponojë ndonjë gjë, si p.sh. identiteti im është më i fortë, më i mirë apo më i zhvilluar. Nuk ka shans që dikush t'i imponojë dikujt diçka, kurse ka hapësirë për të gjithë që të zhvillohen, të jetojnë si një familje edhe pse sipas mendimit tim sot ka gjithfarë njerëzish. Edhe identiteti fetar mund të zhvillohet, vetëm qëllimet të mos përzihen dhe mos t'i imponohet dikujt që të punojë diçka në kuptimin unë jam më i miri. E thashë se në çdo Bibël thuhet: Ruaje të veten, mos e sulmo të huajen. D.m.th. zhvilloje identitetin tënd, por duke mos e fyer identitetin e huaj. Nuk ka nevojë për një gjë të tillë.

A ka mbetur, në fund, diçka që nuk të kam pyetur e që ti do të kishe pasur dëshirë ta thuash ose do të doje të jepje ndonjë porosi?

Në fund unë do të thoja se sikur të gjitha shkollat në vend të ishin të kyçura, që nga ato multietnike, si dhe të gjitha qytetet, në vend në procesin e afrimit, njohjes, shkëmbimit të mendimeve, përpunimit të problemeve të ndryshme, do të përmirësohej shumë pozita e të gjithë punonjësve në shkollë. Ndërkaq, edhe situata e fëmijëve dhe e nxënësve në përgjithësi do të përmirësohej dhe nuk do të kishte urrejtje midis nxënësve.

G. P. Z.

Si e kujtoni kohën para dhe gjatë luftës?

Më kujtohen disa gjëra para lufte, e di që kam mundur të lëvizë lirisht ku kam dashur dhe nuk ka pasur kurrfarë rreziku. Kam mbaruar klasën e parë dhe të dytë të shkollës fillore dhe më kujtohen disa shokë nga klasa, por nuk më kujtohet tamam ndonjë situatë konkrete... Më kujtohet situata gjatë luftës, pjesën më të madhe të kohës kam qenë këtu gjatë kohës së konflikteve, ndërsa pas luftës kam qenë në emigrim.

A ndien ndonjë pasojë të luftës dhe në çfarë mënyre?

Në qytetin tonë ndihen shumë pasojat e luftës për faktin se qyteti është i ndarë në dy pjesë, në pjesën kroate dhe atë boshnjake. Për shembull, shkollat fillore janë të ndara totalisht, Shtëpia e Shëndetit punon e ndarë, shkollat e mesme punojnë sipas parimit “Dy shkolla nën një kulm”, ekziston një linjë e padukshme, e cila e ndan qytetin në dy pjesë dhe kjo ndihet, kur shëtit nëpër qytet dihet saktësisht se deri ku shkohet.

Si ndihesh ti personalisht për këtë? Si jeton me këtë? A e ke pasur ndonjëherë posaçërisht vështirë? Pse?

Po, ndoshta ka qenë vështirë menjëherë pas luftës; nuk e kemi ditur nëse mund të shkojmë në pjesën tjetër të qytetit, nuk kemi pasur komunikim me njerëz nga pjesa tjetër e qytetit. Vetëm kur kanë filluar punën disa organizata, si p.sh. Qendra Rinore Vakufi i Epërm – Uskople, kemi pasur mundësi të vijmë në kontakt me njerëz nga pjesa tjetër e qytetit. Më vonë janë bashkuar edhe shkollat e mesme, kështu që kemi pasur rast për një kontakt më të madh midis nesh.

Çfarë ndryshimesh do të duhej të ndodhnin në mënyrë që të zbuteshin këto pasoja të luftës?

Unë mendoj se kjo nuk është në dorën e njerëzve të thjeshtë, por ka të bëjë më tepër me faktorin politik. Situata aktuale në qytet – nuk ka kryetar, gjithmonë qeverisin partitë nacionale, mostoleranca midis partive është gjithnjë e më e madhe dhe kjo, me siguri, ndikon në ftohjen e njerëzve nga njëri-tjetri.

Si duhet të sillemi ndaj të kaluarës?

Është fakt se ka ndodhur ajo që ka ndodhur dhe sigurisht që njerëzit që e kanë përjetuar luftën nuk do t'i harrojnë kurrë disa gjëra, por mendoj se nuk duhet “të gërmojmë” shumë në të kaluarën. Jeta vazhdon më tej dhe për këtë duhet punuar me gjeneratat e reja.

Çfarë mendon për pajtimin? Çfarë përbën për ty pajtimi?

Asociacioni i parë i fjalës “pajtim” është që njerëzit nga të dy pjesët e qytetit të jenë bashkë; të punojnë bashkë, të shoqërohen. Por prapëseprapë, kjo nuk varet nga njerëzit e thjeshtë, sepse politika ka një rol të rëndësishëm në këtë. Sado që në qytetin tonë të punohet që njerëzit të afrohen, vetëm një shkëndijë duhet që të

Në qytetin tonë ndihen shumë pasojat e luftës për faktin se qyteti është i ndarë në dy pjesë, në pjesën kroate dhe atë boshnjake. Për shembull, shkollat fillore janë të ndara totalisht, Shtëpia e Shëndetit punon e ndarë, shkollat e mesme punojnë sipas parimit “Dy shkolla nën një kulm”, ekziston një linjë e padukshme, e cila e ndan qytetin në dy pjesë dhe kjo ndihet, kur shëtit nëpër qytet dihet saktësisht se deri ku shkohet.



kthehemi në fillim. Kjo edhe ka ndodhur. Situata e tashme është e tillë që nuk kemi kryetar, administrata lokale nuk funksionon, buxheti është ngrirë.

Megjithatë, a mendon se edhe vetë njerëzit nuk punojnë mjaft, se ndoshta kanë një lloj frike nga pajtimi?

Mendoj se kjo varet nga personi tek personi tjetër. Disa njerëz kanë humbur personin e dashur në luftë, disa kanë përjetuar diçka të keqe dhe kanë trauma nga kjo. Ata e kanë të vështirë të shkojnë më tej dhe të bëjnë hapa drejt pajtimit. Mendoj se njerëzit kanë mjaft paragjykime dhe frikë, se edhe një kohë të gjatë nuk do të zhduken këto paragjykime dhe frika, sepse njerëzit që kanë përjetuar përvoja të këqija në luftë do të kenë gjithmonë frikë se ajo do të ndodhë përsëri. Paragjykimet janë krijuar gjatë luftës. Njerëzit që më parë kanë jetuar dhe kanë punuar bashkë, kurse në fund kanë luftuar njëri ndaj tjetrit, nuk mund t'i besojnë më njëri-tjetrit dhe gjithmonë do të ekzistojë frika se kjo mund të ndodhë përsëri. Paragjykimet lindin nga padituria dhe me siguri njerëzit kanë fituar informacione të gabuara duke krijuar imazh të rrejshëm për njerëzit tjerë. Mendoj se nuk është në rregull që fajin ta marrë përsipër i tërë kombi, mendoj që faji është individual. Kur ka filluar lufta, kam qenë shumë i ri që të kuptoj situatën e atëhershme, por ajo që di nga tregimet, librat, mendoj se politika është fajtorë për çdo gjë që ka ndodhur, por politika e disa njerëzve që kanë pasur dobi nga situata e tillë, edhe në luftë, edhe pas saj.

Si të arrihet pajtimi?

I vetmi opcion që ekziston për momentin është që të punohet me gjeneratat e reja rreth kësaj çështjeje. Pra, të punohet me fëmijë që nga çerdhet, shkollat fillore... që historia të mos mësohet individualisht, d.m.th. se nuk ka histori boshnjake apo kroate, të cilat në të shumtën e rasteve janë kontradiktore – të gjithë shkruajnë atë që iu përshtatet dhe fëmijët krijojnë imazh të gabuar edhe për veten, edhe për kombin tjetër... Duhet të gjendet gjuha e përbashkët!

Mendoj se njerëzit kanë mjaft paragjykime dhe frikë, se edhe një kohë të gjatë nuk do të zhduken këto paragjykime dhe frika, sepse njerëzit që kanë përjetuar përvoja të këqija në luftë do të kenë gjithmonë frikë se ajo do të ndodhë përsëri. Paragjykimet janë krijuar gjatë luftës. Njerëzit që më parë kanë jetuar dhe kanë punuar bashkë, kurse në fund kanë luftuar njëri ndaj tjetrit, nuk mund t'i besojnë më njëri-tjetrit dhe gjithmonë do të ekzistojë frika se kjo mund të ndodhë përsëri.

Çfarë mendon për çështjen e përgjegjësisë? A ekziston përgjegjësia e njerëzve “të vegjël, të thjeshtë” për çdo gjë që ka ndodhur?

Mendoj se edhe përgjegjësia është individuale. Nuk mundemi të gjithë njerëzit “e vegjël, të thjeshtë” t'i fusim në një kosh. Megjithatë mendoj se njerëzit kanë mund të bëjnë shumë më tepër duke mos pranuar atë që iu imponohet.

Kush duhet të punojë për pajtim?

Të gjithë do të duhej të punonin për pajtim. Politikanët, ndoshta, do të mund të ishin vetëm mentorë dhe t'u ndihmojnë njerëzve që kjo të arrihet. Me rëndësi është që të flitet për pajtimin. Këto janë hapa të vegjël, por mund të jenë shumë të rëndësishëm për procesin e pajtimit. Njerëzit duhet të punojnë së pari me vetveten, më pas në komunitet, dhe kështu me siguri përhapin “virusin e pajtimit”.

A kanë disa institucione më shumë fuqi dhe mundësi që të ndikojnë tek njerëzit kur flitet për pajtim?

Mendoj se ekzistojnë institucione që kanë ndikim të madh tek njerëzit. Për shembull, mediat dhe institucionet fetare kanë fuqi dhe mundësi të madhe që të ndryshojnë vetëdijen e njerëzve, por mendoj se ato nuk e duan këtë, sepse kjo situatë iu përshtatet. Në këtë situatë që ekziston ata realizojnë disa interesa të tyre personale. Nuk bëjnë shumë merak për masën.

Cila është përshtypja juaj, a duan të punojnë njerëzit për pajtim, a janë të gatshëm për këtë?

Kjo varet nga njëri person te tjetri, nuk mund ta përgjithësojmë këtë. Disa njerëz duan, disa të tjerë nuk duan. Por mendoj se këta njerëz që duan të bëjnë diçka për pajtimin duhet të provojnë të ndikojnë tek të tjerët.

Nga përvoja juaj, si reagojnë të rinjtë ndaj diskutimeve për pajtim? A bisedon ndonjëherë me miqtë tuaj për këtë, si janë qëndrimet?

Shumica e të rinjve duan të pajtohen, por përsëri faktori politik është përcaktues, ai pengon. Situata në qytet, por edhe ajo në tërë shtetin, nuk iu ofron të rinjve mundësi që të zhvillohen, që të thonë atë çfarë dëshirojnë! Fajin për këtë e ka sistemi i vjetër në shkollë, në të gjitha institucionet, që nuk iu ofron të rinjve mundësinë të thonë çfarë dëshirojnë. Sigurisht që kjo është frikë nga autoriteti, nga njerëzit që e kanë fituar në luftë fuqinë dhe kjo i frenon të rinjtë.

Cilat janë parashikimet Tuaja për të ardhmen lidhur me pajtimin? Si e sheh të ardhmen?

Pas luftës është punuar shumë në procesin e pajtimit në Vakufin e Epërm – Usko-ple, por, ndoshta, është punuar në mënyrë të gabuar, kështu që tërë kjo ka prodhuar situatën ekzistuese në qytet. Tani jemi në prag të zeros dhe do të duhej të fillonim të punojmë në procesin e pajtimit, por duke provuar disa metoda tjera, më të mira.

A. G.

Njerëzit po “e marrin veten” ngadalë edhe pse politikanët akoma “kërcënojnë me armë”

Si i kujtoni sot kohët para fillimit të luftës dhe vetë luftës? A ndieni ndonjë pasojë të luftës?

Në prag të luftës kam punuar në Austri dhe në atë kohë atje më shumë se këtu është ndier se diçka po përgatitej. Unë nuk kam besuar kurrë se diçka e tillë mund të ndodhë në këtë qytet, i cili ka qenë shumë tolerant. Njerëzit thonë se edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore ka ekzistuar tolerancë e madhe midis popujve sepse këtu jetojnë kroatët dhe boshnjakët. E përsëris, unë nuk kam mundur as të mendoj se mund të vijë deri te eskalimi i tillë i përleshjeve. Kjo luftë ka qenë njëra ndër ngjarjet më të tmerrshme në jetën time megjithëse si fëmijë e kam përjetuar edhe Luftën e Dytë Botërore dhe eksodin përmes bombardimeve. Kjo që kam kaluar për një vit i ka tejkaluar të gjitha mendimet e mia më të errëta. Populli në atë kohë filloi të ndahet, fshehurazi kalonin natën nga njëra në tjetrën anë, qyteti filloi ngadalë të copëtohej. Unë nuk e kam ndier nevojën që të shkoj diku sepse ende nuk besoja se mund të vinte deri te ajo fatkeqësi e madhe.

Si e shikoni sot procesin e pajtimit? Si mund të arrihet pajtimi dhe kush duhet të punojë për pajtimin?

Nëse këtë nuk e bën vetë populli, nuk mendoj se mund ta bëjë as Përfaqësuesi i Lartë, as bashkësia ndërkombëtare. Për fat të keq, tek ne njerëzit bëjnë punën që nuk u takon, duke filluar nga nëpunësit fetarë. Ata e shfrytëzojnë fenë që të flasin kundër popujve tjerë me qëllim që ta bashkojnë popullin e vet dhe nuk kanë interes fare që të përpiqen të takohen me popullin tjetër. Vetëm nga jashtë ekziston ballina. Unë personalisht mendoj se duhet të vijë një gjeneratë tjetër që ta ndryshojë këtë. Kjo tani më duket e vështirë sepse të rinjtë nuk e dinë se si ne kemi jetuar dikur. Ata kanë lindur në luftë dhe mund të dëgjojnë vetëm nga prindërit e tyre se si ka qenë dikur, ta pranojnë këtë apo jo. Sa i përket kësaj jam pesimist sepse më duket se të rinjtë e shohin kuptimin vetëm në shëtitje dhe ekziston vetëm një pjesë e vogël që dëshiron të punojë në mënyrë aktive për ndryshime, që p.sh. të merren me politikë, kurse sot të rinjtë nuk duan as të dalin në votime. Mendoj se shpëtimi i vetëm është që të rinjtë të aktivizohen, të përpiqen të bëjnë diçka, sepse në qoftë se nuk i ndihmojnë vetë vetes, askush tjetër nuk do t'i ndihmojë.

Çfarë është ajo që do të mund të bënin “njerëzit e thjeshtë”?

Nuk ka ndonjë zgjidhje të madhe. Ne jemi vend në tranzicion, shteti i ka marrë të gjitha nga punëtorët, i ka shitur fabrikat, punëtorët i ka larguar. Kjo periudhë duhet të kalojë në mënyrë që disa gjëra të rivendosen. Nuk e di se çfarë do të mund të bënte njeriu i vogël përveç që të rinjtë të aktivizohen, në qoftë se duhet edhe përmes politikës, të dalin në skenë dhe të provojnë të bëjnë diçka. Ka pasur mjaft përpjekje të organizatave joqeveritare, por pushtetet komunale nuk i përcjellin këto gjëra. Të rinjtë duhet të hyjnë në politikë, t'i gjejnë ato parti që nuk janë nacionaliste dhe që janë për atë që ky shtet të mbetet multi-etnik. Të rinjtë ikin nga politika sepse lojërat e ndryshme politike që janë në fuqi i largojnë nga ajo. Unë derisa nuk jam

Njerëzve iu është thënë se duhet të frikohen njëri nga tjetri – njërit se duhet të frikohet nga njëfarë xhamahirie, ndërsa tjetrit nga njëfarë shteti ustash.



bërë këshilltar komunal nuk e kam ditur se çfarë është pala K dhe B, ndërsa sot e di se kjo është diçka shumë e rëndësishme – K janë kroatët, B janë boshnjakët dhe të gjithë tubohen rreth të vetëve. Duhet kërkuar dhe mbështetur organizatat dhe partitë për të cilat kjo nuk ka rëndësi.

A mendoni se kjo është e mundur? A ekzistojnë njerëz të interesuar për diçka të tillë? A janë njerëzit të interesuar të punojnë për arritjen e pajtimit?

Ky është problem dhe kjo është ajo që më brengos. Unë jam anëtar i PSD-së dhe në partinë tonë ka anëtarë të të gjitha nacionaliteteve. Tani e shoh që kështu është edhe në partitë tjera, por këto parti kanë nxitur luftën, e kanë drejtuar atë dhe çdo njeri i nacionalitetit tjetër që vjen në një parti nacionale është aty për shkak të ndonjë interesi. Të rinjtë me siguri nuk shohin asnjë interes në politikë dhe ne nuk kemi mënyrë si t'i tërheqim. E gjithë kjo që them përmbledhet përsëri në politikë. Më brengos edhe fakti që nuk ka ekonomi për të rinjtë. Unë si njeri ndihem i papërgatitur, nuk kam zgjidhje dhe kjo është ajo që më brengos. Mjaft nga kjo është çështje politike, njerëzit tregojnë që janë të gatshëm – vijnë në treg, shoqërohen aq sa është e mundur. Punët i bashkojnë njerëzit. Ekonomia do të ndihmonte procesin e pajtimit, por duhet që kjo të përgatitet.

A mendoni se ekziston ndonjë frikë tek njerëzit kur bëhet fjalë për pajtimin?

Lufta është e keqe e madhe, ka shumë viktima, por mendoj se të dy popujt janë mashtruar dhe edhe sot e kësaj dite është pak a shumë ngjashëm. Njerëzve iu është thënë se duhet të frikohen njëri nga tjetri – njërit se duhet të frikohet nga njëfarë xhamahirie, ndërsa tjetrit nga njëfarë shteti ustash. Ne kemi arritur që në një projekt (handboll) t'i bashkojmë fëmijët edhe të kombësisë kroate, edhe të asaj boshnjake. Ata janë shoqëruar, u janë gëzuar së bashku fitoreve, janë përqafuar. Ndërkohë fëmijët kroatë kanë filluar menjëherë të mos vijnë dhe këdo që e kam pyetur se pse, askush nuk më ka dhënë përgjigje. A iu është kërcënuar dikush apo ndonjë-

ri nga ata si udhëheqës i ka tërhequr të tjerët? Më vonë, pas njëfarë kohe kanë ardhur përsëri dhe na janë bashkuar. Nuk ka asgjë të keqe në mesin e këtyre fëmijëve. Pra, ndoshta diçka e tillë do të mund të jepte rezultate, por do të duhej të punohej në mënyrë më masovike, kurse për këtë, për fat të keq, nuk kemi kushte.

Cili është mendimi Juaj rreth asaj se si duhet të sillemi ndaj të kaluarës? Si t'ua transmetojmë atë gjeneratave të reja?

Duhet të themi të vërtetën, kurse fëmijët le ta vlerësojnë se çfarë është e drejtë dhe çfarë jo. Megjithatë kjo është shumë e vështirë, sidomos me këto programe shkollore që ekzistojnë. Duhet të punohet sipas programit të përbashkët, të mësohet një histori – Bosnja është një dhe duhet të ketë një histori. Nuk mund ta fshijmë atë që ka ndodhur, unë nuk jam për këtë. Duhet mbajtur mend, nuk duhet harruar, por duhet edhe të falim, sepse një pjesë e njerëzve ka qenë e mashtruar. Unë kam rast të bisedoj me shumë njerëz dhe e vërej këtë. Për fat të keq edhe struktura e banorëve është ndryshuar dhe kjo paraqet një problem. Popullata rurale ka ardhur në qytet. Ata edhe në të kaluarën kanë jetuar disi të ndarë – fshatrat kanë qenë me shumicë ose boshnjake, ose kroate, kështu që ata e kanë tani njëjtë se kë kanë fqinj dhe iu përshtatet kjo situatë. Kjo është diçka që e komplikon çështjen edhe më tepër. Nuk shoh ndonjë rrugëzgjdhje të shpejtë. Kjo duhet të “shkrihet” ngadalë, me durim. Nuk ka shumë dobi as nga organizatat ndërkombëtare. I deleguari i Përfaqësuesit të Lartë që ka qenë këtu tek ne ka shprehur dëshirën që vetëm të mos çojë ndonjë “valë”, që të jetë qetë. Ai rri ulur, e merr pagën dhe nuk ka probleme.

Si e shihni të ardhmen? Cilat janë parashikimet Tuaja lidhur me pajtimin në të ardhmen?

Mendoj se njerëzit po “e marrin veten” ngadalë edhe pse disa politikanë akoma “kërcënojnë me armë”. Njerëzit po e shohin ngadalë se janë të mashtruar. Unë megjithatë pres që kjo duhet të fillojë një herë të lëvizë nga e mira. Vetëm se është për të ardhur keq që është dashur së pari të prekim fundin dhe të provojmë se si është atje, dhe tek atëherë kur të fillojmë të ngjitemi do të shohim se sa mirë është lartë. Ne jemi afër fundit, posaçërisht në qytetin tonë. Unë nuk e di se si njerëzit jetojnë në fakt. Mua më kujtohet pas asaj lufte të gjithë kemi filluar të ndërtojmë falas duke i ndihmuar njëri-tjetri. Ndërsa tani, pas kësaj lufte, më duket se të gjithë presin diçka gati, nuk ka aksione të përbashkëta. Kjo më çudit, sepse ne kemi qenë të gëzuar kur kemi ndërtuar diçka të re. Një mikja ime ka thënë “Ata kaq lehtë shkatërrojnë të gjithë atë që ne e kemi ndërtuar me aq mund dhe jemi gëzuar kur e kemi ndërtuar”. Ndoshta edhe tani do të duhej të zhvilloheshin disa aksione të mëdha me të rinjtë. Por politika aktuale nuk ka interes për këtë. Domethënë, na duhen njerëz të aftë në politikë, ata duhet t'i zgjedhim.

A. G.

A mund të prezantohesh shkurt?

Quhem Tamara, jam 23 vjeçe, studioj fizikën në Beograd dhe jam nga Sombori.

Çfarë kujtimesh ke nga lufta që është zhvilluar në vitet '90?

Mua nuk më kujtohet se ajo ka ndryshuar diçka në jetën time të përditshme, përveç që nuk kam guxuar të shikoj Ditarin (emisionin e lajmeve), pasi që kanë qenë disa skena të vrazhda dhe e di se përherë më kanë dëbuar nga dhoma. Po ashtu mbaj mend një familje, e cila ka qenë e vendosur tek fqinjët – ku kam luajtur me fëmijët e tyre.

Ndërsa nga kjo distancë prej 15 vitesh, si të duket ajo? A ke tani asociacione dhe pamje tjera për atë luftë seç ke pasur atëherë?

Po, është ndryshe, e përjetoj më vështirë. Atëherë kjo nuk më ka interesuar, kurse tani kam shumë pamje të tilla, tani gjërat e tilla imponohen. Imponohen të gjitha ato krime, thuajse shoqëria serbe duhet të hyjë në fazën e pranimit. Në media prezantohen dhe, natyrisht, kjo më prekë, sepse unë shoh se atje ka ndodhur diçka e tmerrshme.

Kur thuhet “ballafaqim me të kaluarën”, ç’është kjo për ty, si e sheh ti këtë? Pavarësisht se si paraqitet kjo në media, ç’është kjo për ty personalisht? Si do ta definoje ti atë?

Unë do të thoja se ky është një pranim dhe njohje... Thjesht, një shikim në atë se kanë ndodhur shumë gjëra dhe të pranojmë se në luftë askush s’ka bërë punë të mira, pra as populli im, as popujt tjerë.

Si e sheh aktualisht këtë ballafaqim, si nevojë – për një shoqëri, për një komb, apo si detyrim, i cili është imponuar për disa arsye ose për ndonjë shkak tjetër?

Unë mendoj se kjo është nevojë e shoqërisë. Për të qenë një shoqëri e shëndoshë, për të ecur më tej, është e nevojshme që ta pranojmë vetë tërë këtë. Nga ana tjetër, kam bindjen se, kjo po shpejtohet, se po na imponohet nga bashkësia ndërkombëtare, nga Evropa dhe se ata po na shtynjë pak, nën moton “ejani, pranojeni këtë, për të vazhduar më tutje”. Kështu më duket se kjo nuk shkon spontanisht, sikur në Serbi ekziston një grusht njerëzish që e kanë të qartë gjithë këtë dhe që nervozohen për shkak se shumica e fshehin këtë nën tepih, duke thënë se nuk ka ndodhur asgjë.

A është kjo punë e mirë apo e keqe që dikush e “shtyn”? Sikur mos ta shtynte askush, a do të vinte vetvetiu?

Mendoj se kjo do të vinte shumë vështirë vetvetiu. Në çdo rast, është mirë që dikush e shtyn, është mirë që dikush e potencon, por më duket se ekziston rezistencë në popull për diçka të tillë.

Për shkak se dikush e potencon këtë apo...

Tani disi më duket se ka mjaft prindër të cilët i kanë nxitur fëmijët e tyre kundër popujve tjerë – si “ky është kroat, ky është musliman – ata nuk janë të mirë”. Para disa ditësh vogëlushët para pallatit tim, kanë nga 11 vjet, luanin poshtë, dhe njëri nga ata tha “vraje, preje, se kroati nuk ekziston”. Ai ka vetëm 11 vjet dhe nuk e di se kush janë kroatët. Ndoshta ai vocërraku që rri pranë tij është kroat!

Për shkak se dikush e potencon, nga jashtë. Nuk ka thënë Toma Nikoliqi “ejani ta pranojmë”, por këtë e thonë properëndimorët, kështu që ky është tani problem.

E sikur të mos ishin këta “perëndimorët”, kush do të ishte ai që do ta lëvizte procesin e ballafaqimit? Kush duhet ta inicojë, ta drejtojë dhe të jetë bartës i këtij procesi?

Nuk e di. Tani tek ne këto i inicojnë dhe i potencojnë organizatat joqeveritare, të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Më duket disi logjike që, edhe sikur të mos kishte ndonjë ndikim nga jashtë, këta njerëz të cilët merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut ta shtyjnë këtë proces...

Po cili është roli i shtetit në tërë këtë? A kanë përgjegjësi vetëm organizatat joqeveritare?

Jo, unë them që ata do të duhej ta bëjnë këtë dhe të jetë ok ajo çka bëjnë. Ndërsa tani, do të ishte e natyrshme që këtë ta bënte edhe shteti, por këta politikanët tanë nuk e kanë ende të qartë se çfarë do të duhej të bëjnë, kështu që merren, si të them, me punë tjera, e jo me ato që duhet. Nuk do të mund të mbështetesh tek ata sa i përket kësaj.

Po ku janë individët, qytetari, qytetarja, si individë në shoqëri? A duhet të marrë pjesë individ në këtë proces dhe si?

Mendoj se individ, duhet të jetë, thjesht, i vetëdijshëm për tërë atë që ka ndodhur dhe të ketë simpati, të ndiejë ngushëllim ndaj atyre njerëzve të pafat që iu ka ndodhur lufta dhe të ndiejnë ngushëllim ndaj njerëzve që po iu ndodh tash lufta, jo këtu, por në vende tjera të botës. Thjesht, të nxiten disa ndjenja njerëzore në popull pasi që mendoj se kjo ndjenjë tani ka humbur, se njerëzit momentalisht janë egoistë.

Si të vetëdijësohet individ atëherë?

Uh! Nuk e di. Mendoj se kjo bëhet përmes edukatës, se kjo “fitohet” nga familja. Mendoj se kjo mund të mësohet pak edhe në shkollë, në orët e historisë, të flitet shumë më tepër për këto gjëra.

Mirë, ky është njëfarë procesi i formimit të brezave dhe shoqërisë së ardhme, por në ç’mënyrë mund të zhvillohet empatia tek njerëzit, në këtë moment, në shoqërinë e sotme?

Mendoj se kjo është e vështirë tek njerëzit e moshuar.

Mendon, aty jemi – ku jemi?

Po. Ndoshta ata njerëz që kanë qenë në betejë dhe që e kanë parë me sytë e tyre... Ndoshta ata që kanë jetuar atje, të cilëve u ka ndodhur lufta, mendoj se kanë shumë më tepër ndjenja për këtë. Ndërkaq ata që kanë shkuar prej këtu si vullnetarë, të plaçkisin, më kupton, të pasurohen, mendoj se për njerëz të tillë nuk ia vlen të flitet. Ndërsa ata që janë ulur këtu dhe kanë shikuar televizorin... Thjesht, nuk më shkon ndërmend se si mund të ndikojë tek ata. Nëse edhe më tej vazhdojnë të rrinë para televizorit, përmes tij do t’ua dërgojnë disa mesazhe.

Po ai procesi i ballafaqimit me të kaluarën, ashtu siç ecen sot, a mendon se ecen siç duhet apo mendon se do të duhej të dukej disi ndryshe? Pa marrë parasysh se kush e shtyn dhe e shpejton, e vë në lëvizje dhe për ç’arsye ndodhë kjo. Si do të duhej të duket, sipas teje, ky proces? Në cilat nivele duhet të ndodhë?

Nuk e di.

A mendon se kështu siç po rrjedhë sot do të sjellë ndonjë rezultat?

Kështu siç vazhdon sot, më duket se njerëzit do të marrin vesh se çka ka ndodhur, por mendoj se këto gjëra nuk do t'i pranojnë si “po me të vërtetë ka ndodhur, besoj se ka ndodhur”, por më shumë do të thonë “ti vetëm fol, i merr era”.

A mendon se nuk do të besojnë se kjo ka ndodhur?

Po. Për shkak se tash kam pasur rast të bisedoj me një vajzë e cila studion drejtësinë. Ajo interesohet për historinë serbe dhe për këto luftëra. Ajo, ta zëmë, pohon, e këtë e kam dëgjuar edhe në media, se nuk kanë qenë aq njerëz sa flitet dhe se, përgjithësisht, nuk kanë qenë ata banorë, por se ka qenë njëfarë shpërnguljeje, njëfarë tregëtie ndërmjet politikanëve, a kupton, dhe se kjo nuk ka ndodhur ashtu siç thotë Natasha Kandiçi.

A e zvogëlon kjo atëherë peshën e krimit?

Nuk mendoj se e zvogëlon peshën e krimit. Mendoj se edhe një njeri është shumë e jo më mijëra për të cilët flitet.

Po kur thuhet “pajtim”? Çfarë është për ty pajtimi në kontekstin e marrëdhënieve të sotme?

Pranimi i fakteve dhe falja. Nëse ke qenë personalisht i prekur nga lufta, kurrë nuk mund të falësh, kjo është e natyrshme.

A mendon se nuk duhet falur?

Nuk them se nuk duhet falur – duhet. Sidomos nëse nuk ke asnjë ndikim në rrjedhën e gjërave. Thjesht, mendoj se nuk duhet prishur jetën dhe të nervozohesh kur nuk mund të ndikosh. Duhet vazhduar të jetosh, këtë desha të them. Nuk ia vlen gjithmonë të hidhërohesh.

Po raporti: harro – fal?

Nuk duhet harruar, duhet mbajtur mend, por duhet të falësh, në kuptimin që nuk duhet të ekzistojnë armiqësi ndërmjet popujve.

A vëren se në shoqërinë tonë ecen procesi i pajtimit?

Tek unë arrijnë mesazhe kontradiktore. Edhe në mjedisin tim ekzistojnë njerëz që thonë “ejani të shkojmë në Kroaci në det”, ndërsa të tjerët thonë “nënë e tyre, kurrë nuk dua të shkoj”, dhe përafërsisht “çfarë duan ata tek ne, ejani t'i rrahim”. Thjesht, nuk mund të vlerësoj se nga cila palë ka më shumë, nga ata që e kanë ok, hajde të qetësojmë, apo nga ata që edhe më tutje hidhërohen.

Po kush duhet ta udhëheqë procesin e pajtimit, ta iniciojë dhe ta drejtojë atë?

Këtë rol e ka në fakt shteti. Fakti që Mesiçi vjen pak te ne, kurse Koshtunica në Zagreb, mendoj se është në rregull. Hajde t'i ulim pak armët.

Kjo është në nivel shtetëror...

Si ta them, nëse kjo fillon tani në nivel shtetëror, supozoj se do të jetë... Në të vërtetë, për individë, për njerëz... Do të duhet pak më shumë kohë. Unë e njoh njeriun i cili as sot nuk guxon të shkojë në Kroaci, sepse ndodhet në njëfarë liste. Edhe sikur të guxonte, dyshoj se do të kishte shkuar. Sa u përket atyre listave – do të kalojnë njëzet vjet para se të bëhet diçka me to ose të harrohen.

A mendon se më parë do të vijë deri tek pajtimi dhe vendosja e disa marrëdhënieve në nivelin shtetëror, kurse njerëzit e thjeshtë do ta pranojnë këtë më ngadalë?

Ka njerëz që kanë gjetur sërish miq dhe që tani e vizitojnë njëri-tjetrin, por nuk shoh shumë sosh në rrethin tim. Kjo nuk do të thotë se nuk ka, por unë thjesht nuk i shoh.

Çka është e nevojshme të bëhet që të arrihet pajtimi i plotë? Cilat janë pengesat që i frenojnë palët e dikurshme ndërluftuese që të pajtohen dhe të vendosin marrëdhënie?

Së pari, më duket se shoqëria jonë është tepër kaotike që të mund të ndërhyhet momentalisht. Mendoj se situata që është sot tek ne, nuk mund të ndryshohet më. Mendoj se kjo duhet bërë ngadalë përmes arsimit. Të fillohet që nga fëmijëria dhe mendoj se duhet të kalojë kohë e gjatë që kjo të harrohet... Jo të harrohet, por mos të hetohet kjo urretje dhe kjo jotolerancë. Tani disi më duket se ka mjaft prindër të cilët i kanë nxitur fëmijët e tyre kundër popujve tjerë – si “ky është kroat, ky është musliman – ata nuk janë të mirë”. Para disa ditësh vogëlushët para pallatit tim, kanë nga 11 vjet, luanin poshtë, dhe njëri nga ata tha “vraje, preje, se kroati nuk ekziston”. Ai ka vetëm 11 vjet dhe nuk e di se kush janë kroatët. Ndoshta ai vocërraku që rri pranë tij është kroat!

A mendon ti atëherë se të rinjtë duhet të jenë bartës të procesit të pajtimit?

Po, mendoj se për këta të vjetrit nuk ka shpresë.

Pse mendon ashtu?

Sepse më duket se ajo gjenerata e mesme, e cila ka marrë pjesë në këto luftëra, ka përjetuar shumë ngjarje dhe nuk mund të falë.

A mendon se ti personalisht mund të bësh diçka?

Nuk e di.

Si e sheh rolin tënd?

Unë mundem vetëm me njerëzit me të cilët takohem dhe shoqërohem. Kur të vërej se kanë qëndrime të padurueshme, t'i ndaloj pak, t'ju them “hej, a e dëgjon veten se çfarë thua?!” , por nuk jam e sigurt se do të më dëgjonin.

Si i parashikon, në një të ardhme të afërt apo të largët, marrëdhëniet në territorin e ish shtetit, në kuptimin e kontakteve ndërkufitare të të ashtuquajturve njerëz “të thjeshtë”, por edhe nivelin “e lartë”? Cila është e ardhmja jonë?

Unë mendoj se ky bashkëpunim ka filluar, pasi që jemi fqinj. Ja, veç kanë filluar ekskursionet në Sarajevë. Mendoj se do të ketë kontakte, udhëtime etj., por në fillim do të jetë e vështirë. Do të jetë në stilin “hajde, ejani ju tek ne, kjo është tamam bukur”. Por, edhe më tej derisa të jesh në ekskursion në Zagreb do të ndiesh njëfarë pasigurie, a do ta marrë kush vesh se nga je, a do të fyej dikush. Mendoj se duhet të kalojë një kohë që kjo të bëhet lirshëm. Ta zëmë, unë do të kisha frikë tani të udhëtoj në Kroaci.

Pse?

Po, ku ta di! Sikur unë të isha nga Kroacia, vështirë se do të vija në Beograd gjatë kohës së derbit. Kurrë nuk e din se në çfarë budallenjsh mund të takosh. Po të shkoja në Nju Jork, edhe atje mund të takoj me siguri ndonjë budalla që do të më

rrihte pa asnjë shkak, ndërsa këtu njerëzit ndiejnë se kanë shkak. Do të kisha frikë. Në Bosnje, ndoshta, jo aq.

Ta përmbledhim bisedën: kush duhet ta barttë barrën më të madhe të këtij pajtimi dhe ballafaqimi me të kaluarën ?

Kush duhet ta barttë?

Po, ta barttë dhe ta paraqesë...

Mendoj se këto organizatat joqeveritare të cilat ngacmojnë duhet të vazhdojnë t'i nxisin dhe t'i shtyjnë politikanët që të flasin për këtë dhe që edhe ata të bëjnë ndonjë hap, që njerëzit me ndikim, të cilët tani "vërtiten" nëpër televizione dhe gazeta, të provojnë të ndikojnë në gjeneratën e mesme, e cila ka marrë pjesë në luftë dhe e cila është bartëse e kësaj shoqërie. Sidoqoftë, mendoj se kur të rrjedhë shumë ujë dhe kur të rriten foshnjat e sotme do të vijë deri tek pajtimi dhe falja e plotë.

T. G.

Si u preva unë, si u preve ti – i njëjti
gjak na rrjedh nëpër damarë

Na tregoni diçka për veten shkurtimisht?

Unë jam nga Prijepola, Sanxhaku. Këtu në Sarajevë jetoj tash 30 vjet. Kam dy djem, bashkëshorti më ka vdekur... Jam në pension.

Çfarë ju kujtohet kur mendoni për fillimin e viteve '90 dhe vitet e para luftës?

Më së shpeshti njeriut i kujtohen ditët e luftës, ato granatat. Kur të thërrasin të ikësh dhe kur unë me fëmijë jemi fshehur nëpër bodrume dhe tek komshinjtë. Pastaj në automobil, tek i ndjeri komshiu Branko – aty kemi qenë dhe i kemi kaluar më së shpeshti netët. Tërë lagja, të gjithë së bashku.

A keni ndier atëherë ndonjë lloj urrejtjeje, zemërimi?

Jo, nuk kam ndier. Nuk di. Kam pasur frikë në vete, vetëm kam pritur, me fëmijë afër vetes, se çfarë do të ndodhë më tej. Kjo ka qenë për mua gjëja më e keqe. Ke disi njëfarë ankthi në organizëm, nuk mund të flesh, pret kur do të trokasim në derë, sepse kemi qenë linja e parë. A do të vijë tek dera. Kjo ka qenë gjëja e vetme. Ndërkaq, sa i përket komshinjeve tjerë, e kam pasur më lehtë kur i kam pasur ata. Kjo do të thotë shumë. Më kujtohet kur kemi shkuar tek “gjyshi”, ai nuk ka pasur kurrfarë frike. Dëgjoheshin të shtëna, ndërsa ai bridhte poshtë-lart. Kur kemi qenë të gjithë së bashku nuk kemi pasur kurrfarë frike. Kemi qenë nga të gjitha palët – edhe muslimanë, edhe serbë, edhe kroatë. Nga të tre popujt.

Si ia keni shpjeguar vetes, ndërmjet kujt është zhvilluar ajo luftë?

Nuk e kam kursesi të qartë, më beso. Unë jam nga Prijepola dhe atje kam komshinj po ashtu serbët. Ja, mund t'ju tregoj edhe fotografitë kur vitin e kaluar kanë ardhur këtu. Aty janë ulur. Dhe pastaj çfarë dallimi ekziston tani, si mund ta ndiej unë dallimin? Krejt varet nga njëri njeri tek tjetri. Nuk e di, nuk mund të jem e urtë pse ka ndodhur kështu...

As tani nuk keni përgjigje?

Me të vërtetë nuk kam përgjigje.

Si ju duket situata e tanishme?

Ja, të të them, ne këtu kemi mbetur ashtu siç kemi qenë. Disa kanë qëndruar këtu tërë kohën, disa janë kthyer, disa janë larguar, si komshiu M. Shiko, të gjithë komshinjtë e mi këtu kanë qenë serbë.

Mua më kujtohet sesi unë dhe Brankoja i ndjerë, ndjesë pastë, kemi ngrënë bakllavanë e Bajramit në vitin 1992, mu në prag të luftës. Ai erdhi këtu tek unë, kurse unë nuk e dija se çfarë po zihej. Thuhet se disa kishin në atë kohë armë në shtëpi, kurse unë nuk kam pasur thikë të topitur siç duhet. Çfarë është e vërtetë, është. Dhe erdhi ai para Bajramit. Unë e pyes se a është e vërtetë kjo çfarë flitet, kurse ai më përgjigjet “Për Zotin, Esma, nuk shkruhet mirë”. Ndërsa unë i them – hajt ta marrë djalli, si nuk shkruhet mirë. Unë kam menduar se më parë do të plasë diku përreth sesa në Sarajevë. Unë dhe bashkëshorti im nuk e kemi ditur aspak se së pari dhe më së tepërmi do të ziejë në Sarajevë, pikërisht në Qytetin e Vjetër.

Si mund ta fsheh unë nëse ty ta kanë vrarë apo prerë më të dashurin tënd? Nuk mundet për Zotin. Ose siç them unë, si mund ta harroj, ta zëmë, të mirën e dikujt? Qoftë në komshi, qoftë diku tjetër. As fëmija im nuk mund ta harrojë të mirën që i është bërë. Por nuk mund ta harrojë as të keqen. Ashtu si unë që nuk mund t'i harroj ato raste, atë mirësi të të ndjerit Branko, ndoshta edhe ata nuk mund ta harrojnë të veten, vrasjet dhe dëbimet etj...

Të gjitha tanket lëviznin, shkonin lart rrugës në tranzit, kurse ne nuk bënim asgjë – vetëm i shikonim nga tarraca. Më thoshte Brankoja se ia thërrasin tërë kohën djalin, kurse në Kroaci në atë kohë tashmë kishte nisur lufta. Ndërsa gruaja e tij më thotë mua: “Unë nuk lejoj që fëmijën tim ta vrasë dikush, e as ai të vrasë dikë. Kjo punë nuk është në rregull”. Ata shkuan në Zvicër, kurse Brankoja i ndërë mbeti këtu për ta ruajtur shtëpinë. Provon ai të shkojë tek kushërinjtë në Marin Dvor dhe kur u nis ma la çelësin dhe më tha: “Ja ku e ke çelësin. Nëse dikush don të hyjë në shtëpi mos ta prishë, por ta hapë derën bukur, të marrë çfarëdo, vetëm të mos ma prishë shtëpinë”. Ma dha çelësin që t’ia ruaj shtëpinë! Çfarë është e vërtetë, është. Por, as dy ditë nuk ka mundur të qëndrojë atje dhe ditën e tretë u kthye prapa. Kurdo që ka pasur festë, xhaxhi Brankoja u ka dhuruar gjithmonë fëmijëve bonbone, çokollata. Ata na kanë ftuar dhe unë kam shkuar gjithmonë në festat e tyre. Unë nuk mund ta harroj këtë kurrë. Edhe ata më kanë ardhur për Bajram! Duhet të flasim drejt!

Kanë ardhur dhe, edhe sot e kësaj dite vijnë. Edhe kur ka vdekur burri im, të gjithë kanë ardhur të më shprehin ngushëllime. Edhe ne kemi qenë kur e kanë vrarë xhaxhi Brankon...

Gjatë vitit të parë të luftës, komshia J. ka përgatitur dimërishten, pekmez, dhe të gjithë e ka ndarë Brankoja. Kurse më vonë na ka dërguar paketa nga Zvicra!

Nuk janë të gjithë të njëjtë, duhet të flasim të vërtetën. Siç thonë, pesë gishtërinjtë e dorës dhe nuk janë të gjithë të njëjtë. Dhe mos e dhashtë Zoti që të jemi të njëjtë...

Po kur e vranë Brankon gjatë luftës... U!h, u zgjuam një ditë dhe shoh unë që diçka nuk është në rregull. Kur shkuam poshtë të shohim se ku është xhaxhi Brankoja, një komshi më thotë “mbylle, Gjulla, e kanë vrarë...” Po, kush e ka vrarë, thashë, e vraftë nëna? Aq vështirë e kam pasur, çdo gjë sikur rrotullisej në mua. Atëherë e kam pasur vërtet shumë vështirë. E di çfarë, kam menduar se do të më bjerë të fikët. Sepse ti nuk i sheh ato gjëra. Ti dëgjon sesi bien granatat dhe tërë këtë, granatat fluturojnë rreth teje. Kurse kjo ka qenë tjetër gjë... dhe “të tanët” e kanë vrarë.

Ta tregoj edhe këtë – unë punoja në fabrikë dhe erdhi njëfarë S. nga Vukovari. Ai kishte qenë teknolog në fabrikë në Borovë dhe vjen ai dhe thotë – në Vukovar çdo gjë është rrafshuar; për Zotin, as këtu nuk do të jetë më mirë, ruajuni! Ai ishte i varfër dhe ne u mblodhëm dhe ia qepëm këpucët për të dhe familjen e tij... Aq vështirë e kemi pasur në atë kohë duke mos ditur se e njëjta gjë do të ndodhë së shpejti edhe tek ne! Por, kur ka filluar në Sarajevë, ai më pas u largua...

Po ata që kanë gjuajtur nga kodrinat, si i keni përjetuar?

Si? Lëre, të lutem... Na ruajt Zoti. Unë nuk e di, unë me të vërtetë nuk do të kisha fjalë për t’i përshkruar se çfarë njerëzish janë ata. Kur jam nisur për Prijepole në vitin 1996, për të parën herë pas luftës edhe unë kam shkuar me fëmijë. Ne jemi nisur nga Grbavica. E din se çfarë frike kam pasur kur kemi qenë në Grbavicë dhe është dashur të zbresim në Llukavicë, nga ku është nisur autobusi për Serbi. Unë vetëm kam pritur që të na thonë se është prishur autobusi, që ta kem më lehtë, të kthehem. Aq ka qenë frika e madhe. Kurse njëkohësisht kam pasur dëshirë të shkoj, ta shoh nënën, vëllanë...

Kurse kjo situata tani... e di çfarë, unë rrëqethem kur dikush thotë se jam nga Bosnja, por nuk simpatizoj për Bosnjen! Mendoj se duhet të jemi real. Po si mundem unë të mos simpatizoj për ty që je këtu me mua, këtu jetojmë.... Po, më afër është komshiu sesa kushëriri i largët. Po mua, po ajo komshia J. më ka dërguar te mjeku

kur nuk jam ndier mirë. Askush tjetër përveç saj. Dhe unë tani duhet t'i them asaj diçka? Mos, të lutem...

Si e kuptoni kur dëgjoni sot se këtu duhet të ndodhë pajtimi?

Nuk e di me të vërtetë... ata atje duhen të pajtohen, ata politikanët, ata, të më falësh në shprehje, qelbësiat! Me kë duhet të pajtohem unë kur nuk jam grindur me askënd. Ne kemi pasur këtu një komshi serb, i cili ka qenë gjithmonë kokëfortë, por as me të nuk jam grindur kurrë. Por edhe ky tjetri që është larguar pa na thënë asgjë, edhe me të kur takohem sot e pyes çdo herë – si je, ç'kemi të re. Edhe ai u telefonon të gjithëve për t'ju uruar Bajramin. Me kë të pajtohem unë? As që jam grindur, as komshiu me mua, as unë me komshiun.

Po në këtë nivelin pak më të lartë, në këtë nivelin shtetëror?

Kjo për mua nuk është vetëm politikë, por politikanët janë grindur. Ata janë zënë, kurse njerëzit kanë vdekur, pa pikë faji. Me të drejtë kanë thënë një natë – më pëlqen më shumë ta ruaj kokën time sesa shtetin. Po në fund të fundit, njeriu edhe ka të drejtë. Ne nuk kemi shtet! Nuk kemi, vetëm shiko se çfarë ndodhen.

Po çfarë është Bosnja e Hercegovina nëse nuk është shtet?

Po çka është? Shtet i shkatërruar, ja çfarë është. Kurse unë nuk mund të jem e urtë se çfarë duhet bërë, më beso. Si i kanë zier punët, unë me të vërtetë nuk e di... Vetëm më vjen keq për rininë sot. Çka do të bëjnë ata sot, nesër? Edhe sikur ta mbarojnë shkollën, ku të shkojnë dhe çfarë të bëjnë më tutje? Ata ia kanë siguruar ekzistencën vetes dhe nipave të tyre, bile edhe stërnipave... Ndërsa çfarë u kemi siguruar ne fëmijëve tanë? Në mënyrë të ndershme... Ne çdo gjë e kemi bërë në mënyrë të ndershme, bukur, por faleminderit prej Zotit, vetëm të jemi shëndosh. Ndoshta ka Zot...

Po si do të kishit dëshiruar Ju që të duket kjo shoqëri, pra Bosnja e Hercegovina?

Ashtu siç ka qenë edhe më parë, vëlla. E bashkuar, siç thonë një shtet, një president, të gjithë së bashku, edhe serbët, edhe kroatët, edhe boshnjakët... Kurse ata që nuk e duan këtë, ata duhet përzënë. Eee, nuk ka më “Goli Otok”, por këta nuk janë as për “Goli Otok”. Unë mendoj këtu për këta politikanët të cilët e nxisin situatën, për ata mendoj... jo për popullin...

A e shihni Ju diku përgjegjësinë e atij popullit “të zakonshëm”?

Po çfarë mund të bëj unë tani? Ku ta di unë nëse ke shtënë ti apo jo? Po unë nuk e di, nuk e di, nuk mund të jem e urtë... Fillova të të tregoj, kur kam shkuar në Prije-pole, përmes Trebeviqit. Atje lart, në çdo vend bunker pas bunkeri, do të thotë se dikush është dashur të dijë për të gjithë këtë. Ata nga lart na kanë pasur si në shuplakë të dorës... Nuk është kjo ndjenjë e thjeshtë... Më e keqja është se serbët e kanë nxitur, ata janë edhe sot disi të dhënë pas të vetes, nuk duan ata që nuk duan, duan diçka të veten dhe falas. E sheh edhe vetë. Nuk e kuptoj pse e duan të veten, kur të gjithë jemi nga gjaku dhe mishi. Të gjithë do të dalim një ditë para të njëjtit Zot.

Por çfarë të bëjë i varfëri? Mbylle gojën, duro derisa të mundesh...

A mendoni se duhet folur sot për ngjarjet që kanë ndodhur gjatë luftës? Çfarë duhet bërë me to?

Nuk duhet t'i fshehim ato, duhet të jemi real. Duhet të tregojmë, le të dihet! Dua të

ta them edhe këtë – kanë ndryshuar fëmijët kur shkojnë në shkollë dhe kjo nuk është në rregull. Kur kam mundur unë të mësoj historinë dhe Luftën e Dytë Botërore, pse të fshihet kjo histori? Atyre nuk u lejohej që të flasin për shumë gjëra në histori. Po pse? Nuk i kemi bërë këto as unë, as ti? Le të dihet, le të dalë e vërteta në shesh, le të dalë, pse jo? Kur e din Zoti, le ta dinë edhe njerëzit. Kjo është thënie e vjetër. Si mund ta fsheh unë nëse ty ta kanë vrarë apo prerë më të dashurin tënd? Nuk mundet për Zotin. Ose siç them unë, si mund ta harroj, ta zëmë, të mirën e dikujt? Qoftë në komshi, qoftë diku tjetër. As fëmija im nuk mund ta harrojë të mirën që i është bërë. Por nuk mund ta harrojë as të keqen. Ashtu si unë që nuk mund t'i harroj ato raste, atë mirësi të të ndjerit Branko, ndoshta edhe ata nuk mund ta harrojnë të veten, vrasjet dhe dëbimet etj...

Çfarë mund ta nxisë këtë që të mos fshihet?

Të mos lejojë rinia që të fshihet! Fëmija im nuk mund të harrojë si kanë rënë granatat, kurse unë e dërgoja në strehimore që të mësojë në shkollë. Nuk mund ta harrojë këtë kurrsesi fëmija. Fëmija im do të kontaktojë normalisht me fëmijën tënd, sepse nuk e ka bërë këtë fëmija yt, por disa njerëz gjaknxehtë. Nuk do të harrohet kjo kurrë, por me kohë do të zbutet. Ndërsa kjo do të lëvizte më shpejt sikur të fillonte prodhimtaria, sikur rinia do të punonte, sikur të ekzistonte sado-kudo liria. Nuk ka më liri të tillë, Tamara ime.

A mund të zhvillohet ekonomia, sipas teje, pa u marrë me çështjen se kush është përgjegjës për luftën dhe gjithë këtë?

Shiko, gjërat do të rregulloheshin sikur ata fajtorët kryesorë do të ishin burgosur. Atëherë çdo gjë do të fillonte ngadalë, ngadalë. Edhe entitetet do të zhdukeshin dhe rinia do të bashkohej e kështu me radhë. Edhe industria do të fillonte të punojë. Por për Zotin, me bark të zbrazët dhe më tërë këtë dhimbje nuk mund të ecet më tej... Ja djali im punon me serbë dhe le të punojë! Po edhe ti je serbe apo jo! Si u preva unë, si u preve ti – i njëjti gjak na rrjedh nëpër damarë.

T. S.

E atëherë vëlla do të fillojmë nga vetvetja

A mund të na prezantoheni për fillim, të thoni diçka për veten, ku keni lindur?

Po, quhem Vojo dhe kam lindur në Mostar në vitin 1974. Përndryshe jam nga Nevesinja dhe tërë jetën kam jetuar në Nevesinje, ku jetoj edhe sot. Kam mbaruar Shkollën e Mesme të Makinerisë. Pastaj kam shkuar në ushtri dhe kam qenë pjesëtar i Ushtrisë së Republikës Serbe nga viti 1992 deri 1996. Pas luftës kam punuar një milion punë, por më së shumti kam shërbyer si kamarier. Tani po ashtu punoj një punë të përkohshme. Përndryshe jam i martuar, baba i një fëmije. Kjo do të ishte shkurt.

A mendon ti si person që ke marrë pjesë në luftë se njerëzit e kanë marrë një leksion nga kjo luftë, se ata tani sillen ndryshe?

A kanë marrë leksion? Po shikuar në përgjithësi, kur i mbledh dhe i shumëzon, i zbret dhe i pjesëton të gjitha, nuk kanë marrë kurrfarë leksioni. Mendoj në shoqërinë në tërësi. Janë çështje tjetër rastet individuale.

A i ka zgjidhur sipas teje lufta disa probleme që kanë ekzistuar në kohën kur ajo ka plasur?

A i ka zgjidhur problemet? Po, nuk e di, në fakt, nëse lufta ka filluar për shkak të disa problemeve. Në fakt, unë ende personalisht nuk kam përgjigje se pse filloi lufta. Ekziston aty... mendoj, kushdo që të përgjigjet në këtë pyetje, kushdo që të ketë përgjigje në këtë pyetje dhe mendon se ajo është përgjigjja e saktë – sigurisht që ajo është njëra ndër përgjigjet e sakta. Pse ia ka filluar? Pse njerëzit menjëherë u shndërruan në njëfarë makinerie apo njëfarë formacioni të dhunshëm? Çfarë ka ndryshuar menjëherë tek njerëzit? Do të thotë tek shumica e njerëzve, tek pjesa më e madhe e shoqërisë ka ndryshuar dhe cilat janë motivet që njerëzit të luftojnë, cilat janë motivet që ata të vriten ndërmjet veti, të dëbohen, të kryhen krime ndaj tyre, të vrasim femra, fëmijë, pleq. Mendoj që në këtë pikë qëndrojmë keq si shoqëri, kështu që është shumë vështirë të përgjigjemi në këtë pyetje.

Mbi çfarë baze mendon se është ashtu?

Po ja, nuk e di se nga t'ia filloj. Le t'ia filloj nga Dejtoni, por do të provoj disi ta shkurttoj sa të mundem. Pra në Dejton është nënshkruar paqja, njëfarë Marrëveshje e Dejtonit për Paqen. Ajo e ka ndaluar luftën, por ekskluzivisht e ka ndaluar luftën. Pse mendoj kështu? Ja, le të themi, kanë kaluar 10 vjet nga Marrëveshja e Dejtonit dhe në përgjithësi ne ende vendnumërojmë. Nuk jemi ende të vetëdijshëm, pra, as për të këqijat që kanë ndodhur gjatë luftës. Nuk do të flasim për krimet e luftës, nuk do të flasim për palën tjetër. Do të flas së pari për veten në qoftë se veç shkojmë drejt njëfarë getoizimi, drejt mbrojtjes së disa interesave nacionale serbe, nuk e di, kroate, boshnjake – nuk është me rëndësi. Pra, të një kombi, të një populli. E atëherë vëlla do të fillojmë nga vetvetja. Ja, unë filloj nga vetja. Secili duhet që golgotën e vet në të gjithë këtë, në qoftë e ka përjetuar, e sigurisht e ka përjetuar, në qoftë se asgjë tjetër ka përjetuar stresin. Edhe gjyshja ime e ndjerë ka qëndruar këtu në

Para së gjithash duhet të ballafaqohemi definitivisht me atë çfarë na ka ndodhur gjithë këtyre viteve. Pra, ky është një lloj ballafaqimi me të kaluarën. Çfarë na ka ndodhur? Ku kam qenë unë në gjithë këtë? Çfarë kam bërë unë? A jam unë përgjegjës? A kam kontribuar unë disi që të ndodhë kjo rrotë e madhe e dhunës? A jam unë pjesëmarrës në gjithë këtë, a jam unë një rrotë e vogël, kushinët në këtë rrotë të madhe?



Nevesinje dhe ka dëgjuar që bien granatat. E ka ditur që unë jam në front dhe është merakosur për jetën time, për pjesën tjetër të familjes, më kupton. Ndoshta edhe për disa fqinj dhe disa njerëz tjerë. Pra, ajo ka përjetuar stres për çdo rast e të mos flas se çfarë kanë përjetuar njerëzit në linjën e parë të frontit apo në disa beteja. Unë mendoj se ne nuk jemi të vetëdijshëm për tragjedinë që na ka ndodhur. Definitivisht mendoj se nuk jemi të vetëdijshëm sa njerëz janë vrarë, sa njerëz, do të thotë civilë janë vrarë, të rinj, pleq, njerëz të paaftë, vetëm pse kanë qenë të fesë apo kombit tjetër. I kanë takuar njëfarë... siç thotë Rambo: “Ne nga martesat e përziera, ne jemi më të këqinjët”. E të mos flasim për krimet e luftës, pastrimet etnike, dëgjjen e shtëpive, shkatërrimin e të mirave. Çdo kafshë në këto hapësira ka vuajtur e jo më njeriu. Ne ende nuk jemi të vetëdijshëm për këtë. Ne thjesht jemi humbur në të gjithë këtë, jemi humbur për shkak se askush nuk na ka mundur dialogun. Ja konkretisht me palën tjetër. Para së gjithash ne nuk kemi pasur dialog midis vetë nesh pas asaj lufte. Nuk mundesh, tani u nënshkrua paqja, e “hajde menjëherë” të krijojmë shtetin. Menjëherë na i kanë krijuar disa institucione, menjëherë na i kanë krijuar njëfarë... sa kush do të ketë ushtri.

A mendon ti se kjo është ekskluzivisht çështje e individit?

Po, nuk mendoj se është ekskluzivisht çështje e individit, por individ është aty i rëndësishëm që të kuptojë gjendjen e vërtetë, që ai ta zgjidhë çështjen me të kaluarën e tij. Pra, që ta kuptojë të kaluarën e tij, ku ka qenë ai në gjithë këtë. Kjo është çështje shumë e rëndësishme dhe këtë mund ta bëjë individ. Ekziston edhe një palë tjetër, ekzistojnë në fakt edhe dy palë tjera. Pala tjetër është pushteti. Do të thotë ky pushtet përfaqëson shoqërinë, një shumicë e njerëzve voton për një opcion që i përfaqëson këta njerëz, a është kështu? Ata jemi ne, edhe pse unë ndoshta nuk kam votuar për këtë pushtet, por shumica e njerëzve ndoshta po. Mendoj në letër është shumicë, por kur këto shifra të shënohen në letër do të shihet që kjo është një

pakicë e njerëzve që qeveris. Mendoj që këtu është një mungesë e madhe e vullnetit politik, jo vetëm në këtë pushtet, në këtë qeveri, në këtë përbërje të Kuvendit e kështu me radhë. Që nga Dejttoni nuk është bërë definitivisht asgjë në këtë aspekt.

Thua se që nga Marrëveshja e Dejtonit nuk ka ndryshuar asgjë. Çfarë është për ty paqja dhe si duket ajo?

Po, të them... çfarë është paqja për mua? Po, paqja nuk është vetëm mungesë e luftës. Ja, për shembull, konkretisht në Nevesinje... Unë do të dëshiroja që të zgjohem një ditë dhe t'i shoh njerëzit që jetojnë normalisht, punojnë normalisht. Të gjithë ata njerëz që kanë jetuar para luftës në Nevesinje dhe pasardhësit e tyre që kanë lindur gjatë kësaj periudhe. Nuk brengosem fare se çfarë sistemi do të jetë, se a do të jetë ndonjë sistem, por që ata njerëz të kthehen dhe që ne thjeshtë... të shkohet në kishë siç është shkuar, që njerëzit të punojnë siç kanë punuar. Mendoj që paqja është, thjeshtë... paqja është liria. Definitivisht që ti të ndihesh i lirë që të thuash çfarë dëshiron, të mundesh të kritikosh disa eprorë, pushtetin, nuk ka rëndësi se kush janë. Do të thotë thjeshtë të jesh kritik dhe të pranosh kritikën, si dhe të jesh vetëkritik. Paqja ekziston kur ka prosperitet në shtet ose paralajmërim të këtij prosperiteti. Paqja mund të jetë jo vetëm mungesë e luftës, por do të thotë edhe njëfarë përparimi. Diçka që shkon përpara. Që njerëzit të bëhen të vetëdijshëm për gjithçka dhe për vetveten, madje edhe për veten në shoqëri. Për shoqërinë ndaj vetes në fund të fundit, që është gjë shumë e rëndësishme. Që thjeshtë të mos u kushtojmë vëmendje problemeve ekzistenciale, mbijetesës, disa stereotipeve të tipit çfarë kombi je. Ne të gjithë duam që fqinjit t'i ngordhë lopa dhe kjo është e vërtetë.

Çfarë është sipas teje e nevojshme që çdo gjë të duket siç ka qenë më parë?

Po mendoj se është i nevojshëm një lloj i pajtimit. Do të thotë, para së gjithash duhet të ballafaqohemi definitivisht me atë çfarë na ka ndodhur gjithë këtyre viteve. Pra, ky është një lloj ballafaqimi me të kaluarën. Çfarë na ka ndodhur? Ku kam qenë unë në gjithë këtë? Çfarë kam bërë unë? A jam unë përgjegjës? A kam kontribuar unë disi që të ndodhë kjo rrotë e madhe e dhunës? A jam unë pjesëmarrës në gjithë këtë, a jam unë një rrotë e vogël, kushinetë në këtë rrotë të madhe? Dhe atëherë, thjeshtë, kur të dalim, pasi që veç jemi të ndarë në tre kombe, në tri palë... Natyrisht, më lehtë është të sundosh individualisht se sa kur njerëzit janë bashkë. Dhe atëherë të shohim se si do të vazhdojmë të jetojmë më tej. Sepse ne jemi këtu definitivisht të lidhur me mentalitetin, historinë. Nuk e di, zakonet i kemi të njëjta, problemet i kemi të njëjta. Atëherë jemi në një territor të tillë gjeografik që është një territor gjeografik i papërfillshëm nëse kemi parasysh një fotografi të përgjithshme. Ne duhet definitivisht të jetojmë këtu. Ne jemi, siç thotë dikush, të dënuar njëri ndaj tjetrit. Nuk është se jam i dënuar, se është dënim që jam me boshnjakun apo me kroatin në punë, në shoqëri, nuk ka rëndësi, në rrugë, në kafene, në shkollë... Që fëmija im të shkojë nesër në shkollë me boshnjakun apo me kroatin. Por, thjeshtë, që të promovojmë disa vlera të cilat janë, natyrisht, vlera. Nëse njerëzit duan të kenë identitet fetar, o Zot, le ta kenë. Të gjithë duhet, pra ata që duan... Nuk ka rëndësi se çfarë lloj religjioni është, por është e rëndësishme që t'u mundësosh njerëzve atë që duan.

Çfarë është për ty pajtimi dhe çfarë nevojitet që të arrihet ai?

Po, pajtimi është për mua..., do të thotë përballje definitive me të kaluarën. Pranimi i përgjegjësisë, qoftë ajo e vogël apo e madhe. Por është definitivisht... Që unë, unë jam përgjegjës, le të them. Por nuk mund të them tani se të gjithë janë përgjegjës.

Shumë nuk e shohin kufirin ndërmjet heroizmit dhe krimit. Dhe kjo vetëm për faktin sepse kemi pranuar që llumi i luftës të na mbajë leksione mbi "patriotizmin".

Por janë përgjegjës të gjithë ata që kanë marrë pjesë në luftë në çfarëdo mënyre. Përballja me krimet e luftës është po ashtu çështje shumë e rëndësishme. Mendoj, të mos lejojmë që njerëzit, të cilët kanë vrarë ndoshta 1000 vetë ose fëmijë të vegjël, nuk ka rëndësi se kë, por civilë, të shetisin sot rrugëve dhe të sillen në mënyrë komode, madje të jenë të privilegjuar në shoqëri. Të mos flasim për krijimin e miteve, legjendave dhe heroizmit për ta. Mendoj se për këtë duhet përfundimisht të merret qëndrim i qartë. Çdo individ, kurse më pas edhe shoqëria në tërësi. Të punojmë në promovimin e jodhunës. Thjesht, t'i heqim nga koka, më kupton, këto stereotipe që i kemi. Që pak më shumë t'i kthehemi vetvetes dhe njerëzve tjerë.

Çfarë hapash duhet ndërmarrë politikanët për ndërtimin e besimit dhe pajtimit? A angazhohen ata mjaft për këtë?

Në mënyrë definitive nuk angazhohen. Përkundrazi i ngadalësojnë dhe i trimërojnë ende ato forca që i ngadalësojnë proceset. Jo rrallë herë ata luajnë rolin e “patriotit”, kështu që shumë nuk e shohin kufirin ndërmjet heroizmit dhe krimit. Dhe kjo vetëm për faktin sepse kemi pranuar që llumi i luftës të na mbajë leksione mbi “patriotizmin”. Për këtë disa edhe nuk i dallojnë shkaqet që na mbajnë në mashtrime të mëdha. Në fushën e politikës ekzistojnë ende tipa që kanë bërë kërdrinë në linjat e para. Së pari duhet të mbarojmë punë me të gjithë ata që kanë vepruar në kundërshtim me ligjin dhe parimet morale, e tek pastaj të fillohet të krijohet klima për dialog me ish-palët luftuese. Këtu e shoh po ashtu një rol të madh të përfaqësuesve fetarë si dhe të mediave.

Në çfarë mënyre ti si individ mund të kontribuosh në ndërtimin e paqes?

Në atë mënyrë që unë si individ të analizoj rolin tim në luftë, veprimet e mia dhe raportin tim ndaj luftës sot. Ekzistojnë ende shumë çështje, por sa më takon mua personalisht nuk ka dilemë. Unë e shoh përgjegjësinë time në faktin që kam marrë pushkën dhe kam qenë njëra ndër unazat në zinxhirin e dhunës gjatë periudhës së kaluar. Dhe pas gjithë asaj që më ka ndodhur në periudhën e luftës, pasluftës dhe asaj që më ndodh sot, jo vetëm mua, por shumicës së të rinjve në këtë vend, mendoj që si individë duhet të punojmë që të mos na përsëriten disa gjëra. Këtu para së gjithash mendoj në urrejtjen, manipulimin, krimet e luftës, pastrimet etnike. Duhet të punojmë në parandalim, që të kaluarës t'i qasemi nga ana e drejtë, në mënyrë objektive, pa paragjykime të tipit: Pse dikush ta arsyetojë krimin për arsye se “të tijtë” kanë kryer krim ndaj “nesh”? Pse të krijojmë heronj dhe mite nga kriminelët? Pse nuk ballafaqohemi me të vërtetën? Unë personalisht nuk kam probleme me këto gjëra dhe e di se çfarë kam menduar për to gjatë luftës, dhe njëjtë mendoj edhe sot. Dhe kjo për mua është e rëndësishme. Për disa gjëra nuk kam qenë i vetëdijshëm, ndërsa sot jam. Por kur flitet për gra, fëmijë, pleq, djegjen e shtëpive, marrëdhëniet ndaj robërve... jam krenar dhe mund t'i falënderohem Zotit që nuk jam shndërruar në egërsirë. Sepse, siç e di, disa janë shndërruar dhe sot me siguri kanë probleme me vetveten dhe vetëdijen e tyre. Ballafaqimi me të kaluarën nuk është vërtetë proces i lehtë. Edhe në qoftë se krijojmë parakushte për këtë, edhe pse ne vonojmë 10 vjet në këtë çështje..., por megjithatë, më mirë vonë se kurrë. Unë i krahasoj hapësirat tona me Palestinën. Gjithmonë këtu gjatë historisë është shikuar se si të niset dhuna, mbi çfarëdo baze. E po tani duhet të ulemi në tryezë dhe të flasim për këtë.

Çfarë i nevojitet shoqërisë që të arrihet pajtimi?

Pikërisht ajo për çfarë kemi folur. E vërteta. Si të arrihet tek e vërteta? Përmes dialo-

gut dhe assesi ndryshe. Por që të ekzistojë dialog i shëndoshë duhet të dënohen të gjitha krimet dhe kriminelët. Të jesh i paanshëm, vetëkritik dhe t'i grumbullosh të gjithë pjesëmarrësit relevantë të luftës përmes llojeve të ndyshme të dialogut në mënyrë që njerëzit ta zbrazin nga vetja të gjithë hidhërimin dhe urrejtjen dhe golgotat e tyre personale. Të flitet hapur dhe pa frikë.

Pse duhet të përballemi me të kaluarën?

Dikush ka thënë një herë diku: “Populli që nuk nxjerrë mësim nga historia e tij është i dënuar ta përfetojë atë përsëri”. Ky konstatim nuk është i zbatueshëm vetëm për hapësirat tona, por për tërë botën. Çfarë është në fakt historia njerëzore? Si do të mund të përkufizohet ajo shkurtimisht? Me një fjalë të vetme e kjo është vdekja. Prej lufte në luftë, prej gjenocidi në gjenocid, prej Holokausti në Holokaust. Nga luftërat e para fisnore deri te luftërat qytetare, nga Revolucioni francez deri tek ai bolshevik. Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore, nga Vjetnami në Irak, nga Somalia deri te trevat tona. Nga çëçenia përsëri deri në Irak e ku ta di deri ku tjetër. Njerëzit në lirinë e vet kanë zgjedhur gjithmonë dhunën dhe rrugën e vdekjes.

A mendon se mund të arrihet “paqja” e përhershme pa u përballur me të kaluarën?

Definitivisht jo! Përndryshe do të biem për të disatën herë në grackën e së kaluarës. Do të doja të shtoja se vështirësia më e madhe e individit qëndron në atë se ne jemi shumë larg vetvetes dhe se duam shumë pak që t'i afrohem vetes. Ne gjithmonë i shmangemi përballjes me vetveten. Disa thonë se kjo ka qenë luftë fetare. Ndërsa unë pyes: A mund dikush ta quaj vrasjen e njerëzve luftë fetare? Sikur të gjithë ne të ishim fetarë, mendoj se nuk do të vinte deri te lufta.

B. A.

Cili është raporti Juaj ndaj luftës tani, dhjetë vjet pas?

Ju sigurisht me luftë nënkuptoni atë që ka ndodhur në territorin e Bosnje dhe Hercegovinës, sepse nuk kanë kaluar ende dhjetë vjet nga lufta në Kosovë! E kam vështirë të jap përgjigje objektive sepse, thjesht, mendoj se lufta është akoma prezente, jo në kuptimin e të ndodhurit në realitetin e përditshëm, por në një mënyrë latente. Pra, nëse shkatërrimi i ish-Jugosllavisë, që ka ndodhur nën intonimin e rëndë të luftës, ka pasur si pasojë formimin e shteteve nacionale, etnike (mund të thuhet se ky ishte qëllimi i luftës), kush sadopak normal mund të garantojë se procesi i shkatërrimit ka arritur portën e vet të paqes!? Me fjalë të tjera, kush mund të garantojë që pakicat e posakrijuara, por edhe ato të vjetrat, nuk do të jenë edhe një rast i mirë i piromanëve me përvojë ose, së fundi, e nxënësve të tyre që të demonstrojnë fuqitë e vet?

Natyrisht, nëse këto shtete nacionale, në politikën e vet të brendshme, do të veprojnë sipas modelit të ish-Jugosllavisë, d.m.th. të ushqejnë nacionalizmat si varrëmi-hësit e vet për të qëndruar në pushtet, siç vëren jashtëzakonisht mirë Leszek Kolakowski?!

Dua të them që ne jetojmë të shtrënguar në një ankth, të ngjashëm me ankthin ekzistencial, i cili konform lepezës së vet të shumëllojshme lë, kam frikë, shenja të pashlyeshme në gjerësinë dhe thellësinë e psikikës sonë.

A mendoni se lufta sidoqoftë ka përfunduar?

Nëse konsiderojmë se lufta, në aspektin e vet aktiv dhe potencial, ka arritur linjën e vet të vdekjes, që është shkak i domosdoshëm që në “paqe” të rishikojmë pasojat e saj, kush mund të qëndrojë indiferent, posaçërisht nëse është musliman, ndaj prononcimeve të luftërave të reja kryqëzatore, të cilat në vend të lirimit të varrit të Krishtit, do të fitojnë dikurs të ri, me kalimin e kohës, (ç)lirimin e botës muslimane?! Për më tepër, nëse si musliman jam merakosur se do të jem qingj i sakrifikuar i shtazarakëve gjakpirës të kultures ultranacionaliste, e cila deri vonë është vërtitur në mjedisin tim, nëse jam merakosur që vala imperialiste do të më zhdukte nga harta historike dhe gjeografike e botës, tani duhet të merakosem që ndokush nga do të më “çojë në hava”?! (edhe pse, sipas definicionit të të Dërguarit të Islamit, të tillët fare nuk gjejnë vendin e vet brenda fushës kuptimore të nocionit musliman).

Kur flisni për luftën, a flisni për luftën në hapësirat tona?

Lufta e ka humbur karakterin lokal. Ajo tash sa kohë është shndërruar në një fenomen planetar, me të cilin domosdoshmërisht, deshëm apo s'deshëm ne, ballafaqohemi dhe në mënyrë permanente pësojmë pasojat e saj, të cilat si të tilla, pothuaj nuk kanë fund.

Por, nëse jam i detyruar që në formë eksplicite të emëroj ndonjë pasojë, ajo që në këtë moment më lajmërohet në mënyrë të fuqishme është shqetësimi në të gjitha moduset e veta, të cilat formojnë një rrjetë specifike brenda fushës së tij semantike. Mendoj se asnjë njeri, i cili është trashëgimtar i natyrës njerëzore autentike dhe

Pra, ajo që dua të them është se personalisht besoj që zgjidhja qëndron në formimin e një shoqërie të hapur, që parimisht garanton ruajtjen e identitetit nacional, kulturor të çdo pakice, e kjo, si pasojë, do të thotë që e liron nga ankthi i asimilimit d.m.th. shqetësimit, e që domosdoshmërisht paraqet parakusht për aventurat e reja ushtarake.

primordiale, nuk është i çliruar nga shqetësimi. Ky shqetësim depërton nëpër të gjitha nivelet e veprimtarisë intelektuale dhe shpirtërore të njeriut, pra, politike, ekonomike, sociale, psikologjike, fetare dhe niveleve tjera...

Çka është e nevojshme që të arrihet paqja?

Në kontekstin e shqetësimit, të cilin e përmenda më parë, si pasojë kryesore të luftës, si teolog dëshiroj të theksoj se Zoti, së paku në konceptin islamik, në rrafshinë e vetëmanifestimit të tij, paraqitet, në mes Emrave dhe Atributeve të tij të bukura, me emrin Selam që d.m.th. Paqe. Kjo do të thotë se myslimanët besojnë se Zoti është Paqe dhe si i tillë Burim i paqes së kësaj bote. Me fjalë të tjera, paqja planetare nuk mund të jetë serioze, derisa ne, si krijesat e Tij, mos të jemi në paqe me Zotin. Pikërisht këtu del në pah roli kryesor i religjionit në përgjithësi, i cili duhet të jetë vendimtar për shekullin tonë. Kjo do të thotë se rrjedhës së djeshme të njerëzimit, i cili pa dyshim vrapon me hapa galopantë kah fundi i vet fatal, nën ritmet e zbrazësisë (thatësisë) shpirtërore, do t'i japë një drejtim më fatlum. Por, me këtë nuk mendohet që përsëri të aktivizohet ndjenja e përgjegjësisë ndaj Zotit, si principit etik i botës, brenda vetëdijes së *homo modernusit* apo *homo teknikusit*, por në të njëjtën mënyrë të bëjë të kapshëm vetë realitetin e pluralitetit dhe diferencës në këtë botë si Vullnetit të pandërprerë të Zotit, prishja e të cilit, me vetë faktin se dëshirohet të ngushtohet në një ton uniform dhe monolit, në të vërtetë, paraqet prishjen e Qëllimit të Zotit, që përsëri sjell shqetësim. Kjo e fundit ka të bëjë me atë që paraqet ideologjizimin e religjionit, gjë që mund të ketë absolutisht pasoja fatale. Ideologjizimi i religjionit ka qenë, pa dyshim, fenomen prezent në luftën e fundit. Kjo ndodhë ndoshta ngase se ky rajon ushqehet me frymën tradicionale epike, e cila është e drejtuar kah e kaluara.

Kështu që mendoj se sintagmës “rikthimi i religjionit”, domosdoshmërisht duhet kthyer dinjiteti i vet i vërtetë. Kjo do të ndodhë atëherë kur brenda cilësdo prej traditave religjioze të afirmohen idetë e atyre traditave, të cilat janë, në përputhshmërinë e vet metafizike, dinjitoze, të mira, të vërtetshme, e të cilat në të njëjtën kohë, janë i vetmi parakusht për një kohabitim të qetë, human, paqësor, kulturor dhe civilizues. Pra, ajo që dua të them është se personalisht besoj që zgjidhja qëndron në formimin e një shoqërie të hapur, që parimisht garanton ruajtjen e identitetit nacional, kulturor të çdo pakice, e kjo, si pasojë, do të thotë që e liron nga ankthi i asimilimit d.m.th. shqetësimit, e që domosdoshmërisht paraqet parakusht për aventurat e reja ushtarake.

E. H. Ç.

Është tmerrësisht e vështirë të thuash: “Unë kam gabuar”

Cili është kujtimi yt për luftën dhe raporti ndaj saj pas këtyre viteve?

Uh, këto kujtime të këqija kryesisht i shtyj rrezikshëm. I tillë jam. I shtyj diku thellë dhe vetëm atëherë kur dua t'i nxjerr nga vetja, i nxjerr nga diku. Më kujtohen momentet e këqija, qëndrimet në strehimore, dëgjimi i granatave dhe tregimeve të këqija, të ndërsyerit e popullit ndaj gjithçkaje, në fillim, kurse më pas fytyrat gjithnjë e më të vrenjtura të njerëzve që ktheheshin dhe pakënaqësia në rritje. Më kujtohet dëshira ime për gjëra që në atë kohë ishin të paarrtshme. Ajo ishte aq bizare, siç është një çokollatë apo shkuarja diku, por... Nuk e di, kam qenë shumë i ri, ndoshta fati im dhe e kam tejkualuar këtë disi. Dhe e kam kanalizuar siç bëjnë zakonisht të rinjtë në atë moshë, tinejxherët, kështu që nuk kam shumë trauma më duket. Shpresoj që të mos vijë nga diku, në ndonjë moshë.

A mund të shërohen plagët e krijuara?

Të miat munden, falë Zotit.

Si i sheh në përgjithësi pasojat e luftës dhe zvogëlimin apo zhdukjen e tyre?

Po duhet të punojmë për këtë. Pra, duhet të punojmë me të vërtetë, të gjithë, sidomos me njerëzit që janë “të plagosur keq”. Do të thotë të flasim për plagët. Nuk mendoj të plagosur fizikisht, natyrisht, por... Mendoj se kanë ndodhur mjaft gjëra të këqija, të cilat ndodhin edhe sot. Për fat të keq, të gjithë i bartim disa histori nga e kaluara. Pra, puna me njerëz, nuk ka mundësi tjetër. Thjeshtë, duhet t'i ndihmojmë njëri-tjetrit që të dalim nga kjo gjendje sepse vetë njeriu vështirë mundet, posaçërisht nëse është i plagosur rëndë, që të lirohet nga diçka, nga ndonjë përjetim. Vetëm mundemi të gjithë t'i ndihmojmë njëri-tjetrit, kjo është gjëja e vetme, më duket, që për momentin është e mundur.

Si e sheh pajtimin, gjegjësisht çfarë do të thotë ai për ty?

E ardhmja. Pra, kjo është ajo që duhet të bëjmë. Kjo është e pashmangshme nëse dëshirojmë të vazhdojmë njëfarë rruge normale, që të pajtohemi. Ja, kohës së fundit kjo është rruga nëpër të cilën ecim zyrtarisht. Kjo është shumë e bukur të shihet dhe të dëgjohet, vetëm se kjo duhet të shkojë më larg se sa pajtimi zyrtar, pajtimi formal. Këtë duhet ta pranojmë të gjithë si yllin e vet udhërrëfyes. Të gjithë, pra, çdo individ, çdo qytetar i çfarëdo vendi apo rajoni, i çfarëdo konfesionit. Kjo është ajo që duhet të bëjmë.

Çfarë është e nevojshme sipas teje për arritjen e pajtimit? Cilat janë ato kushte?

Është e nevojshme që... që... Për fat të keq akoma mund t'i dëgjojmë disa zëra nxitës dhe nuk e di se çfarë lloj zërash edhe në media, edhe nga kreu shtetëror, edhe nga politikanët e çfarëdo blloku... Mendoj se këtë duhet ta ulim në minimum, duhet ta shuajmë. Fatkeqësisht e dimë se sa këto media dhe e gjithë kjo ndikon në vetëdijen tonë, ndërgjegjen tonë si njerëz mesatarë, njerëz mesatarisht të edukuar dhe mesatarisht të vetëdijshëm dhe të ndërgjegjshëm. Prandaj, së pari duhet nisur

Nganjëherë mashtrohem se nuk ekziston urrejtja më tek populli. Dhe atëherë takon dikë që është i mbushur me urrejtje. Kjo urrejtje duhet të ketë ndonjë burim – duhet t'i gjejmë dhe t'i mbyllim ato. Ky është një mjet shumë i lehtë për manipulim: emocionet, urrejtja dhe të gjitha këto plagë...

nga kjo, kurse më pas duhet sërish të punojmë me njerëz dhe të hapemi ndaj të tjerëve, të përpiqemi t'ju ofrojmë dorën të gjithëve, gjithçkaje dhe kujt do, t'i harrojmë disa gjëra të këqija, të kalohet mbi diçka. Për disa kjo do të ishte kafshatë shumë e vështirë, por nuk ka rrugë tjetër.

Kush duhet të punojë në arritjen e pajtimit?

Të gjithë, do të thotë, të gjithë duhen. Fillo nga kreu, natyrisht, por të gjithë duhet të punojmë për pajtimin.

Cilat janë vështirësitë në këtë rrugë?

Po... është shumë e vështirë të kalohet mbi disa... plagë, hajde të themi plagë, sepse njeriu që është i plagosur thellë, shumë thellë, vështirë do t'i harrojë disa gjëra. Por, mund t'i falë nëse i ndihmojmë ne të gjithë që t'i falë, por nuk do t'i harrojë kurrë. Këto janë gjëra shumë të rënda dhe, për fat të keq, nganjëherë mashtrohem se nuk ekziston urrejtja më tek populli. Dhe atëherë takon dikë që është i mbushur me urrejtje. Kjo urrejtje duhet të ketë ndonjë burim – duhet t'i gjejmë dhe t'i mbyllim ato. Ky është një mjet shumë i lehtë për manipulim: emocionet, urrejtja dhe të gjitha këto plagë përdoren ende për të manipuluar për këtë apo atë, nuk ka rëndësi. Kjo është një gjë shumë e shëmtuar.

A mendon se “njerëzit e thjeshtë” e duan paqen dhe a janë të gatshëm të punojnë për të?

Absolutisht po. Sidomos në këtë situatë ekonomiko-sociale në të cilën gjendet pothuajse i gjithë rajoni. Pra, mjaft më me përralla. Të gjithëve u kanë ardhur te hunda fjalimet e politikanëve dhe historitë për luftën dhe... Ne mund të flasim për historitë kur kemi për të ngrënë dhe derisa ndihemi komodë nga kjo anë ekonomike, por menjëherë kur mungon diçka... Ndoshta edhe unë e kam tani të lehtë të flas sepse kam një gojë. Ka mjaft njerëz që kanë nga katër, pesë gojë (për të ushqyer) dhe është pak vështirë t'ia shesësh një tregim të zbrazët diku që... Ata e kanë vështirë ta përpijnë këtë.

Çfarë mund të bëjë “njeriu i thjeshtë” që t'i kontribuojë pajtimit?

Shumë: të punojë me veten, të provojë të punojë me rrethin e vet më të ngushtë nëse ai është larguar apo nuk është për pajtim. Kjo është ajo, mendoj unë, kjo është formula. Në qoftë se të gjithë do të punojmë në veten tonë do ta ndryshojmë tërë botën.

Nëse do të ndodhte pajtimi, çfarë do të përbënte ai për ty personalisht?

Për mua ai veç ka ndodhur. Për mua ka ndodhur pajtimi me vetë faktin se mund të shkojë te miqtë e mi në çfarëdo vendi dhe kudo. Për mua pajtimi është këtu dhe njerëzit përreth meje janë të pajtuar. Pra, mua më ka ndodhur pajtimi, por do të doja që këtë ta përjetonim njëjtë të gjithë, çdo qytetar i çfarëdo shteti, rajoni, ta përjetonte lirinë që të shkonte kudo dhe që të ndihej komod si në shtëpi të vet, siç edhe është në fakt. Kjo përbën një liri e madhe.

E kaluara – çfarë mendon se duhet bërë me të, si të ballafaqohemi me të?

Duhet të shikohet ashtu siç është, pra, pa ndonjë zbukurim shtesë, siç e kemi zakon dhe pa kurrfarë përpunimi. Do të thotë, duhet të flasim vetëm të vërtetën, të shikojmë çdo gjë realisht sa të jetë e mundur. Ndoshta kjo tingëllon pak si utopi, por është e vetmja mënyrë. Të mos rrëfejmë disa histori heroike mbi të kaluarën për t'u shpërlarë para vetes dhe të tjerëve, por thjeshtë të shohim se çfarë ka qenë,



si ka qenë, të nxjerrim së fundi gabimet nga e kaluara në mënyrë që mos t'i përsërisim sërish.

Sa është e vështirë që të ballafaqohesh me të kaluarën në mënyrë të tillë?

Shumë vështirë, tmerrësisht vështirë sepse duhet thënë, e është tmerrësisht e vështirë të thuash: “Unë kam gabuar”. Për gabimin e vogël është vështirë të thuhet “Unë kam gabuar” e lëre më për disa gabime të mëdha. Kjo është në mentalitetin tonë që nuk duam t'i pranojmë gabimet, që nuk duam në atë mënyrë të sillemi ndaj tyre, e lëre më atë të kaluar... E dimë të gjithë se çfarë ka ndodhur. Vështirë, shumë vështirë, por duhet të shtrëngohemi dhe të ballafaqohemi, ta shikojmë një herë në sy edhe të vërtetën, edhe të kaluarën, të gjithë ne, do të thotë, që nga individi i vogël i mjerë e deri tek...

Çfarë mendon për fajin, a duhet kërkuar ai tek njëra palë? Si e shikon fajin, a është ai individual apo kolektiv?

Në mënyrë definitive nuk duhet kërkuar tek njëra palë. Pra, faji është i të gjithë neve. Duhet të ballafaqohemi të gjithë, para së gjithash me fajin kolektiv, në mënyrë që të mos përjashtojmë përgjegjësinë vetiake për çdo gjë që ka ndodhur, sepse të gjithë kemi përgjegjësi, sado kudo. Është lehtë të refuzohet dhe të thuhet “janë ata, nuk jam unë fajtor, çfarë kam mundur të bëj unë”. Në këtë mënyrë shpërlajmë veten dhe mundohemi t'i tejkalojmë disa gjëra, por nuk do të shkojmë larg me këto raporte nëse, thjeshtë, nuk e pranojmë të gjithë fajin tonë, sado që të jetë ai, por që ekziston. Të gjithë kemi vrapuar, të gjitha palët kanë vrapuar. Mua më kujtohet shumë mirë kur kanë kalëruar me armë përreth, kanë ulëritur dhe kënduar këngët e tyre – të gjithë. Kjo është përgjegjësia jonë. Ka pasur zëra të vetmuar në mjegull që kanë ftuar në vetëdije, në dialog, por, për fat të keq, kanë qenë shuar. Këtu është faji ynë, faji i të gjithëve, i të gjithë individëve. Ne kemi qenë atëherë shumë të rinj që të mund të qëndronim dhe të themi fort jo ose po, ose çfarëdo tjetër, por të gjithë që

në atë kohë kanë mundur të thonë po ose jo dhe të vendosin vetë, si dhe që kanë qenë të vetëdijshëm, kanë përgjegjësinë e tyre.

I përmendët mediat. Çfarë mendon për përgjegjësinë e tyre?

Përgjegjësia e mediave është shumë e madhe. Mua më kujtohen të gjitha ato imazhe, të gjitha ato zëra kërcënuese, të gjitha ato rrëfime se ne kemi të drejtë, kurse ata janë fajtorë, se ata nuk janë askushi, ndërsa ne jemi gjithkushi. Madje më ka marrë me vete kjo valë e njohjes dhe vetënjohjes se ne jemi të mëdhenj, ndërsa ata të vegjël. Se si ata duhet t'i mësojmë mend duke përdorur metodat që veç janë përdorur. Kjo është e tmerrshme. Bile edhe sot tmerrohem se çfarë njerëzit lëshojnë në eter apo shkruajnë. Shumë keq. Përgjegjësia e mediave është shumë e madhe, sidomos në mentalitetin tonë. Sepse, edhe sot e kësaj dite, për fat të keq, është e pakontestueshme aksioma “kam lexuar në gazetë”, “shkruan në gazetë”. Nuk ka më aty fjalë as dilema se a është e vërtetë apo jo. Njerëzit janë shumë të kënaqur me atë që lexojnë apo dëgjojnë dhe atëherë është tek gazetarët barrë e madhe, përgjegjësi e madhe, vetëm se disa nuk e kanë përdorur në mënyrë të ndershme.

A ka ndonjë gjë që do të dëshironit të thoni jashtë pyetjeve të parashtruara?

Me rëndësi është të lëvizi dhe të njoh njerëz të tjerë sepse është lehtë të ulërij në turmë dhe të them ata janë kështu, ata janë ashtu. Kjo është e lehtë të bëhet, kjo përihet shumë lehtë. Megjithatë, në qoftë se nga kjo turmë i ndajmë një ose dy persona, nëse i përmendim emrat dhe nëse përqëndrohemi tek ata, atëherë është shumë vështirë të themi “Ata janë kështu, ata janë ashtu”. Pra, duhet të lëvizim pak, t'i shtrijmë edhe duart, edhe këmbët, të lëvizim përreth dhe pa frikë, të jemi të lirë. Mendoj se kjo është një mënyrë dhe metodë shumë e mirë që të tejkalohet e gjitha. Nëse diku e keni një mik, një të njohur, nëse jeni i afërt me dikë, atëherë me siguri, duke iu referuar grupit që i takon, fetar, nacional apo çfarëdo, do ta kujtoni së pari atë njeri. Së paku tek unë kjo vepron kështu. Dhe atëherë nuk mund të thoni përmes gjuhës: “Ata janë kështu apo ashtu”.

L. Z.

Të gjithë kemi vrapuar, të gjitha palët kanë vrapuar. Mua më kujtohet shumë mirë kur kanë kalëruar me armë përreth, kanë ulëritur dhe kënduar këngët e tyre – të gjithë. Kjo është përgjegjësia jonë. Ka pasur zëra të vetmuar në mjegull që kanë ftuar në vetëdije, në dialog, por, për fat të keq, kanë qenë shuar. Këtu është faji ynë, faji i të gjithëve, i të gjithë individëve.

A mund të më thuash diçka për veten tënde?

Jam vullnetar në Qendrën Rinore të Gjilanit dhe merrem me aktivitete që kanë të bëjnë me teatrin, pra me shfaqjen e premierave. Kemi një bashkëpunim të mirë me Ministrinë e Arsimit apo më konkretisht me Departamentin për Kulturë, Rini dhe Sport në nivel të Kosovës, ku edhe jam vullnetar i Rrjetit Rinor Kosovar.

Si e ndien veten tash, gjashtë vjet pas luftës?

Çdo gjë është krejt ndryshe. Mund të them se e ndiej veten shumë mirë, mirëpo nganjëherë edhe shumë keq. Pra janë këto dy përgjigje. Pse e ndiej veten mirë? Po të mos ishte larguar diktatura e regjimit të Millosheviqit prej Kosovës, unë me siguri që nuk do të isha ai që jam sot dhe nuk do ta kisha mundësinë të merrem me të gjitha këto aktivitete me të cilat merrem sot. Tash që ai është larguar, është shumë mirë, por ka edhe një gjë që ende më bren, fakti që ka ende konflikte ndëretnike në Kosovë. Mendoj se është diçka që nuk duhet të ishte megjithëse është e natyrshme pse është kështu.

Pse është e natyrshme?

Po është e natyrshme duke pasur parasysh të gjitha ato krime që janë bërë në Kosovë, gjenocidin që është bërë ndaj popullatës shqiptare, që për fat të mirë nuk më ka ndodhur mua, pra nuk kam asnjë të vranë nga familja apo diçka tjetër. Ajo që më ka ndodhur është se ma kanë djegur shtëpinë dhe kam urrejtje ndaj tyre, urrejtje pra ndaj personave të caktuar për të cilët kam fakte të sakta se kush janë. Por në rregull, ata individë nuk janë më këtu dhe unë megjithëse kam urrejtje, e mbaj në vete.

Si e shikon të kaluarën?

Të kaluarën e shikoj si një tmerr, sidomos vitet '90. Nuk ka pasur mundësi që një i ri t'i dëshmojë aftësitë e tij në ndonjë institucion, universitet apo kudo qoftë. Problemet kanë qenë të pranishme që nga shkolla fillore e deri tek universiteti, ndërsa periudha gjatë luftës ka qenë me të vërtetë shumë, shumë e tmerrshme. Këtu në Gjilan kemi qenë gjithmonë të frikësuar dhe nuk guxonim as të mendonim t'i afrohemi kufirit për shkak se përfliet se të rinjtë i ndalnin në kufi, i keqtrajtonin, i vrisnin, i përdhunonin etj. Thjesht, nuk kemi guxuar të dalim dhe kemi qenë të mbyllur, pra të izoluar. Frika më e madhe ka qenë kur policia na ndau kartonat e verdhë për të cilët thuhej, edhe pse nuk e di se sa është e vërtetë, se bëhej fjalë për politikë të regjimit serb të atëhershëm që përmes tyre të ketë evidencë për të na varrosur nëpër varreza masive. Kjo ishte një frikë me të vërtetë e madhe dhe tërë kohën sa ka zgjatur lufta ishim me familje nëpër shtëpi të familjarëve tonë e jo në shtëpinë tonë.

A mendon se duhet të flitet për të kaluarën?

Mendoj se e kaluara nuk duhet të harrohet. E kaluara është histori dhe ajo nuk bën kurrsesi të harrohet. Duhet, pra, të flitet, por në mënyrë të qetë dhe paqësore.

Të kaluarën e shikoj si një tmerr, sidomos vitet '90. Këtu në Gjilan kemi qenë gjithmonë të frikësuar dhe nuk guxonim as të mendonim t'i afrohemi kufirit për shkak se përfliet se të rinjtë i ndalnin në kufi, i keqtrajtonin, i vrisnin, i përdhunonin etj. Thjesht, nuk kemi guxuar të dalim dhe kemi qenë të mbyllur, pra të izoluar.

Cili është qëndrimi yt lidhur me pajtimin?

Qëndrimi im është se duhet të pajtohemi, duhet t'i ndërtojmë marrëdhëniet e mira ndëretnike, mirëpo të shkohet me hapa të vegjël, duke filluar nga popullata që nuk duhet të ketë më urrejtje ndëretnike. Përderisa ne e urrejmë popullin serb dhe nuk dëshirojmë që ata të jetojnë këtu, atëherë jemi në nivelin e regjimit dhe të serbëve të atëhershëm, të cilët mendonin të na zhduknin me qëllim që të kenë një Serbi të Madhe. Por kjo nuk mund të realizohet kurrë, as prej serbëve e as prej shqiptarëve. Nëse mendojmë që jemi një botë e civilizuar, atëherë thjesht nuk duhet ta urrejmë një person që ndoshta nuk ka bërë asgjë, pa marrë parasysh se çfarë nacionaliteti apo bindjeje fetare ka, sepse edhe ai është qenie njerëzore që merr frymë si ne, ha bukë si ne dhe dëshiron të jetojë këtu si të gjithë njerëzit. Për këtë edhe nuk i çmoj këto urrejtje ndëretnike. Kriminelët duhen të jenë atje ku e kanë vendin – në burg. Ndoshta edhe ndërkombëtarët do të duhej të punonin më tepër në këtë drejtim, sepse siç më duket nuk janë duke u kujdesur fare. Sidomos OKB-ja nuk është duke u kujdesur fare për kriminelët e luftës.

Çfarë paraqet për ty pajtimi?

Pajtimi për mua paraqet përfundimin e dhunës ndëretnike njëherë e përgjithmonë dhe një bashkëpunim më të mirë ndëretnik.

Cilat do të kishin qenë hapat e parë që të arrihet pajtimi?

Së pari do të filloj prej shtetit, prej punës më të madhe. Serbia si shtet apo Unioni Serbi dhe Mali i Zi duhet të dalë institucionalisht dhe t'i dorëzojë kufomat që gjenden ende në Serbi. Përkundër deklaratave të përfaqësuesve serbë se nuk ka të burgosur në Serbi, unë mendoj se kjo nuk është e vërtetë dhe se një numër i madh i të zhdukurve janë gjallë dhe gjenden nëpër burgjet e Serbisë. Unë nuk ju besoj gënjeshtreve politike. Serbia duhet t'i lirojë të burgosurit, sidomos të zhdukurit që janë në Serbi, të gjallë apo të vdekur, dhe gjenden në ndonjë prej varrezave masive.

Ajo duhet t'i kërkojë falje, publikisht dhe institucionalisht, popullit të Kosovës për ngjarjet që kanë ndodhur. Përderisa deklarohen se janë kundër regjimit të Millosheviqit, ata edhe duhet ta dëshmojnë këtë. Ne nuk kemi nevojë për fjalë sepse për fjalë po na kënaqin politikanët tanë sa të duash. Populli i Kosovës ka nevojë për vepra, të shohë faktin, ngjarjen që po ndodhë dhe atëherë ndoshta mund të arrihet ndonjë kompromis ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Sipas teje, kush duhet të punojë në procesin e pajtimit?

Mendoj se ka njerëz të caktuar që mund të punojnë në procesin e pajtimit duke u nisur nga shkalla e parë, pra nga popullata. Popullata duhet ta kuptojë njëherë e përgjithmonë se nuk duhet të ketë urrejtje, nuk duhet të ketë dhunë ndaj një minoriteti, cildo qoftë ai. Vetëm atëherë kur të arrihet kjo, do të ketë edhe pajtim në Kosovë. Po ashtu nevojitet një angazhim i madh i institucioneve të Kosovës. Ato duhet të hapin qendra të ndryshme në komuna. Këto qendra duhet të hapin nënqendra të vogla në fshatra ku ka pasur dhe ku ka kombësi tjera dhe përmes seminareve, trajnimeve, debateve, të diskutohet për të gjitha problemet dhe pse po ngecin gjërat. Mendoj se kjo do të kishte sukses.

A mendon se njerëzit që jetojnë këtu dëshirojnë të pajtohen?

Pasi që kam pasur rast të bisedoj me një numër të madh të qytetarëve mendoj se kur i pyet: "A dëshironi që të mos keni probleme dhe të mos urreheni, të pajtoheni dhe të bashkëpunoni me kombësi tjera?", përgjigjen "Jo". Kur i pyes "Pse?" arsyen

Përderisa ne e urrejmë popullin serb dhe nuk dëshirojmë që ata të jetojnë këtu, atëherë jemi në nivelin e regjimit dhe të serbëve të atëhershëm, të cilët mendonin të na zhduknin me qëllim që të kenë një Serbi të Madhe. Nëse mendojmë që jemi një botë e civilizuar, atëherë thjesht nuk duhet ta urrejmë një person që ndoshta nuk ka bërë asgjë, pa marrë parasysh se çfarë nacionaliteti apo bindjeje fetare ka, sepse edhe ai është qenie njerëzore që merr frymë si ne, ha bukë si ne dhe dëshiron të jetojë këtu si të gjithë njerëzit.



tohen, për shembull, “Ka ndodhur lufta dhe shiko çfarë na ka sjellë” etj. Mirëpo duhet punuar shumë që ky fenomen të shpjegohet dhe të konkretizohen faktet në mënyrë që të binden se nuk ka rrugë tjetër.

Çfarë duhet të bëjë Serbia e çfarë Kosova që të arrihet pajtimi?

Së pari do të flas për vendin tim dhe nuk dua të dal tek komshiu fare. Institucionet e Kosovës duhet të marrin hapa konkretë përmes angazhimit të institucioneve të komunave të ndryshme dhe të qendrave nëpër vende të ndryshme me qëllim që të arrihet pajtimi ndëretnik brenda shtëpisë sonë, Kosovës tonë të madhe.

Ajo që do të duhej të bënte Serbia për ne është që ajo të harrojë njëherë e përgjithmonë se Kosova nuk është më në Serbi apo në Unionin Serbi dhe Mali i Zi, pastaj, siç e thashë edhe më heret, të jetë e gatshme t’i kthejë pengjet e luftës, qofshin ata të vdekur apo të gjallë, t’i kërkojë falje institucionalisht popullit të Kosovës, ta ndërrojë njëherë e përgjithmonë strategjinë e veçantë të hartuar për Kosovën dhe natyrisht, ta pranojë Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran.

Çfarë mund të bëjë një qytetar i zakonshëm që t’i kontribuojë procesit të pajtimit?

Po nisem nga vetja. Edhe unë jam për pajtimin ndëretnik me ata serbë që nuk kanë bërë asgjë. Mirëpo me disa që i kanë duart e përlyera me gjak të Kosovës, me ata nuk ka kurrsesi pajtim. Mendoj se do të kishte qenë mirë që çdokush që ka fakte të sigurta për dikë që ka bërë krime t’i lajmërojë policisë apo organeve gjyqësore dhe të kontribuojë në këtë drejtim. Kjo nuk po ndodh sot në Kosovë dhe njerëzit pastaj nuk e urrejnë individin, por tërë popullin që i përket atij nacionaliteti. Këtu edhe qëndron problemi.

A mendon se faji është kolektiv apo individual për të gjitha gjërat që kanë ndodhur?

Mendoj se faji nuk është kolektiv, por individual. Po e marr si shembull luftën pasi që ajo është një gjë me më shumë kontraste. Është faji individual duke filluar nga Millosheviqi që i ka thirrur këshilltarët e vet dhe kanë përgatitur planin e veçantë strategjik për ta zbatuar në popullin e Kosovës. Synimi i tyre ka qenë t'i dëbojnë shqiptarët nga Kosova dhe të krijojnë Serbinë e Madhe. Definitivisht kemi të bëjmë me faj individual duke filluar prej Millosheviqit, këshilltarëve të tij, armatës së tij. Është një përqindje e konsiderueshme e popullit të Serbisë që e kanë përkrahur luftën kundër shqiptarëve në Kosovë, mirëpo është edhe një përqindje e vogël që nuk e ka përkrahur atë. Këtu bëhet fjalë për atë pjesë të intelektualëve, të cilët e kanë analizuar dhe e kanë kuptuar se nuk duhet të luftohet kundër një qenie njerëzore që ka të drejtë të jetojë në planetin tokë.

Cila ka qenë përgjegjësia e mediave? A ka pasur manipulime?

Gjatë periudhës së luftës e po ashtu edhe para luftës në Kosovë, sidomos *Radio Televizioni i Prishtinës* ka luajtur rol shumë të rëndësishëm dhe lajmet në gjuhën shqipe kanë qenë katastrofale, me plot nxitje dhe urrejtje. Përderisa të gjithë e dinin se shumica e popullatës në Kosovë ishin shqiptarë, folësja thonte “pakica kombëtare shqiptare në Kosovë”. Informatat nga ky burim kanë qenë katastrofale dhe janë përhapur në opinion dhe është manipuluar me qytetarët.

Si e parashikon të ardhmen?

Jam optimist se do të ndryshojë udhëheqja politike në Kosovë dhe se do të jetë një e ardhme më e mirë për të gjithë. Përderisa kemi një udhëheqje politike të njëjtë për gjashtë vite, ku ka ekzistuar një kolaps i vërtetë, kurse për momentin ekziston kolaps i fjetur, popullata dalngadalë do të mllëfoset gjë që do të sjellë trazira.

A ke ndonjë koment lidhur me këtë bisedë?

Më vjen shumë mirë që bëhen intervista të tilla pasi që ka nevojë të dëgjohet edhe opinioni i qytetarëve të Kosovës dhe që edhe një qytetar i thjeshtë të ketë mundësinë të shprehet lirisht për çështjet që na brengosin. Pra është një hap i mirë dhe mendoj që edhe kjo kontribuon në pajtimin ndëretnik. Shpresoj se do të bëhet më mirë edhe pse për momentin është shumë keq.

N. I.

Të lutem, më thuaj diçka për veten...

Ja, unë jam Jadranka, jam 29 vjeçe e gjysëm, edhe pak dhe do të jem 30 vjeçe. Punoj si profesoreshë në shkollën e mesme teknike në Lloznicë. Kjo është, në front çdo ditë, në mposhtjen e vetes dhe njerëzve tjerë...

Si kanë ndikuar tek ti vitet '90, këto luftëra? A mund të thuash diçka për këtë, e di që të kanë ndodhur shumë gjëra...

Me kalimin e kohës, dhemb gjithnjë e më pak, kjo është e para, kurse sa më shumë kohë që kalon e shoh se ajo që vlen edhe ka mbetur. Siç të thashë pak më parë (para intervistës), jam në kontakt me komshinjtë nga Kroacia, të cilët edhe në vitet e luftës kanë qenë njerëz dhe ata na kanë ruajtur praktikisht nga ata që nuk kanë qenë edhe aq të mirë... Ata edhe më tej kanë mbetur njerëz, nuk kanë ndryshuar, kështu që mendoj se ajo që ka pasur vlerë, vlen edhe më tej... Kurse ajo që nuk vlen, del në sipërfaqe, apo jo? Kjo më shërben edhe si ngushëllim, fakti që ata që kanë qenë të mirë nuk kanë ndryshuar fare, kjo më shtyen të eci përpara dhe të besoj në të mirën tek njerëzit... por edhe shpresoj se ata që nuk kanë qenë të mirë do të përmirësohen (gaz). Mendoj se çdokush ka të drejtë të gabojë, por edhe ta ndreqë gabimin.

Çfarë të ka ndodhur gjatë atyre viteve '90 të luftës? Ke jetuar në Kroaci dhe kur ka filluar lufta, ti ke kaluar...

Ah po, kemi kaluar nga Shibeniku në Knin, ku kemi jetuar për një vit e gjysëm, dhe para "Olujës" (ofensiva "Stuhia") kemi ikur nga Knini në Kosovë, dhe atëherë nga Kosova... Por edhe në Kosovë, shqiptarët që kanë qenë në atë kohë atje, pasi që unë kam kontaktuar vetëm me komshinjtë shqiptarë, kanë qenë njerëz shumë të mirë dhe të kulturuar. Pas krejt asaj që ka ndodhur, kur ka pasur probleme, përsëri kanë mbetur njerëz dhe nuk kanë ndryshuar, kanë thënë se sikur të varej prej tyre, ata nuk do të dëshironin që ne të shkonim, por nuk mund të ndihmojnë asgjë sepse do ta sjellin veten në rrezik. Në ato çaste të vështira ata kanë mbetur njerëz. Më vonë edhe jemi takuar ndonjëherë, vijnë ta zëmë në dyqan në atë ndërtesën e izoluar serbe, dhe ashtu në mënyrë të fshehtë pyesin, përsëritjesin të gjithë tek shtëpia, përsëritjesin edhe me dorë kur kalojnë, në mënyrë të fshehtë që mos t'i shohin të tjerët, por nuk e kanë ndryshuar aspak mendimin e tyre për ne, por as ne për ata. Kjo është njerëzore, kjo ndihet, nuk duhet askush ta përshkruaj, ta potencojë, ti e sheh këtë, e ndien. Bile edhe nëse nuk thuhet, e sheh nga sjellja e tyre.

Sa ka lënë kjo gjurmë tek ti për tërë këto vjet?

Mendoj se më ka forcuar. Pikërisht fakti që kam pasur fat të njoh njerëz të mirë në ato çaste të vështira më ka penguar që të kem paragjykime, të urrej dikë, sepse ata njerëz e fshijnë tërë pjesën tjetër të keqe që ka ndodhur. Mjafton të kesh dy njerëz, bile edhe një mjafton që ta mbulojë me hije tërë këtë të keqe. Ka ekzistuar zemërimi në fillim, por nuk ka urrejtje, thjesht kam qenë e pafuqishme, kështu që unë nuk kam bërë asgjë, pse është dashur të ndodhë kjo? Por ka ndodhur në mënyrë që unë të forcohem dhe që të njoh vlerat e vërteta në jetë...

Kontakti ka filluar ngadalë të zhduket, janë bërë gati 14 vjet. Atëherë kam vendosur të shkruaj, të tregoj pak për ne dhe atëherë ata janë lajmëruar. Asgjë nuk ka ndryshuar. Kur dikush është njeri, mbetet i tillë... ka pasur lotë... komshia është tronditur dhe edhe ne jemi tronditur. Pse jemi tronditur ne? Ka qenë diçka e trishtueshme që nga dikush me të cilin je rritur dhe je shoqëruar çdo ditë, gjysmën e jetës mund të them, je ndarë menjëherë.

Si e shikon pajtimin me tërë përvojën tënde që ke? Çfarë është ai për ty?

Po unë nuk kam qenë me askënd konkretisht në konflikt që të grindem, por do të thotë në planin e gjërë është vështirë, më duket...

Pse?

Po, nuk e di, e ndiej që ka mjaft panjohuri dhe paragjykime, sidomos tek njerëzit që nuk kanë përjetuar diçka të tillë dhe që nuk dinë shumë për konfliktet, dhe atëherë dëgjon disa deklaratat të cilat të habisin – nuk kanë lidhje se çfarë ka ndodhur, kurse e urrejnë dikë që as nuk e njohin. Kështu që, së pari duhet të punohet në atë që njerëzit t'i prishin ato shfaqje të këqija sepse nuk mund të urresh dikë nëse nuk e njeh, sidomos jo tërë kombin. A e njeh secilin nga ai komb që të arrish në përfundimin se janë të gjithë të këqinj? Kurse që ti je më i miri. Ndërsa më e keqja është se ai që është i mirë, ai nuk e potencon fare se është i mirë, njerëzit e shohin se është i mirë, kurse njerëzit që nuk janë, ata flasin se janë dhunti e Zotit, kurse në realitet janë të zbrazët dhe ata në fakt i fryjnë zjarrit... Për fat të keq, elemente të tilla ka në të gjitha palët, me sa shoh. Ka edhe nga pala serbe, edhe nga ajo kroate, ka edhe në Bosnje...

Domethënë pajtimi, sipas teje, nënkupton edhe prishjen e paragjykimeve?

Po mendoj se kjo është gjëja e parë. Sikur ta zëmë të rinjtë nga Serbia do të mund t'i njihnin njerëzit nga Kroacia, nga Bosnja... Shumë nga ata kanë lindur pas luftës dhe nuk kanë pasur rast të shohin sesi ka qenë më parë. Dhe tani në bazë të disa tregimeve në shtëpi apo në shoqëri ata ndërtojnë njëfarë fotografie për diçka, për çfarë në të vërtetë nuk e kanë as idenë. Fatkeqësisht të gabuar. Sikur të rinjtë të paktën të mund të shoqëroheshin me njëri-tjetrin sepse ata janë megjithatë e ardhmja. Ajo që më shqetëson është fakti se mjaft të rinj largohen dhe mbesin të moshuarit të cilët nuk janë aq shumë tolerantë...

Theksove se paragjykimet janë gjëja e parë, po çfarë duhet bërë tjetër?

Paragjykimet janë ndoshta problemi më i madh. Pastaj puna me veten. Ta zëmë, si pjesëtare e popullit serb, një karakteristikë e cila nuk më pëlqen është se ne jemi “më të mirët, askush nuk është si ne, popull i Zotit”, nuk e di se çfarë jemi krejt, gjë që në realitet nuk është kështu...

Mjaft njerëz merren me diçka në të cilën nuk besojnë dhe atëherë duhet të gjejnë diçka që u përgjigjet vërtet dhe të punojnë në të, e jo të merren me diçka rreth e përqark, të mos hyjnë fare në thelbin e problemit, e atëherë të përsëndesin me disa etiketime, parulla, kurse në të vërtetë të zbrazët, si tenxherja e zbrazur, pa bazë... Kjo më shkon pak në nerva, pra pse njerëzit nuk punojnë në veten e tyre, por bëjnë zhurmë kot. Kjo është si njeriu që pastron shtëpinë e vet dhe nuk ka kohë të shikojë në oborrin e huaj, kurse këtu duket se çdokush shikon tjetrin dhe çfarë mendojnë të tjerët, çfarë thonë të tjerët, ndërsa veten e përjashton; kopshti i tij rritet, kopshti i shpirtit të tij është i mbushur me plazhna. Domethënë, që njerëzit megjithatë të ulen pak në tokë. Se nuk është çdo gjë aq e përkryer, sidomos tek populli serb; pastaj puna e viktimave, po prit, ngadalë, po nuk je ti viktimë e vetme...

Kush do të duhej të punonte në procesin e pajtimit, në shkatërrimin e paragjykimeve dhe në gjërat tjera që i përmend? Kush do të duhej ta bëjë këtë? Edhe kur dëgjohej se do të duhej nuk thuhet se kush do të ishte ai?

Mendoj se ky është problem i mentalitetit, do të duhej që parku të ishte i pastër, do të duhej që të mos kishte plehra, po do të thotë – ne do të duhej ta bëmë këtë. Sepse, nëse unë i gjuaj plehrat në kazan, e jo pranë tij, nuk do të ketë plehra. Çdokush duhet të fillojë nga vetja, duhet të punojë në veten e tij, të pajtohet me veten e vet para së

gjithash sepse shumë njerëz janë në kolizion me vetveten. Kjo shihet në shoqëri nga numri i grindjeve, vrasjeve... Si të ndërtohet paqja kur ti nuk je në paqe me vetveten?

Do të thotë çdo njeri mund të punojë në këtë. Si?

Ekzistojnë disa vlera njerëzore bazë të cilat duhet të respektohen. Sikur vetëm Dhjetë urdhërat e Zotit t'i respektonin të gjithë, nuk do të kishte kurrfarë problemesh në botë. Të fillohet nga një, ndoshta jo ideologji apo teori, e verifikuar, por nga diçka që me të vërtetë vlen. Por si të niset nga kjo kur njerëzit nuk duan as të dëgjojnë. Ja për shembull, unë konkretisht, nëse e shoh që dy persona grinden, përpiqem të bëj diçka, apo nëse dëgjoj dikë duke thënë “ne viktimat” i them, e kanë bërë këtë edhe tanët, sidomos në Kosovë, atë që e kam parë... Kështu, kur kam folur me kolegen dhe i kam thënë se edhe serbët kanë plaçkitur dhe vjedhur dhe se unë e kam parë këtë, ajo më ka thënë: “Shiko, unë kurrë nuk do të mendoja se ka qenë ashtu”. Nëse së paku një njeriu ia hapë sytë është e mjaftueshme që të fillojë të mendojë pak me kokën e tij, e jo vetëm të pranojë çfarë i përsërisin non stop të tjerët, edhe atë gjithmonë të njëjtën gjë. Sikur bile të ishte i gatshëm t'i hedhin disa gjëra të ndryshme, në mënyrë që të dallojë se cila është e vërteta, e çfarë nuk është... Për pajtimin as që mendohet kryesisht. Njerëzit janë të zhytur në problemet e tyre të përditshme. Do të ishte mirë të jetonim në marrëdhënie miqësore me ish-shtetet, republikat tona të dikurshme, ta zëmë, të kishim marrëdhënie siç i kemi me Bullgarinë, Rumaninë, Hungarinë, diçka e tillë, të afërta, por në distancë, që të mos shkrihem sërish tepër, që të mos plasë përsëri kungulli. Sepse më duket se vendi i mëparshëm është formuar kundër dëshirës së të gjithë qytetarëve të tij.

Theksove se mund të fillosh edhe nga vetja duke ofruar informacione. A ka edhe ndonjë gjë tjetër që mund të bësh ti si “njeri i zakonshëm”?

Ky është një hap, por unë i kam gjithmonë mbi kokë këto paragjykime... Sikur të mund t'i shkatërroja, kurse mundohem aq sa mundem. Jo vetëm ndaj kombeve tjerë, por edhe ndaj grupeve në shoqëri.

Çfarë frikash ekzistojnë, cilat janë pengesat për arritjen e pajtimit?

Mendoj se ekziston frika në çdo popull që të mos ndodhë ajo që ka ndodhur. Për këtë arsye besoj se është më mirë që të fillohet nga njëfarë distance pajtimi, por jo si në rastin kur grinden dy shoqe, po askush më mirë se ata, pastaj plas përsëri, por të përpunohen në mënyrë më të thellë ato marrëdhënie reciproke; por tani është e vështirë sepse njerëzit nuk përzihen mjaft. Ja shikoj televizionin kroat dhe atë serb, shoh që ka mjaft paragjykime nga të gjitha palët për palën e kundërt... Sikur njerëzit të mund të udhëtonin më shumë, të shoqëroheshin, por ke probleme ekonomike dhe nuk mund të udhëtosh; ndoshta disa kampe të lira për rininë, që njerëzit të njihen, që të shohin se ka njerëz normalë edhe në palën tjetër, se nuk janë të gjithë me brirë, e të mos jetë siç u ka rrënjësuar dikush “Të gjithë kroatët janë të këtyllë, të gjithë shqiptarët janë të atillë”. Një shoqe e korit ka qenë para disa kohe në Gjermani në kampin rinor dhe atje ka njohur edhe kroatë të rinj. Ajo thotë se me kroatët është shoqëruar më së miri. Edhe pse ka lindur pas vitit 1980 dhe nuk ka pasur rast të shoqërohet më parë, thotë ja, gjuha na ka afruar; dhe janë shoqëruar më shumë se të gjithë. Kanë mbetur në kontakt, kurse ta zëmë, në jetë nuk i ka parë kurrë kroatët.

Pak më parë the se frikohesh që diçka e tillë mund të ndodhë përsëri. Çfarë të bëjmë me të kaluarën në mënyrë që kjo të mos ndodhë përsëri? Disa thonë të harrohet, disa thonë të ballafaqohemi, të falim – si e sheh ti?

Si matematikane, pasi që çdo gjë ndodh periodikisht, frikohem se lufta është si

funkcion periodik – çdo njëzet, tridhjetë, dyzet, pesëdhjetë vjet... Më mirë është të ballafaqohemi, sepse të harrohet... diçka nuk mund të harrohet. Pastaj është keq që të harrohet sepse kjo është si plaga e infektuar, më pas ajo qelbet, është më mirë që ajo të pastrohet sa është e freskët. Po si të pastrohet? Po nuk e di, para së gjithash ata që e kanë bërë këtë, kanë vrarë njerëz, kanë përdhunuar, plaçkitur – duhet nxjerrë para drejtësisë. Nuk e di nëse ka fare drejtësi sepse kur njerëzit kryesorë në gjyq marrin mito, kujt mund t'i besosh? Sikur ata njerëz të mund të pastroheshin, të pendohen, por si t'i sjellësh deri tek ajo që të pendohen?

Po çfarë mund të bëjnë “njerëzit e zakonshëm” me të kaluarën e tyre?

Çdokush bart aq sa mund të çojë, aq edhe i është dhënë. Unë e kam zier pak, unë e kam përpunuar në mënyrë që të nxjerrë atë që është e mirë nga tërë ajo që ka ndodhur. Edhe atyre njerëzve që i kanë përgjakur duart, nëse asgjë tjetër, duhet të fillojë t'u punojë ngadalë ligji i ndërgjegjes. Kështu, ta zëmë, ka njerëz që fillojnë të lajmërohen vetë, të cilët fillojnë të flasin vetë se çfarë ka ndodhur sepse i vret ndërgjegja, sepse kanë zemër dhe shpirt. Motra ime ka punuar tamam aty në Lloznicë në një bar. Një ditë ka ardhur një djalosh, ka qarë dhe ka treguar në gjendje të dehur se ai nuk ka dashur ta bëjë këtë; ajo ka filluar ta pyes se çfarë. I ka thënë se si ushtar të thjeshtë e kanë urdhëruar të vrasë disa civilë, dhe ai ka qarë aty, duke thënë “unë nuk kam dashur ta bëj këtë, unë nuk kam dashur ta bëj këtë”. Domethënë, megjithatë disa i vret ndërgjegja. Nëse nuk mundet t'u kërkojë drejtpërdrejtë falje njerëzve të cilëve ua ka vrarë dikë, megjithatë ka arritur deri tek ai se nuk është dashur ta bëjë atë... më së keqi është kur njerëzit bëjnë diçka dhe jetojnë me bindjen se ajo është mirë, kurse në fakt nuk është, si p.sh. kur thonë “vraje shqiptarin, vraje serbin, vraje kroatin”, pse? Edhe atë e ka lindur nëna, edhe për të do të qajë nëna. Por më duket se njerëzit e zakonshëm, të cilët nuk kanë kaluar nëpër tërë këtë, ndoshta as që janë të ngarkuar me këtë. Shtrohet pyetja, nëse mendojnë bile fare për pajtimin, a kanë nevojë të pajtohen me dikë me të cilin as që janë grindur.

A ke ti nevojë të mendosh për pajtimin?

Disi nuk jam e sigurt, sidomos pasi që unë nuk kam qenë në ndonjë konflikt direkt, nuk kam diçka për të cilën do të ankoheja, nuk i kam bërë dikujt diçka të keqe. E di se komshinjtë shqiptarë, pasi që nuk kanë qenë aty gjatë kohës së bombardimeve, disa të tjerë u kanë hyrë në shtëpi dhe e kanë përmbysur atë, kurse unë kam hyrë që t'i kthej gjërat në vend sepse më ka ardhur keq që njerëzve... ta zëmë, ai ka qenë profesor i anatomisë, më ka ardhur keq që librat t'i qëndrojnë të shkapërdërdhura dhe unë i kam kthyer në vend pas asaj bastisjeje. Çfarë kam mundur të bëj tjetër? Kur fqinja ime shqiptare është kthyer nga Maqedonia, banesa e saj ka qenë e përmbysur. Ata nuk e hanë mishin e derrit; i është lënë koka e derrit, e pjekur, kurse gruaja ka vjellur në shtëpinë e saj, kurse mua m'i ka dhënë nëna disa qesëza çaji kamomili që t'ia çoj. Gruaja ka filluar të qajë dhe të nxjerrë paratë, kurse unë i kam thënë: “jo, fqinje!” Nuk ka mundur të besojë, motra ka shkuar t'i ndihmojë të pastrojë tepihin. Kjo ka qenë tamam në periudhën nga 10-20 qershori, kur çdo gjë është “përmbysur”. Motra ka pasur po ashtu një mik shqiptar dhe gjatë kohës së bombardimeve ai dhe familja e tij kanë qenë të mbyllur në banesën e tyre dhe ajo ka shkuar disa herë megjithëse ka qenë e rrezikshme të trokitet atje në derë, edhe për shkak të policisë, edhe për shkak të çdo gjëje tjetër. Më vonë, kur ne nuk kemi pasur ushqim, ata na kanë sjellur ne miell dhe qumësht, edhe atë nga pjesa tjetër e qytetit. Ti e rrezikon jetën të shkosh dhe të kthehesh. Ajo njerëzoria, ajo është e vetmja që mbetet, këto janë ato shkëndijat nga

Ta zëmë, më ka goditur lajmi kur kam dëgjuar për Srebrenicën, vetëm në vitin 2001, sepse deri atëherë nuk kam ditur gjë... Nuk kemi pasur para për të blerë antenën satelitore, nuk kam pasur mundësi të dëgjoj radiostacionet e jashtme e as të lexoj revistat e huaja; thjesht, nuk kam ditur. Këtu bëhet fjalë edhe nëse dëshiron... por kur nuk ke mundësi të shikosh palën tjetër, por ke vetëm *RTS 1* dhe sinjal të dobët të *RTS 2*, ose e shikon atë ose nuk shikon asgjë. Dhe unë nuk kam ditur gjë për atë.

ajo bloza që ka mbetur pas. Ajo e mirë njerëzore xixëllon edhe më tej. Nuk kam hidhërim, nuk dua të helmohem. Për fat të mirë, Zoti ma ka dhënë që të shoh atë anën e mirë, të mira ka kudo, kush don ta shohë – e sheh, kurse kush nuk don, nuk e sheh... unë dua ta shoh.

Çfarë paraqet për ty ballafaqimi me të kaluarën? A do të thotë kjo të ballafaqohesh me përgjegjësinë?

Ky është ballafaqim me vetveten, çfarë ke bërë vetë, pendesa, ta shikosh vetveten, të shohësh se ajo nuk ka qenë mirë.

Çfarë duhet të bëjë populli në aspektin e pajtimit? Çfarë duhet të bëjë, ta zëmë, populli të cilit i takon?

Para së gjithash të ndërpresë të luaj rolin e viktimës. Jo ta luaj, mendoj se kjo është aq shumë e rrënjosur, por të mendojë vërtet se është viktimë, pastaj t'i respektojë viktimat e huaja, jo vetëm viktimat e tij. Ekzistojnë të dhëna se sa ka të zhdukur; kur përmendet se sa ka të zhdukur nga pala serbe, le të përmendet se sa ka të zhdukur edhe tek palët tjera. Nuk jam ithtar i statistikave matematikore sesa është kjo në përqindje në raport me popullin sepse çdo viktimë ka vlerë të njëjtë, ai është fëmija i dikujt, apo vëllai, babai ose bashkëshorti. Ashtu si në rastin kur thonë – janë vrarë kaq njerëz, por pesë njerëz janë pesë familje, kjo nuk bën të thuhet kështu. Por ka tendenca të tilla tek ne, si “ajo është një shifër e vogël”. Nuk është kjo ndonjë shifër! Për dikë që i ka ndodhur kjo, për të është tërë bota, kështu që nuk di... Të flitet pak më tepër. Po mirë, flitet, por çdo gjë pritet disi me thikë në asht. Ka qenë në B92, ka emisione të tilla, unë i kam shikuar, më kanë munduar, por i kam shikuar. Më mirë do të mundohem sesa ta mashtroj veten. Torturohesh edhe kur shikon se çfarë ka ndodhur te pala tjetër. Ta zëmë, më ka goditur lajmi kur kam dëgjuar për Srebrenicën, vetëm në vitin 2001, sepse deri atëherë nuk kam ditur gjë... Nuk kemi pasur para për të blerë antenën satelitore, nuk kam pasur mundësi të dëgjoj radiostacionet e jashtme e as të lexoj revistat e huaja; thjesht, nuk kam ditur. Mua më ka thënë kolegu i punës dhe kur e ka parë se nuk di gjë, më ka thënë se jam aktore e shkëlqyer. Por unë vërtet nuk kam ditur. Këtu bëhet fjalë edhe nëse dëshiron... por kur nuk ke mundësi të shikosh palën tjetër, por ke vetëm RTS 1 dhe sinjal të dobët të RTS 2, ose e shikon atë ose nuk shikon asgjë. Dhe unë nuk kam ditur gjë për atë.

Si je ndier kur ke dëgjuar për këtë?

Menjëherë më është kujtuar Kragujevci. 50 vjet flitet për të, vërtet është e tmerrshme, ti flet për atë 50 vjet, kurse pesë vjet nuk e përmend fare Srebrenicën... Nuk qëndron problemi në faktin se kur është dikush i keq ndaj teje, ti je më i keq se ai, por përpiqu të mbetesh ai që je, të mbetesh më i mirë se ai. Kjo më frikëson. Këtë nuk e ka bërë një njeri, por shumë njerëz...

Kur thua se nuk kemi të bëjmë me një njeri, por me shumë njerëz, si e sheh përgjegjësinë, a është ajo individuale apo kolektive? Si qëndron puna me çështjen e fajit?

Nuk e di sesi mund të jetë kolektive kur unë as që kam ditur atëherë gjë. Ajo ka qenë e tmerrshme dhe kur e kam shikuar në B92, unë kam mbetur e shtangur. Kolektive? Nuk jam e sigurt. Është vështirë, nuk e di se çfarë do të mund të bëja për këtë çështje edhe sikur të kisha ditur.

Po tani?

Kur fillojnë të thonë “kaq kanë vdekur”, mund të them “edhe nga pala tjetër janë rreth dyzet mijë”. Është turp të flas kështu sepse çdonjëri është njeri... Jeto ti me atë plagë

duke mos ditur se ku e ke dikë dhjetë vjet. Çfarë mund të bëj unë – të flas. Nganjëherë e pyes veten se çfarë është ajo që i dallon njerëzit, a është ndonjë përbërje në gjak e cila përcakton se çfarë je ti e çfarë nuk je.

Si e sheh të ardhmen me këtë të kaluar?

Uh... ajo që më shqetëson më tepër është se ka mbetur aq kalbësi mbi të cilën do të mbesë ky shtet. Ata që vlejné, shkojnë jashtë. Kjo më shqetëson. Dhe nuk largohen vetëm njerëzit nga Serbia, por edhe nga Kroacia, Bosnja, kurse të moshuarit mbesin me njëfarë hidhërimi të theksuar. Tani e vërej, ka aty njerëz që mendojnë. Njerëzit në pushtet në këto shtete janë produkt i trupit votues në vendet e tyre, e atyre që i kanë zgjedhur. Tani ne mund të themi njerëz të këqinj – pushtet i keq. Kjo më shqetëson.

A mund të flasim për përgjegjësinë e atij trupi votues?

Po, ka shumë që pajtohen me fatin, “çfarë mund të bëj unë”, ka mjaft njerëz të cilëve kjo edhe nuk u intereson më, gjithnjë e më pak dalin në votime. Ndoshta nuk kanë kohë as të mendojnë nga hallet, problemet, dhe atëherë nesër vjen në pushtet një i çmendur i ri dhe hajde të luftojmë. Frikohem... nëse nuk don ti të marrësh pjesë në këtë, atëherë dëshiron dikush tjetër. Dhe ai tjetri do të përbëjë shumicën megjithëse ai ndoshta nuk është shumicë. Për shkak se të tjerët heshtin. Ta zëmë, shumica e britanikëve nuk janë për atë që të dërgohen ushtarët në Irak, por janë dërguar, sepse ata që kanë dalur në zgjedhje janë për këtë, kurse ata që nuk janë për këtë as që duan të dalin në zgjedhje, nuk u interesojnë. Atë që edhe ke mundur ta parandalosh, tani e bën dikush tjetër. Nuk është tamam e ndritshme...

Para se e kemi filluar intervistën ke thënë diçka që menjëherë të ka asocuar në pajtim... që u ke shkruar komshinjtë tuaj në Kroaci.

Që nga viti '91 kur jemi larguar, njerëzit kanë mbetur njerëz deri në fund, kanë dalë të përshëndetën me ne përkundër thërritjeve dhe kërcënimeve të kalimtarëve që nuk na kanë njohur. Derisa numrat e telefonave kanë qenë të njëjtë, jemi dëgjuar. Kontakti ka filluar ngadalë të zhduket, janë bërë gati 14 vjet. Atëherë kam vendosur të shkruaj, të tregoj pak për ne dhe atëherë ata janë lajmëruar. Asgjë nuk ka ndryshuar. Kur dikush është njeri, mbetet i tillë... ka pasur lotë... komshia është tronditur dhe edhe ne jemi tronditur. Pse jemi tronditur ne? Ka qenë diçka e trishtueshme që nga dikush me të cilin je rritur dhe je shoqëruar çdo ditë, gjysmën e jetës mund të them, je ndarë menjëherë. Më pas takon shumë pak njerëz si ai dikushi, kështu që ajo me siguri ka menduar njëjtë. Na kanë ftuar të shkojmë, edhe ne i kemi ftuar ata. Pjesa e trupit tënd të gicilon sepse ata janë pjesa yte dhe edhe ti je pjesa e tyre. Vetëm pak është çrrënjësor për shkak të disa të tjerëve... Kur flitet diçka, sikur zhduket vlera e saj. Por duhet të flitet. Në qoftë se mbahet në vete, askush nuk e merr vesh.

A ke edhe ndonjë gjë tjetër të shtosh në fund?

Të fillojë secili nga vetja. Ka të tillë që nuk duan dhe të tillë që nuk dinë... Si t'u ndihmojmë. Atë që mundem, atë edhe e bëj. Për fat të keq, nuk mund të bëj shumë, por nëse e shkundi ndonjërin që të mos luaj heroin i cili përshëndet me shpatë në ajër, leh e nuk han, t'ia uli pak kokën... Edhe pak mjafton, pak nga pak. Sikur çdonjëri të bënte nga pak, me siguri do të krijohej diçka e madhe. Aq sa mundem, mendoj se kam sukses. Vetëm kur të thotë dikush “ja, për atë nuk kam mundur të mendoj kurrë”, do të thotë, ja, tani ke rast ta mendosh! Pastaj ndoshta do t'ia thotë edhe dikujt tjetër nga rrethi i tij i cili ka menduar si ai dhe atëherë do të përhapet si vala.

Edhe pak mjafton, pak nga pak. Sikur çdonjëri të bënte nga pak, me siguri do të krijohej diçka e madhe. Aq sa mundem, mendoj se kam sukses. Vetëm kur të thotë dikush “ja, për atë nuk kam mundur të mendoj kurrë”, do të thotë, ja, tani ke rast ta mendosh!

Unë jam kroate më e madhe sepse
punoj në të mirë të shtetit tim

Kur e hedh shikimin në atë periudhë të viteve '90, çfarë kujton, çfarë ndjenjash të vërshojnë?

Më kujtohet njëlloj frike joreale nga fqinji i deridjeshëm, më kujtohet se tre-katër muaj nuk kemi fjetur natën, por gjatë ditës, dhe kemi bërë roje rreth shtëpive e kështu... Nga perspektiva e sotme ajo ka qenë krejtësisht e panevojshme, jo frika ime, por të gjitha ato ngjarje të cilat kanë mundur të shmangen me ndonjë marrëveshje të mençur politike që sot arrihet dhe nuk e kuptoj se pse në vitin '91 nuk ka arritur të bëhet. Shumë njerëz kanë vdekur dhe shumë të tjerë kanë mbetur pa asgjë saqë sot 10-15 vjet pas kësaj e tëra të reduktohet vetëm në të. Njerëzit duhet të jetojnë bashkë.

Nga kush mendon se është varur kjo në vitet '90? Çfarë ka mundur të bëhet që të mos vinte deri tek ajo?

Nga mençuria politike, vetëm nga ajo, nga asgjë tjetër. Nga dëshira politike e Zagrebit dhe e Beogradit, kurse një pjesë edhe e Sarajevës. Tani ka njerëz që pas gjithë asaj kthehen. Shiko, unë komunikoj normalisht me të gjithë ata për të cilët e di se nuk kanë bërë diçka, ndërsa ai për të cilin e di, ai as që është shfaqur, ai as që më është drejtuar e as që e ka mendjen ta bëjë këtë. Mirë, unë mendoj se nuk duhet të harrohet se çfarë kush ka bërë, por jeta duhet të ecë përpara. Sidomos nga perspektiva e punës me të cilën merrem, askujt nuk i shkruan në ballë se kush është dhe çfarë është. Kush është mysafir i rregullt, kush është i bukur, i dashur, i mirë, çdo-kush është i mirëseardhur.

Nga ajo trashëgimi e viteve '90 megjithatë ka rrjedhë diçka. Si duhet, sipas mendimit tënd, të sillemi ndaj të kaluarës së luftës, kriminelëve, pastrimeve etnike...?

Duhet të punojmë në atë që njerëzit më në fund të fillojnë të jetojnë. Mendoj se Knini është megjithatë qyteti më specifik nga të gjitha qytetet tjera në Kroaci që kanë qenë në luftë sepse shumë njerëz kanë ardhur, punë nuk ka as për vendorët, për të ardhurit aq më pak, çështja e banimit është e pazgjidhur, çdo gjë është në fakt e pazgjidhur. E vetmja gjë nga e cila njerëzit mund të jetojnë këtu është ajo se ende shikohet kush je dhe çka je, aso nacionalizmi ka ende. Në këtë mjedis kjo do të zgjidhet më së voni.

Pse sipas teje ekziston ende shikimi i njerëzve përmes nacionalizmit dhe përmes asaj se kush je dhe çfarë je?

Për arsye se njerëzit nuk kanë asgjë tjetër, nuk kanë asgjë tjetër për çfarë të kapen. Në vitin 1991 të gjithë janë kapur për të, si për shembull, do të fitosh shtetin tënd dhe ky do të jetë kulmi. Fakti që në atë shtet nuk do të kesh çfarë për të ngrënë, që do ta kesh dyfish më keq për çdo gjë, kjo për askënd nuk ka qenë aq e rëndësishme.

Ka qenë një anketë në *Televizionin* kroat para një dhjetë ditësh, tamam nga Knini. E ndalon fëmijën, nxënës të shkollës së mesme në rrugë, dhe e pyet se a shoqërohet ai me serbë dhe ai thotë jo. Unë e di se shoqërohet, ka shoqëri në të cilën janë së paku dy serbë. Ai ose nuk e din se ata janë serbë ose për shkak të opinionit duhet të thotë se nuk shoqërohet me ta. Nuk e di se çfarë është në pyetje. Megjithatë është në televizion dhe kur ta shohë nëna, mos të dalë pastaj: po me kë shoqërohesh ti?



Nga Knini janë larguar shumë njerëz, disa të tjerë kanë ardhur, a flitet për këtë, a flitet mjaft apo është temë tabu?

Po, nuk e di. Unë qarkulloj në shoqërinë e njerëzve që kanë mendime relativisht normale kështu që nuk mund të flas me siguri. Unë di për atë se cili grupim i njerëzve, përafërsisht, për çfarë flet. Njerëzve që kanë qenë në luftë, njerëzve që janë të sëmurë nga PTSP, është normale që për ata është më e rëndësishmja në botë zgjidhja e statusit të tyre, shtoja kësaj edhe faktin se as ata nuk i zgjedhin më njerëzit në bazë të asaj se do të bashkëpunojnë me dikë që është gjakpastër i theksuar; bashkëpunojnë ata edhe me serbë njëjtë, por gjithmonë aty ka pak vonesë. Don apo nuk don, jeton me ata njerëz, kjo duhet të zgjidhet me kohë dhe do të vijë koha që njerëzit të jetojnë përsëri si më parë. Ka qenë një anketë në *Televizionin kroat* para nja dhjetë ditësh, tamam nga Knini. E ndalon fëmijën, nxënës të shkollës së mesme në rrugë, dhe e pyet se a shoqërohet ai me serbë dhe ai thotë jo. Unë e di se shoqërohet, ka shoqëri në të cilën janë së paku dy serbë. Ai ose nuk e din se ata janë serbë ose për shkak të opinionit duhet të thotë se nuk shoqërohet me ta. Nuk e di se çfarë është në pyetje. Megjithatë është në televizion dhe kur ta shohë nëna, mos të dalë pastaj: po me kë shoqëroresh ti? Nuk e di se cili është motivi, ne tamam jemi qeshur për këtë...

A buron kjo nga ndonjë frikë?

Jo, por nga urrejtja.

Nga buron kjo urrejtje?

Unë kam qenë vitin e kaluar në Serbi. Rastësisht kam shikuar njëfarë emisioni televiziv ku ka qenë njëloj *talk show*. Nuk e di se kush ka qenë mysafir, por tema ka

Mua më shikoj-
në ende si
delen e zezë,
megjithëse në atë kohë
unë dhe i dashuri im i
mëparshëm, i cili ka
qenë ushtar kroat në
luftë dhe i cili me kohë
e ka parë se çfarë
është kjo dhe ka hequr
dorë, dhe e ka pasur
epitetin e kroatit të
madh... Por ne kemi
qenë lokal serb sepse
nuk kemi menduar si
shumica e njerëzve.

qenë lidhur me refugjatët nga Kroacia. Njerëzit lajmëroheshin; ata thjesht nuk i durojnë ata refugjatë atje. Ata mendojnë po ashtu se refugjatët duhet të vijnë vetë në Kroaci dhe t'i zgjidhin çështjet e tyre, e jo të presin që Serbia t'ju zgjidhë atyre problemin e kthimit të pronës; opinion krejt normal apo jo... Nga përvoja di njerëz të cilët nuk duan të vijnë, të cilët frikohen të vijnë në Kroaci edhe pse këtu mund të shihen edhe targa të Beogradit dhe të gjitha targat e mundshme nga Serbia, të cilëve nuk ju ka ndodhur asgjë. Nëse dikush edhe e ka gjetur ndonjë punë diku në Serbi, ai as që do të kthehet këtu ku nuk ka punë dhe ku do të jetojë me halle me një ndihmë sociale, pse do të kthehej...

Pse urrejtja... sikur të isha ndoshta refugjate e popullit tim... si nuk do ta urreje dikë që ta ka bërë atë dhe të ka lënë pa asgjë. Kjo është thjesht akoma kështu, fatkeqësisht, megjithëse mendoj se ashtu siç ka qenë para tri viteve... nuk mund të thuhet se nuk janë bërë disa hapa përpara.

Mbi çfarë baze shihet kjo lëvizje kah e mira dhe si ka qenë para tre vitesh?

Para tri vjetësh tamam nuk ke guxuar të thuash diçka as lidhur me vetë boshnjakun, i cili është vendosur aty, ka zënë shtëpinë e huaj, kurse shtëpinë e tij në Bosnje e ka shitur dhe për të ka marrë para të mira. Për çdo muaj ka shkuar ta marrë ndihmën sociale në Bosnje dhe ka pasur edhe ndihmën sociale këtu. Sikur të kishe thënë diçka publikisht për ta në gazetë do të fitojë shuplaka në rrugë, gjë që edhe i ka ndodhur një mikut tonë, e lëre më që ke mundur të promovosh se ne megjithatë duhet të jetojmë bashkë, duhet të bëjmë diçka në mënyrë që ta bëjmë jetën sado-kudo të durueshme. Sot nuk është ashtu, megjithatë mund të flasësh dhe të shkruash çdo gjë, dhe askush nuk të bën asgjë, nuk do të nxitësh reagime aq të mëdha. Pas këtyre zgjedhjeve lokale unë kam ndier frikë. Unë as tani, si kroate e lindur në Knin (bashkëshorti im është serb), nuk kam liri.

Pse?

Për shkak se pas këtyre zgjedhjeve lokale i kanë numëruar dhe i kanë thirrur me emër në qytet, nëpër gazeta, në bashkinë e qytetit, u kanë bërë thirrje njerëzve të cilët nuk kanë dalur në zgjedhje. Kjo është e dhënë që do të duhej të ishte e fshehtë, e cila nuk do të duhej të dilte në opinion; dhe kujt i intereson, më në fund. Çfarë do të thotë kjo atëherë, që mund të shihet se edhe për kë kam votuar unë në bazë të numrit të fletës së votimit. Kështu që e gjithë kjo është katastrofale në këto mjediset e vogla. Kur shkon diku ku askush nuk të pyet gjë, kthehesh dhe e gjithë kjo të godet në kokë dhe mezi pret të largohesh nga këtu...

Si e përjeton ti pajtimin, çfarë bart me vete për ty domethënia e kësaj fjale?

Pajtimi, hmm, kjo është çështje e secilit person personalisht sesi ai e përjeton atë. Ku di unë, unë nuk mund të pajtohem me dikë nëse më ka bërë diçka keq. Unë mund të them, mirë, ka Zot, do ta gjykojë Zoti apo dikush tjetër, nuk e di, nuk do ta gjykoj unë, por nuk do të kem ndonjë lidhje me të. Ndërsa tani pajtimi, tamam ajo... kjo është ajo që kam thënë se duhet disa gjëra t'i kuptojmë si: kjo ka qenë dhe ka kaluar dhe ecim më tej. Duhet shikuar që në të ardhmen fëmija im të mos ketë lidhje se as kush është, as çfarë është. As që kësaj duhet dhënë rëndësi. Por që t'i interesojë se a mund të punojë aty, a mund të jetojë aty, a ka banesë, a e ka të siguruar ekzistencën. Kur të vijë kjo, atëherë ky mund të quhet pajtim.

A mund të ketë pajtim në qoftë se nuk flitet mbi atë se çfarë ka ndodhur dhe mbi shkaqet?

Nuk mundet, unë mendoj se jo. Vetëm duhet të shikohet doza e sinqeritetit kur bisedon me dikë, në mënyrë që të mos jetë që një gjë flas derisa jam me ty për shkak se je serb, ndërsa ndryshe flas me ndonjë kroat.

Si të punohet në procesin e pajtimit, kush duhet të jetë bartës i këtij procesi, konkretisht në këtë mjedis?

Mendoj se të rinjtë janë bartës të këtij procesi, ata do të duhej të ishin të pangarkuar. Normalisht që familja nëse e ka humbur dikë të afërm si vëllain, babain, nuk do ta ketë të lehtë të përfshihet në këtë proces. Megjithatë, mendoj se 90 për qind e njerëzve nuk kanë pasur trauma të këtilla. Sidomos ata fëmijë, ato gjenerata të reja, le ta zëmë viti i parë i shkollës së mesme, mendoj se ata do të duhej të ecin me logjikën: nuk ma ndien se me kë dal, dal me shoqen sepse është e mirë dhe jo sepse është ajo që është në bazë të kombësisë. Por, këtu shitet me të madhe prona e serbëve, ata e shesin vetë sepse nuk shohin këtu kurrfarë ardhmërie. Nuk është kjo ekskluzivisht për shkaqe politike, por për shkaqe ekzistenciale. Sidomos tani, pas këtyre zgjedhjeve lokale në Knin ku serbët kanë fituar numrin më të madh të votave. Ashtu siç jam kundër asaj që diaspora kroate të votojë nga Australia se kush do të jetë kryetar i shtetit dhe kryetar i Kuvendit, në të njëjtën mënyrë jam edhe kundër asaj që autobusët nga Serbia të vijnë me njerëz që nuk kanë qëllim të jetojnë në Kroaci që të votojnë për këtë pushtet këtu. Vetëm u bëjnë keq serbëve të këtushëm. Ndërsa këtu ata janë të zhvendosur në anën kah: prej nga e drejta që ju tani të zgjidhni cilindo? Kurse për pesë vjet, kjo është e pashmangshme, edhe nëse do të kthehen të gjitha ata njerëz, do të kenë këtu shumicën dhe ata do të pyeten. Por mendoj se këto janë lojërat e Zagrebit dhe njerëzve që përfaqësojnë pakicën serbe në Kroaci, shit-blerja e tyre.

Kur bëhet fjalë për pajtimin, çfarë mund të bëjnë, sipas mendimit tënd, “njerëzit e zakonshëm”?

Mendoj se nuk mund të bëjnë shumë, në këtë mjedis nuk mund të bëjnë shumë pa politikanët, assesi. Pajtim do të ketë atëherë kur serbët të fillojnë të fitojnë punë në shërbimet shtetërore, në pajtim me numrin sa janë në Knin. Në atë mënyrë mund të lëvizë diçka dhe të thuhet se ai proces ka filluar. Kështu, derisa ata janë tabu sa i përket punës dhe çfarëdo aktiviteti tjetër, deri atëherë nuk ka ndonjë lloj pajtimi. Në njerëzit e vegjël të zakonshëm mund të flasim, por kjo nuk vlen shumë derisa ekziston propagandë krejt e kundërt në gazeta, televizion, Qeveri, Kuvend. Mua si pjesëtarë e popullit kroat që i kam kaluar të gjitha këto nuk më duhet kurrfarë kërkim faljeje apo ndjese. Nuk duhet të shikohet shumë në ato forma, çfarë do të pranojmë, sepse ne atëherë nuk kemi pasur të drejtë. Ashtu është siç është, je kthyer, nuk ta kam dhënë unë as lejqëndrimin në Knin, as letërnjoftimin, as lejen e qarkullimit, ta ka dhënë dikush që mendon se ke të drejtë të jesh aty, andaj kush jam unë që të gjykoj. Në planin e pajtimit nuk duhet askush të më kërkojë falje, por të jetë ajo: ka qenë çfarë ka qenë, ecim më tej. Për këtë duhet të kesh bashkëbisedues normal, por ka shumë njerëz jotolerantë që flasin në stilin: mund ta thuash ti tënden, por kjo nuk është ashtu, sepse unë mendoj se je fajtor ti dhe populli yt. Por duhet të bisedohet... Duhet të mbahen tryeza të rrumbullakëta, nëse sot kanë ardhur pesë vetë, pas një muaji do të vijnë 15 dhe kështu do të zgjerohet rrethi.

Kur flasim për procesin e pajtimit dhe procesin e ballafaqimit me të kaluarën, a bartim ne si individë ndonjë lloj të caktuar përgjegjësie?

Unë mendoj se po. Unë mendohem që ta bëj këtë së paku brenda barit tim. E kemi

Cdokush që mendon në mënyrë normale do të duhej t'i kishte pesë njerëzit e tij për bisedë, kështu që pesë nga pesë arrihet njëfarë numri... Konstatimi im është se çdo kroat në Knin e ka serbin e vet. E di atë, serbët janë të këqinj, por shiko këtë, ky është i mirë për mua sepse unë e njoh atë. Mendoj se edhe kjo është një mënyrë e punës...

hapur para shtatë vitesh në kohën kur është shikuar shumë se kush je dhe çfarë je. Kjo në këtë bar nuk është shikuar kurrë, por për këtë arsye lokali im quhet lokal serb. Kjo është edhe tani qesharake. Këtu është lejuar, jo lejuar, por ka qenë gjëja më normale, që të vijë kushdo, të pijë sipas rregullit, të paguaj dhe nuk ma ndien se kush është dhe çfarë është. Për këtë arsye tek ne kanë ardhur të gjitha llojet dhe kombet: të bardhë, të zezë, muslimanë, ebrejë, nuk ka mbetur kush pa ardhur...

Mua më shikojnë ende si delen e zezë, megjithëse në atë kohë unë dhe i dashuri im i mëparshëm, i cili ka qenë ushtar kroat në luftë dhe i cili me kohë e ka parë se çfarë është kjo dhe ka hequr dorë, dhe e ka pasur epitetin e kroatit të madh... Por ne kemi qenë lokal serb sepse nuk kemi menduar si shumica e njerëzve. Unë jam e gëzuar kur pesë të rinj flasin me mua dhe unë atyre përpiqem t'ju shpjegoj disa gjëra se nuk është tamam krejt bardhë e zi siç thuhet në televizion. Unë ndihem e kënaqur kur e shoh që më kanë dëgjuar dhe nesër me siguri iu është kujtuar, sepse megjithatë e kam njëllot autoriteti tek ata të rinj. Kjo është përgjegjësia ime sepse nuk mund të dëgjoj nëse dikush flet keq, mua më duhet t'i afrohem dhe t'i them se nuk është tamam ashtu. Ajo është pjesë e punës që duhet ta bëj dhe e bëj. Çdo-kush që mendon në mënyrë normale do të duhej t'i kishte pesë njerëzit e tij për bisedë, kështu që pesë nga pesë arrihet njëfarë numri... Konstatimi im është se çdo kroat në Knin e ka serbin e vet. E di atë, serbët janë të këqinj, por shiko këtë, ky është i mirë për mua sepse unë e njoh atë. Mendoj se edhe kjo është një mënyrë e punës...

Ja një pyetje personale, në të cilën natyrisht, nëse nuk don, nuk duhet të përgjigjesh. Ti je e martuar me serb, çfarë mendon, sikur të kishte më tepër raste të tilla, si do të ndikonte kjo në procesin e pajtimit?

Tek unë kjo është pak më ndryshe sepse bashkëshorti im nuk ka lidhje me Kroacinë. Ai ka ardhur ta vizitojë gjyshen në Zarë dhe jemi njohur, nuk ka qenë refugjat nga Knini dhe është kthyer, por ne jemi njohur pas luftës. Mendoj se ajo është një mënyrë e inicimit të procesit të pajtimit megjithëse mua disa njerëz edhe sot më shikojnë me sy të keq për këtë arsye. Mua nuk ma ndien fort për këtë sepse secili që do të më thonte diçka, unë do t'i them dhe do t'i dëshmoj me jetën time se jam dhjetë herë kroate më e madhe se ai dhe se nuk mund të më bëjnë asgjë. Kroate më e madhe në kuptimin që punoj mirë për shtetin tim dhe se të gjithë njerëzit janë për mua të njëjtë.

S. D.

Të ndërpritet cikli i dhunës

A mund të na tregoni diçka për veten tuaj?

Quhem Mevludin, me profesion jam inxhinier i makinerisë, jam i martuar dhe kam tre fëmijë. Jeta ime është e zakonshme.

Si e ndieni veten tash, gjashtë vite pas luftës?

Po të isha kthyer në të kaluarën do të isha habitur me vetveten, nuk kisha besuar se jam i njëjti. Kam ndryshuar shumë për shkak të rrethanave që na kanë shoqëruar viteve të fundit. Një kohë me presione të të gjitha llojeve, gjithmonë jashtë “sistemit” dhe jashtë skemave sociale, që më ka transformuar në një njeri krejt tjetër.

Nuk mendoj njësoj dhe nuk besoj njësoj. Çka është më e keqja, unë nuk e ndiej veten mirë. Këtë kohë ose këtë moshë e kam menduar ndryshe. Pos ambicieve profesionale, kam pritur një klimë krejt tjetër, qoftë ajo shoqërore, ekonomike dhe politike, tek e fundit.

Kam menduar se populli im do të dalë nga lufta si një popull me një vetëdije më të qytetëruar, me ndjenjën e sakrificës dhe më i përcaktuar për një të ardhme më të mirë. Mendoja se nuk do të kemi nevojë për ndihmë (edhe gjashtë vite pas konfliktit) sikur të ishim të paaftë. Kam pritur se falë përvojës së hidhur të së kaluarës, ne do ta harrojmë domethënien e fjalës korrupsion, varfëri, hajni etj. Kam menduar se individët të cilët do të detyrohen t'i bartin proceset politike (politikanët) do të jenë njerëzit më të mirë dhe të zgjedhurit e popullit tim. Nuk doli ashtu sepse individët, që falë zgjedhjeve të organizuara nga ndërkombtarët na përfaqësojnë para nesh dhe botës, vetëm e ndërruan garderobën dhe iu përveshën përfitimeve personale dhe benificioneve që i sjell pozita, në kurriz të një populli të shkretë, një populli që vuan nga një varfëri e skajshme, ku mbi 70 për qind e të rinjve janë të papunë dhe pa shpresë që të punësohen në një të ardhme të afërm. “Klasa politike” s'ka ide, aftësi apo edhe vullnet që të ndryshojë diçka në të mirë. Unë që i kam tre fëmijë nuk kam shumë arsye të jem shumë optimist apo ta ndiej veten mirë.

Si e shikoni të kaluarën?

Të kaluarën e shikoj dhe e ndiej si një ëndërr të keqe, mirëpo si një përvojë që nuk blehet dhe as shitet, por fitohet me mund, ndërsa në anën tjetër, me një dëshirë të madhe që kurrë asnjë njeri mos ta përjetojë të kaluarën që e përjetuam ne.

A duhet të flitet për të kaluarën?

Jo që duhet të flitet, por duhet të shkruhet për të, të bëhen studime dhe të analizohet në të gjitha aspektet e mundshme. Siç thashë për faktin që nga përvoja e hidhur duhet nxjerrë mësim, në mënyrë që të mos na përsëritet e kaluara.

Cili është qëndrimi juaj personal sa i përket pajtimit?

Duke filluar nga librat e shkollës fillore, ato fetarë e filozofikë, mandej nga të gjitha llojet e veprave letrare, ku njeriu me shekuj e ka materializuar mendimin e tij subjektiv, kryesisht predikohet për pajtim dhe paqë. Fakti që shoqërinë e përbëjnë më shumë individë tregon se shoqëria është një organizëm i cili mbijeton nga informa-

Mendoj se nuk ka argat të sinkertë që është i tepërt në këtë proces.

Dhe është shumë indikative se asnjë herë nuk më ka rastisur të dëgjoj në media apo edhe biseda të përdoret gjuha e urrejtjes nga ana e atyre që kanë humbur më të dashurit në konflikt. Ndërsa shumë shpesh ndodh e kundërta.

tat e ndërsjella. Unë e kuptoj bashkëpunimin e dy apo më shumë individëve si orvatje për mbijetesë më komfore, më të lehtë. Me një fjalë, nëse dëshiron të jetosh mirë, duhet të respektohet edhe interesi i tjetrit. Pajtimi duhet të jetë gjest dhe veprim i sinqertë i palëve që jetojnë së bashku, pa marrë parasysh arsyen.

Nëse flasim për pajtimin në këtë nënqiellin tonë postkonfliktual, atëherë duhet t'i marrim parasysh faktorët që kanë çuar në nevojën për pajtim, t'i analizojmë dhe në fund të nxjerrim një përfundim. Pajtim duhet të ketë patjetër dhe ai duhet të jetë po ashtu i ndërsjellë. Secili individ apo komb duhet t'i pranojë të palarat e tij dhe të kërkojë falje. Ajo falje duhet të jetë gjithsesi e sinqertë.

A mund të arrihet pajtimi në Kosovë?

Thashë edhe më lartë se pajtimi jo që mundet, por duhet të arrihet patjetër. Sa i përket vetëdijësimit, deri në këtë shkallë kemi arritur, pra e kemi kuptuar se duke qenë të hasmuar mes veti, ne kemi ndihmuar që të pasurohen fëlliqësitat e të gjitha ngjyrave. Kamatën po e paguajmë vetë, edhe atë shumë shtrenjtë, sepse jemi populli (pa marrë parasysh kombin) më i varfër gati në të gjithë rruzullin, edhe atë pa dallim kombi.

Mua më habit vetëm një fakt – si mundet dikush të mbetet ende i manipuluar dhe si nuk jemi ende të gjithë të vetëdijshëm për realitetin e ri? Në fund të kësaj pyetjeje mund të konkludoj se pajtimi i plotë do të arrihet kur të jemi në gjendje ta kuptojmë realitetin, sado i hidhur të jetë ai, së paku 90 për qind e popullit të Kosovës (prapë po e theksoj, pa dallim kombi).

Çfarë duhet bërë që të arrihet pajtimi?

Të falet, sado e dhimbshme të jetë kjo, të kërkohej falje, të mendohet për një të ardhme më të mirë dhe të punohet me ngulm në këte drejtim. Nuk e them këtë pse mundem, nga fakti se qyteti im ka qenë më pak i afektuar nga veprimet e luftës në krahasim me trevat e tjera të Kosovës, por e them dhe besoj që vetëm njerëzit e mëdhenj falin dhe pajtohen, për hir të ndërprerjes së ciklit të dhunës dhe për hir të një ardhmërie më të ndritshme.

Kush duhet të punojë në procesin e pajtimit?

Në procesin e pajtimit duhet të jenë të përfshira të gjitha segmentet e shoqërisë kosovare, duke filluar nga edukimi, pra që nga çerdhet e deri tek Akademia e Shkencave, institucionet fetare, njerëzit e zakonshëm në rrugë, ata të tubuar në forma të ndryshme të veprimit qytetar, si OJQ etj., pa lënë anash këtu edhe miqtë tanë ndërkombëtarë, të angazhuar sinqerisht, pa interesa animi apo “interesa strategjike”. Mendoj se nuk ka argat të sinqertë që është i tepërt në këtë proces.

A mendoni se njerëzit që jetojnë në Kosovë janë të gatshëm të pajtohen? A dëshirojnë të pajtohen?

Nëse bazohem në njerëzit që unë i njoh, mendoj se përgjigjja duhet të jetë po. Në rrethin tim, mendoj në familjen, lagjen, shokët, kolegët e mi etj. Nëse të gjithë njerëzit në Kosovë mendojnë përafërsisht si të lartëpërmendurit, atëherë pajtimi është më se i realizueshëm. Duke qenë të vetëdijshëm për të gjitha vështirësitë, njerëzit dëshirojnë që një ditë e më parë të përshëndeten me të kaluarën, por edhe me të tashmen që nuk po lulëzon shumë. Nëse dëshirojmë që të përshëndetemi me vështirësitë me të cilat po ballafaqohemi, atëherë duhet të pajtohemi. Me këtë del se pajtimi, pos që është një sjellje dhe akt human e burrëror, është edhe domosdoshmëri. Në këtë kalkulum prapë po del që të vetmit segment shoqëror, nëse mund ta

quajmë kështu, të cilit nuk i shkon përshtat pajtimi është kriminaliteti i të gjitha llojeve, pa dallim kombi.

Populli që ka vuajtur më së shumti si para, gjatë dhe pas konfliktit, vuan ende. Dhe është shumë indikative se asnjë herë nuk më ka rastisur të dëgjoj në media apo edhe biseda të përdoret gjuha e urrejtjes nga ana e atyre që kanë humbur më të dashurit në konflikt. Ndërsa shumë shpesh ndodh e kundërta.

Sipas jush, populli ka vullnet të pajtohet?

Pa dyshim.

A ka pengesa në këtë drejtim?

Patjetër që ka. Shfaqen shpesh në formë stereotipesh. Ka njerëz që nuk mendojnë “thellë”. Ka njerëz, siç theksuam më heret, të cilëve iu përshtatet një klimë e këtyllë për përfitime personale etj. Edhe prirja për sensacionalizëm, “zmadhim” të qëllimshëm të ndonjë problemi apo edhe incidenti, është një faktor që mund të llogaritet si pengesë për pajtim. Kjo e fundit përdoret më të madhe nga ana e mediave, që në të shumtën e rasteve tregohen joprofesionale, por edhe qarqeve politike që nuk ia duan të mirën Kosovës dhe popullit të saj. S’duhet lënë pa u përmendur edhe taktika e lansimit të dezinformatave, përsëritja e saj që ajo të gëlltitet si e vërtetë tek njerëzit që nuk e njohin realitetin në Kosovë etj.

Shembull evident është sjellja e politikës aktuale serbe. Klasa politike serbe nuk pajtohet me asgjë, kurse asnjëherë nuk ka dalur me një propozim normal rreth zgjidhjes së problemeve. Ndërkaq, është keq që populli, shpesh nga padituria, iu ndihmon shumë këtyre tendencave, por pse jo, edhe nga njëfarë frike, e cila sikur çdo frikë tjetër buron nga padituria ose e panjohura. Rrjedhimisht mosnjohja reciproke paraqitet si pengesë, ndoshta edhe ndër kryesoret.

Çfarë duhet të bëjë për pajtimin vendi ku jetoni e çfarë vendi me të cilin keni qenë në luftë?

Vendi im nuk ka mundësi apo edhe potencial që t’i artikulojë në mënyrë të duhur porositë në lidhje me pajtimin. Ai në planin e brendshëm i bën disa orvatje që le të mendohet se po orvatet të krijojë një ambient të qëndrueshëm politik, ku njerëzit duhet ta ndiejnë veten mirë. Por nganjëherë ato porosi dështojnë, sepse nuk duken të sinqerta, për faktin se ai praktikisht nuk ka fuqi ekzekutive që t’i mbështesë në praktikë ato zotime. Këto orvatje zbehen edhe për arsye se ata nuk janë në gjendje ta bindin opinionin sa duhet për iniciativat në drejtim të pajtimin, për faktin se rrjedhë logjike e ecjes përpara në atë drejtim është pranimi i fajit nga ana e palës që i ka nxitur dhe deri në momentin e fundit është orvatur që ta fitojë një luftë të pakuptimtë kundër të gjithëve, e që rezultoi me shumë dhunë, krime dhe viktima. Dhe çka është më e keqja, ai nuk mund të bëhet serioz për shkakun se pjesa dërmuese e institucioneve publike janë të korruptuara në atë masë sa që askush më nuk i jep pesë para për ato çka thuhet dhe porositet nga ana e qeveritarëve.

Pala me të cilën populli im ka luftuar për t’i shpëtuar zhdukjes fizike nuk mërzhitet për viktimat e pafajshme, për problemet dhe pasojat që u janë shkaktuar popujve tjerë dhe nuk e bën atë që është hapi më i qëlluar i mundshëm. Fqinjët e mi, me të cilët kemi luftuar, duhet të bëhen të mençur dhe ta kuptojnë se nuk mund të fshehen të gjitha mizoritë që janë shkaktuar nga populli i tyre. Me këtë dua të them se hapi që duhet bërë ata është të kërkojnë falje, së paku viktimave të drejtëpërdrejta. Besoj që kjo do të ishte një porosi e mirë dhe një hap drejt pajtimin.

Çka mund të bëjë një qytetar i thjeshtë që t'i ndihmojë procesit të pajtimit?

Mendoj se mund të bëjë shumë. Në një mënyrë ai edhe ka bërë më së shumti, mendoj në 90 për qind të qytetarëve. Qytetari i thjeshtë, i cili që gjashtë vite me radhë nuk ka furnizim normal me energji elektrike, i cili nuk ka punë të rregullt për t'i plotësuar nevojat elementare të jetës, të cilit i mungon shumë shpesh uji i pijshëm në vapën më të madhe, njeriu i thjeshtë që është në rrezik të shtypet nga ndonjë xhip i blinduar i "politikanit" që e përfaqëson atë, ndërsa po i njëjti e ka obligim që të kujdeset për t'ia lehtësuar jetën qytetarit, e mos të vazhdoj më tutje sepse më duhen nja dy ditë t'i numëroj brengat e tij, mendoj se ka bërë shumë. Ai me durimin e tij nuk e ka penguar rrjedhën normale të proceseve. Mendoj që ky qytetar duhet të nominohet me ndonjë çmim nderi. Arsyeja e thjeshtë, nëse ky qytetar nuk bën probleme të mëdha dhe sakrifikohet me uri dhe skamje për hir të së ardhmes, mund të mendoni se si do të silllej ai po të kishte punë dhe të ardhura të mjaftueshme për ekzistencë, infrastrukturë normale dhe jetë të mirë. Jam i sigurt që do të ishte shembull edhe më gjerë. Sa për ilustrim po e marr një shembull. Unë punoj rregullisht që nga mbarimi i luftës. Kolegët e mi janë të nacionaliteteve të ndryshme, aty ka shqiptarë, serbë, turq, romë etj. Të gjithë fitojmë mirë në krahasim me mesataren e vendit tim të varfër dhe kurrë nuk ndodh të kemi probleme mes veti. Shtrohet pyetja pse? Përgjigjje e thjeshtë – ne nuk kemi probleme të mëdha ekonomike, nuk kemi kohë për të menduar apo krijuar probleme etj. Kjo tregon se ndër faktoret kryesorë që kanë çuar në konflikt dhe që ende pengon për një jetë normale është faktori ekonomik.

Në fund pra më mbetet të konstatoj se qytetari i thjeshtë ndihmon mjaft, por gjithashtu mendoj se mund të kontribuojë edhe më shumë nëse vetëdijësohet dhe nuk qëndron larg proceseve.

A është faji kolektiv apo individual për të gjitha gjërat që na kanë ndodhur?

Mendoj që faj kolektiv nuk ka, për një arsye. Nëse edhe gjysma e një kolektiviteti e bëjnë një të keqe, prapë mbetet gjysma tjetër e pa përfshirë. Por është fakt se gjithmonë shumica fajësohet për veprimet e një pakice, e cila i bën të keqijat në emër të asaj shumice. Kurse unë këtë pyetje e kisha parashtruar më ndryshe. P.sh. sa kemi faj si kolektivitet që nuk kemi reaguar më energjikisht ndaj nxitësve të dhunës dhe konflikteve nga ana e individëve të kolektivitetit tonë?

Cilat janë parashikimet tua për të ardhmen?

Do të nevojitet një kohë kur pjesa dërmuese ta kuptojë se nuk ka tjetër përveç përveshjes së mëngëve dhe fillimit të punës në drejtim të krijimit të një realiteti të ri. Kur të gjithë do ta kemi një qasje objektive ndaj problemeve, kur ta kuptojmë se vetëm sinqeriteti është mjet për besim reciprok, kur ta kuptojmë se të mirat nuk biejnë nga qielli, por krijohen me mund e sakrificë dhe pa gënjeshtër. Me një fjalë, kur të arrihet një vetëdije e qytetëruar e pjesës dërmuese e qytetarëve. Unë shpresoj se kjo do të arrihet, pasi që rrugëdalje tjetër s'do të ketë.

Nga natyra jam optimist, prandaj mendoj se kjo do të arrihet. Dhe sinqerisht shpresoj të ndodhë në një të ardhme të afërt.

N. I.

Ta shikojmë të vërtetën në sy

Çfarë është ajo që të mbetet dominuese kur i shikon vitet '90 dhe luftërat?

Çfarë ndjenjash apo çfarë tjetër bart nga ajo kohë?

Mu në fillim nuk kam besuar se do të ketë luftëra, ashtu siç nuk kanë besuar edhe shumë tjerë, por jam frikuar se do të ketë... Kam parandier diçka, njëfarë të keqeje, kam ndier njëfarë frike.

Cilat kanë qenë ato vite?

Kjo ka qenë diku rreth viteve '91, '90, '89 përafërsisht, kur në mitingje kanë filluar ato keqpërdorimet e fëmijëve me parullat „baba, mos lejo që të ketë luftë“ dhe incidentet e para me APJ-në. Në atë kohë tanimë kam ndier njëfarë shqetësimi. Në atë kohë kanë ndodhur gjëra të ndryshme dhe 9 marsi, demonstratat në Beograd... Pastaj ato skenat e shpartallimit të demonstratave... skenat e tilla i kam shikuar më parë vetëm në televizion, në Izrael dhe në Afrikën Jugore, në regjimet më të errëta në botë. Kur e kam parë këtë në Beograd e kam kuptuar se çfarë po ndodhë. Atë ditë kam ardhur në konflikt me babain tim i cili më ka thënë se jam i çmendur, se nuk kuptoj asgjë, se ky (Vuk Drashkoviç) është mercenar i huaj dhe se don ta shkatërrojë Beogradin. Atëherë kam filluar t'i kërkoj të gjitha stacionet e mundshme në radio dhe të kërkoj informacione. Kam pasur fat të gjej *RFI*-në; *Radio Europa e Lirë* ka qenë ende në Munih, tek ne nuk është dëgjuar ende, kurse nuk ka ekzistuar as seksioni për territorin serbo-kroat. Kam filluar të dëgjoj dhe të shoh se me çfarë mjtesh të ndyta shërbehen për manipulimin e popullit. Kur ka filluar kjo në Sarajevë kam dëgjuar në radio edhe Sarajevën, edhe Zagrebin, kryesisht në valë të shkurtra, dhe më është krijuar neveri, njëfarë antipatie ndaj këtij regjimi, hidhërimi, por kam ndier edhe pafuqi të theksuar. Për shembull, kur është goditur materniteti në Tuzëll, një mjeke telefonon në Beograd, të njëjtin maternitet, klinikë, dhe kërkon ndihmë, lutet që t'ju ndihmohet, thotë se materniteti po digjet, se nënat janë me fëmijë në bodrum... dhe në fund thotë: “Vetëm ta them një të dhënë, unë jam serbe”, dhe fillon të qajë... Ose dëgjoj studenten tonë nga Beogradi, e cila ka studiuar në Rijekë, duke thënë: “Tekstet janë kudo të njëjta, unë shikoj televizionin edhe në Beograd, edhe në Zagreb, vetëm fytyrat janë të ndryshme”. Do të thotë se në të njëjtën mënyrë janë kryer keqpërdorimet e mediave dhe keqpërdorimet e fotografive. Tërë Europa ka ecur në atë kohë drejt proceseve integruese, globalizimit, bashkimit, demokratizimit etj., kurse ne kemi shkuar drejt nacionalizmit, luftërave, ndarjes. Tjetër, mendoj se edhe i gjithë sistemi shkollor ka qenë i tillë, si dhe i tërë sistemi.

Në çfarë mendon kur e përmend sistemin shkollor?

Mendoj në sistemin e arsimit në të gjitha nivelet. Nuk kemi pasur cilësi të vërtetë. Mendoj se niveli i arsimit dhe i kulturës tek ne ka kontribuar mjaft që njerëzit të bien në grackën e mashtrimit, mediave, gënjeshtreve dhe nuk kanë mundur t'i bëjnë ballë kësaj. Në një rast kam dëgjuar intervistën ndërmjet Çiçkos dhe Aleksa Gjilasit në emisionin “Most” (Ura)...

Kur ka filluar kjo në Sarajevë kam dëgjuar në radio edhe Sarajevën, edhe Zagrebin, kryesisht në valë të shkurtra, dhe më është krijuar neveri, njëfarë antipatie ndaj këtij regjimi, hidhërimi, por kam ndier edhe pafuqi të theksuar.

Të gjithë kanë thënë se ne jemi të rrezikuar dhe se na urrejnë, se kështu – se ashtu... dhe çfarë ka mundur të bëjë njeriu i zakonshëm, të marrë pushkën dhe të lajmërohet si vullnetar apo të presë që ta rrëmbejnë dhe ta marrin nga shtëpia, ta mobilizojnë me dhunë...

Kur ka qenë kjo?

Po kjo ka qenë ndoshta tashmë edhe në vitin '94-'95, nuk më kujtohet saktësisht, gjatë luftës ka filluar ai emision dhe tema ka qenë: A janë masat e gjera popullore, d.m.th. a është populli në Kroaci dhe në Serbi fajtor për luftëra, krime, për arsye se ka dëgjuar udhëheqësit e tij dhe ka shkuar pas tyre. Teza që e ka paraqitur Gjilasi, e cila sipas gjykimit tim është e vërtetë, është se të gjithë ata që është dashur t'i shpjegojnë të vërtetën popullit serb kanë thënë se ne jemi të kërcënuar dhe na duhet të shkojmë në luftë. Edhe Akademia e Shkencave, edhe Kisha, edhe fakultetet, edhe të gjitha institucionet e sistemit: Qeveria, pushteti, ministrat, politikanët... Të gjithë kanë thënë se ne jemi të rrezikuar dhe se na urrejnë, se kështu – se ashtu... dhe çfarë ka mundur të bëjë njeriu i zakonshëm, të marrë pushkën dhe të lajmërohet si vullnetar apo të presë që ta rrëmbejnë dhe ta marrin nga shtëpia, ta mobilizojnë me dhunë... Dhe që atëherë të vdesë, të vrasë. Shumë nga ata nuk i kanë kuptuar absolutisht mashtrimet, nuk e kanë kuptuar se ato udhëheqje e zhvillojnë luftën në marrëveshje, me qëllim të ruajtjes së pushtetit dhe mbrojtjes së interesave të tyre. Asgjë më tepër. Për ta nuk kanë qenë të rëndësishme viktimat, as feja, as kombësia.

Sa ke qenë në rrjedhë të ngjarjeve gjatë kohës së luftës, në Sarajevë, në Kroaci, Vukovar...?

Kam qenë mjaft në rrjedhë sepse me net nuk kam fjetur. Unë kam dëgjuar gjatë tërë natës, për shembull gjatë kohës së bombardimit të Sarajevës, *Radio Sarajevën*. Kam dëgjuar edhe urdhërin direkt të gjeneralit Perišić, në fakt jo urdhërin por ultimatumin drejtuar qytetarëve të Mostarit, se në qoftë se nuk i kthejnë dy pilotët, të cilët gjoja i kanë rrëmbyer, do t'i prishin godinat e studentëve dhe fakultetet në Mostar; u ka dhënë afat deri në orën dhjetë të mbrëmjes. Dhe pas kësaj ka filluar granatimi i këtyre objekteve megjithëse është mësuar se qytetarët e Mostarit as që kanë ditur se pilotët në fjalë janë larguar për Kroaci, nuk kanë pasur fare lidhje me këtë, as që ka qenë fare në pyetje rrëmbimi.

Thua se ke dëgjuar radion dhe se nuk ke fjetur me net. Pse? Çfarë të ka motivuar që ta bësh këtë? Çfarë ka qenë vendimtare? Çfarë ndjenjash kanë ekzistuar dhe pse je shqetësuar?

Pse? Nga njëra anë ekzistenca ime në atë moment ka qenë e rrezikuar deri në fund. Mjerimi, skamja, hiperinflacioni. E gjithë kjo ka pasur lidhje. Unë nuk kam familje, nuk kam fëmijë, por jam i edukuar në mënyrë të tillë, nga natyra jam pacifist. Mua më janë dhimbur të rinjtë. Më kujtohet kur Bogdan Bogdanović u ka thënë studentëve: Shpëtoni kokën, pa marrë parasysh të gjitha, sepse asnjë kafshim ujku në Bosnje nuk vlen sa një jetë e juaj e re. Edhe unë kam pasur ndjenja të njëjta: pse të vdesin? Për çfarë? Të gjithë e kanë fshehur të vërtetën se deri dje edhe kroatët, edhe muslimanët, edhe serbët kanë shërbyer në ushtri në të njëjtat kazerma, kanë shkuar në aksione të njëjta. Ndoshta jam jugonostalgjik. Vërtet ai ka qenë shtet totalitar dhe ka pasur mjaft të meta, por ka pasur shumë gjëra të mira, minimumi ekzistencial ka qenë edhe liri personale, e drejta për jetë, për punë. Të gjitha këto i kemi humbur, të gjithë së bashku.

A nuk kanë mundur njerëzit të vijnë deri tek informacioni apo çfarë ka qenë në pyetje? Nëse dikush ka dashur të dijë, a ka mundur të marrë vesh?

Ka mundur! Ashtu siç kam mundur edhe unë. Por në pyetje është sistemi i cili i ka rritur ata njerëz, shkalla e arsimit dhe e kulturës ka luajtur rol vendimtar. Mendoj se



jemi në një shkallë të ulët, në parim. Derisa ka qenë pushteti i Millosheviqit, së pari është sulmuar kultura, ndryshimet e para të mëdha janë bërë në institucionet kulturore, ndërimi i drejtorit të teatrit, televizionit etj. Dhe atëherë llumi ka dalë në sipërfaqe. Shumica i kanë marrë si të vërteta ato që kanë dëgjuar në media. Unë kam lexuar artikuj fantastikë në atë kohë në gazetat *Srpske reči* (Fjalët serbe) dhe *Nasha borba* (Lufta jonë), në të cilat individët kanë demaskuar raste të caktuara të mashtrimeve të tilla. Televizioni ynë e paraqet kishën në Osijek, gjoja serbe, para së cilës shkruan “Gospo, pomozì nam” (në kroatisht „Zot, na ndihmo“). Unë nuk e kam parë që të shkruaj kështu në asnjë kishë ortodokse. Dhe e kam pasur të qartë se ka qenë fjala për mashtrim. Çdo përpjekje që shokëve apo kolegëve në punë t’u shpjegoj se është fjala për mashtrim ka qenë e pasuksesshme. Thonë, ti je i çmendur! Ose, ti je armik, ku jeton ti, ku ke mësuar në shkollë, për ke simpatizon ti?

Si e shikon sot situatën në raport me ato luftëra?

Mendoj se edhe gjatë kohës së luftërave ka pasur njerëz normalë dhe të ndershëm nga të gjitha palët. Shumë nga ata kanë humbur jetën që t’u ndihmojnë komshinjeve, pa marrë parasysh se ata kanë qenë të kombësisë tjetër. Mjaft u kanë ndihmuar të tjerëve që të largohen, të evakohen. Shumë janë pushkatuar për shkak se u kanë ndihmuar të tjerëve. Edhe sot e kësaj dite, shumë dëshmojnë për krimet edhe në Kroaci, edhe në Serbi kundër kriminelëve, pa marrë parasysh se bëhet fjalë për pjesëtarë të kombësisë së tyre. Dhe gjithmonë ka pasur të tillë, vetëm se kanë qenë gjithmonë pakicë. Por ata kanë qenë heronj të vërtetë gjatë kohës së luftës. Sot është shumë më lehtë tërë kjo. Shkon më lehtë. Edhe pajtimi do të arrihet me siguri. Herëdo-kurdo. Vetëm se ky do të jetë proces i gjatë sepse ata të cilët, ta

zëmë, kanë humbur më të dashurit në këtë luftë, nuk do të falin. Disa nga arsyeja fetare, disa nga... Dihet se çfarë mentaliteti dhe zakonesh kemi ne ballkanasit. Për shembull, shqiptarët apo malazezët, gjakmarrja etj.

Përmende pajtimin, çfarë është në fakt për ty pajtimi? Çfarë do të thotë për ty të pajtohem, në çfarë kuptimi? Çfarë duhet të ndodhë dhe si duhet të duket?

Koha e ish-Jugosllavisë dhe e jugosllavizmit nuk do të kthehet kurrë më. Pra, kjo është e kryer. Unë kam pasur fatkeqësinë që jam operuar në Sofje në vitin 1972. Kur jam nisur të shkoj për t'u operuar, nëna ime e cila e ka përjetuar Luftën e Dytë Botërore dhe okupimin bullgar të kësaj treve, më ka thënë: Mirë, ata janë armiq, na kanë ndezur gjatë kohës së luftës, na kanë vrrarë, kurse ti shkon tani që të të ndihmojnë. Thjesht, ajo nuk ka mundur ta harrojë skenën kur i ka takuar një ekspeditë ndëshkuese bullgare në Luftën e Dytë Botërore. Por mua që nuk më kujtohet ajo luftë dhe që nuk e kam pasur atë përvojë, kam parë në Bullgari se edhe ata janë të njerëz të njëjtë si ne. Për nga mentaliteti shumë të ngjashëm. Se në çdo drith ka egjër. Se kudo ka edhe të mirë, edhe të këqinj, edhe të poshtër, edhe të ndershëm, edhe asosh që duan të japin jetën për ty.

Po kush me kë duhet të pajtohet nëse flasim për pajtimin?

Sa u përket elitave politike, atyre sipas meje nuk u përshtatet asnjë lloj pajtimi. Sa u përket njerëzve të zakonshëm, është dëshmuar edhe tani, gjatë kthimit të refugjatëve, se shumë ish-komshinj bashkëpunojnë dhe e ndihmojnë njëri-tjetrin. Por atje ku ka probleme, problemet ekzistojnë nga niveli i lartë, nga ana e pushtetit, institucioneve dhe atyre ekstremistëve më të këqinj të cilët kanë kryer gjatë luftës krimet më të rënda, edhe nga ana e diasporës. Ndërmjet atyre nacionalistëve dhe shovinistëve nuk ka pajtim, ata nuk duan të pajtohen kurrë. Kurse politikanët nuk qëndrojnë larg tyre. Ndërsa njerëzit e zakonshëm, ata që kanë marrë pjesë në luftë, kanë qenë thjesht të detyruar në këtë luftë, dhe akoma ndoshta nuk kanë besim, por nuk i kanë ndyrë duart, në ata mendoj. Ata duhet ta tejkalojnë këtë dhe të vendosin raporte normale njerëzore. Unë mendoj se ky proces duhet të ndodhë në jetën e përditshme, në jetën e zakonshme. Duhet të bëhet kthimi i vërtetë i refugjatëve atje ku kanë jetuar, edhe të njërs palë, edhe tjetrës, edhe të tretës, dhe të fillojnë të jetojnë njerëzit jetën normalisht. Edhe të bashkëpunojnë, edhe të tregëtojnë, edhe të takohen si komshinj dhe ta ftojnë njëri-tjetrin për festa, dhe të martohen me njëri-tjetrin. Këtu ekziston një pengesë e tmerrshme psikologjike për shkak se ka qenë lufta, kanë qenë krimet, kanë qenë manipulimet... Është manipuluar me frikën. Është keqpërdorur frika, njerëzit janë frikësuar. Karaxhiqi është psikiatër dhe dihet se cilat metoda i ka shfrytëzuar që të nxisë luftën. Edhe që ta udhëheqë. Dhe shumica e ka këtë ende aq të freskët dhe të pranishme në vetëdije sa që njerëzit frikohen, njerëzit tmerrohen nga pala tjetër! Domethënë, vetëm në një periudhë të gjatë kohore, përmes një procesi, unë mendoj se mund të vijë deri tek ajo që ata njerëz të afrohen përsëri dhe t'i fillojnë gjërat e përditshme normale njerëzore.

Po kush duhet ta bëjë këtë? Kush duhet ta bartë këtë proces dhe kush është përgjegjës për zbatimin e tij?

Po vetë qytetarët, vetë njerëzit. Por, sikur në Bosnje të mos kishin qenë Kombet e Bashkuara dhe forcat e tyre dhe sikur të mos kishin qenë organizatat joqeveritare, nuk do të ishte arritur kurrfarë suksesi atëherë. Domethënë, ka qenë e nevojshme ajo ndihmë nga jashtë... Por edhe vetë viktimat e luftës, edhe familjet e qytetarëve të rrëmbyer dhe të zhdukur, edhe familjet e viktimave, kanë formuar shoqatat dhe

Është dëshmuar në 15 vitet e fundit se kurrë nuk kemi arritur të zgjedhim anën e drejtë dhe se gjithmonë kemi rënë në grackën e manipulimeve të ndryshme. Çfarë mund të bëjmë? Së pari duhet të zgjedhim qeverisjen e vërtetë. Së dyti, duhet të jemi të gjithë shumë më tepër aktivë.

organizatat e tyre joqeveritare për ndihmë reciproke. Ata duhet ta udhëheqin këtë. Ai proces duhet të jetë edhe më masovik. Por do të duhet të zgjasë shumë, që të tejkalohen ato barrierat psikologjike, frikat, dhe të vendoset ai raport. Vetë qytetarët duhet të përfshihen në të. Por duhet të ekzistojë dikush që do t'i udhëheqë. Pushteti bën ende rezistencë ndaj kësaj. Ky është fakt. Bashkëpunojnë nën presionin e madh të bashkësisë ndërkombëtare. Por organizatat joqeveritare luajnë rol tejet pozitiv.

Po çfarë mund të bëjmë personalisht ne “njerëzit e zakonshëm” në këtë proces?

Është dëshmuar në 15 vitet e fundit se kurrë nuk kemi arritur të zgjedhim anën e drejtë dhe se gjithmonë kemi rënë në grackën e manipulimeve të ndryshme. Çfarë mund të bëjmë? Së pari duhet të zgjedhim qeverisjen e vërtetë. Së dyti, duhet të jemi të gjithë shumë më tepër aktivë, ndoshta pikërisht në ato organizatat joqeveritare ndaj të cilave, ja edhe sot e kësaj dite bëhet fushatë, kundër Femrave në të zeza. Fatkeqësisht edhe RTS fton në emisione të veçanta njerëz të... Unë nuk them se nuk duhet të dëgjohen mendimet e ndryshme, por unë mendoj se ftohen me paramendim, me qëllim, individë të cilët i mbajnë gjallë akoma tensionet, urrejtjen, qëndrimet e forta nacionaliste.

Po çfarë mendon se pret nga ti që të punosh rreth çështjes së pajtimit dikush „nga pala tjetër“?

Nga unë mendoj se presin që të jem normal. Që të votoj në zgjedhje për pushtetin normal. Që të mos votoj për nacionalistët. Dhe që ta mbështes, ta zëmë, organizimin e tyre në përpjekje.

Kush janë ata njerëz që kanë humbur më së shumti në luftë? A është niveli i përgjegjësisë kudo i njëjtë?

Mendoj se nuk janë kudo të gjithë njëjtë përgjegjës. Përgjegjësinë më të madhe e ka ai që ka disponuar me fuqinë më të madhe, forcën më të madhe. Këta jemi ne sepse kemi pasur APJ-në në anën tonë, Serbia, pushteti serb. Mendoj se ajo është më përgjegjësja për fillimin e luftës. Ndërsa ne si qytetarë... Është vërtet vështirë t'i rezistosh kësaj makinerie, sistemit ku kanë qenë të gjithë të futur në atë makinë, edhe akademikët, edhe kisha, por edhe ne mbajmë përgjegjësi.

Po çfarë kemi mundur të bëjmë dhe çfarë mund të bëjmë tani?

Pyetja është shumë e vështirë dhe komplekse. Unë e di se nga të gjitha palët ka pasur edhe viktimë, edhe kriminelë, por mendoj se është shumë i rëndësishëm fakti se në territorin e Serbisë nuk është zhvilluar luftë, por është zhvilluar në territorin e Kroacisë dhe Bosnjes. Kjo flet shumë për atë se kush ka disponuar me forcën më të madhe dhe se kush është më përgjegjës për luftë. Kurse çfarë mund të bëjmë ne, nuk kam ndonjë përgjigje të qartë, apo ndoshta frikohem ta them sepse ajo është ndoshta radikale... Unë mendoj se ne si popull jemi përpjekur t'i bëjmë njëfarë rezistence regjimit të Millosheviqit për dhjetë vjet, por që edhe opozita, edhe populli kanë qenë në tërësi joaktiv. Të gjithë i kanë zgurdulluar sytë në televizor, kanë shikuar ditaret... Të tillë jemi edhe në punë, edhe në ekonomi, edhe kudo. Ne presim që të na ndihmojë Zoti dhe të na bjerë diçka nga qielli, nuk jemi aktivë, thjesht nuk ndërmarrim asgjë. Më kujtohet se kur është nisur ushtria në Vukovar kanë dalur prindërit e ushtarëve, i kanë bllokuar rrugët dhe kolonat ushtarake janë ndaluar. Por, pas kësaj, ata janë kujtuar, kështu që atëherë kanë filluar me mobilizi-

min individual, dërgimin e njësive të veçanta dhe... e kanë amortizuar thjesht rezistencën përmes mediave, që të zvogëlohet ajo rezistencë, dhe përsëri kanë vazhduar me të veten. Ndoshta në demonstratat e 9 marsit është dashur të vdesin jo dy, por dy mijë serbë, por nuk do të zgjaste lufta dhjetë vjet, nuk do të ishin dyqind mijë viktima. Ne e kemi zakon që të flasim për historinë tonë dhe sesi jemi çlirimtarë, kemi çliruar pothuajse tërë botën, jemi shumë trima e kështu me radhë. Mendoj se pikërisht atëherë në rezistencën ndaj regjimit është treguar, nga njëra anë, trimëria e madhe e individëve, kurse nga ana tjetër, ligështia e shumicës, shumicës së madhe. Çdo respekt për djelmoshat, vajzat dhe pensionistët që janë rrahur në rrugë nga ana e regjimit, por shumica nuk ka guxuar që ta nxjerrë jashtë hundën atëherë, ka qenë pasive. Unë si individ mund t'i mbështes të gjithë ata edhe në Kroaci, edhe në Serbi, edhe në botë, dhe të votoj për palën e drejtë, por kot kur më mbivotojnë.

Si duhet të sillemi ndaj luftërave të kaluara? A duhet të harrojmë, a duhet të mbajmë mend, të shënojmë, të kujtojmë?

Mendoj se të gjithë popujt normalë në botë nga kjo nxjerrin mësim. Edhe ne nuk duhet të harrojmë sepse kjo nuk mund të harrohet, ajo është thjesht histori. Tek ne historia falsifikohet, ngjarjet reale falsifikohen. Duhet së pari ta shikojmë të vërtetën në sy. Domethënë të vijë në pushtet një garniturë e cila do t'i hapë të gjitha arkivat dhe t'i tregojë këtij populli se çfarë ka ndodhur realisht dhe nga kjo të nxjerrim mësim, ashtu siç kanë nxjerrë mësim gjermanët nga Lufta e Dytë Botërore. Kam dëgjuar se gjermanët pas luftës, kur kanë parë se çfarë kanë bërë nacistët në emrin e tyre, kur i kanë parë krematoriumet dhe dhomat e gazit, i kanë ulur kokat dhe 50 vjet kanë heshtur dhe kanë punuar. Ndonëse shumica e njerëzve sot në Serbi mendojnë akoma se gjermanët janë fashistë dhe se na urrejnë. Edhe ne duhet të ballafaqohemi me realitetin, ta shikojmë të vërtetën në sy dhe të nxjerrim mësim.

Po çfarë mendon me atë kur thua: ta shikojmë të vërtetën në sy?

Tek ne shumica edhe sot e kësaj dite nuk beson se midis nesh ka kriminelë lufte, megjithëse i kanë parë filmimet. Ndërsa, ajo që është e tmerrshme është fakti se shumë madje edhe i mbështesin ato krime... nëse janë viktima shqiptarët apo kroatët. Mendoj për njerëzit e zakonshëm. Kjo është e tmerrshme, por është e vërtetë, është fakt.

A ekziston nevoja midis “njerëzve të zakonshëm” që të flasin për luftëra? A flasin njerëzit për këtë?

Gjithnjë e më pak. Rrallë herë flitet. Mendoj se shumë njerëz nuk duan tani të flasin për këtë sepse e kanë parë sesi kanë përfunduar për ne ato luftëra, sidomos kjo e fundit kundër NATO-s. Dhe unë mendoj se ne duhet t'i kthehemi të ardhmes. Të flasësh për luftën nuk ka më qëllim. Ekziston nevoja e ballafaqimit me të vërtetën. Njerëzit e zakonshëm as që mund të vijnë vetë tek e vërteta, as të ballafaqohen me të. Për këtë është e rëndësishme që në Serbi të vijë një pushtet i tillë, që edhe mediat të demokratizohen në mënyrë që e vërteta të nxirret në dritë nga një nivel më i lartë. Të nxirren nga varret të gjitha ato kufoma, të tregohen, të nxirren kriminelët para gjyqit, ashtu siç e transmeton B92 gjykimin e Millosheviqit nga Haga. Por, shumë njerëz nuk e shikojnë këtë, shumë nuk e kuptojnë thelbin e këtij gjykimi e as që e kuptojnë këtë proces. Jemi në situatë të rëndë.

M. C. H.

Jemi më të mbrapshtë seç na është thënë

Duke pasur parasysh se rajoni ynë nuk ka qenë i prekur drejtpërdrejt nga lufta, a ke pasur ndjenjë se je duke e përjetuar luftën?

Përkundër fatit që në Mal të Zi dhe Ulqin nuk ka pasur konflikte me armë, unë kam pasur rast ta ndiej dhe ta përjetoj atë, sepse në fillim të viteve '90 kam qenë student në Dubrovnik.

Çfarë është raporti Juaj ndaj luftës tani, dhjetë vjet më vonë?

Të gjithë ata që e kanë përjetuar luftën, sigurisht do të thonë: mos i ndodhtë askujt. Më mirë të negociohet 100 vjet, sesa të luftohet një minutë.

Çka është e nevojshme që të shmangen pasojat e luftës apo që së paku të zbuten?

Së pari, pranimi (pohimi) se krimi është planifikuar dhe ekzekutuar, si dhe pranimi se popujt tanë janë më të mbrapshtë seç na është thënë në familje dhe shkolla.

Çfarë është për ty pajtimi?

Sprovë e armiqve të mëparshëm që të zbulojnë vlerat e përbashkëta, si bazë për bashkëjetesë, ose sprovë e ndërtimit të urave ndërmjet të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes.

Çfarë është e nevojshme për pajtim? Pse është i rëndësishëm ai?

E vërteta dhe pranimi janë supozime të domosdoshme për pajtim e kjo është e rëndësishme që të vendoset drejtësia dhe të ndërtohet shoqëria e hapur.

Si mund të arrihet pajtimi?

Duke kuptuar se në këtë botë jemi vetëm kalimtarë të cilët sjellin me vete vetëm vepra të mira.

Kush duhet të punojë për pajtimin?

Të gjithë. Përgjegjësinë më të madhe e kanë medoemos politikanët, përfaqësuesit e komuniteteve fetare dhe intelektualët e rinj, të cilët, më duket se tani nuk e kanë vetëdijen e ngritur për këtë.

Çfarë mendon se mund të bëjnë “njerëzit e zakonshëm”?

Njerëzit e zakonshëm mund të bëjnë shumë. Ata duhet ta shtyejnë veten të mësojnë, të respektojnë dinjitetin e çdokujt, nuk duhet të flasin të pavërteta, të mësojnë të flasin, në fakt, të mundohen të jenë më të mirë seç janë. E këtu me të vërtetë është mjedis i banuar nga populli i braktisur.

A mendon se njerëzit janë të përgatitur për pajtim?

Pak ka vullnet të sinqertë, dëshirë, përgatitje dhe fuqi për pajtim, por duhet shpresuar se koha, gjeografia dhe ekonomia janë më të forta se ideologjia.

Si duhet ta trajtojmë të kaluarën?

Në mënyrë që të mundohemi të njohim të mirën dhe të keqen në të kaluarën tonë

Historia më së shpeshti përjetohet si vetëshërbim: merrni vetëm atë që në moment Ju përshtatet. Por, e kaluara e cila mbrapset, kthehet jo më si farsë, por si shëmti!

Vetëm fëmijët kanë qenë të pafajshëm në këtë kasaphanë e kaos të programuar.

të afërt dhe të largët. Historia më së shpeshti përjetohet si vetëshërbim: merrni vetëm atë që në moment Ju përshtatet. Por, e kaluara e cila mbrapset, kthehet jo më si farsë, por si shëmti!

A mendon se faji i takon vetëm njërës palë?

A mendoj? Natyrisht që nuk mendoj, por është e qartë (edhe nga vendimet e Tribunalit të Hagës) se fajin më të madh për luftërat dhe tragjeditë në hapësirën e ish-Jugosllavisë e bartë Serbia, udhëheqja e saj e atëhershme dhe elitat e saj politike.

A mund të individualizohet faji apo mendon se ai është kolektiv?

Është e domosdoshme që faji të individualizohet. D.m.th. faji është individual, kurse përgjegjësia kolektive.

A mendon se të gjithë bartim një pjesë të fajit?

Po, varësisht nga pozita në hierarki dhe njohuria. Vetëm fëmijët kanë qenë të pafajshëm në këtë kasaphanë e kaos të programuar.

Çfarë mendon, kush ishte viktimë e luftës?

Të gjithë jemi viktimë, përveç profiterëve të luftës (antiluftës!). Por, mullinjtë e Zotit bluajnë ngadalë!

A mendon se njerëzit i janë nënshtruar shpesh manipulimit të mediave dhe a kanë pranuar ata, në mënyrë të pavetëdijshme, të jenë të manipuluar? A kanë mundur t'i shmangen kësaj (të bëjnë rezistencë)?

Nuk kanë mundur! Fuqia e destruksionit ka qenë shumë e madhe, çdokund përrreth nesh, e më së shumti brenda vetë nesh!

Cila mendon se është përgjegjësia e mediave?

Shumë e madhe. Për këtë arsye është e çuditshme që prokuroria e Tribunalit të Hagës nuk ka ngritur ende aktpadi kundër ndonjë gazetari nga territori i ish-Jugosllavisë.

Për fund, si e sheh të ardhmen e rajonit tonë?

Në Europën pa kufij, ha, ha, ha! Në çdo rast, do të duhet të na lidhin disa vlera të rendit “më të lartë”.

E. H. Ç.

Në këtë kohë,
heronjtë që nuk janë heronj, bëhen të tillë

A mund të më thuash në fillim diçka për veten?

Jam 25 vjeçe dhe jam studente e vitit të tretë të Fakultetit të Drejtësisë. Kam lindur dhe jetoj në Bijelinë. Jam shumë e angazhuar në jetën shoqërore të Bijelinës. Jam anëtare e shoqërisë kulturore-artistike dhe jam e angazhuar në sektorin rinor.

Sa vjeçe ke qenë kur ka filluar lufta në Bosnjë?

Kam qenë 11 vjeçe kur ka filluar lufta dhe vetëdija ime nuk ka qenë mjaft e zhvilluar për të kuptuar seriozitetin e asaj situatë. Ne të rinjtë në Bijelinë kemi mundur të jetojmë disi jashtë tërë atyre ngjarjeve të luftës. Këtu konfliktet ushtarake kanë zgjatuar vetëm tetë ditë dhe ato tetë ditë kam qenë në Bijelinë. Edhe para këtij konflikti veç kanë filluar disa migrame. Disa veç ishin larguar nga Bijelina apo i kishin mënjanuar fëmijët, kurse familja ime ka qëndruar aty. Kjo ka qenë shumë shkurt që të mund të them se kam ndonjë përvojë nga lufta. Kur është qetësuar situata, është vendosur njëloj pushteti (etnik). Ajo që këtu është ndier vërtet ka qenë kriza ekonomike. Dyqanet kanë qenë të zbrazur dhe edhe nëse ke pasur para, nuk ke pasur çfarë të blesh. Por kur është qetësuar situata, janë vendosur lidhjet me Serbinë dhe kjo na ka mbajtur në jetë. Si 11-vjeçare, të paktën sa i përket shoqërisë sime, ne kemi arritur ta organizojmë disi jetën tonë dhe mos të ndiejmë se është luftë. Ne e kemi pranuar tërë këtë si krejt normale, edhe orën policore, edhe kur na fyenin pse këndonim derisa vdesin njerëz.

Sa shpesh diskutojnë për këtë periudhë miqtë tuaj, të rinjtë e gjeneratës tënde?

Shumë shpesh, sidomos ata që kanë pasur përvoja të hidhura. Për fatin tim të mirë, askush nga familja ime nuk ka mbetur në luftë. Njerëzit që kanë pasur përvoja të hidhura e kujtojnë shpesh këtë periudhë. Kjo është një periudhë jete ku ata kanë mbetur. Për ata jeta është ndalur në vitin 1992. Ajo që shoh në familjen time është se vëllai im, i cili është 31 vjeç, ka mbetur, thjesht, në atë kohë. Për të pothuajse asgjë nuk ka lëvizur nga viti 1992 deri 2005. Ai nuk e ka jetuar më asnjë vit. E gjithë kjo reflektohet në jetën e tij, në të tashmen e tij dhe kjo është e dhimbshme. Numri i rritur i vetëvrasjeve në periudhën e pasluftës flet për një depresion kolektiv që sundon në shoqëri, kurse të gjithë shmangemi disi nga kjo, nuk flasim për këtë, nuk i zgjidhim këto probleme, prandaj ndodhin këto vetëvrasje ose kemi vetëvrasës latente që pak nga pak vriten çdo ditë.

Çfarë do të thotë për ty fjala pajtim, pajtim në Bosnje e Hercegovinë?

Le të themi, që të funksionojmë normalisht. Çfarë do të ishte normale? T'i falim njëri-tjetrit gjërat e këqija që na kanë ndodhur në të kaluarën, të krijohet niveli i tolerancës midis nesh, të refuzojmë fajësimin e dikujt, por edhe të pranojmë faljen si mënyrë të veprimi. Ne serbët jemi të krishterë dhe pjesë e kësaj është edhe falja. Dhe për këtë arsye duhet të jemi tolerantë dhe t'ju mundësojmë popujve tjerë që jetojnë në shtetin tonë të jetojnë normalisht, mos t'ju pengojmë dhe të jemi ata që do

të jenë iniciatorë. Duhet t'iu shmangemi pretendimeve dhe "fashizmit" dhe të përpiqemi të jetojmë jetë normale. Tregëtia e lirë, arsimimi i lirë dhe aktivizimi i të gjithë qytetarëve, posaçërisht të rinjve.

Si kanë kaluar kontaktet tuaja të para me entitetin tjetër të Bosnjes e Hercegovinës dhe njerëzit që jetojnë atje?

Për shkak të angazhimit tim në SHKA dhe në punën rimore kam rast të udhëtoj mjaft. Shumë heret pas luftës kam filluar të kontaktoj me njerëz nga entiteti tjetër. Pa marrë parasysh se çfarë kombësie, serbë, kroatë apo muslimanë (boshnjakë), kanë qenë shumë të gëzueshëm. Kryesisht kam kontaktuar me njerëz të moshës sime dhe këto kontakte kanë qenë shumë të gëzueshme dhe me mjaft elan që të ndryshojnë jo vetëm jetën e tyre, por edhe jetën e njerëzve në rrethin e tyre. Unë kam pasur ndoshta fatin të takoj njerëz që mendojnë si unë dhe që ne t'i bashkojmë forcat tona dhe të ndryshojmë diçka në këtë shtet.

Sa e ndihmon pajtimin në Bosnje e Hercegovinë bashkësia ndërkombëtare dhe institucionet e ngritura nga ajo?

Ata kanë një qëllim, që të ruajnë këtë gjendje momentale në Bosnje e Hercegovinë, d.m.th. të mos ketë veprime të armatosura në Bosnje e Hercegovinë. Ky qëllim ka qenë edhe në vitin 1995 dhe këtë qëllim e kanë edhe sot, vetëm të mos ketë të shtëna. Edhe nëse ndodhin disa incidente, siç janë ato që kanë ndodhur në Mostar, Brčko, Janji, ata reagojnë dhe e kthejnë situatën e mëparshme. Madje edhe sikur të dëshirojnë, nuk besoj se do të mund të kishin ndikim tjetër në popullatën e Bosnje e Hercegovinës nga ajo që kanë tani.

Si e përjeton ti tani, dhjetë vjet pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Paqes, lajmin në media se në një pjesë të Bosnje e Hercegovinës ka ndodhur një incident në bazë nacionale?

Aktualisht po zhvillohet një fushatë mediatike se si çdo gjë është në rregull dhe se si ne të gjithë në Bosnje e Hercegovinë jemi shumë të mirë. Përmes mediave fitojmë fotografi krejtësisht të shtrembëruar të realitetit tonë. Qëndrimi im personal është se çdo person është përgjegjës vetë për vete. Dhe nga ai moment kur unë të kuptoj se jam ai që jam, zezake, serbe apo muslimane, kur ta kuptoj dhe ta pranoj këtë dhe të sillem në pajtim me origjinën time dhe me vetveten, do ta kem më të lehtë t'i pranoj popujt dhe religjionet tjera. Tërë kjo është çështje e individit, prandaj mendoj se është gabim i madh që punohet me këmbëngulje në njëloj hedhjeje globale të fajit nga kombi në komb. I mbështes përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare e cila mundohet që mendimet dhe veprat e individëve t'i japë në opinion me theks strikt se bëhet fjalë për rast dhe opinion personal të individit dhe jo të tërë popullit. Sepse, nëse kjo nuk kufizohet qartë, krijohet fotografia e gabuar për tërë popullin mbi bazën e individëve dhe veprave të tyre. Në këtë kohë, heronjtë që nuk janë heronj, bëhen të tillë. Fashizmi bëhet fenomeni më normal. Edhe kjo është vërtet fotografia e shtrembëruar e opinionit tonë, e kjo veç hyn në fushën e gabimeve të politikanëve që e drejtojnë këtë vend në kahje plotësisht të gabuar dhe me vete udhëheqin ushtrinë e njerëzve të rinj. Problemi qëndron edhe në mosnjohjen e vetes si individ në kuadër të popullit. Së pari duhet të dimë se kush jemi dhe çfarë jemi, pastaj do ta kemi lehtë ta rrisim shkallën e tolerancës dhe do të bashkëpunojmë më lehtë me të tjerët. Toleranca nuk është diçka që fitohet me lindje, ajo është shkathësi që fitohet përmes viteve të përvojës. Unë jam që 16 vjet anëtarë e SHKAsë. Përmes atyre udhëtimeve dhe pjesëmarrjeve kam parë sesa është i njohur dhe i

vlerësuar në botë folklori serb. Këtu është edhe feja jonë që është specifike ortodokse, zakonet. Tërë kjo është ajo që një njeri duhet ta hulumtojë vetë sepse kjo është pjesë e trashëgimisë së tij. Ndërsa ne, pjesëtarët e popullit serb, jemi të prirur të turpërohemi nga tradita jonë dhe të largohemi nga ajo. Kjo është diçka që ne mundemi t'i ofrojmë botës. Edhe çdo popull në Bosnje e Hercegovinë duhet të përpiqet në kulturën dhe artin e tij. Arti dhe kultura janë ato që i bashkojnë njerëzit. Popujt janë të orientuar njëri ndaj tjetrit dhe duhet ta shfrytëzojnë këtë për dobinë e ndërsjellë. Integrimi në asnjë rast nuk do të thotë integrim etnik dhe ai lë mjaft hapësirë për njohjen e trashëgimisë së vet dhe trashëgimisë së popujve tjerë. Kur ta kuptojnë këtë shumica e njerëzve në Bosnje e Hercegovinë, nuk do të ketë më pengesa për pajtim.

Sa ka mundësi një i ri në Bosnje e Hercegovinë të marrë pjesë në procesin e pajtimit dhe në proceset tjera shoqërore?

Ka mundësi aq sa i lejon vetvetes që ato probleme t'i interesojnë. Atë moment kur të vendosë që të angazhohet, mund të përfshihet në disa mekanizma të caktuara që mund t'i ndihmojnë. Për këtë arsye meritat më të mëdha i kanë sektori joqeveritar dhe bashkësia ndërkombëtare, të cilët i financojnë këto programe. Organizohen mjaft programe dhe është në dorën e të riut se sa ai don të kyçet. Nga ana tjetër, përkundër mjaft projekteve, mungon informacioni që është në dispozicion të të riut. Në media do të takoni rrallë lajmërime për një program të tillë. Sikur informacionet të ishin në dispozicion, ata do të vendosnin lehtë nëse duan apo jo të marrin pjesë, ndërsa kështu nuk kanë zgjidhje.

A do ta mbajë edhe gjenerata juaj barrën e të kaluarës luftarake të Bosnje e Hercegovinës?

Natyrisht. Madje edhe gjeneratat që vijnë pas gjeneratës sime do ta mbajnë gjatë atë barrë të ngjarjeve luftarake në këtë trevë. E vetmja gjë që na mbetet është të balancojmë. Unë kështu e bëj balancën në jetën time duke u angazhuar në kulturë dhe aktivitete rinore. Në këtë mënyrë mundohem ta ruaj jetën normale dhe të mos mendoj se jetoj në shtetin, i cili pak kohë më parë ka qenë arenë e konflikteve luftarake.

Cila është përgjegjësia e “njeriut të zakonshëm” për pajtimin në Bosnje e Hercegovinë?

Shumë e madhe! Siç e thashë edhe më parë, derisa individi të mos marrë përgjegjësinë për veprimet e veta, nuk do të ketë një shkallë të kënaqshme të pajtimit. Një i njohuri im nga Janji, babain dhe nënën e të cilit e kanë vrarë serbët, ka vendosur që të kthehet të jetojë në Janji me familjen e tij dhe shpesh thotë se nuk ka qëllim të hakmerret dhe të kërkojë vrasësin e prindërve të tij, sepse kjo nuk do ta zëvendësonte humbjen e tij. Kur të gjithë ne të arrijmë një shkallë të tillë të tolerancës dhe arsyes do të mund të ndodhë diçka natyrore në këtë shtet. I njohuri im është ngritur mbi tërë atë situatë dhe është i vetëdijshëm se është njëri ndër personat e shumtë të cilëve iu ka ndodhur kjo e keqe. Në të është zgjuar humanizmi dhe etika, të cilat duhet t'i zgjojë çdo njeri nga vetja dhe të jetojë me këto parime. Përgjegjësia është e nevojshme të ndihet edhe për gjërat më banale. Mendoj se religjioni ka një rol të madh në tërë këtë. Ortodoksizmi që unë e kam trashëguar nga të parët e mi më mëson që të respektoj edhe të tjerët dhe që të fali. Unë i kam këto vlera nga familja ime dhe ata më kanë mësuar se besimi në Zot nënkupton faljen. Pra, ky është ai ortodoksizmi burimor dhe jo ky dogmatik që u shfaq pas vitit 1992. Njeriu duhet ta

Njeriu duhet ta kuptojë se nuk është i vetëm në planet dhe se duhet të mbajë përgjegjësi.

kuptojë se nuk është i vetëm në planet dhe se duhet të mbajë përgjegjësi. Duhet t'ju mundësohet njerëzve të rinj të udhëtojnë dhe të jenë mobilë, të kenë qasje ndaj informacioneve, të njohin popujt, religjionet dhe kulturat tjera dhe që ndoshta atë që nuk e gjejnë në religjionin, familjen apo shoqërinë e tyre, ta gjejnë në një vend tjetër, t'ju mundësohet e drejta e zgjedhjes.

Çfarë është ajo që kombi të cilit ti i takon do të mund të bënte për pajtimin në Bosnje e Hercegovinë?

Jetoj në qytetin i cili ka qenë pothuajse i pastër etnikisht nga viti 1992 deri në vitin 1995. Nga viti 1995 deri në vitin 2005 ka ndryshuar shumëçka dhe situata ndërnacionale është për çdo ditë e më e mirë.

Si e sheh të ardhmen e Bosnjes dhe Hercegovinës?

Kjo është pak problematike. Unë e kam këtë fotografi në kokën time, por më duket se shumë njerëz nuk shohin dhe nuk mendojnë për të ardhmen. E dini se si thonë, dhjetë të mirë nuk mund ta mbulojnë një të keq. Ka pak nga ne që e kemi fotografinë e vërtetë të Bosnjes e Hercegovinës në kokat tona. Fotografinë e shtetit normal të Bosnje e Hercegovinës, ku unë si serbe nuk do të isha e nënvlerësuar dhe e nënçmuar, dhe ku do të mund të thoja “Unë jam serbe, jetoj në Bosnje e Hercegovinë dhe jam ajo që jam”. Dhe të mos kishte komente, dhe unë të mos ndihem keq. Ky do të ishte shteti ku nuk do të më pengonin as kroatët, as boshnjakët. Unë nuk kam probleme me atë pse dikush e quan veten boshnjak dhe gjuhën e tij boshnjake, por dua që edhe e imja të nderohet njëjtë. Tani për tani, i vetmi qytet në Federatën e Bosnje e Hercegovinës ku unë ndihem ashtu është Sarajeva. Vetëm në Sarajevë nuk ndihem e kërcënuar si serbe, kurse qytetet tjera kanë mbetur në nivelin e vitit 1995. Bosnja e Hercegovina duhet të jetë shtet, i cili do t'ju ofrojë të drejta dhe mundësi të barabarta qytetarëve, pa marrë parasysh se çfarë kombësie janë. Sepse shpesh harrohet që në Bosnje e Hercegovinë nuk jetojnë vetëm pjesëtarët e popujve konstitutivë, por edhe shumë të tjerë... sllovakë, rumunë, romë. Por, për diçka të tillë duhet të ngritet pragu i tolerancës.

B. J.

Të mos lejojmë që të tjerët të flasin përherë për ne

Sa vjeçe keni qenë kur ka filluar lufta në Bosnje dhe Hercegovinë?

Kam qenë 21 vjeçe.

Çfarë kujtimesh keni nga periudha e luftës? A mund të na thoni shkurtimeisht se si je ndier në atë kohë?

Kujtimet e luftës mund të jenë kryesisht të këqija. Ashtu si çdo njeri, edhe unë e kam pasur vështirë dhe kam dhënë njëfarë viktime. Por për dallim nga shumica e njerëzve, unë, duke i dashur njerëzit, edhe në luftë kam njohur dhe jam shoqëruar me njerëz të kombësive tjera. Madje edhe sot i mbaj miqësitë e mrekullueshme që kam krijuar në atë periudhë tejet të vështirë.

Sa ka ndikuar lufta në jetën Tuaj? A e ka ndryshuar atë në ndonjë kahje tjetër?

Sa më përket mua, të gjitha shpresat e mia dhe tërë ajo që kam dashur të arrij ka mbetur e parealizuar. Kam humbur mundësinë që të rris fëmijët e mi bashkë me babain e tyre, kam humbur mundësinë që të mbaroj shkollimin ashtu siç kisha planifikuar, kam humbur mundësinë që të jetoj në mënyrë normale. Në luftë humbet shumëçka. Nga natyra jam optimiste dhe nuk kam dëshirë t'i kujtoj gjërat e këqija nga lufta. Mjafton vetëm fjala luftë që njeriu të ndihet keq. Pastaj kujtoj njerëzit e dashur, të cilët ndoshta nuk do t'i takoja kurrë po të mos ishte lufta dhe kjo më bën që ta përballoj më lehtë kujtimin për këtë periudhë. Disa nga miqtë e mi më të mirë janë njerëzit që janë larguar nga trevat tjera të Bosnjes e Hercegovinës dhe kanë ardhur të jetojnë në Bijelinë. Më duket se tërë jeta ime ka lëvizur në një kahje tjetër.

Si e ke përjetuar lajmin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit për Paqe?

Përshtypja e parë ka qenë: "Më në fund u ndalën të shtënat, më në fund mund të jem e sigurt dhe nuk duhet më të mendoj se a do të mbes nesër pa ndonjë anëtar të familjes apo mik".

Sa kemi ecur përpara në Bosnjë dhe Hercegovinë gjatë këtyre dhjetë viteve?

Përparim gjatë këtyre dhjetë viteve... nganjëherë më duket se nuk kemi bërë asnjë hap përpara. Ose në qoftë se edhe kemi bërë, ato janë aq minimale sa që nuk kemi as për çfarë të flasin. Ajo çfarë është bërë deri tani në Bosnje e Hercegovinë është bërë përmes njëfarë heshtjeje. "Unë do ta hesht këtë, ti do ta heshtësh atë", e kurrësi të përballemi sy në sy dhe të themi: "Shiko, unë jam fajtor për këtë dhe për këtë, ndërsa tani thuaj ti se për çfarë je fajtor, në mënyrë që të shohim se cilat janë mundësitë e përmirësimit të marrëdhënieve tona në përgjithësi".

A mendon ti se kjo distancë kohore prej 13 vjetësh nga fillimi i luftës dhe 10 vjetësh nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Dejtonit për Paqe është e mjaftueshme që të fillohet të bisedohet dhe të punohet për pajtim?

Mendoj që është vonë. Sipas meje, për këto tema është dashur të fillojmë të bisedojmë shumë më heret.

Çfarë nënkupton ti me fjalën pajtim?

Identiteti nuk mund të jetë kurrësi pengesë për pajtimin. Pajtimin e pengojnë mendjet e prishura, e kurrësi identiteti. Fakti që ekzistojnë dallime nacionale ndërmjet njerëzve në bazë të lindjes nuk është aq katastrofale, por katastrofal është fakti se ekzistojnë dallime në mendim. Kjo është ajo që sjell probleme e jo identiteti dhe përkatësia nacionale. Por unë vërtet nuk shoh që ne jemi kaq të ndryshëm për nga kombësia sa që të mos mundemi të jetojmë bashkë.

Me pajtim pas luftës konsideroj gatishmërinë për falje, para së gjithash. Megjithëse disa gjëra që janë bërë në këtë luftë janë të pafalshme, ekzistojnë njerëzit që i kanë bërë ato dhe që do të dënohen për ato që kanë bërë. Kjo do të duhej të ishte pikënisja e veprimit të njerëzve në pushtet – të cilët mbajnë një pjesë të përgjegjësisë për pajtimin ndërmjet kombeve të Bosnje dhe Hercegovinës – të dënojnë autorët e krimeve dhe me këtë të krijojnë bazën për pajtim ndërmjet kombeve.

A je ti personalisht e kënaqur me rrjedhën me të cilën po ecen procesi i pajtimit në Bosnje dhe Hercegovinë?

Nuk jam e kënaqur. Në rrethin e njerëzve në të cilin qarkulloj nuk ka njerëz që duhet t'i falë apo apo të më falin mua. Por, ekzistojnë njerëz në këtë vend të cilët është vështirë t'i falësh për atë që na kanë bërë. Megjithatë, sikur ata të bënin tani diçka që do t'i kontribuonte përparimit të këtij vendi (e jo vetëm të trazojnë shpirtrat e së kaluarës), mendoj se njerëzit do të gjenin forcë që t'i falin.

Si duhet të sillemi ndaj të kaluarës së kohës së luftës?

Mendoj se më në fund do të duhej të ndalemi dhe të themi të vërtetën në mënyrë që të mund ta tejkalojmë tërë atë që na ka ndodhur. Derisa të ekzistojnë disa gjëra të fshehta, që vërtet kanë ndodhur dhe fshehen me ngulm, kurse përmenden disa gjëra të cilat në çastin e caktuar iu përgjigjen njerëzve nga vetë kreu i pushtetit, nuk do të jetë mirë për askënd në këtë vend. Vetëm kur çdo gjë të nxirret në dritë dhe të sqarohet se kush është për çka dhe sa fajtor, dhe ky person të sanksionohet, vetëm atëherë individët “e zakonshëm” do të mund t'i zgjidhin më lehtë problemet ndërmjet tyre.

A ke pasur rast të takosh njerëz që nuk janë të gatshëm për pajtim dhe si reagojnë në situata të tilla?

Për fatin tim të madh shoqërohem me njerëz që mendojnë normalisht dhe shumë rrallë, ndoshta vetëm disa herë, kam qenë në situatë të takoj njerëz që nuk janë të gatshëm për pajtim dhe reagojnë në pajtim me këtë qëndrim të tyre. Ndonëse tani më duket se në këto situata njerëzit kanë pasur më tepër qëllim të kundërshtojnë qëndrimin tim, sesa kanë ekspozuar realisht qëndrimet e tyre të vërteta.

Si janë dukur vizitat tua të para në entitetin tjetër në Bosnje e Hercegovinë? Si e ke përjetuar mundësinë e shkuarjes në entitetin tjetër pas vendosjes më në fund të paqes në Bosnje e Hercegovinë?

Mendoj se bëj pjesë ndër personat e parë të cilët kanë rrezikuar të udhëtojnë ndërmjet entiteteve. Kam lindur në Srebrenik, një qytezë afër Tuzlës dhe pasiqë prindërit e mi kanë jetuar në Srebrenik, për herë të parë kam shkuar t'i vizitoj më 14 shkurt 1996. Më duhet të them se përsëri jam nisur në një pasiguri. Bashkëshorti im ka qenë tërë kohën pjesëtar i Ushtrisë së Republikës Serbe, ndonëse nga kombësia nuk jemi serbë. Sikur në atë çast dikush nga familja ime të më kishte thënë “pse”, mu në atë moment do të isha kthyer në shtëpi dhe do ta ndërpreja kontaktin me ta. Në qoftë se dikush nuk ka mundur të kuptojë se pse kemi vendosur të qëndrojmë në Bijelinë, atëherë ai dikushi nuk ka mundur të më kuptojë as mua si person. Shkuarjen në Federatën e Bosnjes dhe Hercegovinës e kam pasur shumë të vështirë. Kam shkuar në një gjendje të pasigurt me fëmijën 4-vjeçar dhe kam lënë në shtëpi bashkëshortin dhe fëmijën 7-vjeçar. Ka qenë vështirë në atë çast të shkosh në vendin ku ke lindur dhe të mbledhësh përshtypjet e njerëzve pas tërë asaj që ka ndodhur. Mendoj që kam pasur fat sepse askush nuk më ka pyetur për asgjë, por

jam e vetëdijshme se ajo vizitë ka mundur të jetë përvojë mjaft e keqe. Gjatë kthimit kam kaluar pak a shumë keq, sepse në atë kohë për të dalur nga Republika Serbe është dashur të lajmërohesh në MPB. Gjatë kthimit në Bijelinë, policia ka dashur të më kthejë nga kufiri midis entiteteve dhe të mos më lejojë të hyjë në Republikën Serbe. Për fat të mirë, miqësia e madhe i zgjidhë të gjitha, kështu që personi që me atë rast më ka vozitur nga Srebreniku ka arritur të më kthejë në shtëpi falë lidhjeve të tij personale.

Gjatë periudhës së luftës fëmijët tuaj kanë qenë relativisht të vegjël... A e kujtojnë tani, kur janë pothuajse të rritur, atë periudhë? A pyesin ndonjëherë për atë periudhë?

Shumë rrallë, posaçërisht djali i vogël, i cili ka pasur 18 muaj kur ka filluar lufta, kështu që e ka kaluar në mënyrë të pavetëdijshme këtë periudhë. Djali të madh i kujtohen disa detaje, por duke pasur parasysh emrin, i cili nuk është emër tipik musliman, nuk ka pasur trauma të këtij lloji.

A shqetësohesh ti si nënë për fotografinë e asaj periudhe, të cilën fëmijët tuaj mund ta marrin përmes mediave dhe sistemit arsimor? A je ti e kënaqur me informacionet që na ofrohen përmes mediave dhe arsimit lidhur me këtë periudhë?

Do të jem e singertë. Kur ka filluar të shkojë në shkollë djali im i madh, në tekstet shkollore ka ekzistuar diçka që ka të bëjë me luftën e kaluar, e që për mua nuk ka qenë reale. Në çdo pikëpamje, unë mendoj se secili prind i ka meritat më të mëdha për atë se çfarë bartin fëmijët nga fëmijëria. Nuk kam qëllim të nënvlerësoj kontributin e punëtorëve pedagogjikë në arsimimin e fëmijëve dhe mendoj se shkollimi tek ne është relativisht cilësor. Megjithatë, bëhen disa gabime në sistemin shkollor, që lindin si pasojë e zënave të njerëzve, të cilët nuk kanë për qëllim pajtimin dhe që konfliktet e tyre i transferojnë në tekstet e fëmijëve, por, për fat të mirë, këto gabime nuk janë aq të mëdha sa të mos munden të përmirësohen tek shtëpia.

A është e mundur sot, sipas mendimit tënd, të realizosh pa pengesa identitetin e vet nacional dhe fetar dhe a janë këto identitete diçka që i kontribuojnë apo që e vështirësojnë pajtimin?

Identiteti nuk mund të jetë kurrësi pengesë për pajtimin. Pajtimin e pengojnë mendjet e prishura, e kurrësi identiteti. Fakti që ekzistojnë dallime nacionale ndërmjet njerëzve në bazë të lindjes nuk është aq katastrofale, por katastrofal është fakti se ekzistojnë dallime në mendim. Kjo është ajo që sjell probleme e jo identiteti dhe përkatësia nacionale.

A mendon se shkalla më e madhe e tolerancës ndaj identitetit të tjerëve (mospërjetimi i identitetit të dikujt si agresion) do ta ndihmonte pajtimin në Bosnje e Hercegovinë?

Po të kemi parasysh se unë personalisht nuk e shoh identitetin si diçka që e pengon procesin e pajtimit, a mendon se kjo është e mjaftueshme? Megjithatë i qëndroj akoma mendimit se nuk është identiteti ai që iu pengon këtyre njerëzve, atyre iu pengojnë disa gjëra tjera... ata e kanë problemin në kokë e jo me identitetin e dikujt. Nuk është i diskutueshëm fakti pse dikush është serb, musliman apo kroat, por sepse dikush i pengon dikujt të zhvillojë dhe të realizojë ambiciet e tij të sëmura. Dikush dëshiron, në një moment të caktuar, ta shkatërrojë shtetin dhe bashkohet me të tjerët që kanë të njëjtin qëllim dhe atëherë gjendet shkak. Këtë herë shkak

Populli të cilit i takoj duhet të bëjë atë që duhet të bëjnë edhe popujt tjerë në Bosnje e Hercegovinë... Mendoj se të gjithë ne jemi fajtorë në mënyrë të barabartë sepse është e pamundur të luftosh kundër dikujt që refuzon të luftojë. Sikur njëri prej tre popujve të heqte dorë nga lufta, me kë do të luftonte ai tjetri? Të gjithë ne, në momentin e caktuar, kemi shfaqur njëfarë force dhe vrazhdësie, kurse tani që duhet të flitet për pasoja, ne veprojmë si fëmijë të vegjël: "Nuk jam unë, ai është!!!"

ka qenë parkatësia e ndryshme nacionale. Por unë vërtet nuk shoh që ne jemi kaq të ndryshëm për nga kombësia sa që të mos mundemi të jetojmë bashkë. Mua nuk më pengon as kambana e kishës, as hoxha që lutet në xhami. Nuk më pengon absolutisht a quhet dikush kështu apo ashtu, por më pengon kur dikush e vret dikë, më pengon kur dikush dikujt i shkakton çfarëdo të keqeje dhe më pengon kur dikush plaçkit atë që definitivisht i takon dikujt tjetër.

Shpesh ke kontakt me njerëz që gjatë luftës janë larguar nga Bijelina dhe tani vijjnë aty vetëm për pushim. Cili është qëndrimi i këtyre njerëzve, a janë të gatshëm të kthehen në Bijelinë dhe si e shohin ata tani Bosnje e Hercegovinën?

Mendimet janë të ndara. Disa njerëz qëndrojnë jashtë vendit për shkak të situatës ekonomike, sikurse edhe ata që nuk e kanë tejkaluar, sqaruar në vetvete çështjen e faljes dhe nuk kanë falur. Ata që kanë dashur, veç e kanë bërë faljen. Që në fillim kam thënë se është shumë vonë të pyetet se çfarë është e nevojshme për procesin e pajtimit në Bosnje dhe Hercegovinë. Kush e ka dashur këtë, e ka sqaruar këtë me kohë në kokën e tij. Apo ndoshta edhe nuk ka pasur çfarë të sqarojë për arsye se ata e kanë ditur, thjesht, se çfarë është ajo që iu pengon dhe që do t'i shmangen dhe çfarë është ajo që nuk iu pengon, të cilës do t'i përshtaten. Qëmoti është sqaruar se kush ka falur, kush jo, kush është kthyer, kush jo. Duke pasur parasysh se kam qenë e njohur edhe me punën e Ministrisë për Refugjatë dhe Persona të Shpërngulur të Republikës Serbe, e cila ka punuar për kthimin e pronës, e di se një shumice, një shumice të madhe i është kthyer prona dhe se një përqindje shumë e vogël e pronës ka mbetur pa u kthyer. Njerëzit të cilëve iu është kthyer prona dhe që janë kthyer në shtëpitë e tyre... nuk janë kthyer ata të gjithë për shkak se kanë dashur, por shumica e tyre janë kthyer sepse janë të moshuar dhe nuk kanë pasur ku të shkojnë tjetër.

Në atë periudhë të luftës ka pasur me siguri edhe njerëz që ty personalisht të kanë shkaktuar mundim duke të fyer, kërcënuar... Si e përballon sot këtë, a të ka kërkuar ndonjëri prej tyre falje për mundimin që ta ka shkaktuar?

T'ju them sinqerisht, për fatin tim të mirë, unë dhe anëtarët e familjes sime nuk kemi pasur lëndime fizike. Ofendime dhe kërcënime verbale ka pasur... E vlerësoj mendimin e fqiut tim, i cili ka vepruar në këtë mënyrë negative dhe i ka lejuar vetes që mua, si pjesëtare e pakicës, të më ofendojë. E vlerësoj atë, ai është mendimi i tij dhe kushdo mund të më urrejë, kjo mua nuk më paraqet problem. Pas gjithë asaj që ka ndodhur, natyrisht që nuk ka kërkuar falje, aq më tepër nuk e kanë parë të arsyeshme as që të komunikojnë me mua pas kësaj, sepse e kanë thënë mendimin e tyre qartë dhe me zë të lartë në momentin e caktuar. Më pak i çmoj ata njerëz të cilët në atë periudhë janë larguar nga unë, gjoja për shkak të njëfarë frike se mund t'ju ndodhë diçka e keqe që mund të më ndodhte edhe mua. Ndërsa tani pas luftës janë bërë të mirë, të dashur, kurse në fakt janë të dobët dhe unë nuk i përjetoj si njerëz që kanë kualitete të mjaftueshme që të shoqërohem me ta. Por, ata nuk kanë qenë miqtë e mi as para luftës. E vlerësoj edhe kur më thuhet se jam e padëshiruar, por kjo nuk do të thotë se duhet të vritemi për arsye se nuk e duam njëri-tjetrin, kurse jetojmë në të njëjtin territor.

A e përjeton tani, dhjetë vjet pas, Bijelinën si mjedis ku mund t'i realizosh të drejtat Tuaja? A mundesh ti, si pjesëtare e njërit prej popujve konstitutivë që është në pakicë në këtë qytet, t'i realizosh në masë të njëjtë të drejtat tuaja?

Që të jem e sinqertë, as gjatë kohës së luftës disa të drejta të mia njerëzore nuk



kanë qenë të kërcënuara në atë masë që kanë qenë të kërcënuara të drejtat e muslimanëve tjerë në Bijelinë. Bashkëshorti im gjatë tërë kohës së luftës e madje edhe sot punon në firmën ku është punësuar para luftës. Unë nuk kam qëndruar në vendin tim të punës, jam pushuar nga puna. Falë rrethanave fatlume dhe njerëzve që më rrethojnë, sot jetoj mirë, unë dhe bashkëshorti punojmë, fëmijët shkojnë në shkollë... Nuk kam pasur kurrfarë problemesh të veçanta për shkak se i përkas kombësisë tjetër. Ndonëse, kur mendoj pak më mirë dhe e analizoj situatën, ekzistojnë disa institucione nga të cilat insistohet që të kthejnë në vendet e punës njerëzit që kanë punuar në ato vende para luftës, gjë që ato nuk kanë dëshirë ta bëjnë... Megjithatë, sipas meje, kjo nuk do të zgjasë shumë sepse çdo gjë në fund do të vijë në vendin e vet, do të ndreqet edhe kjo. Ky është një segment ku mund të them se janë të kërcënuara të drejtat e njeriut.

Jemi dëshmitarë se në Bosnje e Hercegovinë, sidomos në institucionet shtetërore, i kushtohet kujdes parimit të “çelësit nacional” (tripartitetit). Sa mendon se i kontribuon kjo pajtimit në Bosnje e Hercegovinë?

Mendoj se kjo është mihje në plagën e freskët. Nuk e dua tërë atë që vë theksin në përkatësinë nacionale, në plan të parë, qoftë nëse bëhet fjalë për punësimin sipas çelësit nacional, barazinë e numrit të pjesëtarëve të kombësive të ndryshme në institucione etj. Mendoj se duhet të zgjedhen dhe të punësohen njerëz që kanë cilësi, pa marrë parasysh kombësinë. Më shumë ka nevojë që të zgjidhet çështja e falsifikimit të diplomave të marra gjatë luftës dhe punësimit në baza farefisnore, sesa të insistohet në parimin e “çelësit nacional”.

Sa mund të bëjë për pajtimin qytetari, individi i zakonshëm i Bosnje dhe Hercegovinës?

Shumë, duke filluar nga ajo që të mos i lejojmë më vetes të zgjedhim njerëzit e gabuar, të cilët do të sundojnë, udhëheqin dhe flasin se mendojnë dhe punojnë atë që ne kemi menduar, kemi dashur dhe kemi thënë. Nëse heshti dhe rri ulur në shtëpi dhe dëgjoj se si flasin dhe punojnë, çdo gjë dhe gjithçka, natyrisht që jam përlulur dhe e kam lejuar këtë, atëherë e kam merituar këtë, gjërat e këqija që mund të më ndodhin. Mendoj se duhet të fillojmë të flasim atë që mendojmë dhe të mos lejojmë që të tjerët të flasin përherë për ne. Prandaj, nëse do të ishim të vetëdijshëm për atë çfarë do të na ndodhte, sikur para luftës të kishim folur me një zë – nuk do të kishte pasur as luftë, pa marrë parasysh ata njerëz që e kanë dashur këtë luftë. Ndi-hem tmerrësisht keq kur i dëgjoj njerëzit para zgjedhjeve duke thënë: “E di unë se kush do të jetë sërish në pushtet, nuk dua të votoj, e di se kush do të fitojë... etj.” Ndoshta ndonjëherë edhe unë e di se kush do të fitojë, por kur dal në zgjedhje dhe e jap votën time, vetëdija ime është e qetë.

Çfarë duhet të bëjë ende populli të cilit i takon për arritjen e pajtimit në Bosnje e Hercegovinë?

Populli të cilit i takoj duhet të bëjë atë që duhet të bëjnë edhe popujt tjerë në Bosnje e Hercegovinë... thjesht, duhet të flasin të vërtetën, vetëm të vërtetën dhe ta tejkalojnë më në fund atë “hajde të fajësojmë dikë tjetër dhe le të jetë dikush tjetër më tepër fajtorë”. Mendoj se të gjithë ne jemi fajtorë në mënyrë të barabartë sepse është e pamundur të luftosh kundër dikujt që refuzon të luftojë. Sikur njëri prej tre popujve të heqte dorë nga lufta, me kë do të luftonte ai tjetri? Të gjithë ne, në momentin e caktuar, kemi shfaqur njëfarë force dhe vrazhdësie, kurse tani që duhet të flitet për pasojat, ne veprojmë si fëmijë të vegjël: “Nuk jam unë, ai është!!!”, e cila nuk është mënyrë për zgjidhjen e problemeve në nivel shtetëror.

Si e sheh të ardhmen e Bosnje e Hercegovinës?

Po, nuk është inkurajuese, por për çdo rast, nëse nuk do të thonin të vërtetën siç nuk e thonë, kjo gjendje në të cilën ndodhemi tani do të zgjasë gjatë. Po të heshtim, i vëmë kapakun dhe jetojmë keq. Në qoftë se njerëzit do të ishin vërtet të gatshëm t’i pranojnë gabimet e tyre dhe ta pranojnë atë që kanë gabuar... ndonëse, në luftë, ndodhin shpesh edhe humbje të cilat nuk mund të kompensohen. Do të mund të ishte mirë vetëm sikur ne t’i ktheheshim punës që do të sillte përmirësimin e situatës ekonomike në Bosnje e Hercegovinë, por edhe sikur të flitnim disa histori tjera, përveç atyre historive që shfaqen në media se dikush i ka bërë dikujt diçka të keqe vetëm për arsye se është i përkatësisë tjetër. Shumë më të mira do të ishin lajmet se dikush e ka ndërtuar një fabrikë në të cilën ka punësuar një masë njerëzish dhe nuk ka pyetur se çfarë kombësie janë, por a janë mjaft profesionalë. Mendoj se atëherë çdo gjë do të ishte ndryshe dhe më lehtë... Por, thënë sinqerisht, nuk jam optimiste dhe nuk e shoh se diçka e tillë do të ndodhë së shpejti.

B. J.

Besim e jo të na ruajë ushtria

Për fillim më thuaj diçka për veten, kush je, nga je, sa vjet ke...?

Jam Nexhati nga Medvegja. Kam lindur në Medvegjë. Tani do të mbushë 36 vjet. Shkollën fillore e kam kryer në Medvegjë, pastaj kam vijuar shkollën e mesme në Prishtinë, një kohë kam studiuar për kimi. Diku në tetor të vitit '91, kur është mbyllur fakulteti në Prishtinë dhe kur na kanë dëbuar ne shqiptarëve nga konviktet e studentëve, para se ta marr thirrjen për mobilizim në luftë në Kroaci, Bosnjë, nuk kujtohem saktësisht, kam shkuar në Greqi. Jam kthyer kah fundi i vitit 1995. Pas vitit 1995 kryesisht kam qëndruar në Medvegjë dhe Prishtinë, kurse nga gushti i vitit 1999 jam larguar nga Medvegja dhe momentalisht jetoj në Gjilan. Punoj në OSBE. Po ashtu që nga viti 2000 jam aktivist i Aksionit kundër dhunës dhe për ndërtimin e paqes në Gjilan...

Çfarë kujtimesh ke nga vitet e luftës, vite në të cilat ka pasur dhunë?

Ka mjaft momente prekëse kur kthehem në të kaluarën, kur e kujtoj atë. Në jetën time mungojnë nja 5 vjet të cilat i kam kaluar jashtë vendit, të cilat, ndoshta, nuk i kisha kaluar sikur të mos kishte qenë lufta në Ballkan. Dhe kurdo që flitet për atë periudhë, diçka më mungon, nuk kam informacione sepse nuk kam qenë këtu. Nuk mundem të bëj assesi krahasime, por kur më bie ndërmend se si ka qenë gjatë 10 viteve të fundit, tmerrohem dhe për këtë punoj që të mos na përsëriten më gjëra të tilla. Nuk do të dëshiroja t'i kaloja përsëri të gjitha këto, kur kujtoj vetëm kohën kur kam qenë student derisa studioja kiminë, që në vitet '90, ato procese, ngjarje, dhunën e asaj kohe, që përfundoi me luftën e vitit '99 kur kam qenë në Medvegjë... Shumë ndryshime kanë ndodhur.

Si kanë ndikuar tek ti të gjitha këto ngjarje? Si e ke përjetuar tërë këtë që ka ndodhur?

E kam përjetuar vështirë, sepse janë bërë çrregullime të mëdha në shoqëri. Në Medvegjë, prej nga jam dhe ku e njoh krejt atë popull, njerëzit përnjëherë kanë ndryshuar: ecën rrugës dhe dikush nuk don të të thotë mirëdita. Shqiptarët atje kanë qenë pakicë, 36 %, kurse tani janë 4%. Kjo mua më dhemb shumë sepse kur kam ardhur në Gjilan kam vërejtur se gjërat vetëm përsëriten, si bumerang. Këto janë situata të njëjta, vetëm lojtarët janë tjerë, në Gjilan kanë qenë shqiptarët, kurse në Medvegjë serbët. Kjo më ka shkaktuar dhimbje të madhe dhe aktivizmi im i brendshëm ka vluar për këtë.

A i ke ndier ti personalisht pasojat e kësaj dhune?

Kur flasim për pasojat, nuk kam humbur askënd nga familja, as që kam qenë i keq-trajtuar fizikisht, kurse të afërmve të mi u janë djegur shtëpitë. Bëhet fjalë për fshatin Safajlia. I kam vizituar në vitin 1999. Shumica e tyre kanë qenë në Maqedoni, disa kanë qenë në Shqipëri, kurse disa kanë qenë në pyll, sepse nuk kanë pasur ku të shkojnë, kanë qenë të dëbuar dhe këtë e kam përjetuar shumë vështirë sepse si student kam jetuar tek ata. E kam pasur po ashtu vështirë edhe kur familja ime ka

Në Medvegjë, prej nga jam dhe ku e njoh krejt atë popull, njerëzit përnjëherë kanë ndryshuar: ecën rrugës dhe dikush nuk don të të thotë mirëdita. Shqiptarët atje kanë qenë pakicë, 36 %, kurse tani janë 4%. Kjo mua më dhemb shumë sepse kur kam ardhur në Gjilan kam vërejtur se gjërat vetëm përsëriten, si bumerang. Këto janë situata të njëjta, vetëm lojtarët janë tjerë, në Gjilan kanë qenë shqiptarët, kurse në Medvegjë serbët.



jetuar në Medvegjë, kurse unë në Gjilan dhe gjatë viteve 1999-2000 i kam vizituar vetëm katër herë për shkak të atyre pikave të kontrollit dhe keqtrajtimeve në kufirin administrativ. Pasi që unë jam nga Medvegja e kam pasur vështirë në Gjilan t'i rishqyrtoj qëndrimet e mia dhe qëndrimet e të tjerëve, në përgjithësi në njëfarë katrahure dhe e kam pasur vështirë t'i kuptoj njerëzit. Më kanë shikuar si dikë "ky vjen nga Serbia", edhe kjo ka qenë vështirësi, dhe atëherë nuk ka pasur hapësirë që të thuash mendimin e vet se a nuk pajtohesh me diçka.

Si e sheh ti në përgjithësi pajtimin duke pasur parasysh situatën në Kosovë?

Situata në Kosovë është mjaft e tensionuar për shkak të negociatave që duhen të fillojnë. Pas vitit 1999, pas bombradimit, është filluar nga zeroja për krijimin e institucioneve të Kosovës dhe mund të them – nëse them se është paqe, atëherë nuk është ajo paqe që unë dëshiroj ta kam. Për mua është qetësi kur të gjithë në shoqëri janë të kënaqur. Këtu është më tepër një paqe e imponuar nga bashkësia ndërkombe-tare. Ekziston paqja ndoshta për shqiptarët, por jo edhe për serbët dhe pakicat tjera që jetojnë në Kosovë. Gjatë atyre tre muajve të bombardimeve, ndërkaq lufta ka filluar që në vitin 1998, ka pasur shumë shtëpi të djegura, njerëz të zhdukur, edhe nga shqiptarët, edhe nga serbët, dhe ka qenë vështirë. Më vonë gjithçka është kthyer si bumerang, posaçërisht dhuna ndaj serbëve dhe pakicave tjera. Situata nuk ka qenë gjithkund njësoj; për shembull, në Gjilan njerëzit nuk janë dëbuar gjatë kohës së luftës, por vetëm nga fshatrat përreth, dhe edhe tani situata e pasluftës është ndryshe. Në Pejë, ta zëmë, e cila ka qenë e djegur, procesi i kthimit shkon shumë më vështirë; varet nga ajo se çfarë pasojash ka pasur secili qytet në këtë luftë.

Si e sheh pajtimin? A është ai i mundur në Kosovë?

Po, është i mundur. Të gjithë duhet të punojnë në këtë drejtim. Së pari politikanët, të cilët ashtu siç flasin duhen edhe të mendojnë. Ta zëmë, ka deklarata të mira, por

më vonë nuk ka efekt, sepse politikanët nuk qëndrojnë pas asaj që thonë. Pastaj mediat, është me rëndësi të flitet se çfarë ka ndodhur, u kanë ndodhur gjëra të tmerrshme, edhe shqiptarëve edhe serbëve. Do të ishte shumë me rëndësi të flitej për këto gjëra, nuk jam për atë që të harrojmë, por jam për falje, duhet të falim.

A flet ti për një raport aktiv ndaj të kaluarës?

Po, për një raport aktiv. Duhet të tregojmë se çfarë ka ndodhur. Një rol të madh këtu do ta luanin mediat, do të ishte mirë të tregohej në Serbi pamja e vërtetë e asaj çfarë ka ndodhur në Kosovë. Ose sikur të bashkëpunonin mediat ndërmjet veti, sikur të tregohej pamja e njerëzve të zakonshëm se si e kanë përjetuar ata luftën, e jo të gjenden histori të cilat rëndom serviren.

Po çfarë mund të bëjnë “njerëzit e zakonshëm”?

Njerëzit e zakonshëm mund të bëjnë shumë. Së pari, të mos urrejnë. Të mos i përgjithësojnë gjërat, të mos thonë “të gjithë serbët janë të këtillë” ose “të gjithë shqiptarët janë të atillë”. Unë e di se ka shumë paragjykime në mes njëri-tjetrit, ndoshta për shkak të mosnjohjes, informimit të pamjaftueshëm, për shkak të asaj se si dikush e ka servirur përmes mediave më parë apo për shkak të asaj se çfarë promovohet nga qeveritë e atyre vendeve. Duhet të ketë më shumë takime në mënyrë që njerëzit të kenë rast të shprehin atë që mendojnë, të njihen, të shohin se nuk është ashtu siç u është servirur.

A kanë njerëzit rast të takohen?

Nuk kanë tamam sa duhet. Njerëzit në Kosovë jetojnë të ndarë. Kjo është ajo që më mundon më së shumti. Njerëzit jetojnë në enklava të ndara, jetojnë kryesisht në zona të ndara dhe shumë pak komunikojnë mes veti. Njerëzit e zakonshëm shmangen të kenë ndonjë kontakt. Duhet të dëgjojnë njëri-tjetrin dhe të flasin, por kjo mungon. Unë si individ mbaj përgjegjësi në këtë shoqëri – ku jam unë në gjithë këtë rrëfim? Njerëzit e zakonshëm ndoshta do të mund të ndikojnë më shumë në këtë fushë. Nuk mjafton vetëm të kthehem mbrapa dhe të themi “serbët na kanë bërë këtë, këtë dhe këtë, dhe pse unë të pajtohem?”. Hapi i parë i mirë drejt pajtimit do të ishte që të gjithë t'i dënojmë kriminelët nga radhët tona. Kriminelë ka nga të gjitha palët, por për mua ka rëndësi, jo edhe aq çfarë ndodh në Serbi, sa çka ndodh në Kosovë, në kuptimin që dëshiroj të punoj në oborrin tim, aty të veproj. Më pas edhe më tej, por për mua ka rëndësi të kontribuoj në mjedisin tim. Mendoj se kjo punë është mjaft e vështirë, sepse të gjithë ata janë heronj kombëtarë, kreshnikë dhe tërë kjo shikohet nga aspekti i fqinjit – sa heronj të tyre kanë shkuar në Hagë. Mendoj se do të ishte i mirëserardhur sensibilizimi i dhunës dhe se qytetarët do të mund të luajnë një rol të madh në këtë drejtim.

Pak më parë e përmende përgjegjësinë. Si e sheh ti atë? Si është ajo, individuale apo kolektive? A mund të flitet për fajin dhe/apo për përgjegjësinë?

Përgjegjësia është individuale, nuk mund të jetë kolektive, kurrësi. Unë e shoh përgjegjësinë time nëse nuk kam qenë në gjendje të reagoj ndaj diçkaje, ta zëmë në vitin 1999 ose më parë. Po ashtu kam përgjegjësi si pjesëtar i atij kombi apo si qytetar i një vendi. Kur thuhet se të gjithë serbët janë përgjegjës për atë që ka ndodhur në Kosovë, ose kur dëgjoj se të gjithë shqiptarët janë fajtorë për 17 marsin ose për gjendjen e pasluftës, për atë që u ka ndodhur serbëve në këtë periudhë, atëherë para meje shtrohet një pyetje “a jam unë fajtor për këtë?”. Nuk jam. Krimineli ka

Se a do të jetë Kosova e pavarur apo do të mbetet në kuadër të Serbisë... Për mua është me rëndësi që të krijohet besimi midis njerëzve, që njerëzit të kenë besim në njëri-tjetrin, e jo të na ruajë ushtria, të kemi ushtrinë në kufij.

emër dhe mbiemër dhe ai duhet të përgjigjet pa marrë parasysh fenë, kombin, bashkësinë së cilës i takon, kjo nuk më intereson.

Çfarë duhet të bëjë populli të cilit i takon? Çfarë duhet të bëjnë shqiptarët në Kosovë?

Shqiptarët do të duhej të dalin nga roli i viktimës, të mos e shohin veten si viktimë – “çfarë na kanë bërë ne serbët”. Vështirë është. Të gjithë popujve u kanë ndodhur gjëra të këqija dhe kjo nuk e justifikon dhunën ndaj të tjerëve apo të refuzosh që të komunikosh vetëm pse është pjesëtar i atij kombi. Njëri prej proceseve kryesore që do të duhej të inicoheshin janë aksionet paqësore dhe pajtimet. Kjo është më e rëndësishmja për Kosovën; është edhe zhvillimi ekonomik dhe të gjitha tjerat, por vështirë se mund të arrihen pa paqe. Politikanët veçmas do të duhej të kenë kujdes që, ta zëmë, presidenti t’i vizitojë ata njerëz, të shoh se cilat janë nevojat e tyre në mënyrë që vërtet të gjithë njerëzit në Kosovë të ndjehen si qytetarë të barabartë dhe të sigurt.

Cilat mendon se janë pengesat që e frenojnë procesin e pajtimit, cilat janë ankthet?

Njëra prej pengesave është statusi i Kosovës, me të cilin po manipulohet dhe secila parti politike po e shfrytëzon statusin për të fituar pikë dhe po merret pak me problemet e vërteta; kjo është më shumë parullë për zgjedhje. Pengesë të madhe paraqet edhe numri i madh i personave të zhdukur, qoftë shqiptarë apo serbë. Do të ishte shumë mirë sikur e gjithë kjo të bëhej publike. Në Kosovë për çdo muaj kthehen 40 kufoma... Ndoshta do të ishte me më pak dhembje që të kthehen kufomat, pasi që tashmë dihet se ekzistojnë varrezat masive. Mendoj se do të ishte më lehtë edhe për ato familje. Ekziston frika e individëve se, nëse pajtohet me dikë ose nëse bashkëpunon me dikë, bashkësia e tij do ta përjashtojë dhe do ta konsiderojë tradhtar. Një gjë tjetër, në nivel më të lartë, ndoshta politik, qeveria në Serbi ka ndryshuar, megjithatë disa gjëra kanë mbetur të njëjta. Nuk them se këtu politikanët janë idealë, por do të ishte mirë sikur qeveria serbe, sikur politikanët të flisnin për ato krime dhe ndoshta edhe të kërkojnë falje në emër të shtetit. Ky do të ishte një hap përpara drejt progresit. Se a do të jetë Kosova e pavarur apo do të mbetet në kuadër të Serbisë... Për mua është me rëndësi që të krijohet besimi midis njerëzve, që njerëzit të kenë besim në njëri-tjetrin, e jo të na ruajë ushtria, të kemi ushtrinë në kufij. Unë kam frikë se në këto negociata nuk do të arrihet zgjidhja, se zgjidhja do të imponohet nga bashkësia ndërkombëtare dhe se do të krijohet tokë e frytshme për dhunë dhe konflikte të mëtejshme që nuk do të kishin fund. Unë do të dëshiroja që të arrihet paqja e përhershme. Do të dëshiroja që të krijohen kushtet që njerëzit të kthehen, sidomos serbët, dhe joshqiptarët e tjerë, t’i kenë të gjitha të drejtat.

Si e sheh të ardhmen me ngarkesat e të kaluarës ?

Asgjë nuk ka ndodhur përnjëherë, por nëse, për shembull, janë dashur dhjetë vjet që të bëhet diçka e keqe, mendoj se do të na duhet dyfish më shumë kohë që të bëhet diçka e mirë. Duhet edhe shumë kohë, energji. Po ashtu është me rëndësi që të gjithë të marrin pjesë në të, që njerëzit ta njohin rolin e vet në atë shoqëri, të marrin pjesë në ndërtimin e paqes. E ardhmja? Unë përpiqem të punoj për këtë, të jetoj në shoqëri normale ku nuk ka diskriminim...

H. R.

T'i pastrojmë gjërat në kopshtin tone

Me çfarë ndjenjash i shikon tani të gjitha ato ngjarje të viteve '90 në Kroaci dhe çfarë mendon se mund të kuptohet nga e gjithë ajo?

Pyetje shumë e ndërlikuar ku të duhet pak më shumë kohë për të ardhur deri tek disa përfundime që janë të rëndësishme për tani, për të tashmen ose të ardhmen. Në çdo rast, nuk kam shkuar pas ndonjë ngjarjeje aktuale politike si atëherë, ashtu edhe tani, por kjo nuk do të thotë se nuk kam besuar madje edhe në fjalën politike dhe të tjerat, por në një mënyrë që nuk ka qenë as atëherë, por as sot, e pranuar në mënyrë masive. Në vitin 1990 kam qenë anëtar i lëvizjes së Ante Markoviqit, e cila në atë kohë ka luftuar kundër luftës dhe për mbrojtjen e Jugosllavisë, që ka qenë atëherë zgjidhje krejt normale tek të gjithë njerëzit, të cilët nuk kanë vuajtur nga disa histori nacionale. Kam qenë anëtar edhe i partisë së të gjelbërve, e cila ka qenë parti në nivel shtetëror dhe kuvendin themelues e kemi mbajtur në Zagreb. Me politikë nuk jam marrë gjatë luftës, por kam filluar të merrem sërish në Beograd në vitin 1997, në fakt në vitin 1996 kur kanë filluar protestat qytetare kundër regjimit të Millosheviqit. Edhe tani merrem në mënyrë amatore me politikë, jam sekretar i PPK-së këtu në Knin. Mendoj se është e rëndësishme të merresh me politikë, por mbi një bazë krejt ndryshe ngaqë ka qenë praktikë në këto treva të këtushme edhe para luftës, edhe gjatë saj, edhe pas luftës.

Sipas mendimit tënd, cila është ajo mënyra konkrete për t'u marrë tani me politikë?

Të jesh idealist dhe të mos presësh ndonjë informacion të madh pozitiv kthyes. Ndoshta të jesh pak para kohës, por kjo është shumë, shumë vështirë; unë mund të vlerësoj nëse jam unë me qëndrimet e mia politike përpara kohës, nuk them për qëndrimet e të tjerëve. Të paktën ajo që ka ndodhur në të kaluarën ka dëshmuar se kam pasur relativisht të drejtë, megjithëse kam qenë në pakicë totale. Konkretisht, mendoj në zhvillimin e paqes, por në një mënyrë që është totalisht anacionale dhe idealiste, thjesht – të synohet drejt saj. Unë kam menduar në vitin 1990, kur kam qenë në Knin, se nuk ka shans që Knini të jetë qytet i cili do ta nxisë luftën dhe i cili simbolikisht do të jetë luftënxitës në hapësirat e ish-Jugosllavisë. Kam menduar se në Knin mund të jetë diçka plotësisht e kundërt, por këtu jam mashtruar. Kam besuar në disa ideale në të cilët besoj edhe tani sepse nuk kam të dytë. Zgjidhja e dytë është konflikti, përsëri konflikti.

Cilat janë ato ideale?

Të jetohej në vendin i cili është anacional, i cili në bazën e tij nuk është nacional, por vend social. Ideali im është që të jetohej pa dallime sociale apo që njerëzit të jenë të vetëdijshëm për këto dallime sociale dhe të luftojnë për një jetë më kualitative dhe më të mirë, e cila nuk do të mbështetet në atë që na kanë mësuar politikanët gjatë gjithë këtyre dhjetë viteve se në vend të parë është e rëndësishme kombësia, se është e rëndësishëm *background*-i material apo nuk e di se çfarë tjetër. Ajo që unë

Unë kam menduar në vitin 1990, kur kam qenë në Knin, se nuk ka shans që Knini të jetë qytet i cili do ta nxisë luftën dhe i cili simbolikisht do të jetë luftënxitës në hapësirat e ish-Jugosllavisë. Kam menduar se në Knin mund të jetë diçka plotësisht e kundërt, por këtu jam mashtruar.

Zoti apo natyra
ma ka dhënë
që të jem
pjesë e pakicës
nacionale serbe dhe të
shoh, të mos
largohem, të mos
konvertohem, por të
jem i vetëdijshëm sesa
i ka kontribuar populli
im, ndërsa unë si pjesë
e këtij populli, gjithë
asaj që ka qenë e
keqe, konkretisht në
shekullin XX.

mundohem, nuk e di nëse kam sukses, është që të ruhet njëfarë besimi në të gjithë këtë.

Si të ndërtohet shoqëria kaq ideale pa ballafaqimin konstruktiv me të kaluarën?

Së pari duhet t'i pastrojmë gjërat në kopshtin tonë, duhet të shikojmë – ku kam bërë unë si individ ndoshta gabime në raport me ato lëvizje të mëdha shoqërore që janë pritur, paradoksalisht... Atëherë edhe njerëzit tjerë ta bëjnë të njëjtën gjë dhe të mundohen që të jenë po ashtu pak idealistë, por jo që të mos jenë realë. Të përpiqemi të jetojmë në shoqëri e cila ka ardhur në vete nga ana sociale dhe ku në vend të parë do të pastrohet ajo që ka qenë në të kaluarën, qoftë në atë të afërm apo të largët. Mendimi im personal është se sa i përket përfaqësuesve të këtushëm të pakicës kombëtare serbe, duhet t'i pastrojmë disa gjëra dhe unë punoj personalisht në këtë, kurse nëse punojnë apo jo të tjerët, kjo është çështje tjetër.

Në çfarë mënyre?

Konkretisht, sipas mendimit tim, duke pastruar dy gjëra e ky është raporti im ndaj dy gjërave shumë të rëndësishme që rrjedhin nga familja. Në vend të parë është ajo fantazmogoria që ekziston rreth Jasenovcit në Luftën e Dytë Botërore dhe rreth pjesëmarrjes në shkatërrimin e shtetit të përbashkët në vitin 1991. Mua më intereson konkretisht se si është sjellë populli im në tërë këtë histori ndaj fqinjëve të tij, do të thotë konkretisht ndaj kroatëve që janë popull shumicë tani, kurse pakicë në atë kohë, në vitin 1991. Në çdo rast, të pastrohesh nga tërë ajo, thjesht të provosh të jesh i vetëdijshëm sesa unë nuk kam të drejtë për disa gjëra që janë pjesë e trashëgimisë time familjare dhe diçkaje që edhe tani e përpunoj në kokën time, që tek unë mund të prodhojë përsëri disa gabime të reja, pavarësisht sa unë si individ mendoj si pjesë e një kolektivi i cili është ashtu siç është. Zoti apo natyra ma ka dhënë që të jem pjesë e pakicës nacionale serbe dhe të shoh, të mos largohem, të mos konvertohem, por të jem i vetëdijshëm sesa i ka kontribuar populli im, ndërsa unë si pjesë e këtij populli, gjithë asaj që ka qenë e keqe, konkretisht në shekullin XX. Kjo do të mund të kishte ndikim në të tashmen dhe në ditët e ardhshme.

Ku e sheh konkretisht përgjegjësinë tënde duke pasur parasysh ngjarjet e ndodhura?

Mendoj se nuk kam bërë mjaft në atë plan që të jem i kënaqur me veten tani, që do të thotë se, pa marrë parasysh që kam qenë në mënyrë deklarative në anën e njëfarë paqeje dhe kundër luftës, megjithatë heshtazi kam qenë këtu gjatë kohës së Krajnës dhe kam qenë këtu në vitin 1991 kur janë dëbuar kroatët. Po ashtu, kur jam kthyer në vitin 1998 kam qenë në atë kohë unë njëlloj viktime e njëjtë si ata që i ka shkaktuar populli im në vitin 1991. Duhet të jesh i vetëdijshëm për këtë, të punohet në mënyrë aktive që të ndryshohet kjo, që të mos përsëritet. Sepse e kam ndjenjën se do të përsëriten disa gjëra.

Pse e ke këtë ndjenjë?

E kam këtë ndjenjë për shkak të të gjithave, situatës shoqërore-politike, zgjedhjeve të fundit lokale, zakoneve të njerëzve, besimit total të njerëzve se ata kanë pasur të drejtë tërë këto vite. Për mendimin tim në të shumtën e rasteve njerëzit edhe nga pala kroate, edhe nga ajo serbe, nuk i kanë ndryshuar fare qëndrimet që i kanë pasur në vitin 1991 apo ndoshta madje edhe në vitin 1941, këtë nuk e di. Mendoj se njerëzit nuk mësojnë nga e kaluara, as nga ajo e largët, as nga kjo e afërme. Nga



viti 1998, që kur unë jam kthyer, këtu ka qenë vetëm një tubim i vërtetë për paqe. Pas gjithë kësaj zhvillohen zgjedhjet lokale, identike me ato të vitit 1990-1991 – kur tashmë kanë qenë... kur ka ardhur Tugjmani në pushtet. Unë si individ nuk e kam të qartë se si njerëzit nuk ndryshojnë dhe a mundem unë të kontribuoj të paktën tek miqtë apo tek kushërinjtë që t'i ndryshojnë qëndrimet. Unë mendoj se nuk kanë ndryshuar as për një jotë që nga viti 1991. Ndoshta një pakicë prej dhjetë për qind të njerëzve ka kaluar një katarsë të tipit: serbët që kanë mbetur këtu në vitin 1995. Këtu ndodhin gjëra të tilla absurde që kryetarë të komunave përreth Kninit zgjedhen njerëz që janë larguar nga Krajina, që gjatë kohës së Krajinës kanë qenë këtu njëlloj udhëheqësish, madje edhe udhëheqës politikë, të cilët gjatë këtyre dhjetë viteve pas Olujës nuk kanë denjuar të kthehen asnjëherë – dhe ata i fitojnë këtu zgjedhjet. Mua më duket e tmerrshme që ata nuk i kuptojnë gjërat që ndodhin rreth nesh, kurse përsëri do të përhapin ose ndarje, ose moskuptime, ose urrejtje, në fund të fundit... pa marrë parasysh sesa do të na përkëdhelë edhe bashkësia ndërklombëtare, sa duhet tani të thirremi në vetvete, përsëri pa kurrfarë ndërmjetësi. Sepse përsëri do të ndodhin disa gjëra nga viti 1991, kurse unë nuk e dua këtë. Unë jetoj këtu dhe duhet të jem i vetëdijshëm për këtë.

Çfarë duhet të bëhet në këtë drejtim, në kontekstin e njëfarë jete të përbashkët?

Sa më shumë aktivitete me qëllim paqeje, sa më shumë mbështetje në njëri-tjetrin, sa më shumë dialog, sa më shumë komunikim, sa më shumë qëllime konkrete në kuptimin e bashkëjetesës që tingëllon aq abstrakte dhe aq e vjetruar tërë këtyre viteve, por kjo është e vetmja rrugëdalje që të mos përsëriten gjërat që kanë ndodhur edhe në vitin '41, edhe në vitin '91, edhe le ta zëmë tani në zgjedhjet lokale.

Përmende vjetrimin e termit bashkëjetesë, por ka edhe një term tjetër që është aq shpesh në përdorim, ky është termi pajtim. Çfarë do të thotë ai për ty, si e përjeton ti atë?

T'i sjellim në vete dallimet që merren dhe që transferohen nga brezi në brez. Do të thotë mos të punojmë në atë që të shkojmë përmes linjës së rezistencës më të vogël duke thënë – po, ne jemi të njëjtë, ne nuk dallohemi. Jo, s'ka dyshim se diçka na dallon, sado që ne të jemi kundër kësaj. Pra, nga feja, kombësia, *background*-i familjar, dallimet sociale.

Kjo do të thotë që të kuptohemi, të kemi ardhur më parë në vete. Ashtu siç jemi pjesëtarë të familjes sonë apo njerëz me emër dhe mbiemër, të jemi në të njëjtën kohë edhe pjesëtarë të një bashkësie më të madhe apo më të gjerë shoqërore e cila quhet kombësi. Pra, mendoj se zgjidhja nuk qëndron në anacionalitetin apo në largimin përmes linjës së rezistencës së vogël të tipit, çfarë bëhet pse jam dëshmitar gjithë këtyre viteve – le t'i bashkohemi shumicës. Mendoj se nuk duhet t'i bashkohemi shumicës, mendoj se duhet t'i sjellim në vete sa më shumë dallimet në atë nivelin nacional në mënyrë që atëherë të mund të hyjmë në dialog, të mund të kuptohemi dhe të mund të punojmë për qëllimin e përbashkët.

A mund të ma shpjegosh pak, si t'i sjellim në vete dallimet?

T'i sjellim në vete dallimet që merren dhe që transferohen nga brezi në brez. Do të thotë mos të punojmë në atë që të shkojmë përmes linjës së rezistencës më të vogël duke thënë – po, ne jemi të njëjtë, ne nuk dallohemi. Jo, s'ka dyshim se diçka na dallon, sado që ne të jemi kundër kësaj. Pra, nga feja, kombësia, *background*-i familjar, dallimet sociale. Të shikohet sesa tërë kjo ka ndikim tek ne si individë, në mënyrën tonë të menduarit. Kjo është gjë tejet e ndërlikuar, nuk është e lehtë të bëhet. Mos të shkohet kah ajo që të anulohen dallimet, por të jetohej me këto dallime dhe të jesh i vetëdijshëm për këto dallime. Mos të shkohet në gjysmëhisteri, që unë t'i bashkangjitem njëfarë shumice. Jo, sepse ajo do të prodhojë përsëri konver-titetin, pervertitetin, që do të çojë përsëri kah ajo që ka ndodhur edhe në vitin '41, edhe në vitin '91.

Si e përjeton përgjegjësinë tënde personale dhe përgjegjësinë e “njerëzve të zakonshëm” të çfarëdo komuniteti kur bëhet fjalë për pajtimin?

Përgjegjësia qëndron në faktin se nuk kemi qenë të vetëdijshëm për dallimet dhe nuk kemi qenë të vetëdijshëm se duhet t'i mbrojmë të gjitha grupet; a është kjo kombësia tjetër, a është gjinia femërore, a janë ata invalidët apo çfarëdo grupi tjetër i marginalizuar. Mendoj se nuk jemi të vetëdijshëm për këtë. Jemi vetëm, po e them përsëri deklarativë në të gjithë atë që të pranojmë disa të arritura të perëndimit liberal. Nuk e di, tani është cirku në qytet dhe ne tani do t'i mbrojmë kafshët të cilat gjoja keqtrajtohen në cirku. Këtë do ta bëjmë vetëm deklarativisht, kurse nuk do të bëjmë asgjë konkretisht. Ashtu siç në vitin 1991 unë nuk kam qenë i vetëdijshëm se duhet, pa marrë parasysh sesa kam qenë në anën e paqes atë vit, të mbrojmë pakicën nacionale kroate e cila në atë kohë ka qenë këtu apo ndoshta nuk kam qenë madje as i vetëdijshëm se ekziston këtu; vetëm më vonë e kam ditur këtë. Ashtu siç tani duhet mbrojtur pakicën nacionale serbe për shkak se është po ashtu shumë e marginalizuar në të gjitha planet, ekzistenciale... mungojnë kushtet më themelore për jetë. Siç ka qenë pjesërisht me kroatët në vitin '91. Nuk kam qenë i vetëdijshëm për këtë dhe mendoj se këtë duhet sjellë në vete në njëfarë plani kolektiv të një grupi të njerëzve që më vonë mund të ndihmojë. Unë si individ nuk do të bëjë asgjë, por një grup, a është ky politik, humanitar, OJQ, nuk e di se si do të quhemi... vetëm ashtu mund t'i kontribuojmë zhvillimit shoqëror këtu në mënyrë që të mos ndodhin disa gjëra që kanë ndodhur gjatë historisë.

Çfarë do t'ju sillte pajtimi njerëzve që jetojnë në Knin apo në përgjithësi në të gjitha territoret nën kujdesin e posaçëm shtetëror? Çfarë do t'ju sillte popujve që jetojnë në këto treva?

Ndoshta pajtimi nuk është fjala e drejtë, ndoshta nuk duhet të shkohet kah pajtimi, ndoshta duhet të ecet drejt asaj që tërë kohën flitet po ashtu, e tipit: të jemi fqinj.

Nuk duhet ne të përqafohemi, të puthemi e tjerë, por duhet të jetojmë, duhet të jemi legalistë dhe legjitimistë. Mendoj se ne jemi ende në luftë në thellësinë e shpirtit dhe se ende jetojmë në njëfarë mënyre të egër dhe nuk e pranojmë legalitetin dhe legjitimitetin e Kroacisë; këtu mendoj edhe për serbët, edhe për kroatët. Knini jeton akoma në kushte lufte. Serbët jetojnë akoma në disa kushte të luftës së viteve '91-'95, pastaj të asaj shpërnguljes dhe kthimit, se kroatët si shumicë jetojnë akoma me ato nevojat histerike të pas-Olujës për t'u hakmarrur. Kjo tani është më pak e shprehur sepse ajo është realizuar në fund të fundit, por për ndryshim të vërtetë rrënjësor, duhet të lëvizin prapanicat e të gjithë njerëzve të këtushëm që të mendojnë ndryshe.

Si e sheh ti si dikush që merret me politikë, përmende që je aktivist i Partisë Popullore Kroate, kontributin tënd në ndryshimin e gjendjes ekzistuese në Knin?

Kur punojmë gjëra të tilla siç është aktiviteti politik, duhet të jemi shumë seriozë dhe studiozë. A e bëjmë ne këtë si ngarendës të disa politikanëve të mëdhenj kroatë në Zagreb apo jemi udhëheqës narcisoidë të atyre partive të vogla këtu në Knin, duhet t'i kuptojmë në mënyrë shumë serioze dhe studioze këto gjëra. Duhet të kalojmë, duhet të shkollohemi më tej, duhet të grumbullojmë të dhëna që nga ato më banalet, gazetareske, të përditshme e deri tek ato të tipit seminarik. Duhet pra ta kuptojmë përgjegjësinë tonë. Mendoj madje se politikanët dhe gazetarët si ndërmjetës në mes bazës, pra masës, thjesht nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë. Përgjegjësia do të ngajë, fatkeqësisht kjo është kështu... Derisa politikanët të dënohen për atë çfarë kanë bërë në vitin 1991, por nuk kanë qenë të dënuar në vitin 1941, po ashtu edhe gazetarët, ku janë gazetarët? Tani katër-pesë gazetarë kroatë janë shfaqur në Hagë duke u paraqitur se ata nuk kanë lidhje me këtë, por çfarë kanë bërë në vitet '90 këtë e dinë vetëm njerëzit që kanë qenë dëshmitarë të atyre kohëve dhe që kanë qenë të vetëdijshëm për tërë atë. Pra, të punohet në përgjegjësinë, nëse njeriu nuk është përgjegjës për sjelljen e tij, jetën e tij, si mund të jetë përgjegjës ndaj një grupi më të madh të njerëzve? Duhet të hapet komunikimi, dialogu... dhe në bishta duhet të punohet, e dihet shumë mirë se çfarë janë bishtat këtu në nivel shoqëror: raporti ndaj Tribunalit të Hagës, raporti ndaj faljes, raporti ndaj tërë atyre termave që i ka shpikur Kroacia e tretë, të tipit pajtim, bashkëejtesë, madje edhe vëllazërim-bashkim që ka mbetur si gjurmë. Dhe në fund të fundit, të jemi edhe të vetëdijshëm se ne njerëzit nuk jemi të orientuar vetëm ndaj të tashmes dhe të ardhmes, por për fat të keq apo për fat të mirë, nuk e di, edhe ndaj të kaluarës, por nga e kaluara i zgjedhim të gjitha në mënyrë selektive. Dhe atëherë derdhim lot kur mbahet koncerti i grupit Bijello Dugme, kurse nuk jemi të vetëdijshëm se kjo ndoshta edhe nuk është mirë, sepse retromania është në të vërtetë përpjekje që ta ruajmë veten mbi vlerat e vjetra dhe që nuk jemi të prirur dhe të guximshëm të ndryshojmë. Në të vërtetë, duhet të jemi të vetëdijshëm edhe ndaj kësaj retromanie.

S. D.

Më trego në fillim diçka për veten...

Quhem Iva. Kam lindur në vitin 1981 në Zagreb, ku e kam kaluar tërë jetën time deri tani. Momentalisht kam edhe një provim në Fakultetin e Shkencave Politike dhe i gëzohem diplomës. Tre vitet e fundit punoj në *Radion 101* si gazetare dhe gjatë vitit të fundit jam angazhuar pak në sektorin joqeveritar dhe kam filluar të punoj në Qendrën për Voluntaristë në Zagreb. Duke marrë parasysh interesimet e mia në rritje, supozoj se në të ardhmen, shpresoj, do të bashkëpunojë me disa organizata tjera që merren me të drejtat njerëzore dhe me procesin e ballafaqimit me të kaluarën. Kështu do ta përshkruaja veten në dy fjali.

Pasi u shprehe se të intereson kjo lëmi, unë menjëherë do të filloja me pyetjen se si e përjeton ti procesin e pajtimit, çfarë është për ty pajtimi?

Pajtimi është për mua një proces i gjatë dhe i vështirë, por i domosdoshëm, sepse me të vërtetë është e domosdoshme të arrihet një nivel i pajtimit në shoqëritë post-konfliktuale për të mundësuar që jeta të vazhdojë më tej, funksionimin normal të shtetit dhe shoqërisë. Për mua është me rëndësi që të përcaktohet ajo që quhet e vërteta faktike. Do të thotë të përcaktohet se kush çka i ka bërë kujt, pra të përcaktohet në mënyrë të qartë dhe publikut t'i prezentohet e vërteta faktike. Po ashtu për pajtim është e rëndësishme që të denohen të gjitha krimet e bëra dhe të mësohen fatet e të gjithë atyre që humbën jetën apo u zhdukën. Më duket se është me rëndësi të procesuohen kriminelët e luftës, ata që janë akuzuar për krime lufte, kështu që kur të gjitha këto procese të kryhen në mënyrë të drejtë, do të ishte më lehtë të arrihet pajtimi.

Veç i ke përmendur disa mënyra se si mund të arrihet pajtimi sipas këndvështrimit tënd. A mendon se kjo është e mundur, sa dhe në cilën masë është e arritshme?

Nganjëherë më duket se kjo është e lehtë, nganjëherë e vështirë. Kjo më duket se varion mjaft dhe varet shumë nga situatat e politikës së ditës. Sepse p.sh. ndodh diçka e bukur, diçka që e vlerësoj të rëndësishme në kontekstin e pajtimit, le të themi, madje edhe diçka deklarative, si për shembull, kur kryeministri Sanader shkon për t'ju uruar Krishtlindjet besimtarëve ortodoksë, gjë që është shumë deklarative, por më duket se kjo është gjë e bukur. Ndërsa më vonë vërej mohimin e çfarëdo mundësie se dikush ka bërë krim gjatë luftës mbrojtëse dhe atëherë më duket se nuk do të arrijmë kurrësi të bëjmë diçka. Kështu që kjo varion mjaft. Kur bëj përmbledhjen e të gjitha gjërave më duket e mundshme, nuk e di nëse mundet tërësisht, të paktën në të ardhmen e afërt të cilës mund t'i referohem. Më duket se është e mundshme, por do jetë shumë vështirë dhe të gjithë ne që duam ta bëjmë këtë do të mundohemi shumë dhe do të jetë shumë vështirë.

Nëse të kuptova mirë, ti mendon se duhet punuar në procesin e pajtimit?

Absolutisht. Sepse mendoj se në asnjërin prej shteteve apo shoqërive në territorin e ish-Jugosllavisë, me përjashtim të Sllovenisë që veç funksionon si demokraci,

nuk mund të vazhdojmë jetën tonë, shoqëritë nuk mund të vazhdojnë të zhvillohen, të paktën jo në mënyrë të drejtë, nëse gjërat fshehen nën tepih, nëse mashtrohet, nëse fshehet e vërteta, nëse shmangemi të përgjigjemi në disa pyetje të cilat nuk janë të pëlqyeshme... Thjesht, më duket se të gjithë do të ndihemi më mirë nëse i pranojmë gabimet tona, mungesat tona, nëse vendosim bashkëpunim, bile edhe në nivel ekonomik, mendoj se do ta kemi shumë më mirë.

Çka mendon, në kontekstin e Kroacisë, ku ti jeton, kush duhet të pajtohet dhe cilët janë njerëzit që duhet të punojnë në këtë drejtim?

Në idenë e pajtimit duhet të punojnë të gjithë ata që kanë dëshirë që një gjë e tillë të ndodhë, sepse mendoj se këtë mund ta bëjë çdokush në rrethin e tij. Të fillohet biseda gjatë drekës së të dieles, ndoshta të vetëdijësohen disa ide, të bisedohet për disa gjëra. Natyrisht mendoj se në këtë punë mediat janë shumë të rëndësishme, sepse ato në njëfarë mënyre edhe i servirin opinionit publik një sërë të dhënash që ndonjëherë, gjë që nuk është gjithmonë zgjidhja më fatlume, opinionin i merr si të vërteta, si të vërteta absolute. D.m.th. mendoj se mediat kanë rol në vetëdijësimin e opinionit publik, si dhe organizatat joqeveritare të cilat edhe deri tani kanë bërë një punë jashtëzakonisht të madhe. Mendoj se këtu është e rëndësishme edhe bashkësia ndërkombëtare, e cila ndoshta do të tregojë për ndonjë mangësi apo me përvojat, kapacitetet, mjetet financiare, ekspertët e vet do të na ndihmojë të punojmë në këto projekte. Të rëndësishëm në këtë drejtim janë institucionet e arsimit, si p.sh. Instituti i Historisë, Instituti për Hulumtime Shoqërore, Fakulteti i Historisë, Fakulteti Filozofik, Fakulteti i Shkencave Politike. D.m.th. të gjitha këto institucione, organizata ndërkombëtare, joqeveritare, media, individë, nëse kanë dëshirë, mund të gjejnë hapësirë të punojnë në procesin e pajtimit.

Cilat janë, sipas teje, pengesat për njerëzit, për shembull të rrethinës tënde, që të merren apo të fillojnë të merren, apo vetëm të flasin për pajtimin?

Këtu mund të flitet për dy nivele. I pari lidhet me njerëzit e prekur drejtpërdrejtë nga lufta, të cilët kanë humbur të afërmit, të cilët personalisht kanë përjetuar shëmtitë e luftës, të cilët kanë humbur pasurinë, vendet ku kanë jetuar, punën... Këtu jam shumë e vëmendshme rreth asaj se çka do të sugjeroja dhe si do ta bëja këtë. Nuk ndihem mirë t'ju flas njerëzve që kanë përjetuar humbje, dhimbje, se si të kontrollojnë dhimbjen, humbjen e vet. Por mund të them për njerëzit siç jam unë, të rinjtë, të cilët nuk kanë qenë në mënyrë të drejtëpërdrejtë të prekur... Unë nuk ndiej se kam humbur shumë gjatë asaj që ka ndodhur. Mund të them se tek njerëzit e rinj ekziston mungesë e interesimit, ndoshta njerëzit nuk janë të vetëdijshëm se cili është niveli i këtij problemi dhe sa e pengon prosperitetin. Pengesë paraqesin edhe elitat tona politike, këtu mendoj në atë kroate, boshnjake dhe serbe. Nuk e di se sa në të vërtetë ata i potencojnë në mënyrë të drejtë projektet e pajtimit. Më duket se të gjitha gjërat përmbledhen në deklaratat, të mbushura përplot me shprehje që lidhen me bashkëpunimin..., kurse nuk di se sa në të vërtetë mendohet kur flitet dhe sa përkrahen gjërat e tilla në momente të caktuara. Më duket se traumat personale paraqesin po ashtu pengesë të madhe. Në anën tjetër, për mediat dhe OJQ-të më duket pengesë e madhe fakti se tek ne kjo është ende temë e nxehtë, ambient i papërgatitur për gjëra të tilla. Kështu që dikush që don të merret me çështje të tilla, vlerëson se mund t'i shkaktojë vetes probleme, se mund të gjykohet nga një pjesë e opinionit publik. Ekziston këtu me siguri njëfarë pengese, njerëzit ndoshta në një moment e vlerësojnë që ende nuk është koha, me çka unë nuk pajtohem. Mendoj

Nga e kaluara duhet të nxjerrim mësim. Dhe në përgjithësi popujt në hapësirat tona kanë problem të mësojnë nga gabimet e veta, gjë që më duket e tmerrshme në kontekstin afatgjatë. Nëse nuk mësojmë se lufta, konflikti, nuk janë zgjidhje, atëherë ka gjasa që përsëri të ndodhin. Unë shpresoj se nuk do të ndodhin, por më duket e logjikshme që nëse tani nuk ballafaqohemi me të kaluarën tonë, do të manipulohet përsëri me të dhënat, do fliten gënjeshtër përsëri, do të merremi përsëri me njëfarë mitologjie nacionale, me fraza të mëdha patriotike.

se ka kaluar mjaft kohë dhe nëse përherë do të mendohet në mënyrën se ende nuk është koha, asgjë s' do të bëhet kurrë.

Kush janë ata që duhet të pajtohen, cilat janë ato grupe, a janë ata brenda Kroacisë apo nga jashtë?

Mendoj se tani veç ekzistojnë bashkëpunimet rajonale. Mendoj se këto bashkëpunime janë të rëndësishme, se organizatat joqeveritare, konkretisht nga shtetet, mjediset të cilat kanë qenë në mënyra të ndryshme të përfshira në ngjarjet e viteve '90, duhen të nisin njëfarë bashkëpunimi. Mendoj se nuk do ishte keq që dikush të merret me një gjë të tillë. Natyrisht, në mënyrë të drejtë. Nëse promovohen vlerat të cilat konsideron si të dëshirueshme, atëherë mendoj se nuk mund të gabohet. Ekzistojnë një sërë nivelesh në të cilat mund të punohet dhe në këtë kuptim një sërë aktorësh, të cilët këtu mund të marrin pjesë. Prej individëve deri tek institucionet shtetërore, organizatave joqeveritare, mediave, grupeve joformale. Fusha e veprimit është në të vërtetë shumë e gjerë.

Si duhet të sillemi ndaj të kaluarës, të kaluarës tonë të luftës dhe më gjerë?

Nga e kaluara duhet të nxjerrim mësim. Kjo më duket më e rëndësishme dhe në përgjithësi popujt në hapësirat tona kanë problem të mësojnë nga gabimet e veta, gjë që më duket e tmerrshme në kontekstin afatgjatë. Nëse nuk mësojmë se lufta, konflikti, nuk janë zgjidhje, atëherë ka gjasa që përsëri të ndodhin. Unë shpresoj se nuk do të ndodhin, por më duket e logjikshme që nëse tani nuk ballafaqohemi me të kaluarën tonë, do të manipulohet përsëri me të dhënat, do fliten gënjeshtër përsëri, do të merremi përsëri me njëfarë mitologjie nacionale, me fraza të mëdha patriotike. E tërë kjo mund të ketë pasoja destruktive. Më duket e rëndësishme të vërtetohet se çfarë ka ndodhur, por në mënyrë konstruktive. E jo të sillemi në rreth duke akuzuar njëri-tjetrin – ti je fajtor, jo ti je... Mendoj se është me rëndësi të gjendet masa kritike në të gjitha shoqëritë në territorin e ish-Jugosllavisë, të gjendet një numër i caktuar i njerëzve që dëshirojnë të merren me një gjë të tillë. D.m.th. të marrin vesh se kush është fajtor, jo për arsye të akuzimit të njëri-tjetrit, por për shkak të procesuimit të atyre që janë, që të kuptohet se gjërat e tilla nuk duhen të bëhen, se civilët nuk guxohet të vriten, se pastrimi etnik nuk guxohet të bëhet, se gratë nuk guxohet të përdhunohen, vetëm për hir të theksimit të asaj çka është e papranueshme të bëhet dhe se kjo nuk është mënyra. Përveç që nga e kaluara mund të mësohet, për mua është e rëndësishme të ndërtojmë përvoja të reja nga këto përvoja, të gjithë së bashku të kuptojmë që marrja e armës në dorë nuk është zgjidhje, t'i zgjidhim problemet tona me anë të dialogut, bashkëpunimit, të gjithë të kuptojmë që nevojitet më tepër tolerancë dhe më tepër vullnet i mirë në këto raporte se sa është shfaqur deri tani. Edhe në rastet kur ekziston një lloj justifikimi, thënë kushtimisht, kur një fqinj ka qenë i tillë apo i atillë, ndoshta duhet që të vetëdijësohemi që në vete të gjejmë forcë, që ndaj dhunës mos të reagojmë përsëri me dhunë. Do të thotë që nga ajo çfarë ka ndodhur, që pa dyshim ka qenë e tmerrshme, e frikshme, tragjike, të nxjerrim mësim/konkluzione më të mira. Ta mësojmë leksionin dhe të fillojmë të merremi me të ardhmen. Të fillojmë të zbulojmë zgjidhje të cilat të gjithë neve do të na mundësojnë që të jetojmë më mirë dhe të zvogëlojmë potencialet për disa konflikte, mospajtime të ardhshme.

Disa herë përmende procesuimin dhe gjykimin. Si e vështron ti këtë mënyrë të ballafaqimit me të kaluarën, me Gjykatën e Hagës dhe çfarë mund të bëhet me të?

Gjykata e Hagës është një pyetje shumë e ndërlikuar. Së pari, kam një ndjenjë për momentin se është stërngarkuar hapësira, gjërat ecin ngadalë, burokracia... Të gjithë thonë se drejtësia është e ngadalshme. Në rregull, e vërtetë. Ndoshta Gjykata e Hagës nuk është ideale, por sidoqoftë mua më duket se është mirë që ekziston... Për arsye se nuk jam aq e sigurt se ne jemi të përgatitur t'i gjykojmë kriminelët tanë të luftës. Realiteti tregon se ne kemi një numër të madh procesesh të cilat anulohen në Gjykatën Supreme dhe çdo gjë nis prej fillimit... Nuk e di, kam ndjenjë se nuk është ideale, por është mirë të ekzistojë një institucion i tillë. Duhet të ekzistojë dikush që të tregon se nuk mund të harrohen ata që kanë vrarë civilë, se këto janë thjesht gjëra që nuk harrohen dhe procesuohen. Por, po ashtu më duket shumë e rëndësishme që deri në fund të procesit të ballafaqimit me të kaluarën, sistemi gjyqësor kroat të bëhet kompetent të gjykojë të akuzuarit e vet. Sepse, kjo do të ishte shenjë se shoqëria është pjekur dhe ka arritur një nivel, ku mund të ballafaqohet me të. Një ditë kur ndonjë gjykatë e vogël në Osijek apo Split, të dënojë dikë, dënimi mbetet dhe ai dikushi duhet ta kryej dënimin, atëherë do thoja që shoqëria e ka arritur nivelin e dëshirueshëm. Nuk më duket e mirë që të gjitha rastet t'i udhëheqë dikush nga jashtë. Por, më duket shumë e tmerrshme që kur flitet për Gjykatën e Hagës thuhet shpesh diçka e tipit bashkësia ndërkombëtare është kurditur kundër nesh, ata nuk kuptojnë asgjë... Mendoj se bashkësia ndërkombëtare nuk është ideale, ka shumë gabime dhe mungesa dhe ka mjaft hapësirë që të diskutohet për veprimet e saj, por në të njëjtën kohë nuk mund të presim që të gjitha gjërat të funksionojnë në mënyrë perfekte.

Nëse të kuptova mirë, mendon se ky është hap i mirë në ballafaqimin me atë çka ka ndodhur? A e kupton këtë si pjesë të procesit të pajtimit.

Absolutisht. Mendoj se është shumë me rëndësi që pas disa viteve ekzistojnë njerëz të cilët janë të akuzuar, d.m.th. ekziston mesazhi se Kjo nuk guxon të bëhet, pasojat janë dënimi me burg, ndëshkimi nga vetë shoqëria. Mendoj se është e rëndësishme që ekzistojnë proceset dhe vendimet (dënimet) që janë në fuqi.

A e ke përshtypjen se në mjedisin, komunitetin tënd, në Kroaci, janë pranuar këto dënime, d.m.th. që ekziston dënimi?

Në mjedisin tim janë pranuar mjaft mirë, por unë lëvizi në një rreth të ngushtë njerëzish me të cilët jam e lidhur për shkak të interesave të ngjashme, punës. Më duket se mjedisi im nuk është model përfaqësues. Sado që nuk pajtohen në momente të caktuara me mesazhet që vijnë apo me numrin e viteve të dënimit që dikush i ka fituar, këto diskutime ekzistojnë, por qëndrimi i njerëzve me të cilët takohem unë është përafërsisht i njëjtë me timin. Do të thotë që Gjykata e Hagës, proceset që zhvillohen kundër të akuzuarve, është mirë të ekzistojnë. Nuk janë të përsosura, por për momentin nuk dimë më mirë.

E kaluam pjesën që kishte të bënte më tepër me të kaluarën. Tani dëshiroj të të pyes, si e sheh të gjithë këtë në kontekstin e ardhmërisë? Si e sheh të ardhmen?

Mendoj se është e rëndësishme të kuptojmë se nuk mund të ikim nga fqinjët tanë. Nuk mundemi ta transferojmë tani Kroacinë në Atlantik e mos të kemi fqinj, kurse edhe në një situatë të tillë do kishim probleme me ndokënd. Absolutisht është e pamundur me një numër kaq të madh të shteteve, mos të kemi problem me askënd. Me rëndësi është të kuptojmë se duhet ta tejkalojmë në mënyrë sa më konstruktive procesin e pajtimit për hir të bashkëjetesës së mirë me fqinjët. Nëse jo për shkaqe

tjera, atëherë për hir të atyre ekonomike. Në njëfarë mënyre “ne jemi të dënuar ndaj njëri-tjetrit”. Ne kufizohemi me njëri-tjetrin dhe duhet të funksionojmë me njëri-tjetrin. Në fund të fundit, shumë njerëz nga këto vise kanë familjet, pronësinë e tyre matanë kufirit dhe ekziston nevoja që të lëvizin njerëzit, mallrat dhe mendoj se, thjesht, ne duhet të mësojmë të jetojmë së bashku. Nuk kemi nevojë të duhemi, çdokush le të vendosë se sa lidhje të thella don të krijojë me dikë nga shteti tjetër, por si shtet duhet të mësojmë të funksionojmë me fqinjët tanë. Mendoj se kjo gjë pritët prej nesh. Me të drejtë.

Çfarë mendon, sa mund të bëjnë “njerëzit e zakonshëm” lidhur me procesin e pajtimit?

Së pari, mund të mendojnë për qëndrimet e veta, t’ia shtrojnë vetes disa pyetje Si e shoh unë atë çka ka ndodhur këtu, në ndonjë shtet tjetër, si e përjetoj unë krimin e luftës si të tillë, pastaj krimin e luftes të bërë ndaj popullit tim, në emër të popullit tim, të sqarojë atë çështje me vetveten; atëherë të inicojë diskutimin në familjen e vet, mjedisin, të aktivizohet nëse e ndien nevojën, t’i bashkangjitet ndonjë fushatë, të shkruajë tekste, të zhvillojë performanca në rrugë... Mendoj se ka shumë mundësi. Për çdokënd është më mirë të niset nga vetvetja, të sqarojë me veten a do ta merrte armën në dorë nëse do të shfaqej nevoja apo a do të shkonte në luftë, a do të luftonte kundër ushtarëve apo kundër civilëve. A do t’isha i gatshëm të shkojë të luftojë në territorin e huaj, të mendojë se si do vepronte në një moment të tillë... dhe të mendojë se si do vepronte në ato momente... të mendojë për çështjet për të cilat ne kemi folur. Për marrëdhëniet ndaj të tjerëve. Nëse asgjë tjetër, të bëhet i vetëdijshëm për disa qëndrime të tij.

Pra, ti nisesh nga përgjegjësia yte personale?

Po. Para se të nisemi të punojmë çfarëdo apo t’i nxisim të tjerët të fillojnë të veprojnë, është mirë që çdokush të mendojë pak për vete, të vetëdijësohet se çfarë është pajtimi dhe sa i rëndësishëm është ai.

Çfarë mendon se është e domosdoshme, çfarë duhet të bëjë çdo njeri në aspektin e pajtimit? Çfarë është më e rëndësishme?

Çdo njeri duhet të dënojë çdo krim pa asnjë lloj mendimi, vrasjen e të pafajshmëve, djegjen e kishave, të mirave kulturore, keqtrajtimin e femrave... Çdokush duhet të thotë në emrin e tij, në rregull, ka qenë luftë, në luftë ndodhin gjëra të vrazhda, por vrasja e civilëve, keqtrajtimi i njerëzve, burgosja, keqtrajtimi i femrave, këto i kalojnë kufijtë e asaj që konsiderohet luftë. Duhet të ekzistojë qëndrimi se për krime lufte nuk ka justifikim.

A dëshiron të thuash më diçka për fund?

Më duket se kjo është një pyetje shumë komplekse. Kam frikë se kam harruar të them ndonjë gjë apo se jam marrë shumë me çështje jo aq të rëndësishme, por mirë... Nëse do ta bëja këtë intervistë 10 herë, çdoherë do ishte ndryshe, sepse ka shumë gjëra të rëndësishme aty. Por më gëzon fakti se ekziston nevoja që edhe mua dikush të më pyes çka mendoj. Po ashtu do të dëshiroja që të flitet më tepër për këto gjëra.

L. B.

Si është e mundur të jesh i lumtur në rrethin e fatkeqëve?

A i ndieni ende pasojat e luftës? Në çfarë mënyre?

Natyrisht, paga kurrë më e madhe, ndërsa kurrë më pak i kënaqur, por edhe më pak i lumtur, pa marrë parasysh suksesin individual dhe familjar. Si është e mundur të jesh i lumtur në rrethin e fatkeqëve? Shprehja e fytyrave të qytetarëve, disponimi, janë ilustrimet më të mira të gjendjes në shoqëri.

A mund të bëhen disa ndryshime që të përmirësohet gjendja për Ju persona- lisht, por edhe për shoqërinë në tërësi?

Ndryshimet rrënjësore – shteti ligjor (sundimi i të drejtës) janë garancitë më të mira për një të nesërme më të mirë, besimi në perspektivën dhe prioriteti i shoqërisë, e jo pajtimi me fatin, humbja e çdo shprese për mundësinë e shoqërisë më të mirë dhe më të lumtur.

Si të ballafaqohemi me të kaluarën dhe si të sillemi ndaj saj?

Mendoj se receta e gjermanëve është garanci e provuar për sukses – të dënohet çdo krim e jo vetëm ai i pjesëtarëve të kombit tjetër.

Cilat janë qëndrimet Tuaja rreth pajtimit? Çfarë është për Ju pajtimi dhe si të arrihet ai?

Pajtimi është kusht i domosdoshëm për bashkëjetesë. Pa pranimin e të vërtetës nuk ka pajtim, sepse edhe e vërteta më e keqe është më e mirë se sa gënjeshtër më e bukur. Kush ka arritur ta çrrënjosë nacionalizmin me nacionalizëm, a nuk është ky hap drejt shovenizmit, po edhe fashizmit? Flas për situatën para luftës, për vitin 1991/1992. A nuk ka qenë për ju gjëja më normale ndalimi i punës së partive nacionaliste pas vitit 1995? Për mendimin tim, vendi i religjionit dhe institucioneve religjioze në Jugosllavinë e pasluftës ka arsyetim të mjaftueshëm edhe pse ka qenë i domosdoshëm liberalizimi pas një kohe të caktuar, veçanërisht ndaj anëtarëve të LKJ-së, sipas modelit të Italisë, Francës etj. Receta e pajtimit: Gjermania, Franca apo shembull edhe më i mirë Zvicra. Po si? Ja edhe sot mund të shohim shpesh se si policia gjermane reagon ndaj grumbullimit të neonacistëve.

Kush do të duhej të punonte për arritjen e pajtimit?

“Puna për arritjen e pajtimit është punë e të gjithëve” – kjo është fraza e politikanëve tanë, por kjo është e pavërtetë. Kjo është punë e çdo qytetari sepse është anëtar i shoqërisë qytetare, por edhe e të tjerëve në kuadër të kompetencave të tyre, posaçërisht e çdo institucioni: shkollës, bashkësisë fetare, familjes etj. Ne jemi të prirë të themi se kjo është punë e politikës si bartëse e pushtetit që është e përcaktuar me ligj. Por përsëri ju pyes: A mund të punojnë fare nacionalistët për pajtimin dhe a do t'i quanim kështu sikur që më përpara i gjithë koncepti i pushtetit të mos jetë i bazuar në atë nacional dhe si i tillë e përjashton çdo mundësi të çfarëdo bashkëpunimi me pjesëtarët e kombit tjetër... Por, më falni, kam harruar se krimi nuk ka shenjë nacionaliste.

Me vetë faktin se faji është kategori psikologjike, ai është individual, por pasi që individët janë elementë të kolektivit, mund të flitet në mënyrë të bazuar shkencore edhe për fajin kolektiv. Sidomos kur e dimë ndikimin e grupeve shoqërore, siç janë turma, masa, rrëmuja, publiku, simpatizantët etj. Askush nuk është pa përgjegjësi, por përgjegjësinë më të vogël të qytetarit të thjeshtë më së miri e ilustron “makineria” e Hitlerit apo e Musolinit. Megjithatë, nuk dyshoj në arritjen e pajtimit dhe të ardhmen më të ndritur.

A keni ndonjë frikë kur bëhet fjalë për pajtimin? A mendoni se ekziston ndonjë frikë te qytetarët “e vegjël, e thjeshtë”?

Nuk kam kurrfarë frike, përveç asaj që vjen nga ata që janë të paguar të “punojnë për pajtimin”, pra politikanëve. Mendoj që edhe frika e njerëzve tjerë është e ngjashme me timen, që do të thotë se nuk ka frikë – ekziston vetëm frika nga ata të cilëve vetëm koncepti nacional, po edhe nacionalist i pushtetit, ua mundëson pozitën të cilën deri dje as që kanë mundur ta ëndrrojnë.

A mendoni se dikush do të duhej të kishte rol më të rëndësishëm dhe të punonte më intensivisht për arritjen e pajtimit? Kush?

Si të punohet më intensivisht për pajtimin dhe kujt i është mundësuar kjo? Çfarë kemi të përbashkët përveç shoqatave sportive? Ja, që prej disa ditësh edhe ligën e volejbollit. Si qëndron çështja me organizatat e përbashkëta rinore, sindikatën dhe organizatat e ngjashme, të cilat do të mund të kishin rol të rëndësishëm në procesin e pajtimit? Roli i mediave është po ashtu i rëndësishëm – është shumë i madh, por është i madh edhe kontrolli i mediave, posaçërisht radios dhe televizionit.

A mund të bëjnë diçka “njerëzit e vegjël, e thjeshtë”? A mendoni se Ju personalisht mund të bëni diçka?

Unë çdo ditë punoj për pajtimin në kuadër të profesionit tim edhe pse e di se rezultati është i papërfillshëm. Marr pjesë rregullisht në tribuna, tryeza të rumbullakëta etj., para së gjithash për shkak të të rinjve, duke mos u zhgënjyer për shkak të mungesës së rezultateve megjithëse është e njohur rruga efikase drejt pajtimit të ngjashëm: në familje, në shkollë, në terrenet sportive etj. Me zemër të thyer e pranoi pafuqinë time në raport me njerëzit e dobët, të paditurit etj., por ky është realiteti. A e keni të njohur se sa profesorë e kryejnë profesionalisht punën e tyre? Pyesni nxënësit, dëgjojini se si ata përshëndesin në shkollë, në rrugë dhe do të shihni se sa nga ata nuk janë partiakë dhe nacionalë.

A mendoni se është faji individual apo kolektiv? Cila është përgjegjësia e “njerëzve të thjeshtë” për çdo gjë që ka ndodhur?

Me vetë faktin se faji është kategori psikologjike, ai është individual, por pasi që individët janë elementë të kolektivit, mund të flitet në mënyrë të bazuar shkencore edhe për fajn kolektiv. Sidomos kur e dimë ndikimin e grupeve shoqërore, siç janë turma, masa, rrëmuja, publiku, simpatizantët etj. Askush nuk është pa përgjegjësi, por përgjegjësinë më të vogël të qytetarit të thjeshtë më së miri e ilustron “makineria” e Hitlerit apo e Musolinit. Megjithatë, nuk dyshoj në arritjen e pajtimit dhe të ardhmen më të ndritur.

A do të shtoni edhe diçka rreth kësaj teme?

Do të mund të thoja shumëçka, por jo për shkak që të them çfarëdo. Më kujtohet Alija Isakoviqi kur e kanë pyetur se pse heshtën: “Që të mos them çfarëdo”, edhe për shkak se në këtë shoqëri nuk u përmbahen konstantave morale, respektivisht vlerave themelore, e lëre më profesionalizmit, përgjegjësisë etj. Shoqëria e cila nuk u përmbahet vlerave themelore morale ka pak shanse për prosperitet të shpejtë. Dëshiroj t’ju sugjeroj të rinjve që t’i zëvendësojnë të vjetrit në mënyrë që të vjetrit të mos i zëvendësojnë ata, respektivisht t’i përshtasin interesave të tyre të përditshme.

A. G.

Të gjithë presim së bashku në radhët e njëjta

Kanë kaluar plot gjashtë vjet pas luftës, si ndiheni tani?

Kanë kaluar gjashtë vjet pas luftës dhe çdo gjë më duket vërtet e tmerrshme... Jam e lidhur për karrige, mund të them se jam person i handikapuar, por ende aktive dhe dëshiroj t'i ndihmoj komunitetet. Kur them "komunitetet" mendoj në të gjitha komunitetet që jetojnë këtu në Kamenicë. Tërë këtë kohë mund të them se nuk kam pasur probleme personale. Situata e luftës ka ndikuar që shumë njerëz të largohen nga Kamenica. Mund të flas vetëm për Kamenicën sepse më larg dhe më gjerë nuk mund të flas e as nuk di. Në Kamenicë njerëzit i kanë shitur kryesisht banesat e tyre dhe janë larguar, ndërsa fshatrat janë kompakte. Mund të them se kam pasur probleme vetëm më 17 mars të vitit kaluar, që kur edhe kam mbetur totalisht e lidhur për karrige. A ndodhi kjo për shkak të stresit apo diçkaje tjetër nuk e di, sepse çdo gjë në shtëpi e kam pasur të thyer. Sa i përket miqve, fqinjëve të mi të tashëm, ata janë shqiptarë dhe nuk mund të them asgjë të keqe për ta sepse jetojmë së bashku dhe i ndihmojmë njëri-tjetrit. Po ashtu, tash gjashtë vjet punoj në projekte multietnike me kolegen S., që është shqiptare, dhe kemi hasur në probleme të mëdha që duam t'i zgjidhim. Kemi dëshirë t'u ndihmojmë të gjitha komuniteteve, pavarësisht nga mosha dhe etnia.

Si e shikoni të kaluarën?

Ajo që ka kaluar ka qenë e tmerrshme. Nuk dëshiroj sigurisht që të përsëritet, kjo është e qartë. Kush i përziu punët, nuk e di as unë. Si qytetare e zakonshme, çfarë mund të them, se kam shikuar punët e mia dhe jam munduar të punoj. Nuk kam shikuar se kush çfarë bën, kurse politika nuk më ka interesuar, sikurse as tani, normalisht.

A mund të arrihet pajtimi?

Mund të arrihet pajtimi, sidomos këtu tek ne në Kamenicë të Kosovës. Pajtimi mund të arrihet me kusht që të fuqizohen në masë të madhe të gjithë njerëzit në Kamenicë. Përsëri shfaq rezerva dhe flas vetëm për komunën e Kamenicës. Domethënë, forcimi i atyre njerëzve, meshkujve, femrave dhe fëmijëve, me kusht që ata të mos jenë larguar. Është fakt se ata janë aty, duan të punojnë dhe të jetojnë këtu sepse nuk kanë ku të shkojnë. Ata janë me vite këtu. Ajo që ka kaluar, si ta them me një fjalë, nuk e di nëse do të mund ta përshkruaja tërë këtë, përsëri është vepër e atyre njerëzve që kanë dashur të fitojnë terrenin tonë ose të na grindin, t'i grindin komunitetet tona. Apo të na fusin në ndonjë konflikt të cilin ne, normalisht, nuk e duam sepse nuk e kemi pasur as më parë, kurse as tani nuk e kemi në një masë të madhe. Mund të them se ndonjëherë ndodhë ndonjë zënkë dhe se secila zënkë trajtohet si politike apo në bazë nacionale.

Çfarë do të thoshte për Ju pajtimi?

Pajtimi do të thoshte mjaft, megjithëse nuk mund të them se edhe tani njerëzit nuk janë në një lloj procesi pajtimi. Për shembull, serbët dhe shqiptarët tregëtojnë

bashkë dhe çdo gjë këtu në Kamenicë është e përzier. Qoftë në Entin Social, qoftë në bankë, aty keni njerëz nga të gjitha komunitetet dhe shkohet drejt të ardhmes më të mirë ku mund të jetojnë të gjithë së bashku.

A mund të arrihet pajtimi në Kosovë?

Kosova është diçka më e madhe se unë. Mund të them se tash gjashtë vjet që kur kam filluar të punoj në sektorin joqeveritar shkoj madje edhe në Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren. Por, megjithatë, kjo bëhet me ndihmën e OSBE-së, UNMIK-ut apo makinave policore ku mund të qarkulloj, por vetë me makinën time nuk e di nëse do të mund të shkoja. Do të duhej megjithatë dikush të më ofrojë garanci, por disa zotërinj më kanë thënë se nuk mund t'i japin as Bushit garanci të tillë siç e kërkonin ju. Por, megjithatë, unë mendoj se komunikimi me popull do të kontribuonte, e këtë do ta ndërlidhja me kthimin i cili do të kishte domethënie të madhe, bile edhe populli do të afrohej më tepër me kthimin.

Çfarë duhet të bëhet që të arrihet pajtimi?

Unë do të përmendja këtu situatën ekonomike, ndonëse shumë prej tyre nuk e përmendin situatën ekonomike. Mendoj se me përmirësimin e situatës ekonomike do të bëhej mjaft dhe do të kontribuohej ashtu që krahas punësimit, njerëzit nuk do të kishin kohë të grindeshin dhe të ziheshin, por do të shikonin që në mëngjes të shkonin në punë, kurse në mbrëmje të ktheheshin të lodhur dhe nuk do të kishin kohë të mendojnë nëse do të ma prishin mua shtëpinë apo unë t'ia prish dikujt shtëpinë. Sa i përket rinisë, është normale që rinia të mbarojë shkollën dhe do të duhej të angazhohej më tepër në fushën e pajtimit sesa të merret me drogë, alkool etj. Duhet të punohet në edukimin e të rinjve.

Rinia jeton në mjedise të ndara. Si është situata këtu në Kamenicë?

Nëse është fjala për shoqërimin e rinisë shqiptare, serbe dhe rome, mund të them se ekziston ndarje. Ditën të gjithë njihen, komunikojnë të gjithë me njëri-tjetrin, por në mbrëmje, nëse bëhet fjalë për kafeteri dhe gjëra të ngjashme, rinia serbe i frekuenton pak. Unë mendoj se kjo ndodh nga frika sepse frikohen se dikush mund t'u bëjë ndonjë gjë të keqe, por edhe prindërit u thonë fëmijëve të mos shkojnë në atë pjesë sepse ka shumë shqiptarë, mos t'ju ndodhë ndonjë gjë.

Kush duhet të punojë, sipas Jush, në procesin e pajtimit?

Mendoj se ne si organizata joqeveritare mund të bëjmë shumë, duke nisur prej fillimit të formimit të fëmijëve. Nëse atë fëmijë e formojmë si një personalitet të shëndoshë demokratik, ai do të jetë i tillë deri në fund. Por, nëse ne në shkollë flasim me fëmijë gjëra tjera, atëherë atë fëmijë e kemi nxjerrë në rrugë. Do të thotë, të mos flasim para fëmijëve gjëra të tmerrshme, por gjëra të bukura.

A mendoni se dëshirojnë të pajtohen njerëzit që jetojnë këtu?

Unë mendoj se po. Nuk mund të them jo sepse të gjithë presim së bashku në radhët e njëjta, pavarësisht nëse bëhet fjalë për bankë apo për ndonjë institucion tjetër, ndërsa shanset për pajtim janë të mëdha, vetëm duhet të shfrytëzohen.

Cilat janë vështirësitë, pengesat që të arrihet pajtimi?

Kjo është një pyetje e madhe për mua dhe jam duke menduar se çka e frenon procesin...E frenon frika, frika nga situata e sigurisë. Nëse shikojmë vendet tjera, situatat dallojnë, kurse këtu çdo gjë lidhet me njëfarë politike. Politika nuk i formon njerëzit, por njerëzit e formojnë politikën dhe nuk munden ata ne të na shëtisin.

Çfarë duhet të bëjë në drejtimin e pajtimit Serbia e çfarë Kosova?

Që një kohë të gjatë flitet për takimin midis Koshtunicës dhe Bajram Kosumit. Duhet t'u vihet njëherë kapaku disa gjërave, që populli mos t'i vuaj mëkatet e dikujt tjetër. Unë mendoj se ne si popull nuk jemi të detyruar të vuajmë mëkatet e askujt. Ata fitojnë para të mira, kurse ne nuk kemi para!

A do të ishin politikanët, sipas jush, ata që do të punonin për pajtimin?

Jo vetëm politikanët, por edhe populli. Populli tashmë është duke punuar në këtë, por megjithatë duhet dikush nga lart të thotë “Ndaluni, o njerëz, hajde të punojmë së bashku”. Nuk mund të kërkojmë diçka që nuk mund ta arrijmë.

Si mundet një qytetar apo qytetare e zakonshme t'i kontribuojë pajtimit?

Me tolerancë, normalisht. Dhe do të shihet se kush – ku, ka gabuar. Ne jemi njerëz të zakonshëm të cilët përmes komunikimit të zakonshëm të arrijmë deri tek gjërat më të mira.

A është fajësia kolektive apo individuale për çdo gjë që na ka ndodhur deri tani?

Unë mendoj se është individuale. Për çdo grindje, zënkë, duhen të jenë të përfshirë më shumë persona. Kështu që edhe tani kjo ka ndodhur, por nuk kanë qenë të përfshirë të gjithë dhe nuk janë të gjithë njerëzit fajtorë.

Cilat janë parashikimet tua për të ardhmen?

Hap pas hapi. “*Step by step*” dhe mund të arrijmë deri tek qëllimi. Sikur të pyetesh unë, do të ishte tamam çmenduri. Mendoj se të gjithë njerëzve në këtë botë, jo vetëm këtyre në Kosovë, do t'u jepja çdo gjë që mundem. T'i lejoj që të ketë për të ngrënë dhe për të pirë, të mos vuaj nga uria, siç ndodh tani.

A keni ndonjë koment për këtë bisedë? A dëshironi të shtoni diçka?

Do të më vijë keq kur të largohesh, kurse unë të kujtohem atëherë për diçka që kam mundur ta them...

N. I.

Nëse është fjala për shoqërimin e rinisë

shqiptare, serbe dhe rome, mund të them se ekziston ndarje. Ditën të gjithë njihen, komunikojnë të gjithë me njëri-tjetrin, por në mbrëmje, nëse bëhet fjalë për kafeteri dhe gjëra të ngjashme, rinia serbe i frekuenton pak. Unë mendoj se kjo ndodh nga frika sepse frikohen se dikush mund t'u bëjë ndonjë gjë të keqe, por edhe prindërit u thonë fëmijëve të mos shkojnë në atë pjesë sepse ka shumë shqiptarë, mos t'ju ndodhë ndonjë gjë.

Çfarë do të ishte për Ju pajtimi?

Si ka ardhur deri te kjo që të kërkojmë tani pajtim? Disa çështje të pazgjidhura qëndrojnë, por forcimi i nacionalizmit pas shkatërrimit të Jugosllavisë ka sjellë pasojat tragjike që kanë ndezur shpirtat e vjetër dhe ka ardhur deri tek tragjedia. Kërkon pajtim... Çfarë mendoj për këtë?... Së pari, që të shikohet përpara në këtë aspekt, çfarë synojnë njerëzit e thjeshtë? Të jetojnë mirë, të mund të gjejnë punë, të mund të kenë fëmijë dhe t'i shkollojnë ata etj. Në qoftë se shikohet kështu, atëherë me siguri do të harrohen disa vështirësi dhe ide të vjetra të pazgjidhura. Pas gjithë asaj që ka ndodhur në terrenin e Jugosllavisë, tek ne ka ndodhur diçka që disa e quajnë luftë, disa konflikt, disa luftë për territor, disa luftë për të drejtat e njeriut. Sipas meje, çdo herë deri tani nuk është luftuar për të drejta, por lufta është përdorur si vazhdimi i fundit i një politike, si luftë për zaptimin e territoreve etj. Tek ne, për fat të keq, nuk është dhënë vlerësimi se çfarë ka ndodhur dhe pse ka ndodhur tërë kjo. Sigurisht që ekzistojnë dy gjëra. E para është se tek një bashkësi e madhe ka ekzistuar pakënaqësia për shkak të statusit të saj, kurse nga ana tjetër është formuar rryma nacionaliste e cila ka kërkuar që disa gjëra të pastrohen me anë të forcës ushtarake. Kjo forcë ushtarake ka ardhur tek ne nga jashtë, respektivisht është sugjeruar nga jashtë. Ka ardhur nga jashtë edhe nga pretendimet nacionale, parullat dhe angazhimi i atyre që kanë qenë të pakënaqur.

A flisni për shqiptarët?

Po, për shqiptarët. Kur janë pastruar çështjet – kroate, serbe etj. ka ardhur momenti kur është kërkuar pastrimi edhe i çështjes shqiptare. Megjithatë, në Ballkan mbetet, në të njëjtën kohë, e pazgjidhur çështja maqedone.

Çfarë do të ishte pajtimi në këtë fazë?

Unë si komunist mund të them se duhet të respektohet qenia nacionale e popullit maqedon. Të huajt që përpiqen të bëjnë këtë pajtim midis nesh, kanë bërë, sipas meje, një gabim e ky është se nuk mund të ketë pajtim në llogari të dikujt, llogaritë duhet të jenë të pastra, si thonë. Pse e them këtë? Për arsye se, për shembull, Marrëveshja e Ramkovës, në të cilën ka shumë gjëra të mira, nga njëra anë është diktat, i imponuar nga jashtë, gjë që në vetvete është keq, sepse askush nuk don që dikush tjetër t'ia diktojë dhe t'ia zgjidhë. E dyta, Maqedonisë me këtë marrëveshje i është hequr e drejta që të jetë shtet nacional, kurse në këtë Ballkan të përzier kudo janë shtete nacionale – Bullgaria, Kroacia, Greqia, Shqipëria etj. Këtë e sheh njeriu i thjeshtë, maqedoni, dhe i pengon. Pastaj, flitet se Maqedonia është shumënacionale, shoqëri multietnike, shtet multietnik, por në praktikë, në masë të madhe është i shprehur binacionaliteti i Maqedonisë dhe jo multietniciteti i saj. Pa marrë parasysh madhësinë e komuniteteve, të drejtat e njeriut nuk janë të ndryshme për komunitetet e vogla dhe të mëdha, ato janë të njëjta për të gjithë. Kjo gjendje do ta pengojë shumë, me siguri, edhe në të ardhmen, bashkimin kompakt në këtë hapësirë.

Sigurisht që ekzistojnë dy gjëra. E para është se tek një bashkësi e madhe ka ekzistuar pakënaqësia për shkak të statusit të saj, kurse nga ana tjetër është formuar rryma nacionaliste e cila ka kërkuar që disa gjëra të pastrohen me anë të forcës ushtarake.

Si mund të punojmë për këtë bashkim kompakt?

Së pari, ne jemi të ngarkuar shumë me të kaluarën. E kaluara nuk duhet të injorohet, gjegjësisht të harrohet, por në kuptimin që të jetë mësim për të ardhmen. Nëse i mësojmë leksionet – çfarë ka qenë mirë e çfarë jo, atëherë mendoj se do të arrijmë më shpejt të ky pajtim, kurse vetë fjala pajtim veç flet për ndarje. Pajtimi nuk është gjendja e bashkimit. Në qoftë se maqedonët dhe shqiptarët, këtu mendoj edhe në komunitetet tjera, edhe pse tek ata problemi është pak më ndryshe, ata nuk janë deri në këtë masë të konfrontuar, turqit, serbët, vllahët... Kur flasim për vllahët, tek ata është tipike dhe janë më të prirur ndaj bashkëjetesës me të tjerët duke qenë se nuk ekziston shteti vllah. Tek ata nuk ka pengesa në martesë e as në çfarëdolloj kontakti me të tjerët. Ata janë shembull i rrallë e ndoshta edhe unik në Ballkan. Ka mjaft vllahë në Shqipëri, Greqi, kurse në Serbi dhe Bullgari pak më pak etj., por duke mos mbajtur barrën e shtetit nacional etj., janë më të prirur ndaj bashkëjetesës me të gjithë të tjerët.

Nëse ky do të ishte drejtimi i mundshëm për arritjen e pajtimit, a nuk është kjo pak kontradiktore me atë që theksuat pak më parë rreth të drejtës së maqedonëve për shtet nacional?

Po, pak (*qeshet*). Maqedonët kanë hequr megjithatë dorë nga ajo që quhet shtet nacional – jetojnë si një bashkësi në shtet. Ata vetëm mbajnë shenjën e bashkësisë (komunitetit) më të madhe në shtet.

Sa duhet të shkojmë larg në hulumtimin e së kaluarës, asaj që na ka ndodhur dhe pse ka ndodhur?

Të kaluarën duhet vetëm ta vlerësojmë dhe ta studiojmë, dhe mos t'i harrojmë gabimet që nuk duam të përsëriten. Në qoftë se nuk i përsërisim, atëherë do të arrijmë tek ajo që ti e quan pajtim, ndërsa unë e quaj bashkim.

Si është puna me nacionalizmin maqedon?

Nacionalizmi maqedon mund të jetë dhe është ekstrem, sidomos kjo përbuzje ndaj shqiptarëve, thënia se e gjithë kjo është trillim i shqiptarëve etj. Pastaj, mund të të tregoj nga jeta ime. Unë kam shumë miq shqiptarë dhe për disa gjëra ata nuk kanë gjetur shpesh mirëkuptim, si për shembull, për punësimin e tyre, për raportin ndaj inteligjencës së tyre etj. Ndërsa ata kanë treguar se mund edhe të flasin mirë, edhe të politizojnë, të jenë edhe pedagogë dhe çdo gjë që nevojitet. Këtu mendoj se ne kemi gabuar rëndë.

Çfarë mund të bëjë “njeriu i thjeshtë”, pa dallim maqedon apo shqiptar?

Sikur njerëzit të mos ishin të prirur ndaj ndikimeve politike dhe ideologjike, jam i sigurt se do të kuptoheshin më mirë. Ne në Maqedoni kemi edhe shembuj të jashtëzakonshëm të bashkëjetesës, por ato janë midis dy familjeve apo dy fshatrave etj. Tërë këtë ndarje e ka bërë nacionalizmi i egër, si maqedon, ashtu edhe shqiptar. Migrimi i maqedonëve nga rrethi i Tetovës, Kërçovës etj. është diçka shumë tragjike. Ky është lumë pa kthim. Për këtë arsye mendoj se ky konflikt ka qenë luftë për territore. Këtë gjë e kemi tek të dy palët. Përkundër migrimit të maqedonëve nga disa treva të caktuara të Maqedonisë, është djegja e ëmbëltoreve në Manastir, Koçani. Kjo përbën të njëjtën gjë. Tjetër, feja, edhe krishterimi, edhe islami, në këtë moment vënë në pah gjërat më të këqija dhe i fryjnë moskuptimit. Gjëja e dytë shumë e keqe është organizimi i partive politike mbi parimin etnik. Ekziston partia serbe, pastaj ajo turke, vllahë etj. Madje edhe partitë që quhen socialdemokrate,

Të kaluarën duhet vetëm ta vlerësojmë dhe ta studiojmë, dhe mos t'i harrojmë gabimet që nuk duam të përsëriten. Në qoftë se nuk i përsërisim, atëherë do të arrijmë tek ajo që ti e quan pajtim, ndërsa unë e quaj bashkim.

liberale apo disi ndryshe nuk janë vërtetë socialdemokrate apo liberale në qoftë se anëtarësia e tyre është vetëm nga njëri grup etnik. Ky është mendoj element që i pengon pajtimin. Tjetër, ekziston ndarja ndërmjet maqedonëve shumë të pasur dhe atyre shumë të varfër. E njëjta gjë është edhe tek shqiptarët. Këtu është vështirësuar pajtimi edhe nga fakti se nuk është mjaft t'i thuash dikujt të drejtat e tij, por që ai të mund t'i realizojë ato. Gjatë kalimit nga njëri sistem në tjetrin, pajtimi në të ardhmen mund të jetë edhe më i vështirë në këtë plan se sa në atë ndëretnik. Marrëdhëniet ndëretnike kanë pasur një linjë ngritjeje, ndërsa në fund kanë përfunduar me luftë. Ndërkaq, antagonizmat midis të pasurve dhe të varfërve, si dhe midis atyre për të cilët funksionon shteti ligjor dhe atyre për të cilët ai nuk funksionon, po fitojnë tani në dinamikë dhe po ashpërsohen.

Për fund, do t'Ju pyesja diçka pak a shumë personale. Përmendët se keni mjaft shokë shqiptarë. A ka mbetur në relacionet private ajo afërsia e mëparshme apo me prishjen e situatës në vend janë prishur edhe ato marrëdhënie? Kam përvojë të dyfishtë. Me disa shqiptarë, të cilët janë tani madje edhe në pozita mjaft të larta në partitë politike shqiptare, afërsia ka mbetur e njëjtë, dëgjohemi dhe shihemi ashtu si dhe më parë. Disa të tjerë, ndërkaq, i kanë ftohur raportet ndaj meje. Megjithatë, mendoj se njerëzit që kanë qenë me të vërtetë miq mbesin të tillë edhe në kohërat e krizave.

A. B.

Frymojmë lirë, ecim lirë, bisedojmë lirshëm

Si e ndieni veten tani, gjashtë vjet pas luftës?

Kurrë më mirë. Edhe pse njeriu mendon që e ndien veten mirë si i ri apo si adoleshent, asnjëherë në jetën time nuk e kam ndier veten më mirë. Kjo ndjenjë më është shfaqur edhe më 24 mars 1999, por e përzier edhe me një dozë frike.

Unë ndihem më së miri tani kur mund ta tërheqi një paralele se çfarë jete kemi pasur si të rinj e çfarë jete kemi sot?! Nëse tani fillojmë dhe e shtjellojmë atë se a është mirë, relativisht mirë, keq apo relativisht keq, këto janë pyetje që kërkojnë biseda dhe shtjellime shumë më të gjata. Mirëpo, unë po e rrumbullakësoj duke thënë se personalisht e ndiej veten mirë tani kur frymojmë lirë, ecim lirë, bisedojmë lirshëm dhe tabu temat kanë filluar dalngadalë të hiqen. Liria ka trokitur për të gjithë. Thuhet liri e kufizuar, gjë që edhe mund të jetë e vërtetë për shkak të disa koncepteve dhe rrethanave të caktuara. Mirëpo, përderisa nuk e kemi shtetin tonë, dhe atë funksional, mbesim edhe më tej shoqëri e kufizuar që si rrjedhojë ka edhe lirinë e kufizuar. E tillë çfarë është, mendoj se duhet ditur të kënaqemi me të dhe të punojmë për ta plotësuar akoma.

Si e shihni të kaluarën?

Ka qenë një e kaluar e dhimbshme, me plot momente që nuk dëshiroj t'i kujtoj. Një rini që ka pasur dëshira e vullnet të mirë, por pa mundësi realizimi. Një elan i tërë është tkurrur për shumë vite dhe tani është pak vështirë të vihet në binarë të mirë-filltë. Ato dëshira të atëhershme duhet bartur me mençuri tek gjeneratat e reja duke vënë në pah të paktën mundësitë dhe të drejtat elementare që ata i kanë tani. Pra, kujtoj se është koha të përqendrohemi në një punë më të madhe, ku çdo moment duhet shfrytëzuar mirë.

Sipas jush, a duhet të flitet për të kaluarën?

Natyrisht që po. Kam dëgjuar të thuhet se mënyra më e mirë për të dalur prej problemit është përmes problemit. Duhet të ulemi e të flasim, por duhet ta gjejmë vendin dhe duhet ta gjejmë rendin. Duhet t'i gjejmë njerëzit sepse ka qenë një e kaluar e frustruar, me plot ngarkesa, e edhe nëse nuk bisedohet dhe themi se është e kaluar dhe e harruar, gabohemi. Duhet sqaruar problemet dhe gjërat e një të kaluarë të turbullt, por dalngadalë, dita-ditës, e jo të ngutemi ose të mos flasim fare. Duhet të flitet, por me mend dhe me rend.

Cili është qëndrimi Juaj lidhur me pajtimin? Çfarë paraqet pajtimi për Ju?

Vetë fjala pajtim është një fjalë shumë e mirë, e ëmbël. Populli jonë gjithmonë, edhe pse e dimë çfarë historie ka kaluar, përfshirë këtu edhe dekadat e kaluara, është munduar që ta ketë pajtimin në rend të parë si vlerë, pa e zbërthyer tani se për çfarë pajtimi flasim. Mendoj që pa u ulur dhe pa biseduar nuk mund të ketë pajtim. Përsëri duhet pyetur, ka ardhur koha apo ende jo?! Kush duhet kujt t'i qaset i pari në këtë proces? Megjithatë, me të gjitha dilemat dhe sfidat, duhet gjetur një mënyrë të mençur, me ide të mira, me njerëz të mirë dhe të hapur, që kanë potencial intelektual.

tual dhe vizion të qartë e që do kenë ku të fillonin diçka, por gjithnjë duke mos u ngutur dhe duke mos pasur ndjenjën e inferioritetit.

A mund të arrihet pajtimi në Kosovë?

Unë ngandonjëherë shoh shkëndija dhe gjasa që mund të flitet dhe të arrihet pajtimi. Mirëpo, ngandonjëherë e shoh edhe të kundërtën, pra që nuk mundet. Kjo që na ka ndodhur ne shqiptarëve është një pengesë për një pajtim të mirëfilltë. Një pajtim i tillë do të mund të ndodhte pas shumë e shumë vitesh e jo tani. Por mjafton të inicohet. Ne historikisht jemi një popull i pajtimeve, popull shumë i hapur me njerëz, me fqinjët...

Çfarë duhet bërë që të arrihet pajtimi?

Shpesh e përsëris që tek njerëzit duhet patjetër të ngritet vetëdija e përgjithshme, të flasin, të falin, të komunikojnë. Mirëpo, shtrohet pyetja, ku të flitet, ku të dilet për të komunikuar? Nevojitet vendi dhe arsyeja se pse duhet bërë këtë, ku të takohen, për çka të flasim?! Kush dhe çka do na ofronte? A jemi gati?

Në këto pyetje është vështirë të përgjigjesh dhe ka pak vend për pozitivizëm, mirëpo megjithatë mendoj që pa zhvillim ekonomik, pa hapjen e vendeve të punës, nuk ka përparim dhe mirëqenie. Njerëzit afrohen më së miri përmes punës.

Kush duhet të punojë në procesin e pajtimit?

Unë mendoj që duhet të bëhet një kombinim i përvojës dhe iniciativës. Përvoja zakonisht merret prej të moshuarve, ndërsa iniciativa vjen prej të rinjve. Të rinjtë që janë me të vërtetë të përfshirë në proceset e përditshme dhe që kanë elan, nuk mbajnë në vete ndonjë urrejtje, ata që me OJQ-të e tyre po punojnë, nëse mund të thuhet pa ndonjë interes të caktuar, duhen të përkrahen me përvojën e gjeneratave të vjetra dhe të bëhet një shkrirje.

A mendoni se njerëzit janë të gatshëm të pajtohen? A dëshirojnë të pajtohen?

Tash përsëri më duhet të them se Kosova është e vogël, por me një laryshi mendimësh të njerëzve të vendeve të ndryshme dhe duhet ditur ku të fillohet. P.sh. aty ku ka pak bazë duhet të fillohet. Më vonë ajo le të jetë apo le të shërbejë si shembull për ato vende ku nuk ka bazë apo më pak bazë, në menyrë që përvoja, e cila është arritur aty, me më pak mundim të bartet tek të tjerët. Shkëmbimi i përvojave, situatat e relaksuara, toleranca ndaj njerëzve, marrja në konsideratë dhe respektimi i të shprehurit të lirë pa imponime, janë karakteristika që vlejnë të merren parasysh si fillimi i diçkaje.

Cilat janë pengesat e njerëzve në vendin tuaj që të fillojnë të bisedojnë për pajtimin?

Ballkani është rajon pak më specifik, ku gërshetohen kultura e histori të mëdha, ku uni është shumë i fuqishëm dhe përballet me kolektivitet, por pa mundësi të mëdha shprehjeje. Josinqeriteti, mungesa e tolerancës dhe mospranimi i realitetit janë pengesat kryesore krahas atyre të sipërpërmendura.

Çfarë duhet të bëjë për pajtimin vendi ku ti jeton e çfarë vendi me të cilin keni qenë në luftë?

Vendi ku jetojmë ne duhet të vazhdojë të punojë, duhet të vendosë në vend të parë vlerat njerëzore, para çdo gjëje tjetër, sepse unë mendoj se para çdo vlere tjetër, siç janë titujt, ngarendjet pas karrierave etj., duhet të qëndrojnë vlerat njerëzore. Si popull, në përgjithësi këto nuk na mungojnë, por na mungon strategjia e përpuni-

mit të detyrave dhe vlerave. Kur secili e din punën e vet dhe e ndihmon tjetrin ashtu siç kërkohet nga ai, atëherë fillon mbarësia. Mendoj se duhet të punojmë dhe të lexojmë shumë më shumë se tani. Atëherë do të kemi mundësi të mendojmë në mënyrë më racionale dhe të bëhemi dizenjues të fatit tonë.

Në një kuptim njerëzit merren më shumë me viktimën, gjë që edhe duhet bërë, por megjithatë pak punohet me shkaktarin. Me kryesin e veprës, që në këtë rast ka qenë vendi fqinj, duhet të punojnë të tjerët për ta sjellur aty ku duhet, ku baraspesha e vlerave dhe e kërkesave duhet të çojnë në vendin e duhur.

Çfarë mund të bëjë një qytetar i thjeshtë që t'i kontribuojë procesit të pajtimit?

Të gjithë jemi qytetarë dhe jemi të thjeshtë, por pozita ngandonjëherë dikë e bën më të ndërlikuar e dikë më pak “interesant”, gjë që mund të çojë në një keqkuptim sepse edhe qytetari më “i thjeshtë” mund ta ketë idenë më të frytshme. D.m.th. të marrë pjesë aty ku merren vendimet, ku bëhen ekzekutimet e vendimeve, të marrë pjesë aktive në jetën e përditshme, në jetën mediatike dhe faktikisht atëherë kur edhe qytetari “i zakonshëm” të bëhet pjesë e këtyre proceseve, të gjithë së bashku do t'i kontribuojmë zgjidhjes. Në kohën e mungesës së elementeve qenësore për jetesë, pa një rrogë e pa një shtëpi, vështirë se dikush merret me dëshirë me gjëra që nuk janë të dorës së parë për të. Derisa e ke xhepin plot, edhe mendjen e ke plot, kështu që, ata që e kanë xhepin plot “inshallah” e kanë edhe mendjen plot, por dyshoj.

A është faji individual apo kolektiv për të gjitha gjërat që na kanë ndodhur?

Kjo pyetje është pak e vështirë sepse unë për vete nuk mund të them që faji bëhet në mënyrë kolektive, me përjashtim të disa rasteve. Faji bëhet zakonisht në mënyrë individuale dhe del të jetë dhe pervers. Ky veprim individual bëhet më vonë në një rreth prej disa individësh dhe atëherë mund edhe të manipulojë masën. Ashtu ka ndodhur dhe ashtu po ndodh edhe sot.

Nuk mund ta bëj qartazi ndarjen e fajit individual dhe kolektiv në kuptimin e kësaj pyetjeje, mirëpo kam mundur të shoh se kur masa nuk është përgjithësisht e ngritur mjaft dhe kur infrastruktura e dobët e përcjellë këtë, atëherë normalisht që individi në mënyrë të verbër shkon mbrapa një grupacioni apo një individi, pa e ditur se pse.

A keni diçka të shtoni lidhur me këtë temë?

Nuk kam koment, idetë janë të mira. Duhet të pyeten njerëz të niveleve të ndryshme dhe duhet të bisedohet me ta në nivele dhe vende të ndryshme dhe prej krejt kësaj të nxirret një përmbledhje dhe të elaborohet deri tek një përfundim. Kur të bëhen intervistat e tilla të mos pyeten vetëm njerëzit që merren me aktivitete, që kanë përvojë me ndërkombëtarët dhe që janë kritikë apo vetëkritikë. Duhet marrë prej profileve të ndryshme dhe nga e tërë popullata në mënyrë që konkludimet të jenë më reale dhe më të shëndosha.

N. I.

Siç më ka dhembur mua,
ashtu u ka dhembur edhe shqiptarëve, romëve...

Për fillim, të lutem prezantohu, sa vjet ke, si quhesh dhe ku ke jetuar deri tani?

Unë jam Alberti, kam jetuar në Rastovë, fshat afër Gjakovës dhe jam 20 vjeç.

Pra, ke jetuar afër Gjakovës?

Po, 13 vjet.

Cili është kujtimi yt për luftën që e ke përjetuar?

Së pari, nuk kam qenë aty gjatë tërë kohës së luftës. Ne jemi larguar pak më heret për arsye se kanë ardhur fqinjët shqiptarë dhe na kanë thënë se është më mirë të largohemi, sepse fshati është i mbushur me ushtri dhe se nuk mund të na garantojnë sigurinë. Kjo ka ndodhur gjatë Pashkëve të vitit 1998. Kështu që kemi hyrë në autobus dhe në kohën kur kemi dalë nga shtëpia ka pasur të shtëna. Por, tashmë ka kaluar e gjitha, ja viti i shtatë apo i tetë që kur ka mbaruar lufta, që kur jemi larguar. Harrohet shumëçka nga ajo. Ja, për shembull, më rastis të takoj këtu në Podgoricë fqinj nga Kosova dhe unë nuk i njoh... Kam qenë i ri, megjithatë stresi ka mbetur. Më ndodhë që gjatë pikut të ditës të mbylli derën me çelës, edhe pse jam në Podgoricë, ku çdo gjë është qetë. Pastaj zgjohem në mbrëmje për të parë nëse dera është e mbyllur me çelës, a ka mbetur dritarja e hapur etj. Kam harruar shumëçka kryesisht, ndonëse do të gënjeja nëse do të thoja se dy-tri vitet e para tek unë nuk ka pasur urrejtje dhe mllef, gjë që është edhe normale sepse vendin ku je rritur, ku ke lindur, e lëshon në atë mënyrë, edhe pse askujt nuk i ke bërë asgjë dhe këtë e përjeton vështirë. Megjithatë, me kalimin e viteve harrohet, sepse duhet ecur përpara dhe nuk jam i vetmi që kam përjetuar diçka të tillë dhe do të ishte mirë sikur tërë populli të mendonte në këtë mënyrë. Lufta është luftë dhe duhet të ketë viktima. Siç më ka dhembur mua, ashtu u ka dhembur edhe shqiptarëve, romëve... Megjithatë, i kam harruar të gjitha.

Si e ke përjetuar në atë kohë, si fëmijë, ikjen nga shtëpia dhe ngjarjet e atëherëshme?

Po ka qenë shumë vështirë. Për mua ka qenë më së vështiri pasi që jam anëtar i më i ri në familje. Por, kur kemi ardhur në Podgoricë më vonë, e kam vazhduar shkollimin, kam qenë në klasën e tetë të shkollës fillore, shoqëria e re, mjedisi i ri, njohja me fqinjët etj. Disa gjëra kanë bërë që këto t'i harroj shpejt dhe ta kem më të lehtë. Do të thotë, kam filuar të harroj dhe tani ndihem shumë bukur, thuase kurrë nuk ka ndodhur asgjë. Por, më vjen keq që ka ndodhur tërë kjo, me së shumti sepse ka vdekur gjithë ai popull. E për çfarë? Për asgjë. Ja përsëri, edhe sot ka vende ku ka gjakderdhje dhe ku përsëri vdesin njerëz, hidhen bomba etj.

A mendon se fakti që e ke përjetuar luftën heret, derisa ke qenë fëmijë, ka ndikuar në një farë mënyre më të favorshme në jetën tënde aktuale?

Jo, nuk ka ndikuar, sepse kur je fëmijë nuk mund t'i harrosh kurrë disa gjëra dhe ato imazhe të mbesin për tërë jetën. Ato skena, atë film nuk mund ta nxjerrë nga koka. Për shembull: natën e parafundit në shtëpi, ishim në tarracë dhe shikonim,

ishte muaji prill. Shikojmë se si me llamba ndiqnin njëri-tjetrin, gjuanin, demonstratat e shqiptarëve, Ushtrinë e tyre çlirimtare duke kaluar pranë shtëpisë tonë. I gjithë ky stres, vetëm pret se kur dikush do të vijë të të vrasë, duke marrë parasysh edhe faktin që nuk kemi jetuar me babain, por vetëm unë, nëna, motra 18-vjeçare dhe dy vëllezër më të rinj, pra, pa pushkë, pa asgjë. Ka qenë vërtetë vështirë, nuk e di se si t'ju shpjegoj këtë. Shtëpia jonë ka qenë mu pranë rrugës magjistrale Pejë-Prizren, kështu që ka qenë shumë vështirë. Në fshat kanë qenë gjashtë shtëpi serbe, ndërsa 600 shqiptare, kështu që nuk ka qenë mirë të qëndrosh në shtëpi vetëm. Por, megjithatë, shqiptar ka qenë ai që në fund na ka ndihmuar të largohemi, sepse përndryshe do të kishim qëndruar ende duke shpresuar se do të bëhet më mirë... Por, megjithatë, të dalësh nga shtëpia, e mbushur me gjithçka, vetëm me dy kofera, sigurisht që nuk ndihesh mirë. Por, duke marrë parasysh se askujt nga familja ime nuk i ka ndodhur asgjë, askush nuk ka vdekur, përsëri ke shpresë se do të bëhet më mirë. Kur shpëtoni të gjithë gjallë ndihesh më mirë sepse shtëpia ndërtohet përsëri. Tani jetojmë në Podgoricë, kurse shtëpinë dhe pronën në Kosovën e kemi shitur. Në Podgoricë kemi shtëpinë tone, më të bukur seç e kemi pasur në Kosovë, jetojmë shumë më mirë dhe është më bukur të jetosh midis popullit tënd.

Çfarë mendon se i nevojitet popullit që të përmirësohen pasojat e luftës?

Së pari, harresa është kushti i parë, që të harrohet çdo gjë që ka ndodhur. Për disa kjo është e vështirë, si për shembull, kur nëna humb djalin e saj të vetëm, ose, sa familje që i di unë për shembull, kanë humbur edhe dhjetë anëtarë, qoftë ky djali i dajës, djali, dhëndri, vajza etj. Ata e kanë vështirë të harrojnë. Por megjithatë, të flasësh për fajin dhe hakmarrjen, kjo është diçka më e keqe që njeriu mund t'i bëjë vetes. Nuk është i vetëdijshëm se jeta kalon. Jeta është një... Ka shumë që nuk i besojnë fatit e megjithatë fati është ky.

A ke kontakt me miqtë që kanë ardhur po ashtu nga Kosova dhe që kanë pasur fatin e ngjashëm. Si e kanë përjetuar ata këtë?

Shumica nga ata e kanë përjetuar shumë vështirë tërë këtë. Nuk e di se pse. Por, populli ynë është i tillë. Në qoftë se një person ka problem, personi tjetër që duhet ta ngushëllojë atë do t'i thotë se problemi i tij është edhe më i madh. Por, lufta është luftë dhe secili e ka pasur njëjtë. Askush nuk është larguar duke e pasur çdo gjë në rregull. Kam kontakte të dobëta me njerëzit nga Kosova për arsye se, megjithëse them se i kam harruar të gjitha, kur i shoh më kthehen kujtimet. Kjo është hera e parë në katër vitet e fundit që flas për Kosovën, madje edhe vetë kujtimi është i vështirë për mua. Pra, kam kontakt të dobët me njerëzit nga Kosova. Madje, kur i shoh, ose ata qajnë, ose unë... megjithëse unë iu shmangem kontakteve me ish-fqinjët e mi nga Kosova, me njerëzit me të cilët kam mësuar sepse çdo herë përsëritet historia e njëjtë. Ky është problemi më i madh i popullit tonë – gjithmonë na shoqëron historia e njëjtë, një luftë: në Bosnjë, Kosovë, Kroaci. Derisa të jenë gjallë këto histori... Ne, për shembull, fëmijëve tanë, e ky është gabimi më i madh, u blejmë pushkë si lodra dhe iu flasim për luftën. Me këtë i mësojmë fëmijët tanë që kur ata janë të vegjël. Ashtu si tek shqiptarët, për shembull, ku mund t'a shohësh fëmijën treveçar ndoshta që është mësuar të çojë dy gishta. Kjo nuk është shenjë e fitores apo paqes, por e nacionalizmit. Gabimi është i yni si popull. Njerëzit në Mal të Zi dhe në Serbi... i tërë Ballkani është nacionalist, gjë që nuk mund ta kuptoj. E kuptoj se kanë ndodhur mjaft luftëra dhe gjithë ato gjëra, por për shkak të ne të rinjve, njerëzit e moshuar, prindërit, gjyshet dhe gjyshat duhet të luajnë ndonjë valle

Sa i përket familjes sime, ka nga të gjithë: djali i dajës është i martuar me italiane, vëllai është i martuar me boshnjake, gruaja e dajës është nga Kroacia, vajza e dajës është e martuar me musliman nga Bosnja, bile është martuar gjatë kohës së luftës. Ai është larguar dhe janë martuar. Thjesht, nuk mund ta urrej atë popull, atë komb. Tezja është shqiptare, kështu që nuk kam shanse të urrej asnjë popull, sepse nëse e urrej atë popull, atë komb, atëherë nuk e dua as vëllanë, as kunatën, as djalin e dajës.

Megjithatë, me kalimin e viteve, gjithnjë e më tepër dëshiroj që të kthehem, të shikoj vendin ku jam rritur, ku kam lindur, të tërheq vendlindja. Shpresoj se do të kthehem, por do të doja që të paktën të kaloja me automobil pranë shtëpisë sime të dikurshme vetëm që ta shoh. Shqiptarit që ia kemi shitur shtëpinë thotë se asgjë nuk ka ndryshuar në të megjithëse ka qenë e djegur. E ka punuar planin e njëjtë. Madje edhe gruaja e atij shqiptarit i ka mbjellur lulet në të njëjtën mënyrë si nëna ime. Asgjë nuk ka ndryshuar.

tjetër sepse nga ata duhet të fillojë për arsye se ata i rrisin fëmijët dhe iu mësojnë ato. Është vështirë të harrohet.

Sa shpesh mendon për situatën në Kosovë? A mendon se ajo është tani më e mirë seç ka qenë?

Sigurisht që nuk është më e mirë. Shumë fqinj shqiptarë nga Kosova kur kalojnë nëpër Podgoricë më telefonojnë dhe kthejnë të pijnë një kafe. Edhe pse e kam pak të vështirë, nuk i urrej, por edhe sot kur e dëgjoj gjuhën shqipe tmerrohem, më ka mbetur stresi. Por ata thonë që e lusin Zotin që të kthehen serbët, sepse megjithëse është ushtria e KFOR-it që e ruan rendin në Kosovë thonë që as ata nuk janë të mirë, edhe pse kanë ardhur për të qetësuar gjendjen aty. Edhe shqiptarët vriten tani ndërmjet veti dhe i qërojnë hesapet. Kosova është që kur mbahet mend e përgjakur. Dhe mendoj se kanë të drejtë njerëzit e moshuar kur thonë se në Kosovë nuk do të ketë kurrë ditë të mirë. Sado që populli të jetojë qetë, përsëri vjen dita kur diçka do të pëlcase.

Si e shikon pajtimin tani nga kjo perspektivë? Sa është ai afër?

Siç e thashë, unë e kam harruar krejt dhe nuk më pengon. Në fillim më ka penguar, kurse tani e kam krejt njëjtë, bile edhe nuk mendoj për të. Natyrisht që jam për pajtim. Kur i shikojmë vendet e Bashkimit Europian, ku janë ato tani, kurse ku ndodhemi ne, ndërsa dikur kemi qenë shtet i fuqishëm, i njohur në botë. Prandaj nganjëherë më vjen turp kur udhëtoj dhe e tregoj pasaportën tonë pas gjithë kësaj. Ne individët nuk jemi fajtorë, populli si popull, megjithëse kemi edhe ne faj dhe nuk duhet ta hedhim krejt fajin tek politikanët. Individit nuk mund ta bëjë krejt këtë megjithëse populli flet ashtu: ky është presidenti, ky apo ai. Nga populli buron shumëçka, së pari varfëria dhe çdo gjë tjetër. Ka ardhur koha që vëllai vëllanë nuk mund ta shohë me sy ose që të grinden për shkak të politikës, kurse në fakt vetëm kërkojnë shkak për grindje. Kur ka ardhur koha që populli të urrejë për shkak të emrave, aty nuk ka fat. Populli duhet të mbledhë pak veten, të jetë më aktiv në përpjekjen për t'u pajtuar. Nëse dikush quhet Ervin, Esad, Albert, Dragan... ne jemi të gjithë të njëjtë. Unë e shikoj këtë kështu dhe në këtë mënyrë jam i edukuar. Por, ka prindër që i edukojnë fëmijët krejt ndryshe. Sa i përket familjes sime, ka nga të gjithë: djali i dajës është i martuar me italiane, vëllai është i martuar me boshnjake, gruaja e dajës është nga Kroacia, vajza e dajës është e martuar me musliman nga Bosnja, bile është martuar gjatë kohës së luftës. Ai është larguar dhe janë martuar. Thjesht, nuk mund ta urrej atë popull, atë komb. Tezja është shqiptare, kështu që nuk kam shanse të urrej asnjë popull, sepse nëse e urrej atë popull, atë komb, atëherë nuk e dua as vëllanë, as kunatën, as djalin e dajës.

Çfarë mendon, sa janë popujt nga trevat tona të gatshëm për pajtim?

Çdo gjë varet. Sigurisht që së paku 40 përqind janë të gatshëm për pajtim, por 60 përqindëshi tjetër është kundër pajtimit. Siç e thashë, i tërë Ballkani është nacionalist i orientuar. Shpresoj në pajtim, por ai nuk do të arrihet së shpejti, me siguri. Në vend që të ecim përpara, edhe sot krijohen probleme të reja, kështu që është shumë vështirë. Të paktën të mund të shkëputemi nga ky rreth, të lëvizim, të punojmë diçka, e të mos mendojmë për të. Fëmijët t'i edukojmë në një mënyrë tjetër, ta harrojmë krejt të keqen. Nëse i kujtojmë gjithmonë disa gjëra të keqja nuk mund të ecim përpara. Sepse me këtë nuk i shkaktoni dëm personit tjetër, por vetvetes. Ma kanë djegur shtëpinë, jemi larguar nga Kosova, por megjithatë këtu kam një jetë të re. I kuptoj njerëzit që kanë humbur dikë atje. Kjo është e vështirë të harrohet, por,



megjithatë, të fajësosh dikë tjetër, të kesh dëshirë për hakmarrje, të qash non-stop... Unë e di që dhemb, anëtari i familjes, kumbara, fqinji, por, megjithatë, ata që kanë vdekur nuk mund t'i ngjallim duke fajësuar dikë. Të gjithë fajtorët duhet t'ia lëmë në dorë drejtësisë, gjykatës, kurse ne si individë duhet të shkojmë drejt asaj që të harrojmë. Sado që të jetë e vështirë, njeriu duhet të ecë përpara. Çdo gjë që e duam duhet ta fitojmë me mund sepse asgjë nuk bie nga qielli. Populli duhet t'i tejkalojë të gjitha, ta lë këtë urë, këto gjëra të këqija pas.

Sa shpesh takohesh me termin pajtim dhe çfarë do të thotë ai për ty?

Kur dëgjoj fjalën pajtim menjëherë mendoj njerëzit që përsëndeten dhe përqafohen. Nuk e di, bile nuk kam as shumë kohë që të mendoj për gjëra të tilla, megjithëse e dëshiroj me gjithë shpirt këtë pajtim. Më parë kam menduar se nuk do të doja kurrë të kthehesha në Kosovë, edhe sikur e gjitha të jetë e imja. Megjithatë, me kalimin e viteve, gjithnjë e më tepër dëshiroj që të kthehem, të shikoj vendin ku jam rritur, ku kam lindur, të tërheq vendlindja. Shpresoj se do të kthehem, por do të doja që të paktën të kaloja me automobil pranë shtëpisë sime të dikurshme vetëm që ta shoh. Shqiptarit që ia kemi shitur shtëpinë thotë se asgjë nuk ka ndryshuar në të megjithëse ka qenë e djegur. E ka punuar planin e njëjtë.

Me të nuk keni kontakt?

Nuk kemi kontakt, por ai punon me babain tim në Zvicër. Madje edhe gruaja e atij shqiptarit i ka mbjellur lulet në të njëjtën mënyrë si nëna ime. Asgjë nuk ka ndryshuar. Shpresoj se do të shkoj një herë ta shoh. Nuk kam se kë të fajësoj. Situata ka qenë e tillë dhe duke fajësuar dikë nuk do të fitojmë asgjë. Sado që të ketë shqipta-

rë të këqinj, ka edhe serbë të këqinj. Problemi është se kë do të takoni. Në çdo vend ekzistojnë njerëz të mirë dhe të këqinj. Nëse jeni me fat, do të takoni njerëzit e mirë, nëse jo, atëherë do të takoni këta të dytët. Më vjen keq që ka humbur jetën gjithë ai popull. Akoma nuk ka kurrfarë zgjidhjeje për të gjithë këtë. Këto luftëra kontribuojnë që populli të urrehet, ndërsa kjo është e freskët, 10-15 vjet sa ka nga lufta në Bosnjë, tetë nga lufta në Kosovë etj. E gjithë kjo është e freskët dhe duhet të kalojë kohë që populli ta harrojë krejt këtë. Ka edhe shumë të tillë që nuk kanë qenë me fat si unë dhe familja ime. Ne kemi tani shtëpinë tonë, kurse shumë persona të zhvendosur dhe refugjatë p.sh. jetojnë në banesat e huaja, ndërsa disa madje nuk kanë asgjë, por jetojnë nën çadra. Ata sigurisht që nuk mund ta harrojnë. Di shumë raste për njerëz që kanë jetuar në shtëpi trikatëshe, kurse sot bëjnë jetën e lypësit dhe mezi e ushqejnë familjen. Atyre iu është marrë shumë, ndërsa iu është dhënë pak. Jam i gëzuar që jetoj në Mal të Zi, por megjithatë nuk jam i kënaqur me trajtimin e refugjatëve as në Serbi, as në Mal të Zi. Madje mendoj se janë më të mirëseardhur boshnjakët dhe kroatët se sa ne që vijmë nga i njëjti shtet. Nacionalizmi është megjithatë në nivel të lartë.

Çfarë mendon, si duhet të ballafaqohemi me të kaluarën, çfarë duhet bërë me të gjitha ato ndjenja të fuqishme, dhembjen, të gjitha ato të vërteta që iu kanë ndodhur njerëzve? Si do të duhej të bëhej ballafaqimi me të kaluarën?

Po, unë nuk mund të flas në emër të njerëzve tjerë. Unë mund të flas vetëm për atë se çfarë bëj unë dhe se si sillet familja ime ndaj gjithë kësaj në mënyrë që të gjitha këto kujtime të fshihen, edhe pse kjo është shumë e vështirë. Për shembull, unë nuk ia lejoj nënës sime që të shikojë fotografitë e Kosovës ose shtëpisë tonë të djegur, sepse ajo qan gjithmonë. Ashtu edhe motrës, vëllait. Sepse nuk është lehtë për arsye se e kanë kaluar tërë jetën e tyre atje. Faktikisht, unë tërë jetën e kam kaluar atje, kurse këtu jetoj viteve të fundit. Megjithatë ndihem sikur ta kisha kaluar këtu tërë jetën. Përndryshe, kam pasur dëshirë të jetoj në Mal të Zi. Por, për njerëzit e moshuar, kjo është shumë vështirë. Ne jemi të rinj, shkojmë në shkollë, në fakultete, puna e re, e dashura, jeta e re. Kështu të rinjtë e kanë më të lehtë. Ne të rinjtë harrojmë gradualisht për shkak të gjërave të reja që na ndodhin, por të moshuarit e kanë më të vështirë. Si për shembull, gjyshja ime e cila ka jetuar 70-80 vjet në një vend, i ka lindur dhe rritur fëmijët, ajo e ka të vështirë dhe nuk ka ditë që nuk i bie ndërmend se si e ka kaluar në Kosovë dhe të gjitha gjërat që i mungojnë sot dhe i ka pasur në Kosovë. Të kesh pronë, të rritësh fëmijë dhe të punosh tokën tërë jetën, ndërsa atëherë vijnë njerëzit befas dhe iu dëgjin shtëpinë dhe iu dëbojnë nga vendi ku keni jetuar tërë jetën tuaj! Kjo është shumë e vështirë, vërtetë. Shtojini kësaj edhe faktin që askujt nuk i keni bërë asgjë, do të thotë nuk jeni fajtorë për asgjë. Ka pasur shumë njerëz që kanë vdekur apo kanë humbur dhe nuk kanë qenë fajtorë. Bile shumica e atyre që kanë vdekur kanë qenë të pafajshëm. Ata që e kanë gatur këtë, që kanë luftuar, kanë ditur të tërhiqen me kohë. E gjithë kjo ka qenë si e programuar. Nuk ka filluar befas as lufta në Kosovë, ajo ka qenë e planifikuar që më parë. Përndryshe, prej kah tërë ai armatim atje? Shpresoj, por edhe e lus popullin që do ta dëgjojë këtë, të harrojë, të mundohen të harrojnë, sepse të kujtosh tërë atë, të vuash për diçka që nuk mund ta kthesh – nuk ka kuptim. Le t'u kthehen fëmijëve të tyre, natyrisht kush ka. Pra, të harrohet. Duhet të ecim përpara dhe nuk ka arsye të kthehemi prapa. Kurdoherë që do ta bëjmë këtë, do të jetë e dhembshme për ne dhe për të tjerët, të cilët do t'i ofendojmë apo hidhërojmë me mllefin tonë, pra njerëzit që nuk kanë lidhje me këtë.

Kur ke folur për fajin, çfarë mendon kush është fajtor? A është dikush përgjegjës dhe sa janë përgjegjës “njerëzit e thjeshtë”?

Sa i përket Kosovës, ne kemi qenë pakicë. Nuk e di se si ka qenë situata në Bosnjë dhe Kroaci. Kam qenë më i ri dhe nuk jam kompetent të flas për këtë. Ne kemi qenë pakicë në Kosovë, vetëm disa mijëra serbë dhe dy milionë shqiptarë. Dhe populli, civilët, sigurisht që nuk kanë qenë për asgjë fajtorë. Megjithëse ka faj edhe nga njëra, edhe nga tjetra palë, sepse vjen deri tek inati i tipit “Aha, ai e ka djegur shtëpinë e fqinjit, edhe unë do t’ia djegë atij shtëpinë, edhe pse nuk ka lidhje me të”, hakmarrja etj. Ndonëse edhe pala shqiptare na ka bërë këtë neve. Çdo gjë ka shkuar përmes linjës cik-cak. Të gjithë kanë marrë pjesë dhe të gjithë kanë humbur dikë apo diçka në këtë luftë. Nuk duhet të hidhet faji vetëm në njërin palë, sepse të gjithë janë fajtorë. Ashtu sikur se edhe unë që si 13-vjeçar kam ndodhur në këtë luftë dhe duhet ta ndajë fajin. Nëse njëra palë ka filluar, tjetra sigurisht e ka ndezur. Edhe pasojat, edhe faji, tërë kjo është e përbashkët. Ashtu siç të gjithë kemi marrë pjesë në luftë, ashtu duhet të gjithë së bashku të tubohemi dhe të ngushëllohemi. Duhet të tubohemi të gjithë dhe të themi “Stop!” sepse nuk shoh se ku na çon kjo. Mu për shkak të të ardhmes sonë të përbashkët duhet të harrohet e gjithë kjo në mënyrë që të vijmë tek një rreth pozitiv në të cilin rinia jonë dhe fëmijët tanë që tek do të lindin, të mund të rriten normalisht në një botë normale, siç rriten fëmijët tanë në shtetet tjera të Europës dhe botës.

Si e sheh të ardhmen?

Për dhjetë vjet, sipas meje, shumë gjëra përsëri nuk do të ndryshojnë. Ne jemi aktiv si popull, por stereotipat nga barcaletat se ne jemi popull dembel janë deri diku të sakta. Çfarëdo që të jetë në pyetje, ecen me një ritëm të ngadaltë dhe me rrotullimin në rreth, nga i cili nuk ka dalje. Si i ri megjithatë shpresoj se për dhjetë vjet do të jetë më mirë.

A ka edhe ndonjë gjë tjetër që dëshiron ta thuash?

Ë bëmë thirrje të gjithë njerëzve nga Bosnja, Kroacia, Kosova dhe vendet tjera që të ecin përpara, të harrojnë çdo gjë që ka ndodhur, sepse duke e kujtuar gjithmonë të gjithë këtë, nuk do të jetë mirë as për ata, as për rrethin.

L. Z.

Të lutem prezantohu?

Unë jam Darko nga Kulla dhe punoj në Horgosh

Cilat janë përvojat tuaja apo kujtimet nga lufta dhe vitet e luftës?

Pasi që kam lindur në vitin 1975 nuk kam marrë pjesë në luftë, por kam mundur t'i përcjellë ngjarjet në mjedisin tim. Vëllai im ka marrë pjesë në luftë si rezervist. E kanë marrë pa dëshirën e tij. Në momentin kur e përcollëm vëllain ndodhi një rast interesant. Meqë babi ia ka firmosur thirrjen, ndërsa ai nuk ka dashur të shkojë fare, është fshehur dhe kjo ka shkaktuar grindje në familje “pse e ke firmosur thirrjen?!”, pastaj “nuk është dashur” dhe vëllai ka qenë i detyruar të shkojë. Ata majmunët nga Reparti Ushtarak, për shkak të një parregullsie në evidencë, nuk e kanë regjistruar fare se ka shkuar në ushtri. Policia erdhi në orën katër të mëngjesit në shtëpi me informatën se vëllai nuk është lajmëruar në ushtri.

Babai del me rrobat e gjumit, ata e mënjanojnë, shëtisin me reflektor nëpër shtëpi, derisa unë rri i shtrirë, ndërsa ata pyesin “Kush është ky?”. Babai u përgjigjet “ai është djali im i vogël, mos e prekni atë”. Kur është kthyer vëllai, ai ka pasur përvoja të theksuara traumatike. Është dridhur, nuk i ka përngjarë vetes, ka shkuar vazhdimisht në kopsht për të pirë duhan, ka qarë, thoshte se atje ka parë njerëz të bërë copa-copa, të cilët i kanë sjellë pranë shtabit ku ai ka qenë i angazhuar pasi që nuk ka marrë pjesë drejtpërdrejt në luftë. Kjo ka ndodhur pikërisht gjatë invazionit të kroatëve në Torjançe. Me këtë rast kanë vdekur 25 veta nga komuna e Kullës. Përveç kësaj, kam pasur një vajzë e cila është dashuruar në një tip nga Bosnja, dhe, ndoshta, për këtë shkak, ka filluar të shfaqë disa qëndrime, si “duhet mbrojtur populli serb”, pastaj kjo, pastaj ajo. Më kujtohet se edhe atëherë kam pasur qëndrim pacifist duke thënë “lëre, kjo është marrëzi, çfarë flet, çfarë do”. Domethënë këto të gjitha kanë qenë disa përvoja indirekte. Kjo është ajo. Ndërsa nga farefisi nuk kam pasur dikë atje.

Si ndjehesh sot pas dhjetë vjetësh dhe çfarë disponimi ekziston në mjedisin tënd?

Unë personalisht nuk kam pasur kurrë problem për këtë, sepse kjo nuk ka qenë luftë e imja. Madje edhe kur bisedojnë se “tanët kanë pushtuar këtë e atë” unë i pyes cilët janë tanët? Ata nuk janë të mitë. Nuk jam unë pjesëtar i atij fisi i cili lufton atje me një fis tjetër primitiv. Prandaj, sa më përket mua, unë nuk kam qenë kurrë pjesë e kësaj. Ndërsa sa i përket mjedisit dihet se çfarë bëhet dhe në çfarë mënyre mendohet – 30% janë ende të helmuar.

A mendon se ecim drejt pajtimit?

Nuk e di se çka do të thotë pajtimi. Për mua pajtimi i plotë, për shembull, mund të ndodhë vetëm pas 4-5 dekadave. Kur të rriten fëmijët që nuk e mbajnë mend luftën dhe kur fëmijët e tyre të fillojnë të martohen me njëri-tjetrin, siç ndodh tani, ta zëmë në Vojvodinë në mes kombeve dhe kombësive. Ai është njëfarë pajtimi i plotë,

Vëllai im ka marrë pjesë në luftë si rezervist. E kanë marrë pa dëshirën e tij. Në momentin kur e përcollëm vëllain ndodhi një rast interesant. Meqë babi ia ka firmosur thirrjen, ndërsa ai nuk ka dashur të shkojë fare, është fshehur dhe kjo ka shkaktuar grindje në familje “pse e ke firmosur thirrjen?!”, pastaj “nuk është dashur” dhe vëllai ka qenë i detyruar të shkojë.

kurse ky që po ndodh tash, kjo është, nuk e di, njëfarë tolerance. Këta po ndryshojnë disi pak...

Nuk mundet, e din... Truri i njeriut është i ndërtuar në mënyrë të tillë që të arrijë deri tek përfundimi përmes rrugës më të shkurtër të mundshme – serbët më kanë vrarë, njëfarë serbi, i çmendur, ekstremist më ka vrarë babain, nënën, vëllain – serbët janë të këqinj. Dhe mendja menjëherë i përgjithëson “serbët janë të këqinj”. Për këtë është me rëndësi burgosja e atyre kriminelëve, me qëllim që të përcaktohet fajtori i saktë.

A ekziston diçka që quhet fajësi kolektive?

Po ekziston. Fajësinë do ta rëndisja ndoshta në tre nivele: i pari, ata që kanë vrarë – kjo është më e vështira, i dyti, ata që kanë votuar, dhe i treti, ata që kanë abstenuar në zgjedhje. Tani janë dënua, tani radikalët janë në pushtet, ta zëmë, në Novi Sad. Unë nuk jam fajtor në bazë të asnjërës prej këtyre formave, sepse gjithmonë kam dalur në votime, gjithmonë kam qenë pacifist dhe kam folur kundër luftës, gjithmonë e kam bindur mjedisin se nuk duhet të votojë për Milosheviqin, se aty qendron e keqja. Ndoshta më ka munguar pak aktiviteti, kam shikuar më shumë prapancën time, çfarë të bëj unë në gjithë këtë, ndoshta është dashur të jem më tepër aktiv, por kjo është e lidhur pak me dhunti. Njeriu duhet të jetë i aftë për të nxitur masën. Por në çdo rast, për një çikë pasiviteti, ja për çfarë do të mud t'ia zija vetes për të madhe. Kjo është ajo.

Kush duhet ta nxisë procesin e pajtimit?

Po ja, të thashë. Të burgosen këta, të dënohen. Domethënë, pushteti – në radhë të parë. E tani, falja... Çfarë do të thotë kërkimi i faljes dikujt që ka humbur? Nuk e di. Megjithatë kjo duhet të ndodhë, por nuk e di se çfarë do të ndihmojë kjo. Falje para kujt, para meje? Mundet, ndoshta, për shkak të mënyrës së pasivitetit që e kam shfaqur. Nuk e di, me siguri u përket instancave më të larta që ta nxisin, kurse më vonë... Duhet kohë që të ndodhë ky proces.

A e vëren se ka filluar?

Në çdo rast janë qetësuar pasionet dhe ky është hapi i parë. Dhe tashti, sa e kam llogaritur unë se do të duhet të kalojnë, 4-5 dekada... Mendoj se ka filluar, ta zëmë.

Si mendon se po zhvillohet edukimi i të rinjve? Cilat janë ato vlera që u rrënohen dhe a do të jenë ata pas 40 viteve me zemër të pastër?

Po do të mbesin disa farëra, madje edhe atëherë, por gjenerata e parë, nën ndikimin e prindërve të shqetësuar, do të mendojë me siguri “serbët – jo të mirë”, “kroatët – të këqinj” etj. Vetëm gjenerata e tretë, fëmijët e këtyre fëmijëve që tani rriten, ata, nën ndikimin e atyre prindërve më pak të shqetësuar, do të jenë më normalë, me siguri. Atëherë do të fillojnë martesat e përziera etj.

A mund ta definosh pajtimin? Çka do të thotë ai për ty?

Po ja, ta thashë më parë – të jetë në nivelin e jetesës në Vojvodinë, të funksionojë në mënyrën – ti je kroate, unë jam, nuk e di, rusin, tani ne do të krijojmë fëmijë, të jesh shoqja ime, çfarëdo. Kjo përbën për mua pajtim.

Po ballafaqimi me të kaluarën?

E vërteta duhet të dihet. Nuk e di. Ja, edhe në kohën e Luftës së Dytë Botërore, nuk jam aq njohës i historisë, nuk di saktë sesa pjesëtarë të hungarezëve kanë qenë në radhët e hortijevcëve, kurse sa në radhën e partizanëve. Ndonjëherë, edhe gënje-

Fajësinë do ta rëndisja ndoshta në tre nivele: i pari, ata që kanë vrarë – kjo është më e vështira, i dyti, ata që kanë votuar, dhe i treti, ata që kanë abstenuar në zgjedhje.

Kjo ka ndodhur diku afër, por jo mua personalisht, kështu që nuk e di sesa jam unë meritor të flas për këtë; mua nuk më kanë vrarë njeri të afërm e as unë nuk i kam bërë diçka të keqe dikujt, kështu që sa më përket mua, unë do të martohesha nesër me kroate... ose me shqiptare.

shtra është e mirë, nuk e di. Sepse në shkollën fillore na kanë mësuar se ka pasur edhe njësi partizane hungareze dhe rusine, ndërsa ka pasur edhe hortijevas, ka pasur kësosh e asosh. Tani nuk e di se a ka qenë kjo kështu apo jo, por sikur të kisha menduar se të gjithë hungarezët kanë qenë hortijevas ndoshta sot me ndër-dije do të mendoja për ta se janë të këqinj, nuk e di.

Po nga “kjo” anë?

Të gjithë ata njerëz duhet të shpërblehen në mënyrë që ta pranojnë se “po, ne kemi votuar për Millosheviqin”. Me siguri në atë kohë kanë thënë verbërisht “duhet, duhet, ata na kanë sulmuar, kanë dashur të na dëbojnë”, ndërsa tani kur është qetësuar situata, thonë “kjo është e tmerrshme”, ndërsa një pjesë thotë “ky është fotomontazh”... Mendoj se secili duhet të bëjë diçka për shpirtin e tij. Edhe ato gra që kanë votuar, të cilat kurrë nuk kanë shkuar në luftë, kjo përherë më ka nervozuar më së shumti – “Voja e di të thotë, Voja e di”. Edhe ata që nuk kanë marrë pjesë duhet ta dinë se çka është bërë, të jenë të vetëdijshëm për këtë, të shohin pak edhe përgjegjësinë e tyre. Edhe ata që nuk kanë dalë në zgjedhje, unë i kuptoj si qelbanikë, s’je i vetëdijshëm, dhe ke ikur, kjo është njëfarë eskapizmi – “nuk di ç’po ndodhë”.

Kush duhet t’ua hapë sytë?

Pushteti. Organet kompetente. Natasha Kandiçi dhe të tjerët. Ata duhet të thonë të vërtetën – ka qenë kështu e kështu e jo të pengojnë e të bëjnë dredhi. Domethënë ka qenë kështu, kështu e kështu, nga njëra anë, dhe të vërtetohen saktësisht faktet, nga ana tjetër. Nuk e di sa e mirë është kjo për pajtimin, por është e mirë për bashkimin e kombit. Bëhu i vetëdijshëm për atë çfarë ke bërë?

A e sheh ballafaqimin me të kaluarën si detyrim apo si domosdoshmëri për ndonjë arsye tjetër në situatën e sotme?

Si detyrim – ndaj vetvetes. Si ta shikosh veten në pasqyrë kur zgjohesh në mëngjes? Unë jam fajtor për këtë, këtë dhe këtë. Si detyrim.

A sheh ndonjë pengesë ?

Ka sa të duash! Mos të hyjmë në politikë.

Çfarë na pengon që të pajtohemi para vitit 2050?

Shumëçka. Këtu ende ka gjak të keq. Kjo është gjithnjë e freskët, prandaj, para së gjithash, duhet të kalojë shumë kohë. Mendoj se koha është faktori kryesor, kurse më pas të bëhet verifikimi se kush sa ka vrarë nga ata dhe si. Po ashtu duhet verifikuar sa më parë edhe se kush janë përgjegjës që po fshehen. Ata duhet të përgjigjen dhe të dënohen urgjentisht para drejtësisë. Vetëm kështu mund të ecim përpara. Sepse këto pushtete që janë edhe në Kroaci, edhe në Serbi sikur e miklojnë mendimin nacionalist. I përcjellin me disa nderime (në Hagë). Duhet distancuar nga kjo politikë. Ata kanë qenë të këqinj, tani ne bëjmë diçka tjetër, tani populli na mbështet ne – domethënë populli nuk është më i çmendur siç ka qenë, është mbushur pak me mend.

Çfarë mund të bëjë inividit?

Ta pyes veten se ku ka qenë dhe ç’ka bërë gjatë tërë këtyre viteve. Ta pyes veten se cili ka qenë mendimi i tij dhe nga kush është ndikuar në kohën e kërcënimeve, gjatë viteve ’89, ’90. Domethënë të shikojë sesi është zhvilluar e gjithë kjo tek ai në mënyrë kronologjike, duke filluar nga periudha më e shëmtuar e viteve ’88–’89 e

deri më sot. Kur të takohet më vonë me ndonjë person të kombësisë tjetër nuk do të ketë gjak të keq. Nëse zgjedh rrugën e përjashtimit “ju jeni fajtor për këtë e këtë”, “ju keni filluar të parët”, “ju keni dëshiruar t’i dëboni serbët, ashtu siç ka dashur Hitleri”, “kroatët janë të këqinj”, “kroatët e kanë pasur Jasenovcin”, të njëjtit qelbësira janë edhe kroatët, edhe serbët, edhe muslimanët, ata janë fise primitive. Unë jam i bindur se Jasenovci do të ndodhte edhe në anën tjetër sikur të kishte qenë ndryshe kostelacioni i ngjarjeve historike. Edhe deklaratat se “ju ia keni filluar, ne kemi qenë të detyruar të mbrohemi” etj... Duhet shkruar në fillim dhe pastaj duhet kaluar të gjitha përsëri nga kjo e sotmja.

A duhet harruar?

Natyrisht që jo.

Po a duhet kërkuar falje?

Kujt? Unë, ta zëmë, personalisht, nuk kam kujt t’i kërkojë ndjesë për asgjë. As mua nuk duhet dikush të më kërkojë falje për diçka, kështu që nuk e di. Dhe tani, të gjitha përvojat e mia janë nga “ana”. Kjo ka ndodhur diku afër, por jo mua personalisht, kështu që nuk e di sesa jam unë merituar të flas për këtë; mua nuk më kanë vrarë njeri të afërm e as unë nuk i kam bërë diçka të keqe dikujt, kështu që sa më përket mua, unë do të martohesha nesër me kroate... ose me shqiptare.

Cila është e ardhmja jonë e përbashkët?

E ardhmja e përbashkët? Po në Bashkimin European (qeshet)! Nuk e di, do të jetë këtu gjithmonë njëfarë rivaliteti: Dinamo, Cibona, Partizani, Zvezda... Do të jemi disi si turqit dhe grekët! Kjo është ajo, por do të bashkëpunojmë, do të kam miq kroatë dhe unë do të jam mik i tyre etj. Do të jetë ok, bota po shkon kah e mira (qeshet). Para 200 vjetësh gruaja e cila tani është ndoshta fituese e Çmimit Nobel ka qëndruar pranë shporetit, prandaj pas 200 vjetësh edhe ne nuk do të grindemi, do të jemi të gjithë të buzëqeshur, të bukur...

T. G.

Dua të të pyes për konfliktin që ka ndodhur në vitin 2001, si e ke përjetuar atëherë? Dhe dua të të pyes se si e përjeton, si konflikt, si luftë, si luftë qytetare?

Oh, i mjeri unë, përkufizimin e konfliktit dhe luftës e ka dhënë Klauzevici dhe unë nuk do të doja të besoja se ajo që ka ndodhur tek ne ka qenë luftë. Ka qenë diçka, Zoti e di se çfarë. Disa e quajnë atë luftë për të drejtat e njeriut, disa e quajnë terrorizëm, disa e quajnë invazion nga shteti fqinj. Në çdo rast, është shtënë me armë dhe kjo ka qenë shumë keq. Ka sunduar njëllë, jo edhe aq rrezik i vërtetë sa njëllë psikozë e pabesueshme, e cila të ka mbytur. Për fat të mirë, ne kemi filluar atëherë me *Live radio*. Diku në nëntor të vitit 2000 kemi filluar të punojmë në këtë temë duke mos menduar fare se një gjë e tillë mund të ndodhë. Ka pasur periudha kur rrugët e Shkupit kanë qenë të zbrazura, kurse ne kemi qenë të vendosur në Mavrovkë (qendër tregtare në anën e majtë të Vardarit, afër Çarshisë turke, e ashtuquajtura pjesa “shqiptare” e qytetit), që është, apo jo, vend i rrezikshëm. Aty kemi ardhur të gjithë. Edhe pse në atë kohë nuk ka qenë e qartë sesi do të jetë, është folur për ndarje, shkëmbim terriroresh, asgjë nuk ka qenë e sigurt. Ne kemi qenë të sigurt vetë në vete dhe kjo ka qenë mënyra me të cilën jemi shmangur nga ajo psikozë. Dhe kjo ka ndikuar, të paktën tek unë personalisht, që ta përjetoj më lehtë konfliktin sesa disa të tjerë ndoshta, sepse ne nuk jemi grindur në mes vete, maqedonë dhe shqiptarë, turq apo serbë, apo nuk e di se kë tjetër kemi pasur në radio. Nuk jemi akuzuar, ky ka vrarë kaq, ai ka vrarë aq, ju bëni këtë, ata bëjnë atë. Ne jemi marrë me atë me të cilën merremi tërë jetën, kemi konstatuar situatën dhe jemi munduar që në ato rrethet tona të mbesim shëndoshë shpirtërisht. Kështu ka qenë disi. Kështu e kam përjetuar unë konfliktin. Megjithatë përjashta kanë ndodhur një milion gjëra, unë personalisht kam bërë muzikë me “Long play”. Kemi qenë pjesë edhe e atij koncertit të paqes në të cilin kanë marrë pjesë shumë banda. Që në fillim jemi munduar si njerëz të themi: – Hej çfarë po ndodh, kurse aty ka qenë edhe lëvizja tjetër – Është Mjaft! Jemi tubuar, kemi nënshkruar peticione që të qetësohen gjakrat, që t’i qaset situatës me kokë pak më të ftohtë, të mendohet më matur, por ka qenë evidente se stadi i të menduarit tek kreatorët e politikës, mediave, tashmë ka qenë shumë negativ. Për shkakët e luftës nuk do të doja vërtet të flas duke qenë se nuk jam njeri që mendoj se dhuna mund të jetë zgjidhje për çfarëdo, me përjashtim të momentit kur dikush të sulmon dhe duhet ta mbrosh veten nga nevoja, ta shpëtosh disi jetën. Por me dhunë t’i zgjidhësh gjërat, është vështirë.

A mendon se ende tani ka pasoja nga ajo që na ka ndodhur gjatë kohës së konfliktit?

Ka, ka, definitivisht ka. Unë jam optimist në këtë aspekt. Mendoj se Maqedonia po shërohet çuditërisht shpejt nga ajo që ka ndodhur. A është kjo përshtypja ime për arsye se jetoj në botë të tillë, në rreth të tillë. Ne bile edhe gjatë kohës së luftës kemi bërë muzikë nëpër klube, në të vërtetë para katër-pesë personave, sepse në atë kohë njerëzit janë frikësuar të dalin, por ne e kemi bërë tonën, thjesht që të mbesim

Por ekziston një pjesë e madhe njerëzish që jetojnë ende me paragjykime, mos këtë, mos atë... Një vit pas konfliktit më ka ndodhur që në Ohër të mos më japin dhomë sepse kam folur shqip.

të pastër dhe të shëndoshë para vetes – kur të shikohesh në mëngjes në pasqyrë të mos shohësh ndonjë fytyrë të trembur të çoroditur, por të shikosh sado-kudo njeriun normal. Po shërohem, po shërohem shpejt, por mua më frikëson diçka tjetër – fakti që akoma ka njerëz që dëshirojnë t'i frenojnë proceset dhe dëshirojnë t'i japin njëfarë etnodimensioni tërë asaj që po ndodh. Thjesht, tek ne njerëzit nuk janë mësuar ende me atë “mendimi im personal”, pjesa më e madhe e tyre, nuk them të gjithë sepse ka, falë Zotit, njerëz të mrekullueshëm normalë që nuk merren me këtë, por me jetën, përditshmërinë, por ekziston një pjesë e madhe njerëzish që jetojnë ende me paragjykime, mos këtë, mos atë... Një vit pas konfliktit më ka ndodhur që në Ohër të mos më japin dhomë sepse kam folur shqip. E kemi pasur të qartë se pse është ashtu. Akoma ka njerëz të tillë, fatkeqësisht, ka në ato struktura që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi vendosin mbi të ardhmen tonë. Kjo më frikëson mua. Nuk frikohem sesi sillen njerëzit normalë, ata të cilët politikanët i quajnë masat popullore; masat popullore, më duhet t'i zhgënjej politikanët tanë të çmuar, masat popullore janë shumë më të shëndosha se ata. Për këtë arsye edhe nuk ka ndodhur lufta, edhe pse ka pasur njerëz që i kanë nxitur; megjithëse kanë dashur të ndezet Tetova, të ndezet Shkupi, Dibra, Strumica, kanë dashur që kjo të ndodhë. Ka pasur struktura që e kanë dëshiruar këtë, por populli është treguar shumë i zgjuar, i ka parandier.



Të të pyes, kur flasim për popullin akoma...

Edhe sot ka veteranë të këtillë, veteranë të atillë, që duan, pastaj kërkojnë, bllokojnë rrugët, duan punë, kanë qenë rezervistë, kanë luftuar në UÇK, duan pensione, të jenë të trajtuar si veteranë të luftës, invalidë të luftës... kjo mua nuk më intereson. Shiko, në çdo konflikt ka gjëra që duhet të zgjidhen. D.m.th. duhet këta njerëz që kanë marrë pjesë në atë luftë, në atë konflikt, të risocializohen, sepse ai nëse ka shtënë me armë, nëse ka qenë në front, nëse është ballafaquar me vdekjen, ai ka pasoja dhe për të duhet të kujdeset shteti. Sepse në qoftë se jo sot, nesër, nesër ai do ta bëjë problemin, miliona raste. Luani ka hyrë në bar, është dehur, ka nxjerrë bombën, nëse ai njeri nuk e ka kaluar atë fazë kur ka qenë i ekspozuar ndaj gjakut, vrasjes... Këto nuk janë situata normale të cilat mendja njerëzore mund t'i përballojë; ti mund të shtiresh se je i marrë – po, unë kam qenë në luftë dhe tani jam normal. Nuk është ashtu. Ka diçka që mbetet në nënvetëdije dhe që duhet të shërohet, të trajtohet, që shteti të kujdeset për këta njerëz, t'ju gjejë punë, t'i strehojë, të përpiqet që sa më lehtë të kalojnë përmes asaj që kanë përjetuar.

Po banorët e zakonshëm?

Mendoj se banorët e zakonshëm që kanë qenë në të ashtuquajturat regjione krize, mendoj se edhe me ata duhet të punohet shumë, sepse ekziston mosbesim. Por ky mosbesim ka ekzistuar gjithmonë. Mendoj se është budallallëk i madh të thuhet: sa mirë që kemi jetuar. Paragjykimet kanë ekzistuar gjithmonë këtu, gjithmonë ai tjetri është shikuar disi... Dhe duhet të punohet në këtë, duhet të punohet shumë... Ka dy lloje aktivizimesh; aktivizimi që nuk është pretencioz, unë do ta quaja të përdit-shëm. Nuk duhet të bëhen koncerte, karvane apo seminare. Kjo është po ashtu mi-rë, por duhet të ketë asolloj aktivizimi – ngjarje të vogla që për çdo ditë do t'i afronin njerëzit. Pajtimi... Nuk duhet ne të bëjmë festival, të vijmë 500 vetë dhe tani... ata janë të pajtuar. Nuk është e vërtetë. Duhet njëlloj bashkëpunimi tjetër; duhet diçka që rrjedh përditë, që ndodh, atë që miqtë tanë anglezë e quajnë *reconciliation* apo pajtim. Jo diçka që mund ta bësh përnjëherë – shtrak dhe gati, ne jemi pajtuar, por duhet të ekzistojë njëfarë procesi, ata njerëz duhet të kontaktojnë përditë, të shohin se kjo është krejt normale. Çfarë, a duhet t'ju shesësh pajtimin? Ose esnafit nga çarshia ku ka maqedonë, turq, shqiptarë, boshnjakë t'i flasësh sesi të jetojnë bashkë. Ka ndodhur lufta, ndërsa edhe sot e kësaj dite njerëzit jetojnë në çarshi, nevoja i shtyn njërin tek tjetri, ata janë fqinj. Në qoftë se asgjë tjetër, duhet ta pas-trojnë rrugën, ta zëvendësojnë dritën e rrugës; nëse ekzistojnë probleme – ia kanë thyer njërit dyqanin, po prit të organizohemi; duan apo nuk duan duhet të bashkë-punojnë; së pari do të duhet, kurse më pas do të duan. Shumë më lehtë do të jetë të bëjë biznes aty me shokun, me fqinjin, sesa nuk e di unë se më kë.

Kush mendon se duhet të punojë në këtë proces?

Të gjithë, që nga pastruesi i rrugës deri te kryetari i shtetit, të gjithë. Më nervozojnë shumë personat që na shfaqen në televizion, që udhëheqin partitë, shtetin, të cilët dinë të japin deklaratë nga e cila, jo në mënyrë direkte por midis rreshtash, lexohet urrejtja. A mendojnë njerëzit për atë se a do ta kuptojë ndonjë fshatar nga Shipkovi-ca, i cili ka kryer katër klasë të shkollës fillore, nuk e kupton se çfarë do të thotë politika, drejtimi i shoqërisë. Elita jonë politike është shumë e papjekur dhe nuk i matë fjalët e saj, nuk e din çfarë bën me veten. Ata persona bëjnë politikë sot për sot. Madje as sot për nesër, këtu qëndron problemi. Ata shikojnë të fshehin bishtat e tyre dhe të përshkohen nga njëri proces zgjedhor në tjetrin. Po e them prapë, ky popull i kupton, por gjithmonë diçka nga kjo mbetet dhe kthehet si njëlloj nervozizmi. Kur ka popuj të ndryshëm që jetojnë në një vend, kjo do të thotë automatikisht se ndonjë grup i një populli do ta urrejë popullin tjetër. Kjo është kështu sipas përkufizimit, nuk mund të kesh një vend ku të gjithë do të jetojnë të gëzuar dhe të lumtur. Bile as në Zvicër nuk është ashtu.

Më thuaj, sipas teje, ku qëndron përgjegjësia për gjithë këtë që po na ndodh?

Përgjegjësia qëndron në atë se është dashur të mendohet për probleme para se të ndodhin. Thjesht, kjo mund të tingëllojë sikur mbaj krah, por shqiptarët kanë pasur problem në atë shtet; në atë RSFJ, kanë pasur në mënyrë konstante disa probleme. Edhe gjatë kohës së Babait kjo është zbutur disi, është zgjidhur përmes disa zgjidhjeve ad hoc, por Babai ka ditur ta menaxhojë atë bukur. Por, kur Babai ka vdekur nuk është gjetur dikush i tillë që do të dinte ta çonte këtë process më tej. Çdo gjë ka shkuar me atë – tani nuk është koha, tani nuk është koha. Nga ana tjetër, kjo ka krijuar pakënaqësi tek shqiptarët. Dhe çdo pranim të atyre të drejtave e kanë përdorur nga ana tjetër disa struktura politike që të thonë: Aha, shiko tani, tani na

kanë marrë këtë, nesër do të na marrin shtetin dhe është krijuar një grup i shqiptarëve të pakënaqur që bërtasin: çfarë është kjo? Tek maqedonët është shfaqur po ashtu grupi i të pakënaqurve: Shiko, ja të gjitha do t'i marrin, nesër universitetin, pasnesër do të kërkojnë gjysmën e shtetit, do të shpëputen, kushedi se çfarë do të bëjnë dhe tërë kjo. D.m.th. janë fryer gjërat: “Këta maqedonët do të na shkatërrojnë, do të na asimilojnë”, ndërsa këta të tjerët – shqiptarët do të na shkatërrojnë. Dhe gjatë gjithë kohës askush nuk iu ka prerë rrugën këtyre rrymave, tërë kohën këto rryma radikale kanë ndezur zjarrin dhe kanë fituar votat në zgjedhje. Pas kësaj do të vijnë të huajt, do të ulen, do të qetësohen dhe do të thonë: Ja tani është mirë, tani çdo gjë është bukur, do të jetojmë mirë si vëllezër, kurse deri dje kanë ngrënë gurabia nëpër mitingje. Ndërsa nesër ulen dhe bëjnë marrëveshje, vozisin mauna, bëjnë biznes.

Ndodhin edhe sot gjëra të tilla. Ata janë njerëzit që më së tepërmi i kanë rënë gjoksit nëpër mitingje. Petkoja do të ulet me Hashimin dhe nuk ka problem nëse bëhet fjalë për ndonjë marrëveshje të mirë, do të jemi vëllezërit më të mirë, do të shkojmë së bashku në skarë.

Më thuaj, a ekziston sipas teje diku faji?

Fajin nuk mund ta shoh në popull pasi që populli në parim nuk vendos shumë për atë çfarë do t'i ndodhë. Populli vendos nëse do të shkojë në pushim apo jo – dhe shumica nuk do të shkojë sepse nuk ka para, çfarë do të punojë sot, kurse çfarë nesër, si të gjendet që të fitojë ndonjë para për të mbijetuar. Fajin e shoh ekskluzivisht tek politikanët, mediat dhe njerëzit që kanë dashur të bëhen pjesë e njëfarë establishmenti. E kemi fjalën për kriminelët që kanë bërë para, por që duan të krijojnë edhe status shoqëror. Flas për njerëzit që vrapojnë tërë jetën pas politikanëve në mënyrë që edhe vetë të bëhen politikanë. Kështu që bëhen më katolikë se papa; në qoftë se Petkoja flet me fjalorin nacionalist, poltroni i tij do të flasë edhe më tepër për arsye se duhet të tregohet para eprorit të tij se ai është konsekuent ndaj ideve.

A mendon se ne si njerëz kemi përgjegjësi sepse kemi lejuar që të na manipulojnë ashtu?

Po ndoshta pak, por atë që kanë mundur ta bëjnë njerëzit normalë, mendoj se atë edhe e kanë bërë pak a shumë. Vetëm nuk kemi dalur të gjithë në rrugë të themi: e nuk duam, nuk duam bre, por në ato situata frika është më e madhe se guximi. Ne madje edhe kemi bërë muzikë në shesh, por kush na pyet se a do të ketë paqe apo jo. Edhe në koncertin “Roku për paqe” ka pasur publik, ka pasur mjaft, aq sa i thua vetes nuk ka shans të ketë luftë, shiko sa popull është tubuar. Por fatkeqësisht, atje kanë qenë tri-katër mijë, por ekzistojnë 30-40 mijë që bërtasin: Shiko në televizion sesi e kanë gjuajtur, nesër edhe mua do të më vijnë tek shtëpia. Sidomos njerëzit që jetojnë në Tetovë, Kumanovë, Gostivar, Kërçovë, Strugë, ata me siguri e kanë pasur më problem se ne. Ne në kryeqytet as që e kemi ndier luftën. E kemi ndier psikozën e luftës, por luftën jo. Por aty ku njerëzve u kanë xixëlluar plumbat, granatat... ka pasoja. Tani, nëse je njeri i formuar dhe e din se çfarë ke, ti fillon të shërosh; vetveten para së gjithash. Por këtë nuk mund ta bëjë çdokush.

Më thuaj për fund, cili është parashikimi yt, çfarë do të na ndodhë viteve të ardhshme në Maqedoni?

Oh, i mjeri unë, sikur të më kishe pyetur këtë para një viti, dy, do të kisha thënë se çdo gjë do të jetë në rregull. Tani nuk di. A do të ketë konflikte, këtë nuk e besoj, kjo është ajo që më pak e besoj. Por që akoma do të ketë njerëz të cilët kalërojnë në ka-

Do të thotë, për çdo ditë ata që udhëheqin politikën, ata që drejtojnë gazetatat, televizionet, duhet të mendojnë, të shikohen në pasqyrë dhe ta pyesin veten: çfarë duhet të bëj që ky shtet të jetë më i mirë, e jo çfarë duhet të bëj për të mbushur xhepin tim. Puno diçka, ke mundësi, tani ke mundësi. Ndoshta më parë nuk e ke pasur mundësinë, por tani e ke. Ke përgjegjësi. Dy milionë njerëz të shikojnë. Duhet të punosh në këtë.

lin e nacionalizmit, të cilët do të kërkojnë të arrijnë deri tek karrigeja, pushteti, paratë, të tillë do të ketë dhe me siguri do të ketë njerëz që do të ngjiten në atë moment. Ata i kërkojnë zakonisht ithtarët e vet tek shtresat e varfëra, tek njerëzit që nuk kanë para dhe të cilëve është lehtë t'ju thuhet se për atë që nuk kanë para “nuk jam fajtor unë që tërë jetën ju vjedh, por fajtor është shqiptari, fajtor është maqedoni”. Shqiptari do të thoshte: Të gjithë ata punojnë punë shtetërore, kurse neve na duhet të shkojmë në Zvicër, Gjermani... ata janë fajtorë. Maqedoni do të thoshte: Shko ti në Kërçovë, Tetovë, shiko se çfarë shtëpish të mëdha kanë ndërtuar. Ndërsa njeriu ka pastruar njëzet vjet tualetin që ta ndërtojë atë shtëpi. Por mjafton vetëm t'i thuash – ai shtëpi të madhe, ti shtëpi të vogël. Nga i ka fituar ai ato para? – Nga droga, ndonëse, ka mjaft nga ata që edhe nga droga i ndërtojnë shtëpitë. Disi jam pesimist. Jo edhe aq nga aspekti se ndodhin incidente. Do të ketë njerëz të tillë që do të merren me nacioide, kombe, ide, bile ka edhe struktura të tilla në shtet që udhëheqen nga ideja e Mbimaqedonit, Mbishqiptarit – që është e rrezikshme dhe ajo duhet të pritët që në fillim. Mua sinqerisht më frikëson krimi. Ne po bëhemi shtet i kriminalitetit. Shteti, prona private, ku secili mund të bëjë çfarë t'i shkojë ndërmend nëse ka para që të nxirret më vonë. Edhe sot e kësaj dite kriminelët ndaj të cilëve është lëshuar urdhër arrestimi na shëtisin nëpër vend. Unë i kam parë kriminelët që janë në listën e të kërkuarve të ulur në tavolinë në bar.

Po, është vështirë, por çfarë na duhet që të lëvizim kah e mira?

Çfarë na duhet? Që të vetëdijësohen, sepse nga poshtë nuk mund të bëhet asgjë, nga poshtë mund të bëhet vetëm revolucioni, kurse ai nuk na duhet, mendoj, mua personalisht. Unë kam disa bindje anarkike dhe tash them se shteti është e keqja më e madhe që i ka ndodhur njeriut dhe si i tillë nuk duhet të ekzistojë. Fatkeqësisht, ajo që na duhet neve nuk e shoh si kapacitet tek ata që na drejtojnë. Nëse urreheni edhe tani, ndoshta për pesë vjet do t'ju ndodhë e njëjta gjë. D.m.th. të punohet në parandalim. Ne nuk punojmë në parandalim. Fatkeqësisht, ne nuk jemi në fazën që të punojmë në parandalim. Mund të punojmë me të rinj, me fëmijë, por parandalimi... Me të rritur nuk duhet të punohet në parandalim, por duhet të shërohen. Do të thotë, për çdo ditë ata që udhëheqin politikën, ata që drejtojnë gazetatat, televizionet, duhet të mendojnë, të shikohen në pasqyrë dhe ta pyesin veten: çfarë duhet të bëj që ky shtet të jetë më i mirë, e jo çfarë duhet të bëj për të mbushur xhepin tim. Puno diçka, ke mundësi, tani ke mundësi. Ndoshta më parë nuk e ke pasur mundësinë, por tani e ke. Ke përgjegjësi. Dy milionë njerëz të shikojnë. Duhet të punosh në këtë.

L. G.

Kemi për çfarë të turpërohemi

A i ndieni edhe më tutje pasojat e luftës dhe në çfarë përmasash?

Të gjithë i ndiejmë dhe do t'i ndiejmë gjithnjë edhe për shumë kohë. Shumë njerëz janë vrarë, janë plagosur, janë invalidë. Shumë shtëpi, objekte dhe pasuri të tjera janë shkatërruar, shumë martesë janë shkurorëzuar, shumë miqësi janë prishur, janë ndërprerë shumë lidhje midis njerëzve, familjet janë ndarë, shumë njerëz për të mbijetuar kanë ndërruar emrin, mbiemrin, fenë dhe kombësinë. Shumë kanë mbetur pa punë vetëm pse janë të një feje apo nacionaliteti tjetër. Gjoja në suaza ligjore dhe nën patronazhin e partisë së atëhershme në pushtet BDK (HDZ) në Kroaci është bërë i ashtuquajti transformim dhe privatizim, që në të vërtetë është vetëm emër tjetër për plaçkitjen dhe grabitjen më të madhe të pasurisë me vlerë të jashtëzakonshme, të krijuar në Republikën e Kroacisë në 45 vjetët e fundit, nga viti 1945 deri në vitin 1990, edhe pse të gjithë kanë thënë se sistemi i mëparshëm nuk ka pasur vlerë.

Çfarë do të duhej të ndodhte që këto pasoja së paku të zbuteshin?

Do të na duhej një magjistar i mirë, shumë më i mirë sesa David Koperfildi, që të përmirësohej kjo gjendje. Kjo më ngjan në provën që pastën e nxjerrur të dhëmbëve të provojmë ta kthejmë, ta fusim mbrapa në tubë, gjë që është praktikisht e pamundur. Nga kjo që thashë shihet qartë se janë grumbulluar shumë gjëra të cilat nuk mund të zgjidhen brenda një kohe të shkurtër. Natyrisht se nuk është i mundur kthimi në vitin 1990, por me zgjidhjen e problemeve *one by one* apo *step by step* do të mund të tejkalohen edhe këto probleme. Por, duhet kohë, shumë kohë. Mirëpo, kush ka kohë të presë? Të gjithë jemi të vdekur në një afat të gjatë. Me zhvillimin e civilizimit, demokracisë dhe shoqërisë civile në hapësirat e ish-Jugosllavisë, problemet e krijuara mund të zgjidhen në një afat të gjatë, nëse jo për gjeneratat e sotshme, atëherë për ato të ardhshme.

A është zgjidhje pajtimi? Çfarë është për ju në të vërtetë pajtimi?

Pajtimi është pranimi i të vërtetës mbi rolin e vërtetë të “tanëve” dhe të “tyreve” në ngjarjet e këtyre 15 vjetëve. Ashtu sikurse për dashuri, ashtu edhe për luftë duhen dy palë. Ose një dinar kurrë nuk tingëllon në dorë. Pajtimi është njëfarë ardhjeje në vetvete për rolin negativ “të tanëve” dhe rolin pozitiv “të atyre”. Ai është pranimi se edhe “tanët” kanë bërë punë të këqija, krime dhe se kemi për çfarë të turpërohemi. Duhet të kuptojmë dhe të themi haptas, çdo individ, se kjo nuk është bërë në emër të tij dhe se ai nuk e ka kërkuar këtë. Vetëm kështu mund të “zhveshet” faji kolektiv, kurse në erë do të mbesin ata që kanë menduar se do t'i ndërtojnë karrierat e tyre të “suksesshme” duke vrarë nevojtarët, pleqtë, gratë dhe fëmijët. Këta janë ata guximtarët nga prapavija të cilët vijën e parë të fronit as që e kanë nuhat. Kur ta bëjnë këtë të gjithë popujt që kanë marrë pjesë në konflikte, kur të gjithë t'i gjykojnë djelmoshat e tyre të këqinj, do të mund të flasim për pajtimin.

Përveç kësaj që theksuat, çfarë nevojitet tjetër për arritjen e pajtimit?

Nevojitet vullneti dhe dëshira e madhe për pajtim, duhet të shikohet me kujdes

Do të na duhej një magjistar i mirë, shumë më i mirë sesa David Koperfildi, që të përmirësohej kjo gjendje. Kjo më ngjan në provën që pastën e nxjerrur të dhëmbëve të provojmë ta kthejmë, ta fusim mbrapa në tubë, gjë që është praktikisht e pamundur. Natyrisht se nuk është i mundur kthimi në vitin 1990, por me zgjidhjen e problemeve *one by one* apo *step by step* do të mund të tejkalohen edhe këto probleme. Por, duhet kohë, shumë kohë. Mirëpo, kush ka kohë të presë? Të gjithë jemi të vdekur në një afat të gjatë.

Pajtimi është njëfarë ardhjeje në vetvete për rolin negativ “të tanëve” dhe rolit pozitiv “të atyre”.

Ai është pranimi se edhe “tanët” kanë bërë punë të këqija, krime dhe se kemi për çfarë të turpërohemi. Duhet të kuptojmë dhe të themi haptas, çdo individ, se kjo nuk është bërë në emër të tij dhe se ai nuk e ka kërkuar këtë. Vetëm kështu mund të “zhveshet” fajti kolektiv.

gjendja e tashme dhe të shohim se jemi fqinj, se jetojmë njëri pranë tjetrit dhe se, me sa duket, ky është fati ynë dhe se një ditë të bukur, ndoshta edhe më parë, do të jetojmë përsëri bashkë në Evropën e bashkuar, do të udhëtojmë si dikur në RSFJ, pa kufij. Atëherë ndoshta edhe qenve të luftës do t’ju vijë nga prapanica në kokë se në fillim të viteve ’90 kanë zgjedhur rrugën më të vështirë.

Kush duhet të punojë në procesin e pajtimit?

Çdo individ do të duhej të nisej nga vetja. Po ashtu edhe partitë politike qytetare, të gjithë politikanët, bashkësia ndërkombëtare, por më së shumti organizatat joqeveritare, jopolitike, jofitimprurëse, institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile etj. Që të arrihet pajtimi do të duhet kohë dhe ndihmë e gjerë. Do të ishte mirë të shfrytëzohen përvojat e luftëtarëve antifashistë nga Lufta e Dytë Botërore.

Cilat janë ankthet tuaja lidhur me pajtimin?

Nuk kam ankthe të posaçme lidhur me pajtimin, por vazhdimisht tek njerëzit do të ekzistojë frika për atë se a mendon pala tjetër seriozisht apo vetëm flet ashtu; një gjë flet, ndryshe mendon, kurse krejt ndryshe vepron. Kjo frikë mund të përjashtohet nëse vërtetohemi se pala tjetër i arsyeton fjalët e saj me veprime konkrete. Por edhe ne duhet në praktikë t’i dëshmojmë palës tjetër se mendojmë seriozisht. Duhet pasur ndërmend se në këtë rast besimi krijohet shumë vështirë, kurse humbet shumë lehtë.

A mendoni se njerëzit në vendin tuaj janë të gatshëm për t’u pajtuar?

Nuk jam aq i sigurt se njerëzit në Kroaci, këtu mendoj ekskluzivisht për popullin shumicë, e dëshirojnë pajtimin dhe se për këtë janë të gatshëm. Kjo mund të vërehet në raportin e pushtetit ndaj pakicave nacionale, veçanërisht serbëve. Ata gjithnjë diskriminohen në të gjitha çështjet: kthimi, rindërtimi, dokumentet, të drejtat e strehimit, gati nga çdo shtepi serbe të paktën një anëtar është i akuzuar për të ashtuquajturin krim lufte. Për krime ndaj serbëve janë dënuar vetëm disa njerëz e edhe atë me dënime të lehta. Për ata nuk ka punë, publikisht thirren me emër e kështu me radhë.

A mendoni se popullit i nevojitet ndjesa e ndonjë udhëheqësi? Cila është në të vërtetë frika lidhur me pajtimin në vendin ku jetoni?

Do të ishte e mirëseardhur ndjesa e disa politikanëve udhëheqës, mirëpo duhet edhe kohë. Pikësëpari do të duhej popullin ta vetëdijësojmë se pjesëtarët e popullit tonë kanë bërë marrëzira, kështu që edhe ne duhet të kërkojmë ndjesë. Atyre duhet mbushur mendja se situata nuk është aspak e thjeshtë, e njëanshme, respektivisht bardhë e zi, se Serbia nuk ka bërë agresion në Kroaci dhe se në rastin e RSFJ-së është bërë fjalë për luftë qytetare, se ka pasur elemente agresioni, por të shuman-shme. Për shembull, për agresion mund të flitet vetëm pas datës 15.01.1992 dhe pas pranimiit ndërkombëtar të Kroacisë, por edhe ushtria kroate ka qenë në Bosnje dhe Hercegovinë në kohën e përlëshjeve të kroatëve dhe muslimanëve. Më tej, Kroacia i ka lejuar të fluturojnë mbi territorin e saj aeroplanët e NATO-s, kur ata kanë bombarduar Serbinë dhe Malin e Zi, gjë që sipas të drejtës ndërkombëtare përbën po ashtu akt agresioni. Domethënë duhet t’i vetëdijësojmë pjesëtarët e kombit të vet se edhe nga pala tjetër nënat, motrat dhe gratë kanë qenë të mbështjellura në të zeza. Më duket se populli kroat frikohet nga ajo me të cilën e kanë frikësuar nacionalistët – panserbizmi, dominimi serb dhe se gjithnjë janë për atë kursin nga vitet ’90: portofoli kroat në xhepin kroat, litari kroat në krahët kroatë dhe kroati Zot në

shtëpinë e vet. Në shumë veprime mund të dëgjoni njerëzit duke thënë se nuk është me rëndësi pse gjendja ekonomike është e keqe, por është me rëndësi të kenë shtetin e tyre kroat, andaj nëse duhet – edhe bar do të hanë. Për këtë nuk duhet çuditur që Tugjmani i ka quajtur kafshë me dhëmb të imët. Unë nuk ha bar, as që do ta ha, kurse nga vetë shteti nuk kam kurrfarë levërdie, por përkundrazi.

Do t'i rikthehemi pajtimit. Çfarë mund të bëjnë në këtë fushë “njerëzit e zakonshëm”?

Frikohem, shumë pak, sepse ata edhe ashtu nuk i pyet askush për asgjë. Veç kësaj nuk ekziston dëshira që të ndriçohen ngjarjet e 15 viteve të kaluara. Politikanët vetëm i hutojnë me fushatat parazgjedhore. Derisa të mos shohin vetë se elitat politike i kanë përdorur për interesat e tyre nuk do të ketë sukses. Ne njerëzit duhet ta shpjegojmë se çfarë ka ndodhur vërtetë, cilat janë arsyet, shkaqet dhe pasojat e shkatërrimit të RSFJ-së, kush ka qenë në çfarë mënyre i përfshirë në këtë etj. Këtu është shumë i rëndësishëm roli i institucioneve të shoqërisë civile.

A duhet të ekzistojë ndonjë dallim në qasjen ndaj pajtimit midis shteteve të cilat kanë qenë në luftë? Dhe cili shtet do të duhej ta fillojë më intensivisht këtë proces?

Të gjithë do të duhej që së pari ta shikojnë situatën në mënyrë objektive dhe ta pastrojnë atë para dyerve të veta. Të tregojnë vullnet të mirë, të mësojnë nga gabimet, të pranojnë pjesën e vet të fajit, e jo vetëm të akuzojnë të tjerët. Kur ta bëjë këtë njëra palë, nuk ka rëndësi se cila, shembullin e saj do ta ndjekin edhe të tjerët. Vetëm kush do ta marrë guximin, edhe do të fillojë të pastrojë para pragut të vet? Kush do ta bëjë këtë hap, nuk e di. Me sa duket asnjëra palë nuk është e gatshme për një gjë të tillë. Më duket se në të gjitha këto shtete fjalën kryesore e kanë ende ekstremistët dhe radikalët dhe se politikanët dhe pushteti trembet nga ata në njëfarë mënyre. Nuk ka rëndësi se kush do t'i bëjë hapat e parë të vërtetë drejt pajtimit, por me rëndësi është që kjo të ndodhë. Ndoshta e ka më të thjeshtë të fillojë ai shtet në të cilin vetëdija dhe demokracia janë në nivel më të lartë. Por është vështirë të vlerësohet se cili është ai.

Kur të ndodhë kjo, çfarë do të ndryshojë për Ju? Çfarë ndryshimi do të shfaqet për vendin tuaj?

Pajtimi nuk është akt afatshkurtër – tani jemi pajtuar dhe që tani në mes nesh vlejné rregulla dhe raporte tjera. Pajtimi është proces i cili zgjat shumë kohë dhe gjithmonë do të ketë asosh që nuk do të pajtohen. Por nëse do të ndodhë pajtimi, ky do të ishte një lehtësim për të gjithë ne dhe atë në të gjitha segmentet e jetës. Më së shumti do të përfitonin pakicat në vendet tjera, për shembull serbët në Kroaci, kroatët në Serbi. Do të zhvillohej dhe do të përmirësohej situata ekonomike në ato vende, do të zvogëlohej papunësia, do të përmirësohej standardi i jetesës. Bashkëpunimi midis shteteve të ish-RSFJ është në të vërtetë një shkollë e vogël, praktikë dhe përgatitje për marrëdhëniet që vlejné në BE. Ato shtete duhet të mësojnë të sillen ndërmjet vete ashtu siç do të duhet të sillen një ditë në BE.

Kjo është e ardhmja, por më thoni, si të veprojmë ndaj të kaluarës?

E kaluara nuk mund të ndryshohet, pandaj atë duhet pranuar ashtu siç është dhe ta shqyrtojmë në mënyrë kritike me qëllim që të nxjerrim mësim të caktuar dhe të mos përsëriten gabimet. Por, në këtë nuk ka pasur sukses asnjë gjeneratë e llojit njerëzor. Historia ka dëshmuar se gabimet përsëriten. Fajtorët për krime duhet të

Duhet t'i vetëdijësojmë pjesëtarët e kombit të vet se edhe nga pala tjetër nënat, motrat dhe gratë kanë qenë të mbështjellura në të zeza.

dënohen individualisht. Kjo duhet të jetë vërejtje për popujt tjerë, por po ashtu edhe për popullin e vet. Ndoshta për model do të na shërbenin gjermanët, të cilët çdo shfaqje të fashizmit e presin në rrënjë.

A është të falurit zgjidhje?

Duhet falur, por nuk duhet harruar. Pikërisht për faktin që të mos ndodhë diçka e ngjashme. Sikur të harronim, shumë lehtë do të mund të paraqitej Hitleri i ri, kam-pet e përqendrimit, Jasenovci, por edhe Srebrenica, Vukovari, Shkabrnja, Fusha e Pakracit, Gosipi, Karlobagu...

Cilës palë i takon faji ose pjesa më e madhe e tij?

Faji nuk është vetëm i njëjës palë. Asnjëra palë nuk ka dalë e pastër nga konflikti në trevat e ish- RSFJ-së. Secila palë ka gjalpë në kokë. Sllovenia dhe Kroacia janë ndarë me luftë. Serbia, e personifikuar me figurën dhe (jo)veprën e Slobodan Milo-sheviqit nuk e ka çarë po ashtu kokën për Jugosllavinë. Të gjithë e kanë sulmuar Ante Markoviqin, forcën e fundit kohezive të RSFJ-së, e kanë shkatërruar reformën e tij. Tugjmanit i ka penguar teprica e serbëve në Republikën e Kroacisë, kurse Mi-llosheviqit i kanë munguar serbë në Kosovë, prandaj marrëveshja e tyre në Kara-gjorgjevo ka përcaktuar fatin e banorëve të ish-Jugosllavisë. Kontributin e vet e ka dhënë gjithashtu edhe Alija Izetbegoviqi. Këto janë vetëm disa nga tezat, sepse është e pamundur të përgjigjesh në mënyrë sipërfaqësore në këtë pyetje komplekse.

A është faji atëherë kolektiv?

Vështirë është të flitet për fajin kolektiv, sepse ai në të vërtetë nuk ekziston. Faji është individual. Megjithatë, elitat politike kanë arritur të mobilizojnë dhe homogje-nizojnë pjesën më të madhe të popullatës të shtetit të vet rreth disa ideve të dyshi-mta. Se ku e ka çuar Kroacinë politika e Tugjmanit është e njohur, ashtu sikurse dihet se ku e ka çuar Millosheviqi Serbinë. Por ata kanë qenë disa herë të zgjedhur në mënyrë legale dhe legjitime si udhëheqës të shteteve të tyre. Sipas kësaj logjike, për statusin e tanishëm të tyre të keq do të mund të ishin fajtorë edhe vetë zgjedhë-sit. Kroacia është shkatërruar ekonomikisht dhe politikisht, kurse me sa di unë, gjendja në Serbi është edhe më e keqe.

Cila është përgjegjësia juaj?

E kam sqaruar se cila është përgjegjësia e njeriut të “vogël”, votuesve, nëse shikoj-më në atë kontekstin e gjerë. Unë personalisht kam dalur në të gjitha zgjedhjet dhe gjithmonë kam votuar për opsionin e majtë, për paqe, bashkëjetesë, vëllazërim dhe bashkim, barazi. Këto janë idetë për të cilat kam luftuar me votën time. Por, shumic-a ka dashur ndryshe, kurse ne kemi qenë pak. Gjithmonë përmes veprimtarisë sime jam angazhuar për objektivitet, saktësi, qetësimin e tensioneve, por me këtë që në vitet '90 i kam rënë në sy pushtetit të ri, kështu që në vitin 1991 më kanë përjashtuar nga puna dhe në këtë mënyrë më është pamundësuar veprimi i mëtejshëm.

Cila është në përgjithësi përgjegjësia e “njeriut të zakonshëm”?

Ajo mund të jetë në atë se nuk ka menduar me kokën e vet, pse ka lejuar të mashtrohet dhe ka votuar për premtimet mbi të nesërmen më të mirë. Për shkak se ka rënë në rrethin e nacionalizmit dhe nacionalistëve. Për arsye se për problemet e tij, fajtorë kanë qenë serbët dhe kroatët, kurse nuk e ka kuptuar se po e shfrytëzoj-në dhe po e shkatërrojnë elitat e tij politike. Por në vendet ku përqindja e analfabe-

tëve dhe e atyre me shkollë fillore është e madhe, ku TV nacional është e vetmja lekturë, as që ka mundur të pritët diçka më e mirë.

Kush është atëherë viktimë e luftës?

Të gjithë janë viktima, përveç, natyrisht, elitave politike, por meqë në natyrë ekziston baraspesha, edhe ato elita politike do ta paguajnë heret a vonë faturën për gjithçka që kanë bërë keq dhe me qëllim. Në luftën qytetare të gjithë qytetarët janë viktima.

A janë njerëzit pjesërisht përgjegjës për shkak se i janë nënshtruar manipulimit? A kanë mundur t'i rezistojnë manipulimit?

Njerëzit në Republikën e Kroacisë i janë nënshtruar mjaft manipulimit. Rol të veçantë negativ në këtë drejtim ka luajtur televizioni kroat. Në të ka qenë shpesh e prani-shme gjuha e urrejtjes, të cilën shumë e kanë provuar në lëkurën e vet. Njerëzit që shikojnë dhe dëgjojnë vetëm njërën palë, do të veprojnë me dëshirën e huaj, që edhe ka qenë qëllimi. Njerëzit nuk kanë qenë të vetëdijshëm se manipulojnë me ta, por me strukturën e dobët arsimore të pjesës dërmuese të popullatës, me përkrahjen politike të manipulimit mediatic, ia kanë arritur lehtë qëllimit. Mediat kanë dhënë informacione “sipas nevojës”, kështu që në këtë mënyrë i kanë mashtruar njerëzit, kurse mbi bazën e informacioneve të rrejshme njerëzit i kanë bërë apo nuk i kanë bërë disa gjëra, kështu që në pjesën më të madhe edhe me fajin e vet kanë qenë të manipuluar. Kanë mundur të rezistojnë, por përgjegjësitë e tërësishme nuk u kanë shkuar për dore, as që kanë qenë të vetëdijshëm se me ta dhe në emër të tyre manipulohet.

Çilat janë parashikimet tua për të ardhmen?

Sikurse edhe pas Luftës së Dytë Botërore do të duhet shumë kohë që të ulen tensionet. Pas vitit 1945, nga viti në vit është rritur numri i martesave të përziera, njerëzit gjithnjë e më shumë janë deklaruar si jugosllavë. Besoj se edhe pas këtij konflikti do të ngajë diçka e ngjashme pas 20-30 vjetëve. Ndoshta, madje edhe më parë, sepse besoj se të gjithë do të jemi pjesë e Evropës së bashkuar. Parashikoj se atëherë të gjithë ata që do të kenë dëshirë do të kthehen në vatrat e tyre të vjetra, se gjeneratat e reja do t'i tejkalojnë shumë më lehtë disa probleme dhe se do të arrihet njëfarë pajtimi në një periudhë më të gjatë.

A dëshironi të shtoni diçka në këtë temë?

Tema është mjaft e gjerë dhe është e vështirë që ta përmbledhësh dhe ta shqyrtosh brenda një kufiri normal kohor. Pyetjet tuaja janë mjaft komplekse dhe nga secila do të mund të bëhej një punim i vogël shkencor. Si përfundim mund të thuhet: Pajtimi është proces i cili zgjat dhe do të zgjasë edhe shumë kohë. Gjeneratat që vijnë do të duhet ta marrin këtë barrë mbi vete. Ndihma e bashkësisë ndërkombëtare është e domosdoshme. Krime ka pasur nga të dyja palët, kurse kush do ta bëjë hapin e parë vendimtar në drejtim të pajtimit nuk është aq me rëndësi. Me rëndësi është të ekzistojë vullneti për pajtim midis njerëzve dhe strukturave politike. Rol të rëndësishëm duhet të luajnë edhe bashkësitë fetare dhe institucionet civile. Sporti dhe kultura po e thyejnë të parat akullin dhe kjo jep shpresë. Të pakënaqur, fatkeqësisht, do të ketë gjithmonë, por më duket gjithnjë e më pak. Rroftë pajtimi! Nuk shqetësohem kur më quajnë jugonostalgjik. Nostalgjia është dukuri normale kur vuani për diçka të mirë që nuk ekziston më. Për këtë arsye ju rekomandoj të gjithëve të lexojnë Leksikonin e mitologjisë jugosllave!

Kam frikë nga mungesa e tolerancës dhe diskutimit, kurse kjo është ajo çka na duhet

Lufta ju ka goditur mu në fillim të moshës së tretë, d.m.th. pensionit. Kur është dashur të filloni një jetë të qetë pensionisteje, ndodhi lufta civile. Si ndiheni sot kur e kujtoni atë?

Vështirë, vërtet vështirë. Ka qenë një periudhë pamasë e vështirë e jetës, të cilën nuk kemi mundur as ta paramendojmë. Realizim i një ëndrrë të keqe. Akoma në thellësi të shpirtit i ndiej pasojat e ngjarjeve të viteve '90, mendimet e mia janë akoma intensivisht me të rinjtë të cilët kanë humbur jetën në atë luftën tonë. Mendoj edhe për invalidët e vërtetë të cilët, në kuptimin e plotë të fjalës, luftojnë për ekzistencë. Ato plagë nuk do të shërohen kurrë.

Çka paraqet për Ju në fakt pajtimi dhe a është ai i realizueshëm?

Pajtimi është i nevojshëm. Duhet shtrirë dorën e pajtimit, por assesi dhe kurrë të mos harrohet. Për pajtim është i nevojshëm besimi i mirë dhe fuqia në shpirtin e njeriut që t'i falë të gjitha krimet që kanë ndodhur.

Si mund të arrihet pajtimi?

Së pari duhet të fillojmë të besojmë. Unë besoj në një të nesërme më të mirë, besoj se të gjithë njerëzit nuk kanë qenë kriminelë dhe se jo të gjithë i kanë bërë keq njëri-tjetrit. Besoj se kanë qenë të pafuqishëm dhe se si individë nuk kanë pasur mundësi që të ndryshojnë të keqen që ka mbretëruar.

Pajtoheni se për pajtimin duhet punuar. Cilat hapa tjerë duhet ndërmarrë përveç besimit?

Njerëzit reciprokisht, të gjithë ne, duhet të gjejnë forcë dhe vullnet që të gjejmë një gjuhë të përbashkët dhe të nisemi të gjithë së bashku kah një e nesërme më e mirë.

Cila është frika Juaj lidhur me pajtimin? A keni frikë nga ballafaqimi me të kaluarën?

Kam frikë nga mungesa e tolerancës dhe diskutimit, kurse kjo është ajo çka na duhet. Pajtimin mund t'i kontribuojnë njerëzit e zakonshëm pikërisht me tolerancë, mirësjellje, dialog, takime dhe bisedime.

A mendoni se njerëzit kanë fuqi, janë të gatshëm për pajtim? Sa mund t'i kontribuojnë ata këtij procesi?

Njerëzit e zakonshëm janë individualisht të pafuqishëm, por tek ata ka fuqi dhe vullnet për mirëqenien e të gjithë njerëzve. Njerëzit janë, në fund, gjithmonë të gatshëm që të falin dhe të pajtohen, por për këtë iu duhet kohë, edhe më shumë forcë dhe besim për një të nesërme më të mirë.

Çfarë përfitimi do të kishit Ju dhe populli Juaj sikur të normalizoheshin në tërësi marrëdhëniet?

Bashkë me pajtimin do të vinte për ne edhe një fllad ndriçimi dhe do të merrnim frymë më lirisht të gjithë ne në këtë regjionin tonë. Mendoj se mundemi dhe

Së pari duhet të fillojmë të besojmë. Unë besoj në një të nesërme më të mirë, besoj se të gjithë njerëzit nuk kanë qenë kriminelë dhe se jo të gjithë i kanë bërë keq njëri-tjetrit. Besoj se kanë qenë të pafuqishëm dhe se si individë nuk kanë pasur mundësi që të ndryshojnë të keqen që ka mbretëruar.

duhemi të bashkëpunojmë dhe të gjejmë pikat e përbashkëta të cilat do t'u sjellin mirëqenie të gjithëve.

Cilat janë veprimet që do të duhej t'i bënte shteti Juaj, gjegjësisht veprimet që priten nga vendi me të cilin vendi Juaj ka bërë luftë? Kush do të duhej, sipas Jush, ta zbatonte më intensivisht procesin e pajtimit?

Tek ne kroatët është që të falim, kurse tek ata që të shfaqin keqardhje për të gjitha krimet që kanë bërë. Jeta do ta kryej vetë procesin e pajtimit, sepse njerëzit normalë nuk mund të jetojnë vetëm dhe në urrejtje.

Si të sillemi ndaj të kaluarës? Si të ballafaqohemi me të?

E kaluara është pjesa jonë, nuk guxojmë ta harrojmë, dhe duhet të mbesim pjesë e saj, e jo të ikim nga ajo. Nuk guxojmë kurrsesi të harrojmë sepse e kaluara është udhërrëfyesi ynë për të ardhmen.

A mendoni se faji është vetëm i njërës palë?

Për grindje dhe luftë duhen dy palë, por dikush është gjithmonë megjithatë më shumë fajtor.

A mund të individualizohet faji apo ai është kolektiv?

Duket se është kolektiv, sepse liderët e popullit kanë shkaktuar çmendurinë kolektive dhe e kanë drejtuar popullin në kahje të gabuar.

A ndieni edhe Ju personalisht përgjegjësi?

Jam njeri i "zakonshëm" i cili ka marrë pjesë psikikisht në luftë, por unë nuk e ndiej veten fajtorë për asnjë veprim të gabuar që është bërë gjatë luftës. Kurse faji i popullit është se nuk kemi qenë më të shpejtë në marrjen e vendimeve. Shumë gjatë kemi jetuar në vëllazërim-bashkim, kurse atëherë papritur kemi pasur pak kohë të kuptojmë se çfarë po ndodh mu në fillim të viteve '90.

A ka pasur situata kur edhe "njeriu i zakonshëm" brenda kufijve të mundësive të tij dhe fushëveprimit ka mundur të reagojë dhe me këtë ta reduktojë së paku pjesën e tij të përgjegjësisë?

Ne kemi mundur të bëjmë pak, në të shumtën e herave kemi qenë të pafuqishëm nga frika që ajo më e keqja mund të na ndodhë edhe neve.

Kush është në realitet, sipas Jush, viktimë e gjithë kësaj që ka ndodhur?

Të gjithë, tamam të gjithë njerëzit e zakonshëm që nuk kanë bërë krime.

Cilat janë parashikimet Tuaja për të ardhmen lidhur me këtë bisedë?

Edhe dashuria, edhe urrejtja kanë orbitën e vet të ngritjes dhe rënies, kështu që duhet besuar që ne tani do të nisemi në linjën e ngritjes së dashurisë dhe tolerancës, bile edhe ne që kemi qenë të përfshirë drejtpërdrejt në luftë.

Si do të kishit pasur dëshirë ta përmbyllni këtë bisedë?

Zoti na ruajt nga të gjitha të këqijat dhe lufërat dhe le të na sjellë paqe, lumturi dhe begati të gjithë neve.

E. P.

Kam frikë nga mungesa e tolerancës dhe diskutimit, kurse kjo është ajo çka na duhet. Pajtimin mund t'i kontribuojnë njerëzit e zakonshëm pikërisht me tolerancë, mirësjellje, dialog, takime dhe bisedime.

Ju lutem të prezantoheni?

Kam lindur në Loznicë. Jam 37 vjeç, i papunë. Kam kryer Shkollën e Lartë Elektrike në Suboticë. Në këtë qytet edhe jetoj momentalisht. Çfarë të them më tepër?! Jetoj, por nuk punoj!

A keni ndonjë përvojë nga lufta?

Kam. Në të vërtetë, jo pjesëmarrje të drejtpërdrejtë, por indirekte. Më kanë thirrur në të gjitha luftërat që janë zhvilluar këtu, në territorin tonë. Derisa studioja më kanë thirrur kur ka filluar lufta në Kroaci, në të vërtetë, së pari në Slloveni e pastaj në Kroaci, dhe në këtë luftën e fundit kundër forcave të NATO-s. Ndërkaq, nuk më kanë thirrur në luftën e Bosnjës.

A jeni përgjigjur ndaj të gjitha këtyre thirrjeve?

Po. U jam përgjigjur të gjitha thirrjeve. Në të vërtetë, në fillim, për shkak se studioja këtu, kam tentuar të arsyetohem në llogari të studimeve, por pa sukses, sepse erdhën këtu, më dërguan thirrjen, e unë shkova dhe çdo herë iu përgjigja thirrjes. Kur ka filluar lufta në Slloveni, unë kam qenë në Lloznicë, ku kemi qëndruar rreth 40 ditë. Aty jemi përgatitur se ku do të shkojmë, çfarë po ndodhë, midis vere. Disa morën rrobat e dimrit, disa morën skitë dhe vetëm atëherë e kuptuam se çka po përgatitet, ku duhet të shkojmë... E atëherë populli në Lloznicë filloi të rebelohet. Dhe kur u bëmë gati të nisemi, e gjithë kjo u ndal dhe nuk shkuam. Jo, më falni, ky ka qenë rasti me Kroaci, ndërsa sa i përket Sllovenisë, ishte vetëm një tubim e më pastaj na lëshuan. S'ka qenë asgjë. Ndërkaq, më vonë në Kroaci zhvilluam disa stërvitje, pak kaluam edhe në Bosnjë. Atje patëm disa marshime dhe u kthyem. Kjo zgjati rreth 40 ditë dhe unë isha në kazermë edhe në momentin kur duhej të nisehim, sepse babai veç kishte qenë në front të luftës, vëllai ishte po ashtu në ushtri dhe kur e gjitha plasi, shkova. Kam qenë në Kroaci. Nëna shkroi një lutje për të më liruar dhe atëherë më liruan, kështu që nuk shkova. Grupi im shkoi diku në Sllavoni. Aty qëndruan afro një muaj e gjysmë. Ata u kthyen. Unë erdha sërish për të studiuar dhe kështu... Më pas u lajmërova këtu në Suboticë duke menduar se këtu nuk do të më thërrasin. Por edhe këtu filluan të më thërrasin rregullisht. Në kohën e bombardimeve, që nga fillimi e deri në fund, kam qenë nëpër ferma.

Çili ka qenë disponimi në kohën kur ka filluar lufta?

Disponimi ka qenë njëqind për qind kundër luftës. Domethënë, askush s'ka qenë i disponuar për gjëra të tilla. Madje edhe na kanë ndaluar kur jemi nisur. Krijua kolonën kushedi sa kilometra të gjatë, me armë, me kamionë. Populli doli në rrugë, u mblodh e tërë Lloznica dhe na ndaluan. E ndaluan kolonën, nuk mundëm të kalojmë... Ka pasur këtu mjaft skena të mundimshme, njerëzit shtroheshin nën rrota që të mos kalojmë.

Disponimi ka qenë njëqind kundër luftës.

Domethënë, askush s'ka qenë i disponuar për gjëra të tilla. Madje edhe na kanë ndaluar kur jemi nisur. Krijua kolonën kushedi sa kilometra të gjatë, me armë, me kamionë. Populli doli në rrugë, u mblodh e tërë Lloznica dhe na ndaluan. E ndaluan kolonën, nuk mundëm të kalojmë...

Ka pasur këtu mjaft skena të mundimshme, njerëzit shtroheshin nën rrota që të mos kalojmë.

shtëpi. E gjithë kjo shpërtheu ndoshta rreth 15-20 ditë e pastaj na ftuan përsëri përmes radios të gjithëve që ishim t'i përgjigjemi thirrjes, të shkojmë përsëri. Dhe kështu iu përgjigjëm përsëri thirrjes, të gjithë apo jo nuk e di, dhe atëherë zhvilluam disa stërvitje, kryesisht nëpër Serbi. Bëmë, le të them, një ose dy marshime të vogla në Bosnjë dhe u kthyem mbrapsht. Dhe, në atë kohë kur vërtetë është dashur të shkojmë në luftë, mua më liruan. Unë atëherë kam qenë këtu, nuk kam qenë atje, por ka qenë vëllai im, babai...

Çili është tani disponimi në Lloznicë?

Tash!?... Sikur të mos kishte qenë luftë. Njerëzit nuk bisedojnë më për këtë, jetohet normalisht. Edhe më parë kanë ardhur përplot njerëz në Lloznicë, ku edhe kanë punuar. Tani nuk vijnë aq sa përpara, por nuk e di, edhe sikur të vinin – do të ishte njësoj si përpara. Sikur të mos kishte qenë fare luftë, njerëzit sillen krejt njëjtë.

A bisedohet për ballafaqimin me të kaluarën?

Gjithnjë e më pak. Njerëzit janë të preokupuar me problemet dhe brengat e veta, me këtë situatë në shtet, me papunësinë. Këto tërheqin vëmendjen e shumicës së njerëzve. E kur transmetohet diçka në television, atëherë kthehen pak kujtimet, por, çka di unë, e shoh se aty askush s'ka fituar. Sikur të ishte pyetur populli, ju garantoj se nuk do të kishte ardhur deri tek kjo. Por dikush aty e ka nxitur popullin, pak me propagandë, jo pak, por propaganda këtu ka bërë mjaft punë.

Kush është ai “dikushi”?

Ata të cilët kanë qenë atje lartë në pushtet, ata të cilët tani përgjigjen, të cilët, do të duhej të përgjigjeshin, sikurse edhe ata që nuk përgjigjen, pra që janë të penguar, iu ka penguar vdekja. Ata të cilët i kanë zier të gjitha. Me mua, derisa shkoja në shkollë të mesme, kanë qenë plot muslimanë në shkollë. Unë në atë kohë nuk dija aspak se çka është muslimani. Kështu jam rritur, jam edukuar në mjedisin tim. E kam ditur se ekzistojnë muslimanët, por çka janë ata, për çka dallohen, nuk kam ditur fare. Kur kam shkuar në ushtri, në fillim ka pasur muslimanë, kroatë, sllovenë. Dallimi ishte, çka di unë, në të folur, në një lloj shqiptimi, në gjuhë, tek sllovenët dhe maqedonasit, por dallime të tjera nuk kam bërë. E, në atë kohë, ka filluar të ndodhë ajo, të zihet, të bëhet propagandë. Vetëm atëherë e kam ditur se kush është serb dhe çfarë është serbi, çfarë është kroat, çfarë është muslimani. Domethënë deri në atë kohë, i këtillë ka qenë mjedisi, kështu kemi jetuar. Ndoshta njerëzit e vjetër e kanë ditur këtë, ndërsa unë, atëherë isha 18 vjeç, nuk kam ditur fare për çka dallohem ne nga muslimanët dhe nga kroatët, nga të gjithë të tjerët. Dhe atëherë, vijnë në skenë politikanët që na sollën deri tek e gjithë kjo që po na ndodhë tani.

A është faji individual apo kolektiv?

Faji kolektiv jo, me siguri jo, kurse faji individual po, por dhe ky vetëm i një pjese të vogël njerëzish. Ky numër, me siguri, nuk është i madh. Faji është i atyre që në atë kohë kanë qenë në pushtet. Kur fillon lufta njerëzit sillen ndryshe. Kur përjetohet diçka, njëfarë fatkeqësie, kur dikujt i ndodhë diçka e padëshirueshme në familje, atëherë njeriu nuk mund as të mendojë, atëherë e nxisin emocionet, propaganda e bën të veten. Secili në atë moment është i gatshëm të bëjë diçka që s'do ta bënte para kësaj, sepse e di se si unë i kam përjetuar të gjitha këto kur ka filluar lufta. Kur atje sheh disa vrasje, kur sheh se dikujt ia kanë prerë kokën, dikujt këtë e dikujt atë, dëgjon vetëm nga njëra palë, kurse nga pala tjetër nuk dëgjon asgjë. Dhe ti atëherë, natyrisht, rreshtohesh në atë anë. Në luftë me siguri ka pasur të atillë që

Unë në atë kohë nuk dija aspak se çka është muslimani. Kështu jam rritur, jam edukuar në mjedisin tim. E kam ditur se ekzistojnë muslimanët, por çka janë ata, për çka dallohen, nuk kam ditur fare. Kur kam shkuar në ushtri, në fillim ka pasur muslimanë, kroatë, sllovenë. Dallimi ishte, çka di unë, në të folur, në një lloj shqiptimi, në gjuhë, tek sllovenët dhe maqedonasit, por dallime të tjera nuk kam bërë. E, në atë kohë, ka filluar të ndodhë ajo, të zihet, të bëhet propagandë. Vetëm atëherë e kam ditur se kush është serb dhe çfarë është serbi, çfarë është kroat, çfarë është muslimani.

kanë bërë krime, ndër të gjitha palët, dhe me siguri, në numër të madh, por nuk mund të thuash se të gjithë janë fajtorë dhe se të gjithë duhet të përgjigjen. Kjo sigurisht nuk është përgjegjësi kolektive.

A mendoni se procesi i ballafaqimit me të kaluarën po ecen tek ne siç duhet?

Mendoj se nuk po shkon siç duhet. E gjithë kjo, për mendimin tim, po shkon ngadalë. Tani po e shfaqin ngapak, ja e shfaqën Srebrenicën. Kushedi, ndoshta tanët, s'do ta paraqisnin fare, por... E gjithë kjo shkon ngadalë, të gjitha i pamë njëanshëm, sikurse me siguri edhe palët tjera – kroatët çka u prezantuan të vetëve, muslimanët po ashtu. Kjo është me siguri kudo njësoj. Edhe tek ne janë shfaqur vetëm viktimat tona, domethënë viktimat ka patur gjithkund dhe normalisht secili që ka bërë krime duhet të përgjigjet.

Çfarë është për ty ballafaqimi me të kaluarën? Si e kupton ti atë?

Si diçka që nuk duhet të përsëritet më. Ajo që ka qenë më parë, që na ka ndodhur, të mos përsëritet më, sepse askush nga kjo nuk ka pasur dobi. Lufta nuk sjell asgjë të mirë, përveç ndoshta disa individëve, profiterëve të luftës. Gjëra të këtilla ka në çdo luftë, por tash askush prej nesh nuk jeton më mirë seç ka jetuar në atë kohë. Sllovenët ndoshta, ata luftën e kanë përfunduar shpejt, kanë shkuar në rrugë të vet, kurse këta të tjerët, ju garantoj se të gjithë kanë jetuar më mirë përpara seç jetojnë tash. Unë e di për vete se kam jetuar më mirë, shumë më mirë se tash.

Mendon para luftës?

Po, para luftës. Nuk kam pasur kurrfarë brengash, nuk kam menduar se si të ushqej vetveten, e lëre më krijimin e familjes. Për këtë të fundit gati edhe s'mendoj fare.

A ndien një pjesë të përgjegjësisë?

Nuk e di... Koha ka qenë e atillë që më është dashur t'i përgjigjem thirrjes, në të kundërtën do të më kapnin dhe do të më çonin në gjykatën ushtarake dhe kushedi se çfarë sanksionesh do të kisha pasur. Jam përgjigjur thirrjes sepse këtë e kam pasur detyrim – në ushtri betohesh në diçka, se do të bësh këtë e atë. Dhe erdhi koha që t'iu përgjigjesh atyre thirrjeve, e unë iu përgjigja. Shumë njerëz i janë përgjigjur thirrjes nga frika. Tani, aty me siguri ka pasur edhe vullnetarë, të cilët... Propaganda e ka bërë të veten që ai të jetë vullnetar, që ai të mendojë se është e drejtë pse ka shkuar atje, kushedi pse të luftojë, të vdesë, të vrasë. Me siguri një përqindje e madhe e atyre njerëzve që kanë shkuar vullnetarë në luftë e kanë kuptuar më vonë se çka është dhe si është ajo. Ata me siguri tash, Zoti mos e dhashtë të ndodhë më, do të mendonin ndryshe.

Në çfarë mendon kur thua “propagandë”?

Mendoj në media, televizioni, radio, shtypi. Domethënë krejt çka ka ndodhur në atë kohë ka qenë e preokupuar me këtë, pra është shikuar se kush çka ka punuar. Në të vërtetë, askush nuk ka punuar asgjë. Të gjithë kanë shikuar televizionin se çka po ndodhë atje, se çka po ndodhë tek ne.

Sa janë mediat objektive sipas Jush?

Janë objektive, por jo aq sa do të duhej të ishin. Edhe më tutje gjithkund, shikoj këtu kanalet televizive të Kroacisë, Bosnjës, të gjitha ato i shikojnë nga këndi i vet. Domethënë secili mendon se ai është viktimë, se pala e tij është viktimë, se të tjerët janë fajtorë. Edhe tek ne ka lëvizje të tilla të cilat, jo se nuk dëshmojnë, por duan të paraqesin se nuk është vetëm njëra palë viktimë ose dy apo tri, por të gjithë jemi

viktimë, të gjithë jemi fajtorë për atë çka na ka ndodhur. Fajtorë me siguri jemi edhe ne të gjithë, por shumë më pak se disa nga ata njerëz...

Kur flasim për popuj, respektivisht për ish-republikat jugosllave, shtetet e tashme, a ka më shumë apo më pak fajtorë dhe viktime të mëdha apo të vogla?

Nuk e di. Me siguri ka, por kush mund ta dokumentojë këtë tani? Ne as sot, dhe kushedi se sa vjet duhet të kalojnë që ne ta dimë të vërtetën. Ndoshta kurrë s'do ta dimë. Në çdo luftë fituesi shkruan historinë dhe ti mëson se kjo ka qenë kështu. E tash kushedi se a ka qenë ashtu? Domethënë, unë mund të flas për atë që unë di, çfarë unë kam përjetuar, çfarë ka përjetuar vëllai im, i cili ka qenë në frontin e luftës, ka qenë në ushtrinë e rregullt dhe ka shkuar në Kroaci. Atje ka qenë në frontin e luftës, pikërisht në atë vend ku kanë vdekur, aty ku, pasi është tërhequr ushtria në Bosnjë, i kanë sulmuar muslimanët. Karvani i cili ka qenë i siguruar dhe sipas marrëveshjes është dashur të tërhiqet në mënyrë të qetë nga territoret kroate, është sulmuar dhe shumë prej tyre kanë vdekur aty. Një shok i vëllait tim ka vdekur pranë tij. E tani, kur e sheh këtë, vetëm këtë kur e shoh ose vëllai im i cili e ka përjetuar këtë, domethënë ai do ta ketë pamjen dhe përshtypjen se ata të tjerët janë fajtorë. Ai e di për këtë rast, çka i ka ndodhur atij, por nuk di për shumë raste të tjera se çka ka ndodhur, ndoshta në palën tonë ose atë kroate. Pra, gjëra të tilla ka pasur gjithkund. Kur fillon lufta, ajo merr me vete çdo njeri. Njeriu ndryshe, shumë ndryshe, mendon në luftë se sa tani. Në luftë mendon se si të mbetesh i gjallë, të ruash kokën tënde, të ruash farenë, miqtë e tu. Nëse dikujt i ndodhë diçka, atëherë njeriu e humb kontrollin dhe vështirë është t'i mbushësh mendjen.

Çka do të thotë për ty pajtimi?

Pajtimi? Vështirë do të arrihet pajtimi tek ne, do të duhet të kalojë edhe shumë kohë. Njerëzit vështirë do t'i harrojnë viktimat e rëna. Ai që nuk e ka provuar në lëkurën e tij, ai do të harrojë. Kush e ka provuar në lëkurën e tij, për Zotin, do të duhet të kalojë edhe shumë kohë, kushedi, ndoshta duhet të kalojnë edhe disa gjenerata që e gjithë kjo të harrohet. Për pajtimin duhet të punojmë, të bashkëpunojmë në fusha të ndryshme, ekonomike, kulturore. Ajo çka ka qenë më përpara, me siguri nuk do të jetë kurrë më, por secili duhet të jetojë për vete dhe të bashkëpunojmë. Kjo është ajo...

Po “njerëzit e thjeshtë”?

Njerëzit e thjeshtë? Nuk e di. Ja, unë singërisht bisedoj për të gjitha këto dhe për shumëçka që ka ndodhur, kështu që as unë nuk besoj në shumë gjëra. Unë, për shembull, nuk do të merrja guximin të shkoj vetëm në Kroaci. Ende nuk do të guxoja. Unë i them dhëndërrit dhe motrës sime, kur vijnë nga Zvicra, se e kanë më afër përmes Kroacisë. Më vonë kur mendoj se a do të guxoja unë të vij me fëmijë, kushedi se çfarë ekstremistësh ka ende atje, çka mund të ndodhë, kush i garanton se do të kalojë i sigurt. Njerëzit lëvizin, shkojnë e vijnë nga Kroacia. Këtu askujt nuk i ka ndodhur gjë. Tanët shkojnë atje, por akoma... Unë mendoj se gjithnjë ekziston diçka në ajër që fatkeqësisht na ndanë. Tani, sa kohë do të kalojë që njerëzit t'i harrojnë të gjitha këto dhe që gjithçka të kthehet siç ka qenë më parë – vërtetë nuk e di.

Kush mendon se mund të jetë bartës i procesit të pajtimit, ballafaqimit me të kaluarën? Kush duhet ta iniciojë këtë?

Të gjithë duhet ta iniciojmë këtë, por rolin më të madh mund ta luajnë edhe sot

politikanët, sepse ata janë më të pranishëm në të gjitha mediat. Ata i dëgjojmë dhe i shohim çdo ditë. Çfarë mundem unë tani, ku mund të paraqitem unë? Edhe nëse them diçka në një radio apo televizion të vogël, ajo zgjat një ditë dhe ditën e dytë harrohet. Ata që janë çdo ditë në televizion, në shtyp, mund të bëjnë shumëçka. Nuk them se munden të gjithë, por ata munden shumë më tepër, pikërisht për faktin se mediat janë të tilla.

A mund të pajtohem nëse nuk ballafaqohemi me të kaluarën?

Vështirë. Duhet të themi qartë se kush ka qenë dhe fajtorët të përgjigjen. Kushdo që është fajtor, nga cilado palë qoftë, duhet të përgjigjet për atë çka ka bërë. Derisa dikush të jetë në liri e ka bërë gjëra të tilla, nuk do të ketë pajtim. Domethënë të gjithë duhet të jenë atje ku e kanë vendin.

A ka ndonjë pengesë tjetër konkrete, përveç kësaj, në rrugën drejt pajtimit?

Kurdo që të pajtohem, nëse pajtohem, me siguri, nuk do të jetë më si përpara. Shumë njerëz nëse duan të martohen me dikë të nacionalitetit tjetër, do të mendojnë shumë më tepër për këtë se sa më parë. I tillë ka qenë mjedisi tek ne, nuk është shumëncional si në Vojvodinë. Ka pasur edhe kombësi të tjera, por shumë më pak dhe nuk i është kushtuar vëmendje aspak se kush me kë po martohet, cilës fe i takon, i cilit komb je, por vetëm kush të pëlqen – me atë je martuar. Ndërsa tani është pak më ndryshe, sepse çdonjëri ka nga një përvojë të hidhur nga këto luftëra. Shumë martesë janë shkatërruar mu për shkak se janë të feve të ndryshme. Shumë fëmijë kanë mbetur pa babë ose nënë, kështu që unë tash shumë vështirë do të martohesha me dikë të kombësisë tjetër se sa para luftës – për shkaqe objektive. Ajo që na ka ndodhur – shpresoj të mos përsëritet më. Ndoshta s'do të ndodhë.

Cila është ardhmëria jonë?

Of! Me siguri nuk do ta kemi të bukur. Duhet të kalojnë edhe shumë vite. Ne, së pari, duhet ta ndryshojmë mentalitetin tonë, për ç'gjë duhet mjaft kohë. Duhet ngritur këtë shtet pas këtyre luftërave të forta, pas aq shkatërimesh, dhe për këtë duhet shumë kohë. Nuk shoh se për një 10 vjet do të jetë më mirë. Do të jetë ashtu siç është sot. Nuk shoh për ne ardhmëri të bukur edhe shumë kohë. Parulla: "gjeju vetë". Kështu është tani këtu. Askush nuk do të të ndihmojë nëse nuk i ndihmon vetvetes. Askush nuk të ofron asgjë, askush nuk të kujton për asgjë, shumë njerëz kanë mbetur invalidë në këtë luftë, tash askush nuk e kthen vëmendjen nga ata. E kur i përmendëm këta njerëz invalidë? A kanë diçka për atë që kanë mbetur invalidë? Jo, nuk kanë! Ndoshta dikush ka fituar pak, por ajo është e parëndësishme. Domethënë kush pret të hajë në sahan të tjetërkujt, mbetet shpesh pa ngrënë.

T. G.

Janë shumë të rëndësishme disa pajtime të vogla

A i ndieni akoma pasojat e luftës? Në çfarë mënyre?

E falënderoj Zotin që në luftë nuk kam humbur askënd prej të afërmve, kështu që pasojat e luftës i ndiej krejt ndryshe nga njerëzit që kanë humbur dikë nga të afërmit. Po, unë i ndiej pasojat, kam fituar “dhembje”, tension të lartë, familja më është shpërndarë në të gjitha anët. Para lufte kam jetuar në sistemin i cili ndoshta na ka penguar, por që të gjithëve në njëfarë mënyre na ka ruajtur. Edhe pas 10 vitesh, ka shumë shkatërrime edhe në mjedis, por edhe në shpirtrat njerëzore – rinia sorollatet pa qëllim dhe është dhënë pas veseve të këqija dhe për to nuk kujdeset askush, përveç ndonjë organizate të huaj, e cila ndoshta edhe iu ndihmon për momentin, por qeverisja jonë për këtë nuk ka veshë.

Çfarë është ajo që Ju do të dëshironi ta ndryshoni? Cilat ndryshime do të sillnin përmirësimin e situatës së tashme për Ju personalisht, por edhe për tërë shoqërinë?

Unë do të doja që fëmijët të shkonin bashkë në shkollë, që rinia të ulej në kafeteri të njëjta, që t'i mbaronin shkollat dhe të punonin çfarë dëshirojnë, që njerëzit të punësoheshin dhe të mos ndahen në “tanët” dhe “të tyret”. Si të arrihet kjo? Edhe për mua kjo është pyetje e vështirë. Mendoj që një kontribut të madh në këtë drejtim mund ta japin shkollat përmes ndryshimit të mënyrës së tyre të punës, pastaj shoqatat sportive, institucionet fetare... Shkollat do të duhej që duke u nisur nga përvoja e organizatave të ndryshme rinore dhe të huaja të organizonin takime midis fëmijëve, që nga ata të shkollës fillore e deri tek ata të shkollës së mesme dhe më të vjetër, të organizonin udhëtime, ndeshje, manifestime të përbashkëta. Ndoshta këto do të mund të jepnin ndonjë kontribut, sidomos nëse këto aksione do të lavdëroheshin, mbështeteshin, ndihmoheshin nga politikanët e spektreve të ndryshme.

Si të ballafaqohemi me të kaluarën? Si të sillemi ndaj saj?

E kaluara është diçka që mbahet mend, sidomos tek ne ku ekzistojnë të kaluara shumë të ndryshme. Falënderoj Zotin që nuk urrej. E respektoj edhe të veten, edhe të huajën, mundohem t'i kuptoj të tjerët, pa e zvogëluar dhembjen e tyre. Përqipem që përmes shembujve të thjeshtë të dëshmoj se nuk ka qenë krejt zi, kështu që shpesh gjatë bisedave përmendim disa gjëra nga koha e luftës që janë shembuj pozitivë në këtë të keqe që ka ndodhur. P.sh. “A të kujtohet ajo shoqja ime e paraluf-tës, ne i kemi dërguar pako me ndihma njëra-tjetrës megjithëse kemi qenë të ndara, ndërsa edhe sot dëgjohe mi shpesh dhe mbajmë korrespondencë”. Ajo po ashtu mund t'i tregojë dikujt shembullin e saj etj. Në qoftë se do të fillonim me fajësime dhe dënime siç bëjnë politikanët nga të gjitha palët, atëherë do të bëhemi njëjtë si ata, pa dëshirë që të ndryshojë diçka.

Cilat janë qëndrimet Tuaja rreth pajtimit? Çfarë është për Ju pajtimi dhe si të arrihet ai?

Përqipem që përmes shembujve të thjeshtë të dëshmoj se nuk ka qenë krejt zi, kështu që shpesh gjatë bisedave përmendim disa gjëra nga koha e luftës që janë shembuj pozitivë në këtë të keqe që ka ndodhur. P.sh. “A të kujtohet ajo shoqja ime e paraluf-tës, ne i kemi dërguar pako me ndihma njëra-tjetrës megjithëse kemi qenë të ndara, ndërsa edhe sot dëgjohe mi shpesh dhe mbajmë korrespondencë”.

Janë shumë të rëndësishme disa pajtime të vogla – takimet gjatë tregëtisë, në treg... Pajtimi nuk mund të arrihet me ligj, por me tolerancë, takime reciproke. Mediat do të mund të bënin shumë në këtë drejtim – sikur mediat të ndryshonin gjuhën e tyre, sikur secili të mos “tërheqte” përsëri në anën e tij, pa marrë parasysh se cila është e vërteta. Tamam njeriu e harron diçka kur përsëri në gazetë apo në TV shfaqen disa imazhe të këqija nga e kaluara, të shoqëruara me interpretime dhe deklarata shumë të këqija, të cilat e kthejnë njeriun sërish në të kaluarën dhe këtë në një mënyrë të keqe. Pajtimi është zgjidhja – njerëzve iu duhet perspektiva, shkollimi, puna, shoqëria. Ajo që për mua është interesante është fakti se në bisedat individuale të gjithë pajtoheni, duheni, e tregojmë të kaluarën në një mënyrë tjetër, ndërsa kur është grupi më i madh çdo gjë ndryshon. Sikur t’i druhemi njëri-tjetrit se çfarë kush do të thotë.

Kush do të duhej të punonte për arritjen e pajtimit?

Veç e kam theksuar se mediat, shkollat do të mund të bënin disa përparime me ndryshimet e vogla në mënyrën e tyre të punës. Përveç tyre, edhe institucionet fetare mendoj se do të mund të bënin diçka. Pasi që tani në shkolla mësohet feja, mendoj që punëtorët fetarë mund të ndihmonin shumë për pajtimin duke u folur fëmijëve për fqinjët në një mënyrë tjetër – që t’i duan të gjithë njerëzit. Ata kur të vinin në shtëpi do t’ua bisedonin këtë familjarëve dhe kështu do të vazhdonte. Po ashtu në objektet fetare të flitet për fqinjët, për njeriun e fesë tjetër me respekt etj. Por ata janë shndërruar në politikanë që përmendin vetëm “të vetët” dhe i ndajnë në “tanët” dhe “të tyret”.

A keni ndonjë frikë kur bëhet fjalë për pajtimin?

Frika ime ka të bëjë me rolin e bashkësisë ndërkombëtare, e cila mendoj se nuk e kupton mentalitetin e popujve tonë. Ne kemi jetuar gjatë në shoqërinë e sunduar nga kulti i personalitetit, ndërsa tani na “lejojnë” njëfarë demokracie. Ne këtë demokraci nuk e kuptojmë dhe e shfrytëzojmë gabimisht.

A mund të bëjnë diçka “njerëzit e vegjël, e thjeshtë”? A mendoni se Ju personalisht mund të bëni diçka?

Personalisht jam për pajtim dhe për këtë punoj ngadalë, por me sukses – shoqërohem me të gjithë në shkollën time, e cila punon si dy shkolla nën një kulm. Fëmijët e mi i kam mësuar që ta duan të veten dhe ta respektojnë të huajën, kështu që në shkollë flas çdo ditë me nxënës për “të tjerët”, i mësoj të dallojnë të mirën dhe të keqen, e jo të bëjnë ndarjen në “tanët” dhe “të tyret”.

A mendoni se njerëzit në vendin tonë janë të gatshëm për t’u pajtuar? A e duan ata pajtimin?

Njerëzit janë të gatshëm për t’u pajtuar, por shumica e tyre megjithatë do të thonë “se është heret”, njëjtë sikur edhe politikanët e tyre. Po ashtu njerëzit nga diaspora, të cilët kënaqen në vendet perëndimore, shpesh neve këtu na fusin shqetësime duke thënë “është e rëndësishme...”. Ata janë shpesh të gatshëm që të hyjnë në konflikte me njerëz me të cilët ne ndërtojmë marrëdhëniet dhe pajtimin duke mos menduar tek ne këtu. Mendoj se njerëzit janë të gatshëm të pajtohen, e duan atë, por mendojnë se është më lehtë kështu – që secili të jetojë në “vathën” e tij. Ndërsa politikanët dhe një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare e përkrahin këtë.

A mendoni se faji është individual apo kolektiv? Cila është përgjegjësia e “njerëzve të thjeshtë” për të gjithë këtë që ka ndodhur?

Të gjitha fajet nuk janë as individuale, as kolektive, por në raste të caktuara janë edhe njëra, edhe tjetra. Përgjegjësia më e madhe iu takon politikanëve dhe partive të tyre. Është e rëndësishme edhe përgjegjësia e mediave, pastaj edhe e punonjësve fetarë. Të gjithë ata ua kanë futur frikën njerëzve të thjeshtë për “ata të tjerët”. Në këtë mënyrë te njerëzit është gjithmonë e pranishme frika nga pala tjetër, e cila tregohet si armik, krijohet frika se lufta do të plasë përsëri. Ndërsa njerëzit e thjeshtë duke votuar për “të tyret” e shtojnë këtë proces të pajtimit. Por për të kaluarën njerëzit “e vegjël, e thjeshtë” nuk janë fajtorë.

Kur flisni për të ardhmen, cilat janë parashikimet Tuaja lidhur me të? Si e shihni procesin e pajtimit në të ardhmen?

E ardhmja e bukur pa gjithë këto ndarje është larg, por do të ekzistojë nëse përsëri nuk shfaqet ndonjë budalla nacionalist. Mendoj se përfundimisht dikush duhet t'i heqë, t'i ndalojë partitë nacionaliste. Ky është një hap që do të kishte domethënie të madhe.

A. G.

E ardhmja e bukur pa gjithë këto ndarje është larg, por do të ekzistojë nëse përsëri nuk shfaqet ndonjë budalla nacionalist. Mendoj se përfundimisht dikush duhet t'i heqë, t'i ndalojë partitë nacionaliste. Ky është një hap që do të kishte domethënie të madhe.

Si e ke përjetuar konfliktin që na ka ndodhur në vitin 2001?

Po, unë personalisht nuk kam qenë aq i befasuar me konfliktin duke i njohur gjërat, jo vetëm tek ne, por edhe më gjerë. Personalisht, nuk jam ndier mirë, sidomos unë që punoj dhe jetoj me maqedonët. Jetoj në komunën me 90 përqind maqedonë dhe nuk jam ndier shumë mirë.

Më thuaj se a i ndien tani, pas katër vjetësh, ende pasojat e atij konflikti?

Po, unë personalisht jam i njëjti edhe pas katër vjetësh, por e ndiej se tek njerëzit, sidomos menjëherë pas konfliktit, ka pasur, si të them, shumë, shumë mosbesim. Edhe pse ky mosbesim ka ekzistuar edhe para luftës, ai është thelluar edhe më tepër pas saj.

Më thuaj, në çfarë drejtimi të orientohe mi dhe në çfarë mënyre të sillemi ndaj këtij mosbesimi që ekziston?

Kjo është një çështje pak e komplikuar sepse, para së gjithash, duhet të kalojë kohë dhe në këtë periudhë kohore pak më të gjatë njerëzit duket të përshtaten në këtë mënyrë të jetesës; d.m.th. t'i pranojnë gjërat si reale, të pranishme dhe atëherë nuk do të ketë problem. Dhe, kuptohet, pushteti duhet të kontribuojë shumë, ai duhet të kontribuojë më së shumti.

A mendon se pajtimi midis, thënë kushtimisht, dy palëve që kanë qenë të përfshira në konflikt është njëri nga drejtimet e qasjes ndaj këtij mosbesimi?

Pajtimi... po, ku ta di. Unë nuk ndiej se jam grindur. Megjithatë, do t'i rikthehem asaj çfarë thashë, pranimi i realitetit, jo vetëm asaj që përbën realitet për palën maqedone, por edhe për palën shqiptare. Pra, realiteti që kjo është Maqedonia, se nuk mund të ndahet dhe se të gjithë duhet të jetojnë dhe të kontribuojnë për të mirën e këtij shteti, gjegjësisht të punojnë së bashku, gjë që besoj se është qëllimi i të gjithëve, respektivisht hyrja në Bashkimin Europian dhe atëherë këto probleme do të jenë më të vogla.

Kush duhet të punojë në këtë proces?

Po që nga koka deri tek thembra, do të thoja, ose që nga qeveria deri tek njeriu më i thjeshtë, të gjithë duhet të kontribuojnë. Ky është zinxhir, hallka kryesore janë ata lartë, por në qoftë se të mungon një unazë, nuk do të funksionojë.

A e sheh diku përgjegjësinë për atë konflikt, për tërë atë situatë?

Përgjigjësi sigurisht që ka, nuk mund të mos ketë. Ashtu siç ka edhe arsye. Por, a janë ato arsye apo shkaqe aq të mëdha sa të ndodhë kjo, këtë nuk e di. Këtë ndoshta mund ta thonë analistët. Sigurisht që para ndonjë konflikti ekziston një periudhë para konfliktit, konflikti dhe periudha pas konfliktit. Sigurisht që periudha para konfliktit është periudhë shumë e rëndësishme. Mjaft konflikteve që kanë ndodhur në Ballkan apo le të themi në Bosnje, Kosovë, Maqedoni dhe në vende tjera, iu ka paraprirë gjithmonë diçka. Edhe pas konfliktit, varësisht nga madhësia e luftës, nëse

Por e ndiej se tek njerëzit, sidomos menjëherë pas konfliktit, ka pasur, si të them, shumë, shumë mosbesim. Edhe pse ky mosbesim ka ekzistuar edhe para luftës, ai është thelluar edhe më tepër pas saj.

ajo ka qenë qytetare, ndëretnike, midis shteteve, madje edhe midis republikave, si të them, varësisht nga kjo vihet deri tek rezultatet, paqja apo marrëveshja. Do të thotë me siguri që më parë diçka nuk ka funksionuar, ndoshta tek shqiptarët, ndoshta tek maqedonët dhe kjo është lënë pas dore dhe është grumbulluar. Për këtë arsye besoj se në të ardhmen nuk do të ketë probleme. Unë jam i bindur se ky konflikt nuk mund të zgjerohet sepse problemet ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonëve nuk kanë qenë aq të mëdha që të kishim një luftë të madhe. Mendoj se kjo ka qenë një luftë e kontrolluar nga disa hallka më të mëdha, kështu që ata e kanë kontrolluar situatën, ata edhe e kanë përfunduar atë.

A e sheh diku fajin apo fajtorët?

Fajtorët ekzistojnë, por nuk mund t'i emërtoj. Nuk do të duhej të hynim shumë në këto analiza, sepse ato do të mund të prodhonin diçka tjetër. Për këtë arsye nuk do të doja. Sigurisht që ka faj dhe fajtorë, nuk mund të mos ketë, por ka nga të dy palët apo edhe nga të tri palët. Megjithatë, askush nuk mund ta pranojë se vetëm ai është fajtor për diçka. Kjo është gjëja e parë. Ndërsa gjëja e dytë, kur të shpërndahej faji, sigurisht që mbi dikë do të bjerë më tepër, kurse te dikush tjetër më pak; me rëndësi është se të gjithë jemi fajtorë dhe që përgjegjësia të pranohet publikisht. Për shembull, ne shqiptarët jemi fajtorë për këtë, maqedonët për këtë, serbët për këtë, për arsye se të gjithë jemi pjesëmarrës në konflikt. Në Maqedoni ndoshta shqiptarët dhe maqedonët, por në Bosnje – serbët, kroatët, boshnjakët dhe ndonjë tjetër, i tretë, siç i quaj unë.

Cili është parashikimi yt për Maqedoninë?

E ardhmja është në Bashkimin Europian. Vërtet, kur ta kesh standardin, punën dhe kur t'i gëzosh të drejtat themelore, jo të drejtat themelore etnike, por ato qytetare, atëherë nuk do të ketë probleme, me të vërtetë për askënd. Dua të të them se jam i bindur që këto probleme nuk do të ekzistojnë absolutisht një ditë, vetëm normalisht që do të duhet kohë. Kur them kohë mendoj në gjenerata, jo për ne. Kur një fëmijë pesëvjeçar do të bëhet 30 vjeç, do të mendojë ndryshe.

L. G.

Askush nuk mund ta pranojë se vetëm ai është fajtor për diçka. Kjo është gjëja e parë. Ndërsa gjëja e dytë, kur të shpërndahej faji, sigurisht që mbi dikë do të bjerë më tepër, kurse te dikush tjetër më pak; me rëndësi është se të gjithë jemi fajtorë dhe që përgjegjësia të pranohet publikisht. Për shembull, ne shqiptarët jemi fajtorë për këtë, maqedonët për këtë, serbët për këtë, për arsye se të gjithë jemi pjesëmarrës në konflikt. Në Maqedoni ndoshta shqiptarët dhe maqedonët, por në Bosnje – serbët, kroatët, boshnjakët dhe ndonjë tjetër, i tretë, siç i quaj unë.

A mund të prezantohesh shkurtimisht?

Unë quhem Milica. Kam lindur në Zenicë në vitin 1953. Aty jam rritur, kam kryer shkollën e mesme dhe kam punuar në Hekuranë 21 vjet. Nga Zenica jemi larguar në vitin 1993 dhe që nga ajo kohë jetojmë në Bijelinë.

Si ka ndikuar tek ti fillimi i luftës në Bosnje e Hercegovinë?

Ashtu si edhe tek pjesa më e madhe e njerëzve që nuk kanë shpresuar fare se do të ndodhë kjo luftë. Unë personalisht nuk e kam ndier se në Zenicë, qytet ku jam rritur dhe shoqëruar tërë jetën time me njerëz të kombësive, feve, madje edhe racave të ndryshme, do të ndodhë lufta. Nuk kam pritur se në një mjedis punëtor, siç ka qenë Zenica, në të cilin kanë ardhur të punojnë njerëz nga të gjitha anët e ish-Jugosllavisë, aty kanë krijuar familje dhe kanë qëndruar të jetojnë... Të gjithë jemi shoqëruar dhe nuk kam pritur se në një mjedis të tillë mund të ndodhë lufta. Mua më ka zënë lufta krejtësisht të papërgatitur dhe kam qenë e shokuar. Nuk e di sesi e kanë pritur të tjerët, por unë fillimin e luftës e kam pritur krejtësisht e papërgatitur.

Sa ka ndikuar ajo që ke përjetuar gjatë luftës në jetën tënde të mëvonshme?

Shumë. Ma ka ndryshuar jetën rrënjësisht... Kur kam pritur se do të filloj të jetoj më bukur, fëmijët janë rritur, kemi pasur vende të mira pune, kemi pasur shtëpi, gjendjen e rregulluar materiale, brenda natës kemi mbetur pa asgjë. Na ka mbetur vetëm jeta, por, në fakt, kjo është ajo më e vlefshmjë.

Sa shpesh mendon sot për periudhën e luftës?

Akoma mendoj shpesh, sidomos për ditët e para të luftës. Shpesh përmendet edhe fillimi i luftës. Por më shpesh se kjo, ne dhe miqtë tonë i kujtojmë kohët tona të bukura para luftës dhe jetën që kemi bërë atëherë.

Familja juaj ka përjetuar momente të vështira gjatë luftës. A ndieni hidhërim kur i kujtoni ato çaste?

Jo, nuk kam ndier hidhërim as atëherë kur ka ndodhur kjo. Kam qenë e zhgënjyer nga miqtë, fqinjët, por asnjëherë nuk ia kam dëshiruar askujt të keqen. Bile as njerëzve që mua dhe familjes time na kanë bërë atë që na kanë bërë, kurrë nuk kam dëshiruar që t'ju përsëritet e keqja. Ndoshta ndonjëherë në afekt kam thënë "Dhashtë Zoti t'i ndodhë edhe atij!", por nuk kam dëshiruar që kjo t'i ndodhë realisht askujt. Kur përmendëm ngjarjet e këqija që na kanë ndodhur mua dhe familjes sime do të doja ta shpjegoja këtë. Asnjëherë me komshinjtë nuk kemi pasur kurrfarë problemesh derisa nuk ka filluar lufta. As që kam pritur se unë personalisht mund të kem probleme. Familja jonë është multi-etnike, në kuptimin e drejtë të fjalës, sepse nga aspekti farefisnor jemi të lidhur me pjesëtarë të kombësive të ndryshme. As unë, as motra ime, nëna, bashkëshorti, nuk kemi besuar se mund të na ndodhë diçka e tillë. Deri në ditën e fatkeqësisë as që kam menduar ndonjëherë se do të mund të largohesha nga Zenica. Derisa një natë persona të panjohur nuk kanë hedhur dinamit në shtëpinë e nënës time. Nëna ime dhe motra, e cila në atë

Kur kemi mbërritur në Zhepçë veç është ndier se situata është e tensionuar dhe strehim na ka ofruar një familje kroate, e cila nuk na ka njohur aspak. Na kanë gjetur në rrugë dhe na kanë pranuar në shtëpi. Nga Zhepça përmes shkëmbimit kemi arritur në Republikën Serbe.

kohë ka pasur 11 vjet, kanë qenë të plagosura rëndë, kurse shtëpia e shkatërruar plotësisht. Vajza ime ka qenë e shëmtuar krejtësisht dhe një kohë nuk kemi ditur se a do të mbijetojë ndopak. Në spitalin e Zenicës i kanë ofruar ndihmën adekuatë dhe mjekët e kanë vendosur në repartin e syve, edhe pse ajo nuk është dashur të vendoset aty duke marrë parasysh plagët e saj. Personeli mjekësor është kujdesur për të. Por nga ajo ditë kur e kam parë të shkatërruar shtëpinë time të lindjes, kam vendosur që unë dhe familja ime të largohemi nga Zenica. Mezi kam pritur që të largohem nga qyteti të cilin e kam dashur si asnjë qytet tjetër në botë dhe në të cilin kam dashur ta kaloj tërë jetën time. Për shkak të të gjithë asaj që ka ndodhur, na është dashur të largohemi nga qyteti. Por duke pasur parasysh se serbët në Zenicë në atë kohë kanë jetuar në geto, nuk ju është lejuar të largohen nga qyteti, kështu që unë me emrin dhe mbiemrin tim nuk kam mundur të largohem nga Zenica.

Si ke arritur të largohesh nga Zenica?

Vështirë. Siç e thashë, serbët e kanë pasur të ndaluar të largohen nga Zenica. Unë e kam lutur shoqen time të punës që të ma japë letërnjoftimin e saj. Ajo ma ka plotësuar dëshirën dhe jam e sigurt se ma ka shpëtuar jetën dhe këtë nuk do t'ia harroj kurrë. Edhe pse ne të dyja nuk përngjajmë aspak, për rojen në barrikadë ka qenë e mjaftueshme të shohë emrin e saj që të më lëshojë. Vajzat e mia kanë udhëtuar me të njëjtin autobus, por të ndara nga unë. Miku i vajzës sime të madhe, një i ri nga Zhepça, musliman, d.m.th. boshnjak, u ka prirë atyre dhe i ka thënë rojes se ato janë kushërirat e tij refugjate nga Vitezi. Bashkëshorti im i ka dhënë të gjitha paratë që kemi pasur për t'i korruptuar pjesëtarët e policisë ushtarake që ta nxjerrin nga Zenica. Kur kemi mbërritur në Zhepçë veç është ndier se situata është e tensionuar dhe strehim na ka ofruar një familje kroate, e cila nuk na ka njohur aspak. Na kanë gjetur në rrugë dhe na kanë pranuar në shtëpi. Nga Zhepça përmes shkëmbimit kemi arritur në Republikën Serbe.

A ka ndryshuar situata në Bosnje e Hercegovinë për të mirë që nga ato ditë të luftës e këndej dhe sa?

Sikur të isha pyetur unë, luftë nuk do të kishte pasur kurrë. Sikur të ishte pyetur pjesa më e madhe e njerëzve, luftë nuk do të kishte pasur. Situata ka ndryshuar. Nga fillimi i luftës e deri tek largimi nga Zenica kam përjetuar dredhi të ndryshme nga ana e kolegëve të punës, duke filluar që nga zemërkeqësitë e vogla e deri tek fyerjet e tmerrshme. Megjithatë, kur kam shkuar për herë të parë në vitin 1996, kam përjetuar që të njëjtit njerëz të më përshëndesin përzemërsisht, të më ftojnë të shkoj tek ata. Kam qenë e shokuar me këtë ndryshim. Ndoshta do të isha ndier më mirë sikur të kishin vazhduar të silleshin ashtu siç janë sjellur në luftë. Tërë atë kohë nuk e kam pasur të qartë sepse unë nuk kam ndryshuar. Sikur edhe më tej të kishin vazhduar ta kthenin kokën në anë të kundërt, së paku do të dija se ku jemi. Do të dëshiroja që njerëzit të ishin më pak dyfytirësh.

Si ndihesh tash kur shkon në Zenicë?

Shkoj rrallë. Me kalimin e kohës kam gjithnjë e më pak dëshirë të shkoj atje. Kur kam ardhur për herë të parë pas luftës në Zenicë, kur i kam parë oxhaqet e hekura-nës, në hyrje të qytetit, lotët kanë filluar të më rrjedhin në mënyrë të pakontrolluar. Vajza ime nuk e ka pasur të qartë se pse qaj, kurse unë e kam ndier veten aq të pikëlluar sa që më është dashur të largohem nga ai qytet. Sa më tepër kohë që kalon, aq më pak e dua. Kurrë nuk do të dëshiroja të kthehesha të jetoj në Zenicë. Kur ka vdekur vajza ime, askush nga miqtë dhe mikeshat e mia të kombësisë boshnjake nuk

Ajo që njerëzit kanë përjetuar gjatë luftës dhe kujtimet e këqija na pengojnë të kthehemi në vendet ku kemi lindur.

ka pyetur për fëmijën tim, as që kanë ardhur të më vizitojnë. Deri në atë kohë të gjitha gëzimet dhe hidhërimet tona i kemi përballuar së bashku. Ndërkaq atëherë askush nuk ka denjuar as që të më telefonojë për të pyetur se si është fëmija im. Në rastin e parë kur janë rivendosur lidhjet telefonike i kam thirrur të gjithë miqtë dhe mikeshat e mia duke menduar se edhe ata mezi presin të më dëgjojnë. Por, megjithëse të gjithëve ju kam dhënë numrin tim, asnjëherë askush nuk më është lajmëruar. I kam marrë dy-tri herë në telefon, por askush nuk më ka telefonuar mbrapa. Sikur motra ime të mos jetonte në Zenicë, kurrë nuk do të dëshiroja të shkoja atje.

A mendon ti, si qytetare e “zakonshme”, kur e shikon situatën në Bosnje e Hercegovinë, se pajtimi është në nivel të kënaqshëm?

Mendoj se nuk është. Ndoshta qytetarët e zakonshëm edhe e duan pajtimin, por mediat dhe politika ndikojnë mjaft në këtë proces. Mediat e nxisin akoma periudhën e luftës, kurse politikanët nuk çajnë kokën fare.

Cili është tani raporti ndërmjet njerëzve të kombësive të ndryshme në Bijelinë?

Mendoj se në Bijelinë nuk ka intolerancë ndëretnike. Kur kam ardhur në Bijelinë, në rrugën tonë të gjithë fqinjët kanë qenë muslimanë. Na kanë ndihmuar që të rregullohem sepse kemi ardhur në Bijelinë pa asgjë. Jemi shoqëruar mirë dhe nuk kemi pasur kurrfarë problemesh as ne me ata, as ata me ne.

Cili ka qenë reagimi yt kur ke dëgjuar se është nënshkruar Marrëveshja e Dejtonit për Paqe?

Kam qenë shumë e gëzuar, madje si idealiste e vërtetë kam menduar se do të fillojë periudha e rindërtimit, siç ka ndodhur pas Luftës së Dytë Botërore. Kam menduar se pas vendosjes së paqes, edhe Bosnja e Hercegovina do të ndërtohet dhe do të përparojë ashtu. Nuk kam pritur se do të vijë deri tek plaçkitja e përgjithshme, se individët do të arrijnë të pasurohen, kurse pjesa më e madhe e popullit do të mbetet e varfër, pa kushte për jetë, pa punë.

A flitni për temën e kthimit me të njohurit dhe miqtë tuaj që bëjnë pjesë në kategorinë e refugjatëve?

Flasim shpesh për këtë, por askush nga miqtë e mi, refugjatë nga Tuzla, Zenica, Travniku, Bugojna,... askush nga ata nuk dëshiron të kthehet në vendin ku ka jetuar para luftës, por të gjithë duan të jetojnë në Republikën Serbe.

Cila mendon se është arsyeja e qëndrimit të tyre të tillë?

Me siguri ekzistenca. E dimë se nëse do të ktheheshim, do të ishim qytetarë të rendit të dytë. As këtu nuk kemi ndonjë punë, por gjendemi disi, kurse atje as kaq nuk do të mund të arrinim. Por, edhe ajo që njerëzit kanë përjetuar gjatë luftës dhe kujtimet e këqija na pengojnë të kthehemi në vendet ku kemi lindur.

Çfarë do të duhej të bëhej tjetër në Bosnje e Hercegovinë që të normalizohen marrëdhëniet njerëzore?

Çfarë do të duhej të bëhej? E përmendëm Dejtonin, ku është nënshkruar se Bosnja e Hercegovina është shtet me dy entitete të barabartë, Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës dhe Republikën Serbe. Mendoj se nuk duhet të preket ai model i Dejtonit dhe se Republika Serbe duhet të qëndrojë si njësi federale në kuadër të Bosnjes dhe Hercegovinës. Kjo do t'i kontribuonte pajtimin, që Republika Serbe ta ruaj statusin që e ka fituar në Dejton, që të jetojmë aty ku dëshirojmë dhe që askush të

mos na imponojë diçka. Presionet e përditshme për zhdukjen e njërit prej entiteteve na kthejnë në fillim të viteve '90. Duhet të jetojmë si fqinj të mirë dhe çdokush të jetojë ku dëshiron dhe në pjesën e tij.

Sa mund të bëjë individi për pajtimin dhe stabilizimin e situatës?

Individi mund të bëjë pak. Sa më përket mua, ky pajtim do të ishte arritur kaherë, por kjo nuk varet nga ne, por është çështje e politikës të cilën ne nuk e kuptojmë. Ndoshta qëllimet e politikës së sotme do t'i zbulojnë vetëm fëmijët dhe nipat e mi.

Kur thuhet pajtim, çfarë kupton me të?

Unë nuk jam me askënd e grindur. Me kë do të duhej unë të pajtohem? Pajtimi për mua është i mjaftueshëm derisa mund të lëvizim lirisht dhe të shoqërohemi me kë dëshirojmë. Unë dhe familja ime edhe veprojmë kështu, për ne nuk është akoma e rëndësishme se cilit komb dhe racë i përket dikush. Njeriun e vlerësojmë në bazë të vetive të tij njerëzore që posedon. Sa më përket mua, pajtimi është arritur. Nuk kam mëri me askënd, të gjithë njerëzit janë për mua të dashur, njerëzit e këqinj nuk i urrej, por edhe nuk i dua.

Si e sheh të ardhmen e Bosnjes dhe Hercegovinës?

Uhh... Të zezë. Çdo gjë po shkatërrohet, nuk ka kurrfarë përparimi... Më vjen keq për fëmijët e mi sepse nuk jam e sigurt se edhe ata do të arrijnë ta fitojnë pensionin në Bosnje dhe Hercegovinë, ndërsa për veten dyshoj se do ta arrij këtë. Njerëzit jetojnë vështirë dhe mezi arrijnë të fitojnë për të mbijetuar, kurse asgjë nuk po shkon kah e mira.

Çfarë mund të bëjë tjetër populli të cilit i takon për pajtimin në Bosnje e Hercegovinë?

Jo vetëm populli im, por edhe popujt tjerë në Bosnje e Hercegovinë, do ta arrinin më lehtë pajtimin sikur njerëzit të fillonin të jetonin normalisht dhe të kishin punë të mjaftueshme, të punonim dhe kur do të arrinim njëfarë standardi normal. Atëherë nuk do të kishim kohë të mendojmë për gjëra të tjera përveç punës. Përmirësimi i situatës ekonomike do t'i kontribuonte edhe përmirësimit të marrëdhënieve ndërmjet popujve. Mundësia e jetës normale dhe siguria ekonomike do t'i kontribuonin pajtimit.

Si reagon tani kur në media dëgjon për një incident të shkaktuar nga jotoleranca ndëretnike?

Mediat i kontribuojnë edhe më shumë ndarjes. Ndoshta nuk do të duhej e tëra edhe të publikohej, kurse ata me vëmendje të tepruar, në mënyrë sensacionale, i trajtojnë ato incidente dhe i kontribuojnë ngadalësimit të procesit të pajtimit dhe rritjes së jotolerancës ndërmjet njerëzve.

Si të sillen njerëzit ndaj përvojave dhe kujtimeve të këqija nga lufta?

Mendoj se duhet falur, por nuk duhet harruar. Unë i kam falur me kohë njerëzit që më kanë bërë keq, por nuk kam harruar kurrë e as që do të harroj.

A ndikon në procesin e pajtimit, sipas mendimit tënd, përfaqësimi në institucione në bazë të “çelësit nacional”?

Nëse jemi shtet i tre popujve konstitutivë, kjo duhet t'i kontribuojë pajtimit. Përfaqësimi i barabartë është mënyrë që asnjëri nga popujt konstitutivë të mos ndihet i nxjerrë jashtë ose i përfaqësuar në mënyrë të pamjaftueshme.

B. J.

Derisa kemi jetuar në Shibenik, kemi kaluar tre muaj në bodrume. Babai ka qenë në kazermë, pothuajse i zënë rob. Ajo që kujtoj është se fqinjët janë treguar njerëzit më të mirë, kanë shkuar për ne në treg, na kanë sjellur gjëra njëjtë si dhe vetes, pastaj kanë kontrolluar në kazermë se si është babai. Të gjithë atë që ne nuk kemi mundur e kanë bërë ata për ne. Ndoshta atëherë edhe nuk kam mundur ta kuptoj se sa shumë do të thotë kjo derisa nuk e kam dëgjuar se çfarë krejt ka ndodhur dhe çfarë kanë përjetuar njerëzit.

Sa vjet ke dhe nga je?

Jam 26 vjeçe, ndërsa nga jam, kjo është një histori e gjatë... Kam lindur në Prizren, kam jetuar pak aty, pastaj në Prishtinë, Gjakovë, të gjithë këto në Kosovë, pastaj në Shibenik, Drvar, Bijello Pole dhe tani në Podgoricë. Histori klasike e fëmijës së një ushtaraku.

Si janë kryqëzuar këto shpërngulje me fillimin e luftërave në fillim të viteve '90?

Ne kemi qenë në Kosovë kur atje kanë filluar demonstratat dhe rebelimet për të drejta më të mëdha, kurse babai im ka qenë ushtarak kufiri në atë kohë dhe ka punuar shumë në terren. Ne atëherë jemi rritur, kurse ai ka kërkuar të disloketohet diku tjetër në mënyrë që të largohet, sepse qysh atëherë ka filluar të jetë rrezik. Ai ka dashur të shkojë në pension, të shkojë paqësisht. Atëherë ka fituar urdhër që të zhvendoset me punë në Shibenik dhe atje kemi kaluar dy vite të bukura '89-'90, derisa edhe atje nuk ka filluar lufta. Atëherë babai im ka fituar urdhër për zhvendosje në Drvar, Bosnjë, derisa edhe atje nuk ka filluar lufta. Pas kësaj kanë marrë urdhër që secili të kthehet në vendin nga është. Atëherë jemi kthyer në Mal të Zi. Edhe aty ka mbretëruar kaosi derisa nuk kemi filluar të adaptohemi pak.

Si e ke përjetuar ti si fëmijë atë periudhë të luftës?

Atë që mua si fëmijë ma ka treguar lufta, si fëmijë i mbrojtur nga të gjitha anët, është ana e mirë, fytyra e mirë e njerëzve. Për shembull, derisa kemi jetuar në Shibenik, kemi kaluar tre muaj në bodrume. Babai ka qenë në kazermë, pothuajse i zënë rob, kurse ne në banesat ushtarake ku të gjithë kemi qenë fëmijë të ushtarakëve. Gjysma veç kishin kaluar në Gardën kroate, kurse të tjerët akoma nuk dinin çfarë të bëjnë dhe si. Nga banesa kanë mundur të shëtisin lirisht vetëm familjet e atyre që veç kishin kaluar në Gardën kroate, që do të thotë se ne e kemi kaluar kohën kryesisht në bodrum. Ajo që kujtoj është se fqinjët janë treguar njerëzit më të mirë, kanë shkuar për ne në treg, na kanë sjellur gjëra njëjtë si dhe vetes, pastaj kanë kontrolluar në kazermë se si është babai. Të gjithë atë që ne nuk kemi mundur e kanë bërë ata për ne. Ndoshta atëherë edhe nuk kam mundur ta kuptoj se sa shumë do të thotë kjo derisa nuk e kam dëgjuar se çfarë krejt ka ndodhur dhe çfarë kanë përjetuar njerëzit. Prandaj, unë i kam përjetuar gjërat më të mira në atë periudhë dhe kam parë një farë fytyre të bukur të njerëzisë.

Si ka rrjedhur jeta e mëtejme në Podgoricë? A janë ndier pasojat, a i ke ndier ti personalisht?

Kudo që kemi qenë kemi kaluar mirë. Kjo si falë neve që jemi komunikativë dhe të hapur, ashtu edhe falë mjedisit: pas Shibenikut kemi qenë në Drvar ku jeton popullsia e pastër serbe, kurse ne kemi ardhur me mbiemër tërësisht musliman. Në fakt, nuk kemi pasur ndonjë identitet aq të madh musliman, por më tepër është mbështetur në jugosllavizëm, por megjithatë kjo ka mundur t'ju avullojë veshët njerëzve, por nuk ju ka avulluar dhe kjo ka qenë fenomenale. Kur kemi ardhur në Podgoricë

kemi qenë praktikisht pa gjëra, vetëm ne të tre. Më vonë fqinjët na kanë sjellë disa gjëra dhe atëherë e kemi pasur më lehtë. Në Podgoricë kam kaluar periudhën më të vështirë. Kemi ardhur në kohën para inflacionit dhe ndarjes më të madhe të mundshme partiake. Ditën e parë në shkollë më është afruar një djalosh dhe më ka pyetur: “A je ti liberale apo radikale?”. Unë nuk kam ditur fare se çfarë më pyet derisa nuk ma ka shpjegur se bëhet fjalë për parti politike dhe se klasa është e ndarë midis këtyre dy partive politike. Kjo ka qenë definitivisht shpërngulja më e vështirë, ndoshta edhe për momentin në të cilin kam ardhur ose ndoshta për shkak të mbylljes së rrethit të të rinjve në Podgoricë, të cilët kanë qenë pak më të mbyllur se sa në mjediset tjera.

A e ke ndier si të vetin këtë pjesë të identitetit të luftës? A ka pasur më tej ndonjë domethënie në jetë dhe a janë sjellur njerëzit ndaj teje në raport me të?

Lufta më ka marrë disa momente të bukura të fazës tinxhere, më është dashur të piqem më heret, edhe si fëmija më i madh. Në përgjithësi, as tani nuk e kuptoj qëllimin e asaj lufte dhe as që e shoh arsyen, madje as rezultatet nuk tregojnë se me të është arritur ndonjë gjë. Ajo që për mua ka qenë e tmerrshme është se njerëzit është dashur të kalojnë përmes saj. Ne kemi jetuar në një mjedis të sigurt, por përreth kanë ekzistuar këto fërkime, megjithëse ne nuk kemi mundur t'i ndiejmë. Më keq e kam pasur në Podgoricë sepse më kanë bërë vazhdimisht pyetje se “a jemi profitorë të luftës” apo “pse nuk shkojmë në tonën”, kështu që e kam ndier veten më keq se sa në territoret e luftës ku kemi qenë. Kam një shembull nga shkolla, që është interesant. Në gjimnaz kam pasur njësh nga gjeografia, gjë që ka qenë e palogjikshme sepse e kam dashur gjeografinë. Ai madje nuk ka dashur as të më pyes. Në fund babai im është dashur të shkojë në shkollë që të shohë se çfarë ndodhë dhe ka përfunduar me arsyetimin se babai im nuk është muxhahedin dhe se ka punuar në APJ. Pas kësaj ai ka pranuar të më pyes. Këto janë disa gjëra që më kanë mbetur në kujtesë për të keq, por nuk është diçka që ka mundur të ndikojë në mua dhe familjen time.

A ka marrë pjesë, sipas teje, Mali i Zi në luftëra?

Fakti që Mali i Zi nuk ka pasur luftë në terrenin e vet nuk do të thotë se nuk ka marrë pjesë. Unë i shoh këto të gjitha nga një perspektivë e fëmijës dhe në atë kohë e gjithë kjo më është dukur e tmerrshme, ndërsa sot kur zbulohen disa informacione më duket edhe më e tmerrshme. Unë mendoj se po, të paktën edhe heshtazi, por njëjtë edhe me vepra. Edhe këtu ka pasur disa fushata të mëdha mediatike. Por njerëzit kanë mundur megjithatë të dëgjohen edhe pas një kohe, ashtu si edhe ne, sepse na kanë telefonuar vazhdimisht, kështu që e kemi ditur se çfarë po ndodhë në të vërtetë. Kështu që ka qenë në dorën e njerëzve se si do t'i pranojnë këto informacione. Atëherë e kam krejtësisht të paqartë se si ka ndodhur Dubrovniku ose dorëzimi i njerëzve në Shtërpcë, gjë që është e palogjikshme për dikë që nuk ka marrë pjesë në luftë apo është “oazë e paqes”. Këto nuk janë gjëra që i ndodhin dikujt që nuk është në luftë ose është neutral. Kjo ka qenë për mua edhe çështje e çdo individi sa që ka qenë e pabesueshme. Sepse diskriminimin më të madh që e kam përjetuar në bazë fetare dhe nacionale, gjë që nuk ka qenë edhe aq pjesë e identitetit tim derisa njerëzit nuk kanë filluar të më dallojnë sipas kësaj baze, atëherë bile nga inati kam filluar t'i kem disa çështje të rëndësishme, e kam përjetuar në Mal të Zi, dhe në disa nga ato momente ajo frikë nga ndryshueshmëria ka kulminuar.

Ajo më pyeti “kush je, si e kam mbiemrin?”, ndërsa unë i thashë “Haxhibegović”. Ajo u gjet me këtë e hutuar dhe në fund komentoi: “Nuk ke ti faj” dhe shpjegoi se edhe ajo kishte pasur fqinj muslimanë dhe se nuk janë të gjithë të këqinj, pra “ka edhe të mirë”.

A mendon se ajo frikë është zvogëluar sot?

Unë lëvizi në mjedise shumë të bukura, prandaj nuk mund të përgjigjem plotësisht në këtë pyetje. Është krejt ndryshe kur shkohet në veri, kur zbritni në bregdet, pas-taj në fshatra... Mua më pëlqen shumë të udhëtojë dhe të njoh njerëz tjerë. Një herë më ka ndodhur të qëndroj në male në veri. Aty është fshat dhe njerëzit mbajnë bagëti. Edhe njerëzit janë pak a shumë të vetmuar dhe kushdo që vjen ata janë të gëzuar të bisedojnë me të, të dëgjojnë të rejat nga qyteti etj. Ishim tre veta dhe një grua na ftoi për pogaçe dhe qumësht, të bisedojmë me të dhe t'ia transmetojmë të rejat. Ajo na shpjegonte se si jeta aty ishte e vështirë dhe kështu me radhë, ndërsa unë i thashë se i di këto gjëra sepse edhe unë kam fshat. Ajo më pyeti “kush je, si e kam mbiemrin?”, ndërsa unë i thashë “Haxhibegoviq”. Ajo u gjet me këtë e hutuar dhe në fund komentoi: “Nuk ke ti faj” dhe shpjegoi se edhe ajo kishte pasur fqinj muslimanë dhe se nuk janë të gjithë të këqinj, pra “ka edhe të mirë”. Nuk ka kuptim t’ju shpjegosh çfarëdo qoftë këtyre njerëzve, sepse ajo, për shembull, jeton aty 80 vite dhe mendon nëse unë jam fajtor apo jo pse kam lindur me fe tjetër. Mendoj që kjo pak a shumë është rrënjësuar në shoqëri, në familje, në edukim. Besoj se mund të ndryshohet, por nevojitet shumë kohë. Duhet të ndikohet në këtë nga të gjitha anët: TV, shkolla, shoqëria, familja, rruga. Edhe pse mjafton vetëm një ndikim negativ që të luhatet tërë ajo që të tjerët bëjnë në këtë fushë.

Çfarë do të thotë për ty pajtimi?

Bashkëjetesë – të mund të jetojmë me njëri tjetrin dhe mos t’i shikojmë këto dallime. Unë nuk mund t’i shoh, sepse mua që nga fillimi më kanë mësuar të shoh të mirën dhe të keqen tek njerëzit. Këtë linjë shoh dhe gjithmonë mund të nxjerrë diçka të mirë nga njerëzit. Edhe falja është shumë e rëndësishme. Njerëzit duhet të mësojnë të falin njëri-tjetrin. Unë di të flas gjëra që nuk janë edhe aq reale, sepse duhet të kalojë edhe një distancë e caktuar kohore. Unë kam kaluar nëpër luftë, por e kam parë atë vijën e mirë tek njerëzit. Edhe pse ka pasur bombardime dhe viktime, mua nuk më ka vdekur askush nga familja e afërt kështu që nuk e kam ndjenjën e humbjes që do të ishte e lidhur ngusht me luftën, e cila do të mund të më shkaktonte ndonjë urrejtje shtesë etj. Për mua pajtimi është i mundur, bashkëjetesa është e mundur – jeta me njerëz, e jo jeta me “çfarëdo” njerëzish.

Çfarë do t’u sillte, sipas teje, pajtimi “njerëzve të thjeshtë”?

Gjithçka, pasurinë. Për mua edhe qëndron pasuria tek këto njerëz të ndryshëm, kultura të ndryshme. Për mua është e pabesueshme të shkoj në ndonjë dasëm në fshat në Bijello Pole dhe në një dasëm në Kotorr. Është fenomenale kur shikoj atë dallim të zakoneve. Po ashtu edhe atje ku gërshetohen të gjithë këto zakone... Ne jemi në një farë mënyre edhe paganë sepse mjaft nga paganizmi ka mbetur tek ne. Mua më duket se do të jetonim shumë më mirë sikur do ta falnim njëri-tjetrin, kur do të mësonim nga njëri-tjetri dhe do të njihnim më mirë njëri-tjetrin.

Kur flitet për gatishmërinë e njerëzve për t’u pajtuar, a mendon se ajo është specifike kur bëhet fjalë për njerëzit në Mal të Zi? A mendon se këtu është njohur fare nevoja për pajtim?

Ajo që më mungon mua është që njerëzit në Mal të Zi ta kuptojnë se ekziston ose se ka ekzistuar problemi. Ky është paragrafi i parë. Vetë ai tregimi se Mali i Zi nuk ka marrë pjesë në luftë, se çdo gjë është zhvilluar rreth tij, thjesht nuk është real. Njerëzit duhet të bëhen të vetëdijshëm se me vetë faktin që kanë heshtur dhe nuk kanë bërë asgjë, kanë marrë pjesë në të gjithë këtë. Në qoftë se nuk kanë dalë në

votime – atëherë i kanë lejuar ata 30 përqind që të vendosin për to – dhe këtu përfundon historia! Ky është për mua kushti i parë që aty të ndryshohet ndonjë gjë. Në qoftë se nuk shohin fare që kanë marrë pjesë në këtë, atëherë nuk e shohin as nevojën që të pajtohen, ndoshta ata janë paqesjellës?! (Unë nuk ndihem dikush që është vetëm nga Mali i Zi. Por në Mal të Zi nuk duket megjithatë mjaft se ne kemi marrë pjesë në të gjithë këtë. Edhe pse ka edhe hapa përpara, siç po punohet diçka së bashku në kufirin me Kroacinë. Si dhe përmes kulturës dhe muzikës. Mendoj se është e rëndësishme që njerëzit e thjeshtë ta kuptojnë dhe ta pranojnë këtë në mënyrë që të mënjanohet faji kolektiv.

Mu për faktin se je mjaft e pranishme edhe në rajon jashtë Malit të Zi, si e shikon gatishmërinë e njerëzve tjerë duke pasur parasysh se ata janë në një farë situatë pak më të ndryshme?

Pas luftërave kam udhëtuar shumë, i kam vizituar vendet ku kam jetuar, sepse e kam pasur të rëndësishme ta bëj këtë. Diku kam takuar njerëzit që i kam njohur edhe më parë, kurse diku jo, sepse është ndryshuar plotësisht fotografia e popullsisë. Mendoj se ekziston akoma mjaft urrejtje, lëndime, fyerje dhe moskuptueshmëri e disa gjërave. Mendoj se duhet të kalojë mjaft kohë dhe kontakte të njerëzve. Tani është aktual kërkimi i faljes nga politikanët, por kjo është disi vetëm në letër dhe me fjalë, ndërsa do të duhej të ndodhte në kokën e njerëzve për të kuptuar se çfarë kemi bërë. Megjithatë ekonomia do ta luajë rolin më të rëndësishëm, mendoj se është e rëndësishme të flitet për këtë, të flitet për probleme. Kjo kërkesë për falje duhet të shoqërohet me veprime. E kanë të vështirë edhe disa njerëz ta pranojnë se kanë qenë të mashtruar kaq kohë.

Si të ballafaqohemi me të kaluarën, me tërë atë që ka ndodhur?

Nuk e di. Mund të them vetëm se si kam vepruar unë. Kam dashur të gjej informacione nga të gjitha anët: gazetat, TV, interneti. Një informacion është përpunuar, e pabesueshme, në shumë mënyra, që nga disa mënyra shumë të ngushta e deri te disa të përpunuara parimisht dhe më objektive. Unë edhe sot marrë vesh se çfarë ka ndodhur, sepse shpesh nuk mund ta shohim çdo gjë realisht. Pra, përmes fotografisë informative marr vendimin për qëndrimet, veprimet dhe sjelljet e mia. Qëndrimi mund të ndryshojë varësisht nga nevoja, sepse nuk jam ithtare e mosndryshimit kokëfortë të qëndrimeve. Duhet ta shikojmë po ashtu edhe zemrën për të parë nëse ekziston dëshira për pajtim, pikëllimi etj. Unë edhe sot mundohem të vendosi kontakt me njerëz që në atë kohë më kanë ndihmuar shumë, sepse do të doja t'ju thoja “faleminderit”. Sepse mu ata më kanë mësuar se çfarë do të thotë të jesh njeri. Mendoj se e njëjta gjë do të duhej të ishte edhe nga perspektiva tjetër. Nëse ka ndodhur diçka e keqe, atëherë duhet të shikoni veten se pse dhe si, dhe dikujt edhe t'ia thuash këtë. Me mbajtjen e këtyre ideve vetëm për vete nuk mund të bëjmë asgjë të mirë.

Sa është për ty i rëndësishëm raporti individual ndaj të kaluarës?

Për mua historia ka qenë interesante për shkak se kam pyetur se pse mësojmë kaq shumë për luftën. Është fituar përshtypja sikur gjithmonë vetëm është luftuar. Më duket se historia nuk jep edhe aq shumë informacione për atë se çfarë ka qenë realisht, çfarë ka ndodhur. Për mua kjo është e rëndësishme që të dihet se çfarë është përjetuar dhe që të shihet se çfarë kanë përjetuar të tjerët. Unë nuk kam pësuar ndonjë humbje në këtë luftë, por kam mundur ta përjetoj nga njerëzit tjerë se sa e egër dhe e panevojshme ka qenë ajo.

Ajo që më mungon mua është që njerëzit në Mal të Zi ta kuptojnë se ekziston ose se ka ekzistuar problemi. Ky është paragrafi i parë. Vetë ai tregimi se Mali i Zi nuk ka marrë pjesë në luftë, se çdo gjë është zhvilluar rreth tij, thjesht nuk është real. Njerëzit duhet të bëhen të vetëdijshëm se me vetë faktin që kanë heshtur dhe nuk kanë bërë asgjë, kanë marrë pjesë në të gjithë këtë. Në qoftë se nuk kanë dalë në votime – atëherë i kanë lejuar ata 30 përqind që të vendosin për to – dhe këtu përfundon historia!

Çfarë mund të bëjë njeriu i thjeshtë dhe cila është, sipas teje, përgjegjësia e tij?

Më e madhja. Për mua ka qenë gjithmonë e qartë se unë jam përgjegjëse për çdo veprim timin. Por edhe për çdo gjë që bëhet në emrin tim të di për të, ose të protestoj kundër tij. Duhet të dëgjohet zëri ynë kur ndodhin apo nuk ndodhin disa gjëra. Vetëm nëse e ndryshoj vetveten, tek atëherë mund të ndikojë në mjedis. Nëse e zgjidhi çështjen me veten, me të kaluarën time, tek atëherë mund t'ju ndihmojë të tjerëve në zgjidhjen e problemeve të tyre dhe të ndikojë në mjedis sa i përket pajtimit.

Kurse nesër?

Unë kam qenë nxënëse e mirë në shkollë dhe gjithmonë më kanë thënë se duhet të shkoj jashtë dhe atje të jetoj jetë të bukur. Mua kjo nuk më ka tërhequr kurrë plotësisht, sepse unë edhe jashtë do ta merrja veten ashtu siç jam. Në qoftë kam probleme me diçka, do t'i kem edhe atje, jam e sigurt për këtë. Dikur ka qenë ndryshe dhe njerëzit është dashur të shkojnë jashtë sepse, thjeshtë, nuk kanë pasur zgjidhje. Zgjidhja ime është të qëndroj këtu sepse besoj vërtetë se diçka mund të ndryshojë. Sa mund të ndikojë unë si person në këtë, kjo është diskutabile, por unë jap çdo gjë nga vetja ime dhe jam e kënaqur me atë që bëj. Me rezultate nuk jam gjithmonë e kënaqur, por punoj më së miri që mundem. Sipas vlerësimeve të një instituti amerikan për atë se kur do të hyjë Serbia dhe Mali i Zi në Bashkimin Europian, rezultati ka qenë – 20 vjet. Këto janë gjëra që i dekurajojnë plotësisht njerëzit dhe nuk ka kup-tim të thuhet. Ndoshta, në fakt, duhet t'i motivojnë njerëzit që të aktivizohen. Unë kam zgjedhur që të jetoj këtu dhe të ndryshoj diçka. Nëse do të zhgënjehem plotësisht, do të largohem dhe do të kërkoj ku të jetë më e lehtë. Mendoj se e nesërmja është e mundshme, pra e nesërmja më e mirë. E kam fjalën që kur nesër të takohem me dikë që ka të kaluar dhe emër tjetër – të mund të funksionojmë. Edhe pse jemi impulsivë, mendoj se mund ta arrijmë këtë.

A do të thotë kjo se të ardhmen e rajonit tonë nuk e sheh të zezë?

Kjo është zgjidhja ime personale, diçka në të cilën besoj dhe për të cilën punoj. Nuk mund të them se shoh një të ardhme shumë optimiste. Duhet shumë kohë që një njeri të ndryshojë. Punoj me njerëz të rinj, me fëmijë. Dhe kur ai fëmijë të kthehet në shtëpi dhe kur babai i tij apo i saj shikon televizionin dhe thotë “magjupët e çmendur”, çdo gjë që ne kemi punuar me këtë fëmijë është shkatërruar. Nevojiten shumë ndryshime të vogla që të krijohet një masë kritike, që të ndryshohet diçka. Unë lëvizim në mjedise shumë të bukura, por njerëzit nuk e kuptojnë se mund të ndryshojnë shumëçka dhe për këtë nuk janë të vetëdijshëm. Në aspektin e këtyre ndryshimeve unë mendoj se ekzistojnë dhe se mund të lëvizet përpara, megjithëse nganjëherë situata është kjo: një hap përpara – një prapa. Çështja është vetëm se sa është kush këmbëngulës dhe sa është i gatshëm për të shpenzuar fuqi, energji dhe kohë.

L. Z.

Nuk ka rënë ai nga qielli, ne e kemi zgjedhur

Si ndihesh sot kur vështrosh të gjithë atë që ka ndodhur në vitet '90 dhe çfarë ka rrjedhë nga ajo sot? Cili ka qenë motivimi yt për të shkuar në luftë?

Tamam pyetje disi e çuditshme... Sistemin që ka qenë para këtij sistemi e kujtoj si një sistem shumë të keq, për mendimin tim, jo për shkaqe nacionaliste, por të natyrës sociale. Në bazë të përvojës sime nga ai sistem, edhe pse është propaganduar si shtet social, i të drejtave të punëtorëve e tjerë, kjo ka qenë vetëm një maskë që në fund është hequr. Nga jeta dhe përvoja personale nuk mund të them se ai sistem më ka paraqitur diçka pozitive. Duke shikuar sot vitin '91 kur unë kam shkuar në luftë, kam menduar se do të arrijmë të bëjmë një kthesë, jo vetëm në kuptimin ushtarak, e assesi nationalist, por në një përparim dhe rregullim të përgjithshëm shoqëror. Se do të ndërtojmë një shoqëri krejt normale si në perëndim, që do të thotë se kreativiteti dhe aftësitë e njerëzve të rinj të vijnë në shprehje, gjë që në komunizëm nuk ka qenë gjithaq e pranuar. Gjithmonë sistemi ka qenë krijues, ndërsa individit nuk ka guxuar të jetë krijues. Kam pritur në vitin '91, por edhe më vonë se do të arrijmë ta krijojmë këtë sistem ku do të mund të vijnë të aftë e jo të përshtatshmit; por, kjo nuk ka ndodhur. Sot e ndiej se nuk janë realizuar disa dëshira dhe ëndrra të mia të cilat është dashur të jenë të lidhura për gjendjen e sotme.

A mund të më thuash, sipas mendimit tënd, si është gjendja sot?

Ne sot kemi sistemin i cili është identike me atë të kohës së komunizmit, vetëm se në një, mund të themi, version më të zburur, le ta quajmë demokraci. Ti si individ, ta zëmë në punë, në disa organizata, po ashtu nuk mund të kesh sukses nëse nuk je në tufë të caktuar. Ajo tufë është e njohur në Kroaci si parti politike. D.m.th. që të realizosh ndonjë satisfaksion tëndin, që të kesh sukses në ndonjë qëllim tëndin, duhet të jesh në tufë. Përndryshe situata të është vështirësuar që t'i realizosh disa të drejta tuaja themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kroacisë. Nuk duhet të jem aq i aftë, sa duhet të jem i përshtatshëm që të jem i suksesshëm. Në qoftë se e paraqes situatën në mënyrë të kundërt, atëherë nuk ka shans që të kem sukses aty.


Si shikon ti në situatën pas luftës, në atë që lufta e ka lënë si trashëgimi, ndërsa për të nuk flitet?

Këtu nuk flitet për shumë gjëra. Të gjitha institucionet politike, organizatat që merren me çështjet e të drejtave të njeriut, kam ndjenjë se sorollaten si macja rreth qullit. Askush nuk dëshiron të hyjë në thelbin e problemit dhe të ballafaqohet me të. Thelbi i problemit është pikërisht shoqëria, ky është mendimi im. Kemi problem me një ndërthurje të ndryshkur mentale të kësaj shoqërie që është narcisoide dhe hipokrite kështu që mendoj se ky është një problem shumë i madh.

Si narcisoide, në çfarë kuptimi?

Gjatë kohës së komunizmit ti ke pasur sistemin në të cilin është dashur të punosh dhe të heshtësh, dhe nuk ka pasur problem. Por sot propagandohet se duhet të

Njeriu i zakonshëm vjen në fazën që të marrë gjërat në dorën e vet dhe të fillojë ta rregullojë fatin e vet, e jo ndonjë politikan që rri ulur në qeveri. Ai e zgjedh atë politikan, e jo ai politikan atë.



flasësh, duhet të punosh, por anash, në njëfarë mënyrë thuhet – hesht akoma, mos turbullo. Çfarëdo ndryshimi pozitiv, nëse ekzistojnë përpjekje për të ndryshuar atë që ka qenë më parë dhe që është tani, konsiderohet turbullim dhe nuk u përgjigjet shumë elementeve shoqërorë, sidomos atyre më të moshuar të cilët në socializëm janë mësuar të jetojnë dhe të mos punojnë sepse sistemi është kujdesur për ta.

Si sillen kreu shtetëror dhe qytetarët ndaj ngjarjeve të kohës së luftës?

Mendoj se fjala kyçe në të gjithë këtë është përgjegjësia, sepse askush nuk dëshiron ta marrë përgjegjësinë për çfarëdo problemi. Kemi plot shembuj nga jeta e përditshme, shtypi e kështu me radhë. Në qoftë se ekziston një problem, gjithmonë topi dhe përgjegjësia hidhet tek tjetri dhe askush nuk e zgjidh atë problem. Ai vetëm kalohet nga njëra palë tek tjetra.

Kur flasim për të kaluarën, konkretisht për krimet e luftës, si sillen shoqëria ndaj kësaj?

Nuk flitet fare për këtë. Njeriu i zakon-

shëm, punëtori, fshatari, njeriu që punon në administratë, nuk don të mendojë për këtë. Politika ditore vendos tezën se as ajo nuk don të flasë përditë për këtë. Në atë mënyrë kryhet ai sistemi që ka ekzistuar në socializëm, kjo është përhapja e frikës. Njerëzit frikohen të flasin për këtë sepse vlerësojnë se do t'i hajë terri, se nuk vlen të merresh me brinokët dhe me iks gjëra të tjera që janë të pranishme në jetën e përditshme.

A është e bazuar kjo frikë?

Problemi qëndron në atë se ekziston një numër i caktuar i njerëzve që dëshiron të flasë për disa gjëra, por ata janë në pakicë. Pikërisht për faktin se janë në pakicë, konsiderojnë se nuk e kanë numrin e mjaftueshëm që të hyjnë në polemikë për këtë.

A ekziston nevoja tek “njerëzit e zakonshëm” që të flitet për të kaluarën e luftës?

Ekziston. Unë them se nuk ekzistojnë njerëz të këqinj. Askush nuk lind plaçkitës, por njeriun e bën të tillë rasti. Në natyrën e njeriut është që padrejtësitë që i bëhen, problemet e caktuara, t'i pengojnë në nënvetëdije. Por mu për shkak të këtyre frikave dhe paragjykitimeve të caktuara njeriu nuk don të flasë publikisht për këtë, por në nënvetëdije dëshiron që të flitet për këto. Këtu duhet të bëhet gjithçka që të arrihet

ai hap përpara në mënyrë që njerëzit të shohin se për gjëra të tilla flasin shumë njerëz dhe se atyre njerëzve nuk u ka ndodhur asgjë. Ballafaqimi me të kaluarën dhe historia për krimet e luftës këtu është punë pioniere. Pikërisht ata pionierë që do të flasin për këtë, në qoftë se nuk do t'ju ndodhë asgjë, do t'i inkurajojnë këta të tjerët të cilët më vonë do të mund të flasin për këto gjëra pa kurrfarë frike.

Çfarë mendon mbi praninë e mohimit në shoqërinë tonë. Kur them mohimit, mendoj në atë – ne vetëm jemi mbrojtur, ne nuk kemi mundur të bëjmë asgjë të keqe... A është më lehtë të jetohet me këtë?

Ky është një iluzion. Kur kemi qenë në një takim në Selcë, ka marrë pjesë një nënë e cila kërkonte djalin e zhdukur në Vukovar. Në takim kanë qenë të pranishëm dy njerëz nga Shoqata për Mbrojtjen e Shëndetit Mental të Veteranëve të Luftës nga Novi Sadi dhe ajo ka kërkuar nga ata që të kërkojnë ndjesë në emër të popullit serb. Ata janë mjekë dhe nuk kanë lidhje me këtë, por ja... Kështu që kam ndërhyrë dhe i kam thënë se kjo nuk është në rregull, kurse ajo nënë, pas kësaj, ka dashur të hyjë disa herë në polemikë me mua dhe të bisedojë me mua dhe gjithmonë ka kërkuar ndjesë se unë më në fund nuk jam ndier mirë. Unë i kam thënë: “Zonjë, unë e kuptoj dhimbjen tuaj, kur ju më flitni mua si nënë e cila edhe sot e kësaj dite kërkon djalin e saj, unë ndihem shumë keq. E kam të vështirë edhe t’ju them se nuk keni të drejtë për disa gjëra”. Kështu që ajo pas pesë-gjashtë herësh që kemi biseduar më ka thënë kështu: “Unë e kuptoj se çfarë thua ti dhe jam e vetëdijshme se ajo është në rregull. Por unë frikohem të ballafaqohem me atë sepse do ta humbi atë mendimin që kam tani, e ky mendim është se djali im ka vdekur, megjithatë, për diçka, nuk ka vdekur kot”. Megjithatë është më lehtë të jetosh në iluzion si: megjithatë unë e kam dhënë djalin për diçka të vlefshme. Do të shikosh sot, kur flet me mbrojtësit (luftëtarët) dhe kur ta pyesësh se pse ke luftuar, ai do të thotë – unë kam luftuar për Kroacinë. Kur ta pyesësh se çfarë Kroacie ka dashur ai – Kroaci thotë, të lirë, të pavarur... Do të thotë, ai flet atë që flitet në rrethet politike, ai përsërit politikën e përditshme, nuk e ka qëndrimin e tij, për arsye se është mësuar që sistemi të mendojë për të, e jo ai për sistemin.

Si i përjeton këto ndjesat e fundit të politikanëve nga të dy palët, a mund t’i ndihmojnë asaj pjesës më të madhe të opinionit kroat që të hapet për të folur mbi të kaluarën?

Nuk është qëllimi që ne tani të kërkojmë ndjesë. Ajo që kanë bërë Mesiçi dhe Maroviçi, ajo është në thelb dyfytërsi. Politikanët janë ata që e kanë rregulluar tërë luftën, ekzistojnë sot për këtë mjaft fakte, ata kanë bërë tregëti midis vete, janë takuar fshehurazi, i kanë rregulluar dhe i kanë ndryshuar kufijtë, kanë bërë tregëti me një numër të caktuar njerëzish, terroresh, dhe ata kanë përgjegjësi të madhe. Natyrisht që politikanët e kanë sot vështirë të dalin në opinion dhe të thonë se politikën e tyre të mëparshme kanë qenë shumë të ndyta. Shihet përmes politikës së përditshme se si ekzistojnë përpjekjet për të manipuluar me njerëz, sapo njerëzit fillojnë të prekin ballafaqimin me të kaluarën, sapo fillojnë të zbulohen gjërat nga e kaluara, mashtimet, kjo-ajo, menjëherë fillon të kalojë në nacionlizëm që të bëhet njëfarë mashtrimi në mënyrë që të mos ndodhë ndonjë shpërthim.

Cila është rruga për tejkalimin e kësaj? Si të nxiten njerëzit që të pranojnë përgjegjësinë dhe nga të fillohet, nga nivelet e larta apo nga “njerëzit e vegjël të zakonshëm”?

Kurse pajtimi është para së gjithash respektim. Ai nuk bazohet as në kombësi, as në fe. Ai bazohet në respektimin reciprok. Derisa ne të pëshpërisim, ashtu siç kemi bërë para 50 viteve – ai është serb, ai është musliman, mund të shoqërohesh me ta, por mos krijo kurrfarë lidhjeje – nuk ka aty pajtim të vërtetë. Kur ta shikojmë njeriun si njeri atëherë ekziston shansi që të arrihet pajtimi i vërtetë.

Mendoj se potenciali kryesor për nxitje është pikërisht tek njerëzit e vegjël. Njeriu i zakonshëm vjen në fazën që të marrë gjërat në dorën e vet dhe të fillojë ta rregullojë fatin e vet, e jo ndonjë politikan që rri ulur në qeveri. Ai e zgjedh atë politikan, e jo ai politikan atë. Mendoj se pikërisht njerëzit e rinj, sidomos njerëzit e rinj që nuk kanë këtu perspektivë për të ardhmen, duhet të organizohen në organizata të caktuara të interesit, si individë apo grup, dhe në këtë mënyrë të ndikojnë në politikën e përditshme e cila vetëm atëherë do të ndryshojë. Sepse politikanët nuk do të ndryshojnë vetvetiu, kurse nëse i lejojmë që ata ta bëjnë këtë, atëherë ata do ta bëjnë në njëqind vitet e ardhshme. Do të thotë, nuk ka ndryshime radikale, kurse neve na duhen ato.

Si e përjeton fajn kolektiv apo individual në raport me të kaluarën?

Të filloj, ta zëmë, nga veteranët. Ambasadat e huaja apo shtetet tjera të jashtme i shikojnë veteranët e luftës si njerëz destruktivë. Duke e analizuar këtë tezë, njeriu i cili mban armën dhe shkon për të vrarë njeriun tjetër nuk mund të jetë konstruktiv, pa marrë parasysh nëse ai mbrohet, nëse lufton për pavarësi. Le të kuptohemi menjëherë, lufta në vetvete është destruktive. Shoqëria që zgjedh elitën e tillë politike, e cila e çon në luftë, nuk mund të thotë nesër – ne nuk jemi përgjegjës. Këtu ne mund të flasim për përgjegjësinë kolektive dhe fajn individual për disa gjëra dhe askush nuk mund të thotë se unë jam përgjegjës për këtë apo atë. Ky është po ashtu iluzion dhe kjo është ajo që njerëzit nuk duan ta pranojnë. Nëse të gjithë kemi votuar për Franjo Tugjmanin, e ai i ka bërë dyqind familje të pasura, kurse të tjerët janë të gjithë ta varfër, të gjithë sot e pështyjnë Franjo Tugjmanin, ndonëse të gjithë e kanë zgjedhur. Do të thotë, kemi problem, nuk ka rënë ai nga qielli, ne e kemi zgjedhur. Do të thotë, ekziston faji kolektiv... Kur ka qenë përkujtimi i 60-vjetorit të fitores së antifashizmit në Evropë, një gjerman i ri, 22-vjeçar, ka thënë se ndihet përgjegjës për atë çfarë ka ndodhur para 60 vitesh; as që dua të mendoj për rezultatet e anketës tek ne. Kjo shoqëri duhet të ballafaqohet me përgjegjësinë e vet personale të të jetuarit në shoqëri. Në zgjedhjet e kaluara lokale, këtu 30 për qind e votuesve të regjistruar kanë dalë në zgjedhje, herën tjetër do të dalin më pak dhe të gjithë do të thonë se nuk duan të votojnë as për të djathtët, as për të majtët, sepse nuk vlejnë as njëri as tjetri, nuk ekziston zgjidhja e tretë, ndërsa në fakt shoqëria është ajo që nuk don ta krijojë atë solucionin e tretë. Pra, njerëzit nuk duan ta marrin përgjegjësinë për çfarëdo.

Çfarë mund të bëhet që të ndryshojë kjo?

Duhet të investohet në njerëz që janë të gatshëm të ballafaqohen me problemet e jo në dikë që ka oratorinë e mirë, fjalët e mira që di t'i shesë mirë. Problemi i shoqërive në Ballkan është se njerëzit kërkojnë gjithmonë një idhull, por duhet ta kuptojnë se duhet ta kërkojnë idhullin në vetvete, e jo tek njerëzit tjerë. Këtu është i rëndësishëm ekipi. Ashtu si në futboll apo në basketboll ku rezultate arrin ekipi i mirë, ashtu edhe në shoqëri duhet të jetë ekipi i mirë.

Si e përjeton ti pajtimin, a e kemi të nevojshëm?

Po, sigurisht është i nevojshëm, kurse pajtimi është para së gjithash respektim. Ai nuk bazohet as në kombësi, as në fe. Ai bazohet në respektimin reciprok. Derisa ne të pëshpërisim, ashtu siç kemi bërë para 50 viteve – ai është serb, ai është musliman, mund të shoqërohesh me ta, por mos krijë kurrfarë lidhjeje – nuk ka aty pajtim të vërtetë. Kur ta shikojmë njeriun si njeri atëherë ekziston shansi që të arrihet pajtimi i vërtetë.

Më lehtë është të thuash se është fajtor ky apo ai për gjendjen time, kurse unë më së paku jam aty fajtor, dhe ta paraqesësh veten gjithmonë si njëfarë viktime. Njerëzit duhet të pushojnë të mendojnë se janë viktimë e diçkaje dhe të fillojnë ta ndryshojnë këtë.

Çfarë frike ekziston, sipas mendimit tënd, pse janë njerëzit skeptikë kur bëhet fjalë për pajtimin?

Njerëzit frikohen, por as vetë nuk e dinë se nga çfarë frikohen. Ata thjesht frikohen dhe kjo është e tillë në natyrën njerëzore. Në qoftë se njeriu nuk është i ngritur dhe nuk është vetja, në qoftë se nuk i respekton emocionet e tij dhe emocionet e njerëzve tjerë, gjithmonë do të frikohet nga ndryshimet, nga diçka e re ku do të duhet të ngritet. Ndonëse, kur dëgjohet fjala pajtim, asociacioni i parë është – çfarë më duhet mua të pajtohem tani, të krijojme përsëri njëfarë vëllazërim-bashkimi... Në flamarin francez qëndron e shkruar në përkthim – liria, vëllazërimi dhe bashkimi. Në vëllazërim-bashkimin si koncept të përgjithshëm në civilizim nuk ka asgjë të keqe. Sipas mendimit fetar njeriu është vëlla i njeriut dhe kjo e ka kuptimin e vet dhe nuk duhet të kërkojmë shkas dhe shkaqe të pakuptueshme që të urrehemi ndërmjet njëri-tjetrit. Njerëzit frikohen, kurse shkas për urrejtje është lehtë të gjendet. Nëse nuk është kombësia, atëherë është se ai e ka ndërtuar murin, ndërsa unë nuk dua ta kem murin para vetes; gjithmonë ka një varg gjërash që të urrehet për shkak të diçkaje.

Si e shikon ti përgjegjësinë e palës kroate e si të asaj serbe në procesin e pajtimit?

Unë dua të flas vetëm për palën time. Pala serbe duhet ta sqarojë me vetveten problemin e saj, jo t'ia sqaroj unë. Unë mund t'i përkrahë duke vepruar, duke folur me ata njerëz, t'ju tregoj mënyrën se si unë e bëj këtë, si punojmë në organizatë, kështu që ata ndoshta të shikojnë mënyrën se si ata mund të punojnë. Nuk më takon mua ta drejtoj gishtin. Më lehtë është të thuash se është fajtor ky apo ai për gjendjen time, kurse unë më së paku jam aty fajtor, dhe ta paraqesësh veten gjithmonë si njëfarë viktime. Njerëzit duhet të pushojnë të mendojnë se janë viktimitë e diçkaje dhe të fillojnë ta ndryshojnë këtë.

Çfarë do të na sillte si shoqëri pajtimi?

Sikur të punohej në respektimin e njeriut ndaj njeriut dhe respektimin e të drejtave të njeriut kjo do të kishte shumë rëndësi për këtë shtet, por edhe për shtetet fqinje, dhe do të jepte një garanci të fuqishme se kjo që ka ndodhur tani dhe që ka ndodhur gjatë Luftës së Dytë Botërore, nuk mund të përsëritet aq lehtë. Kjo është garanci e paqes.

S. D.

Cili është raporti Juaj ndaj luftës tani, 10 vjet pas?

Dhjetë vjet pas luftës ndihem e mjerë. Luftën e kujtoj për ecjen në këmbë nga 12 km në ditë për të shkuar në punë me qëllim të shpëtimit të jetës së tjerëve, e kujtoj për qëndrimin në radhë për ujë nga 5 orë që të mbushi dy bidonë nga 10 litra, të cilët kur vija në shtëpi i përdorja për të bërë dush, për të larë rrobat, ndërsa të nesërmen bëja të njëjtën gjë. E kujtoj për ndarjen në mëngjes nga fëmija dhe mendimi se athua do ta shohë përsëri atë apo ai mua. Më kujtohet kur fqinja më lajmëroi se godina jonë ishte granatuar dhe se kulmi ishte dëmtuar, gjëja e parë që kam menduar ka qenë se nuk do të arrij të ruajë asnjë fotografi të fëmijës nga ditët e tij të hershme. Dhe të kalohen të gjitha këto, për çfarë!

Çfarë është për Ju pajtimi?

Unë nuk e kam ndjenjën se duhet të pajtohem me dikë sepse nuk jam e hidhëruar me askënd, ndërsa nëse do të më pyeste dikush, kjo luftë as që do të ndodhte.

Cilat janë kushtet për t'u pajtuar?

Përsëri do të përmendi situatën financiare sepse në qoftë se njerëzit do të kishin para të mjaftueshme që të shkonin në teatër, kinema, udhëtime, as që do t'u shkonte ndërmend ta kujtonin më luftën dhe pasojat e saj. Situata financiare stabile e drejton çdo individ kah pajtimi.

Kush duhet të punojë për pajtim?

Për pajtim duhet të punojë ai që e udhëheq shtetin, por jo pa ndihmën tonë individuale.

Cilat janë problemet në të cilat mund të hasë procesi i pajtimit dhe a janë njerëzit të gatshëm për t'u pajtuar?

Nuk e di. Për pajtim është vështirë të bisedohet me njerëz të cilët kanë humbur, për shembull, anëtarët më të afërt të familjes. Atyre do t'u duhet shumë më tepër kohë që të fillojnë të mendojnë për pajtimin. Ndërsa tek unë ky proces ecen më shpejt sepse në luftë kam qenë e kursyer nga rastet e papëlqyeshme të këtij lloji.

Çfarë mendoni se mund të bëjnë “njerëzit e thjeshtë”?

Njerëzit e thjeshtë mund të bëjnë shumë pak në planin politik. Gjëja e vetme që iu mbetet është pranimi i njëri-tjetrit, toleranca dhe bashkejetesa.

Si duhet të sillemi ndaj të kaluarës dhe a duhet ta harrojmë tërë këtë?

Kujtimi im i tanishëm ndaj luftës është banesa e devastuar, e cila është në fazën e adaptimit. Lufta që ka ngjarë është pjesë e pandashme e historisë sonë dhe në qoftë se për asgjë tjetër, duhet t'u shërbejë si kujtesë gjeneratave të ardhshme. Harresa në do rast nuk vjen në konsideratë.

Në qoftë se do të ndodhte pajtimi, çfarë do të ndryshonte në jetën Tuaj?

Mendoj se pajtimi çon drejt prosperitetit ekonomik të rajonit, ndërsa kjo drejt

Më kujtohet kur fqinja më lajmëroi se godina jonë ishte granatuar dhe se kulmi ishte dëmtuar, gjëja e parë që kam menduar ka qenë se nuk do të arrij të ruajë asnjë fotografi të fëmijës nga ditët e tij të hershme. Dhe të kalohen të gjitha këto, për çfarë!

mirëqenies së çdo individi, gjë që në një farë dore është në interes të secilit prej nesh.

A duhet të shikohet faji vetëm te njëra palë?

Mendoj se jo sepse për çdo luftë nevojiten dy apo më shumë palë. Secila nga ato palë ka të vërtetën e vet dhe arsyet për luftë, kurse cila është e vërteta globale do ta tregojë koha.

A është faji individual apo kolektiv?

Po, një kolektiv e përbëjnë individët, kështu që shikimi i ndarë i palëve në këtë rast nuk është i mundur. Ajo që nuk duhet bërë është vështrimi i një kombi përmes krimeve të disa individëve që i përkasin atij kombi.

A mendoni se të gjithë ne bartim një pjesë të fajit?

Unë personalisht nuk ndihem fajtorë! Jam fajtorë nëse kam dashur të mbijetoj, t'u ndihmoj njerëzve tjerë që të mbijetojnë dhe për faktin se kam qëndruar këtu dhe në vendin e punës e kam kaluar tërë luftën. Më vjen keq që ajo luftë është bërë në emrin tim, kurse askush nuk më ka pyetur nëse e dua apo jo.

Çfarë përgjegjësie mendoni se kanë pasur mediat?

Mediat në luftë kanë qenë vetëm kukulla të drejtuara nga njerëzit me influencë. Ato na kanë krijuar vetëdijen për armikun, aleatët dhe mendoj se askush në atë moment nuk ka pasur kohë që të merret me vërtetësinë e gjërave, të cilat na janë servirur. Mendoj që tani është koha më e përshtatshme për këtë.

Për fund, si e shihni të ardhmen e rajonit tonë?

Po, nuk e di! Përparimi i ngadaltë i situatës ekonomike, krijimi i një lloji tregu të përbashkët, i cili i shkon përshtat marrëzisë së luftës së kaluar.

V. E.

Për çdo luftë nevojiten dy apo më shumë palë. Secila nga ato palë ka të vërtetën e vet dhe arsyet për luftë.

Për fillim më trego diçka për veten, si do të prezentoheste?

Quhem Nina, jetoj në Beograd dhe jam 42 vjeçe. Punoj në Ministrinë për Investime Kapitale dhe përveç kësaj jam edhe aktiviste e paqes.

Kur i kujton vitet '90, çfarë është gjëja e parë që të shkon ndër mend?

E para gjë që më shkon ndër mend janë, ta zëmë, protestat, lufta, frika dhe shpresa.

Frikë nga kush?

Për shkak se jeta është bërë çdo ditë e më e keqe, sepse njerëzit kanë humbur jetën, sepse një pjesë e kohës është shënuar nga mungesa e shpresës dhe ndjenja e pafuqisë. Ndjenja e pafuqisë ka qenë... shumë e pranishme. Dhe ndjenja se jam e vetmuar në këtë gjë, nuk jam ndier pjesë e mjedisit, jam ndier thjesht e huaj, sikur ky nuk është vendi im, qyteti në të cilin kam jetuar deri atëherë dhe të cilin e dua. Po ashtu, më kujtohet se gjithmonë ka qenë e pranishme dilema, të qëndroj apo të largohem. Po ashtu edhe ndjenja e familjes së ndarë. Gjysma e familjes ka mbetur në Kroaci, lidhjet kanë qenë të ndërprera. Ndërsa vëllai ka qenë jashtë vendit dhe nuk ka mundur të kthehet. E kam pasur shumë vështirë edhe ta vizitoj. Nuk ka mundur të kthehet sepse nuk ka dashur të shkoj në luftë. Kam menduar se kjo është gjë e mirë, nga njëra anë jam gëzuar që ai është atje, kam menduar se atje është i mbrojtur nga lufta, nga dhuna, nga policia e cila shpesh e ka kërkuar dhe e ka përkujtuar për detyrimet e tij ndaj regjimit; në të vërtetë ata e kanë quajtur ndryshe. Këto janë disa ndjenja dominuese... mendoj se pafuqia ka qenë më e pranishme.

Si je ballafaquar me të në atë kohë?

Ajo ka qenë, disi... është varur nga dita, viti, kam kaluar nëpër faza të ndryshme. Kam pasur ndjenjë konstante se unë nuk mundem, pavarësisht sesa vështirë e kam pasur, se nuk mundem dhe nuk duhet t'ia sjellë shpinën asaj çka ndodhte, të mos shikoj televizionin dhe të mos shikoj viktimat. Nuk kam mundur të ndahem prej kësaj, megjithëse tërë këtë e kam përjetuar rëndë. Kam pyetur veten se çfarë mund të bëj unë. Ajo që kam bërë nuk më është dukur e mjaftueshme, nuk kam parë kurrfarë rezultatesh konkrete, thjesht nuk kam parë se diçka ka ndryshuar. Kam parë se edhe njerëzit tjerë bëjnë disa përpjekje, por e gjithë kjo ka qenë njëfarë energjie e shkapërderdhur. Në momente të caktuara ka ekzistuar më shumë shpresë, pas demonstratave dhe zgjedhjeve të caktuara, por në parim ka mbisunduar ndjenja se unë thjesht nuk mundem... Kohë pas kohe kam qenë tërësisht... më kapte një lloj dëshpërimi, mendoja se thjesht duhet të largohesha, por më në fund megjithatë nuk jam larguar. Ndoshta jam frikësuar nga pasiguria, por mendoj se ka mbisunduar njëfarë ndjenje se e kam vendin këtu, se sikur të largohesha kjo do të përbënte arratisje. Nuk ka ekzistuar askush tjetër që mund ta bënte punën tonë. Sikur të ikja, kjo do të thoshte se do t'ia lija punën dikujt tjetër.

Çka është ajo puna jonë?

Sado që është lehtë që t'i vishen të gjitha Millosheviqit dhe njerëzve që kanë marrë pjesë në pushtet, të cilët kanë pasur dobi direkte... Unë çdo ditë kam folur dhe kam parë njerëz të cilët e kanë përkrahur atë haptas, apo ata që nuk kanë bërë asgjë, që nuk kanë folur asgjë. Prandaj mendoj se ne këtu, në Serbi, të gjithë bartim një pjesë të përgjegjësisë. Jo të gjithë përgjegjësi të njëjtë, por...

Njerëzit kanë shkuar edhe para kësaj kohe jashtë shtetit. Por kam menduar se puna jonë është që ta bëjmë këtë shtet vend për jetë, ta humanizojmë, thjesht të bëjmë prej tij diçka tjetër, ta ndryshojmë.

Kush të është dukur përgjegjës për tërë situatën që ka ndodhur në atë kohë?

Më janë dukur të gjithë. Tërë kohën ka ekzistuar një shumicë e qetë e cila nuk ka bërë asgjë. Nga njëra anë, po, ka qenë aty regjimi i personifikuar nga Millosheviqi, por nuk më është dukur se ai është i vetmi, ndoshta as vendimtari, në aspektin e përgjegjësisë. Sado që është lehtë që t'i vishen të gjitha Millosheviqit dhe njerëzve që kanë marrë pjesë në pushtet, të cilët kanë pasur dobi direkte... Unë çdo ditë kam folur dhe kam parë njerëz të cilët e kanë përkrahur atë haptas, apo ata që nuk kanë bërë asgjë, që nuk kanë folur asgjë. Prandaj mendoj se ne këtu, në Serbi, të gjithë bartim një pjesë të përgjegjësisë. Jo të gjithë përgjegjësi të njëjtë, por... Sikur të mos ekzistonin njerëz që kanë votuar për të, apo jo vetëm që kanë votuar, por nuk kanë bërë asgjë, nuk kanë dalë në votime – edhe kjo ka qenë një mënyrë që të evitohet për t'u bërë diçka... Nganjëherë sot dëgjohet se, ja, regjimi ishte i keq. Mendoj se regjimi, respektivisht sistemi, nuk do të mund të funksiononte aq gjatë nëse do të bazohej vetëm në një grusht njerëzish. Millosheviqi ka pasur mbështetje qysh në fillim, e cila, në të vërtetë, është zvogëluar me kohë. Sot duhet t'i shërojmë pasojat e kësaj, t'i ndryshojmë gjërat. Të nisemi nga ky supozim, e jo nga supozimi se një grusht i njerëzve ka qeverisur, kurse të tjerët kanë qenë fatkeq, të pafuqishëm dhe viktimë.

Kur flasim për të kaluarën, çfarë mendon se është më së miri të bëjmë në këtë situatë, si të ballafaqohemi me të? Disa thonë se duhet harruar të gjitha, disa thonë se nuk guxohet dhe nuk mund të harrohet në asnjë mënyrë... Çfarë mendon ti?

Mendoj se definitivisht nuk duhet harruar pavarësisht se për çfarë do të angazhohemi ne tani, nëse bëhet fjalë për bashkëpunim në mënyrë që të sillemi sikur nuk ka ndodhur asgjë, që thjesht t'i kapërcejmë 10 apo 15 vjet, të zhvillojmë marrëdhënie ekonomike apo kulturore. Unë jam patjetër për krijimin e marrëdhënieve, por mendoj se duhet folur për të kaluarën. Nuk besoj se ka njeri që ka jetuar në Serbi, i cili nuk e di vërtet se çfarë ka ndodhur në Kroaci, Bosnjë... që me të vërtetë nuk e di se çfarë ka ndodhur në Srebrenicë. Besoj se njerëzit nuk duan thjesht ta dinë këtë, se e refuzojnë këtë në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme. Për fillim mendoj se duhet me këmbëngulje të flitet për këtë, të shkruhet. Në këtë pjesë ka punë për të gjithë, për mediat, shkollat, organizatat joqeveritare, strukturat shtetërore. Sigurisht që do të duhej të ekzistonte ndonjë program apo plan në nivel shtetëror, por mendoj se kjo do të ecë vështirë... Kjo duhet të jetë temë e diskutimit tonë, duhet të jetë e pranishme sepse ajo që quhet ballafaqim mendoj se nuk mund të ndodhë për një ditë. Më duket se në nivele të ndryshme kjo duhet të jetë gjithmonë objekt i diskutimit, takimeve, aksionit, e cila nuk do të varet vetëm prej strukturave shtetërore, prej komisioneve për hulumtimin e krimeve, për gjetjen e të zhdukurve. Natyrisht, edhe ata duhet të kryejnë punën e tyre. Thjesht, kjo bisedë duhet të jetë e pranishme.

Pse?

Për arsye se njerëzve duhet t'u jepet rasti që t'i dëgjojnë këto, t'i pranojmë, të thonë çfarë mendojnë, që mos ta përjetojnë këtë si diçka që iu imponon dikush.

Më duket se është më e lehtë kur e bind veten se vetëm "të tuajt" janë vrarë, se të tjerët janë vrarë më pak ose, nuk e di... Mendoj se është deri diku më lehtë të ndihesh si viktimë sepse atëherë pret që dikush tjetër të të ndihmojë, t'i kuptojë vuajtjet tuaja, të bëjë diçka për ty, kurse ti nuk duhet të bësh asgjë.

Nëse nuk bëjmë asgjë, nëse e kthejmë kokën në anën tjetër, nëse themi se nuk na intereson politika për arsye se nuk kemi kohë, mendoj se me këtë refuzojmë përgjegjësinë tonë, kurse do të mund të bëjmë gjëra të ndryshme që bëjnë pjesë në ndërtimin e paqes. Mendoj se ndërtim paqeje është edhe nëse përpiqemi të jemi të informuar për atë çfarë ndodh në shoqëri.

Pse mendon se është i rëndësishëm ky ballafaqim me të kaluarën që e përmend?

Mendoj se është e rëndësishme që secili nga ne qytetarët të ketë rastin dhe të dëgjojë diçka që ndoshta nuk e ka dëgjuar ose për atë që e ka ditur se ekziston – të pranojë, të mendojë për të, të mendojë po ashtu për përgjegjësinë e vet, për atë se çfarë ka punuar në atë kohë, si ka vepruar. Sepse, thjesht, kjo është baza e asaj që do të jetë nesër, gjegjësisht cila do të jetë edhe e sotmja, edhe e nesërmja. Mendoj se gjendja, gjegjësisht situata, do të flas vetëm për Serbinë, nuk mund të ndryshohet vetëm me faktin se Serbia do t'i afrohet Bashkimit Europian. Situata duhet të ndryshojë përbrenda, duhet të ndryshojë vështrimi ynë për përgjegjësinë ndaj shoqërisë dhe për atë çfarë është bërë. Në fund të fundit, ne të gjithë ndikojmë se çfarë rruge do të ndjekë shoqëria jonë dhe si do të jetë ajo në të ardhmen. Të mos jetë më e mundur që dikush si Millosheviqi, një manipulues, demagog, nacionalist i pafytyrë, të fitojë përkrahjen e shumicës. Do të thotë, ky shtet të mos shkojë më kurrë në luftë, që ushtria e tij të mos vrasë pjesëtarë, gjegjësisht qytetarë të shteteve tjera dhe që qytetarët e tij të vriten. Mendoj se kjo është me rëndësi edhe për shkak të fqinjëve tanë, por edhe për vetë Serbinë, pavarësisht se brenda cilëve kufij dhe më kë do të jetojmë, të pavarur apo me Malin e Zi, mos t'i hapi këto çështje.

Më trego, çfarë është për ty pajtimi?

Nuk jam tamam e sigurt. Ky term më duket pak i habitshëm. Për mua personalisht... Unë nuk e kam ndjenjën se jam grindur me dikë. Nëse pajtim do të thotë që ne të mos urrejmë, ne – qytetarët e këtij shteti, të mos kemi paragjykitime ndaj të tjerëve... Ndoshta pajtimi është që të jemi të aftë t'i pranojmë faktet kur i dëgjojmë. Ta zëmë, faktet për viktimat, për Srebrenicën, e të mos kemi nevojë që... gjë që e dëgjoj shpesh, që njerëzit nuk dëshirojnë të dëgjojnë atë që është vërtetuar si fakt, por i lakojnë ato. Thonë se në Srebrenicë nuk janë vrarë shtatë apo tetë mijë njerëz, por dy mijë. Gjërat e tilla... Mos t'i përmendin gjithmonë vetëm viktimat serbe.

Çka mendon se është shkak i kësaj?

Njëri është shmangia e përgjegjësisë, tjetri është... Më duket se është më e lehtë kur e bind veten se vetëm “të tuajt” janë vrarë, se të tjerët janë vrarë më pak ose, nuk e di... Mendoj se është deri-diku më lehtë të ndihesh si viktimë sepse atëherë pret që dikush tjetër të të ndihmojë, t'i kuptojë vuajtjet tuaja, të bëjë diçka për ty, kurse ti nuk duhet të bësh asgjë.

Sa është e rëndësishme, sipas teje, puna në ndërtimin e paqes dhe pse?

Mendoj që është e rëndësishme, natyrisht që është e rëndësishme. Kjo është aq e rëndësishme, sa ç'është e rëndësishme hyrja e Serbisë në Bashkimin Europian, ose që së paku t'i afrohet hyrjes në të. Ne duhet ta ndryshojmë këtë shoqëri dhe mendoj se kjo është rruga. Ta ndryshojmë në atë kahje që të jetë shoqëri e qytetarëve të barabartë, jo vetëm e serbëve. Serbia është vend i cili ka një përqindje të madhe të qytetarëve që nuk i takojnë komunitetit etnik serb. Më ka penguar shumë në kohën e Millosheviqit dhe m'i ka vrarë veshët (mund ta imagjinoj sesi është ndier dikush që nuk ka qenë serb ose serbe) – kur është folur vetëm për popullin serb... gjithmonë dëgjonim “populli serb don këtë, don atë”, kurse askush nuk të pyet nëse mund të flasë në emrin tënd.

Mendoj se ndërtimi i paqes është i rëndësishëm që kjo shoqëri të jetë stabile, që në të, të gjithë njerëzit të mund t'i realizojnë potencialet e veta, të kenë shanse të barabarta, të jetë shoqëri e të drejtës sociale në të cilën do të kenë të gjithë të drejta të

barabarta, për shkollim, shëndetësi, të drejtën e jetës, të drejta që, në fund të fundit, u janë rrezikuar shumicës deri në vitin 2000.

Çka është ndërtimi i paqes për ty?

Mendoj se kjo nënkupton shumë gjëra që çdokush prej nesh, pjesëtarëve të kësaj shoqërie, mund t'i bëjë. A është kjo që të reagojë kur, ta zëmë, një fëmijë rom e nxjerrin jashtë nga autobusi apo kur dikush niset ta godasë... të reagojë ndaj padrejtësisë, të reagojë ndaj gjuhës së urrejtjes, të luftojë kundër korrupsionit, të organizojë protestë, të shprehë mendimin e vet. Mendoj se kjo është ajo si dhe shumë aksione individuale, nuk flas vetëm për aktivistët paqësorë që punojnë në organizata... Shumë prej nesh mund të bëjnë diçka dhe aty shihet përgjegjësia jonë. Nëse nuk bëjmë asgjë, nëse e kthejmë kokën në anën tjetër, nëse themi se nuk na intereson politika për arsye se nuk kemi kohë, mendoj se me këtë refuzojmë përgjegjësinë tonë, kurse do të mund të bëjmë gjëra të ndryshme që bëjnë pjesë në ndërtimin e paqes. Kjo është një gjë që askush nuk mund të na e sjellë, nuk mund ta sjellë as vetë prosperiteti ekonomik, kur të realizojmë nuk e di se çfarë të ardhurash për banorë. Ky është një proces afatgjatë dhe varet nga të gjithë ne. Mendoj se ndërtim paqeje është edhe nëse përpiqemi të jemi të informuar për atë çfarë ndodh në shoqëri, në vend që të themi “nuk më interesojnë lajmet”, “dua ta pushoj trurin”. Po, ndonjëherë është e nevojshme ta pushoj trurin, por dua të di se kush më përfaqëson, për shembull në Kuvend, si dhe nuk dua të votoj për partinë që ka në program diskriminimin e të gjithëve që nuk janë serbë. Nuk dua të votoj për dikë që mbron të akuzuarit për krime lufte. Mendoj se edhe kjo përbën ndërtim të paqes. Por gjithsesi edhe disa aksione të menduara, të koordinuara të cilat duhen t'i lëvizin njerëzit. A bëhet fjalë për aksionin kundër anëtarësimit të Serbisë në NATO apo për ndonjë aksion tjetër, mendoj se ekzistojnë shumë aksione të tilla.

Përmende se je kundër hyrjes së Serbisë në Paktin NATO. Pse?

Ekzistojnë shumë shkaqe racionale në aspektin se çfarë do të thoshte kjo për buxhetin e Serbisë, çfarë obligimesh imponon anëtarësimi në këtë organizatë. Në opinion nuk ekzistojnë shumë informacione objektive se çfarë do të thoshte hyrja në NATO, por kjo shitet në paketë – nëse dëshirojmë të jemi në BE, atëherë duhet të hyjmë në NATO. Unë mendoj se nuk është kështu. Besoj se kjo hapësirë duhet të jetë e çmilitarizuar. Hyrja e Serbisë në NATO do t'i forconte strukturat militariste në këtë shoqëri. Ne kemi trashëgiminë me të cilën, thjesht duhet të luftojmë që këtë shoqëri ta lirojmë nga ndikimi i tillë. Mendoj se hyrja në NATO nuk do t'i kontribuonte kësaj definitivisht. Në mes tjerash, NATO-ja e ka bombarduar këtë vend... disisi do të më dukej si shaka e vrazhdë që Serbia të hyjë në këtë organizatë. Do të ishte mirë që njerëzit të kenë në dispozicion sa ma shumë informata objektive kur të merret vendimi për hyrjen në NATO.

Si e ke përjetuar bombardimin? Ka njerëz që mendojnë se kjo ka qenë mënyra e vetme që të përmbysët regjimi i atëhershëm. Si e ke shikuar ti bombardimin atëherë apo si e shikon tani?

Unë kam qenë definitivisht kundër bombardimit. Nuk mendoj se kjo ka qenë mënyrë që të përmbysët regjimi. Regjimi nuk ka qenë kurrë më i fortë se në atë moment. Më është dukur plotësisht absurde që dikush të më dëbojë me bomba nga shtëpia në mënyrë që t'i sjellë dikujt tjetër diçka të mirë, nëse në përgjithësi me bomba mund të sillet ndonjë e mirë. E di se çfarë i ka paraprirë kësaj dhe me çfarë është arsyetuar në fund ai operacion, pra se është dashur të përmbysët Milloshevi-

Puna për të mirën e përgjithshme kurrë nuk është vlerësuar këtu në masë të madhe, ne nuk e kemi atë traditën e angazhimit shoqëror e cila nuk sjell dobi direkte. Unë edhe vetë kam qenë më parë e mashtruar duke menduar se çdo angazhim shoqëror – marrja me politikë, nga kjo kam pasur neveri sepse nuk kam dashur të jem e fëlliqur nga politika. Por politika është çdo gjë, jeta e zakonshme është politikë: sa do ta kemi pagën, çfarë do të mësojnë fëmijët në shkollë, a do të hamë ushqim të helmuar apo të freskët – tërë kjo është politikë.

qi, gjegjësisht se është dashur të ndërpritet represioni i regjimit në Kosovë. Kjo është njëra prej gjërave kundër të cilave kam qenë; me vite kam marrë pjesë në protestat kundër regjimit, kundër luftërave që i ka udhëhequr ky regjim dhe represionit që ka bërë ndaj popullatës shumicë shqiptare në Kosovë. Mirëpo, mendoj se bombardimi nuk ka qenë definitivisht mënyrë e mirë. Jo vetëm që janë shkatërruar objektet civile, infrastruktura, por të gjithë ata që kanë qenë kundër Millosheviqit – e kanë humbur pozitën që kanë pasur. E di se unë jam ndier e vetmuar, e hutuar... Nga ajo botë për të cilën kam besuar se jam pjesë e saj, në aspektin e vlerave për të cilat kam besuar se janë të përbashkëta – kanë ardhur bombat. Thjesht, këtë nuk kam mundur ta kuptoj. E di që askush nga njerëzit rreth meje nuk ka mundur ta pranojë këtë.

Çfarë sheh si pengesa kryesore në punën për ndërtimin e paqes?

Mendoj se kjo shoqëri prej një nacional-socializmi të shtrembëruar, si ta quaj, ka hyrë pas vitit 2000 në njëfarë tranzicioni dhe njerëzit janë varfëruar në atë proces, shoqëria thjesht është ndarë në mënyrë ekstreme në një shtresë të vogël të pasurish dhe në një numër të madh të atyre që mezi e sigurojnë ekzistencën. Në kushte të tilla, shumë njerëz do të thonë se ata nuk kanë kohë të merren me çfarëdo gjëje që nuk ka të bëjë me sigurimin e ekzistencës së tyre. Këtë mund ta kuptoj deri diku. Por mendoj se kjo nuk është pengesa e vetme. Mendoj se pengesa janë, në mes tjerash, mediat, situata në to, kurse nganjëherë edhe vetë njerëzit që punojnë në media. Një prej pengesave është edhe situata në shkollim, pastaj disa struktura të trashëguara, të cilat nuk janë transformuar mjaft. Shkollimi në një periudhë të socializmit, e di sepse kam shkuar në shkollë në atë kohë, nuk na ka arsimuar mjaft që t'i kuptojmë proceset shoqërore, mënyrën sesi funksionon shoqëria, ndoshta edhe kjo është pjesë e pengesave. Në këtë kuptim mediat do të mund të luanin rolin që në fakt nuk e luajnë. Një prej pengesave janë organet e pushtetit. Shpesh ato nuk ekzistojnë apo ligjet miratohen me vonësë. Mendoj se këtu mungon vullneti politik. Sidoqoftë, mendoj se ka mjaft hapësirë që të bëhet diçka, madje edhe nëse nuk ekziston mbështetja prej vetë strukturave. Ajo që mua më ka lënë përshtypje pas vitit 2000 kur Millosheviqi më në fund i humbi zgjedhjet dhe u desh të tërhiqej është se është zhdukur frika. Unë kam qenë shumë e pakënaqur me shpejtësinë e ndryshimeve dhe e frustruar, le të them, sepse kam menduar se gjërat do të lëvizin më shpejt. Nuk kanë mundur dhe këtë e kam të qartë. Por është zhdukur frika dhe njëfarë represioni direkt, kështu që ka hapësirë për të punuar megjithëse mungon përkrahja institucionale.

A mendon se punohet mjaft?

Supozoj se gjithmonë mund të punohet më tepër. Sigurisht që nuk punohet mjaft. Ndoshta njerëzit nuk kuptojnë se nga kjo mund të kenë dobi, jo në kuptimin material, por që mund të jetojnë më mirë, do të thotë jo vetëm të kenë paga më të mëdha. Ta zëmë, shpesh dëgjoj nga femrat, që janë më pak të paguara për të njëjtën punë se meshkujt, sesi i përkrahin politikanët seksistë dhe shovinistë mashkullorë. Dhe këtë nuk e kam të qartë.

Mendoj se mungon ajo vetëdija se ndonjë aksion prodhon rezultat, si dhe që askush nuk do të na sjellë këtë rezultat. Do të thotë lidhja ndërmjet mundit që investojmë dhe ndryshimeve që do të arrihen është aksioni që do ta realizojmë ne, e jo dikush tjetër. Ndoshta kjo është trashëguar nga socializmi – puna për të mirën e përgjithshme kurrë nuk është vlerësuar këtu në masë të madhe, ne nuk e kemi atë



traditën e angazhimit shoqëror e cila nuk sjell dobi direkte. Unë edhe vetë kam qenë më parë e mashtruar duke menduar se çdo angazhim shoqëror – marrja me politikë, nga kjo kam pasur neveri sepse nuk kam dashur të jem e fëlliqur nga politika. Por politika është çdo gjë, jeta e zakonshme është politikë: sa do ta kemi pagën, çfarë do të mësojnë fëmijët në shkollë, a do të hamë ushqim të helmuar apo të freskët – tërë kjo është politikë. Më duket se mungon vetëdija që munda, energjia, resurset që i investojmë, do të na kthehen përmes ndryshimit të gjendjes drejt së mirës, por kjo nuk presupozon vetëm “unë do ta kem pagën më të madhe” ose do të jem në pozitë më të mirë.

Përmende tmerret e luftës. Kur e vështron tërë situatën, sa mendon se është i mundur në përgjithësi pajtimi?

Mendoj se është, definitivisht. Disa njerëz, një përqindje e vogël, nuk do të pajtohen kurrë. Por kjo nuk duhet të jetë vendimtare në kuptimin se nëse dikush ngurron që të bëjë diçka apo jo. Mund të them se është i mundur sepse kam kontaktuar me njerëz, kam folur, kam kaluar kohë, kam bashkëpunuar me njerëz nga Bosnja dhe Kroacia, nga Kosova, me njerëz që janë bërë miqtë e mi, e që nuk i kam njohur më parë. Mendoj se njerëz të tillë ka edhe në Serbi, edhe në vende tjera, pra, që besojnë se pajtimi është i mundur dhe që bëjnë diçka në këtë drejtim. Por, kjo është po ashtu punë e të gjithë neve. E di, sa herë që kam udhëtuar, në Bosnje, për shembull, njerëzit më kanë pyetur sesi jetohej atje, a ka punë, si është jeta në përgjithësi. Ishte kjo nga kureshtja, kemi jetuar në një shtet, kështu që kjo është normale. Nga njëra anë kjo më shtyen të vazhdoj – kur e shoh se nuk jam vetëm, gjë që ka qenë njëfarë ndjenje e imja dominante gjatë një sërë vitesh; sado që kam marrë pjesë në protesta, kur kthehesha në shtëpi, ndizja TV dhe ndihesha se unë nuk i përkas këtij vendi, se jetoj në ankthin e natës dhe se ky është realiteti i shtrembëruar. Tani e shoh se ekzistojnë edhe njerëz të kombësive, religjioneve tjera, të cilët flasin bile edhe gjuhë tjetër, kurse ne të gjithë besojmë në të njëjtën gjë, e kjo është se mund të

jetojmë normalisht, se nuk jemi të destinuar në konflikte, se nuk e kemi këtë në gjene, siç mund të dëgjohet. Të gjitha lufërat e zhvilluara nuk burojnë nga fakti se konfliktet me popujt tjerë kanë qenë veçoria jonë.

Çka mendon se duhet të bëjë shoqëria në Serbi me qëllim të arritjes së pajtimit? Çka pret nga shoqëria në të cilën jeton?

Pres që të ndalohet falsifikimi i fakteve. Po ashtu të ndalohen gënjeshttrat dhe të mos bëjmë sikur nuk dimë gjë. Ndihej vërtet keq kur e shoh këtë. Përmenda Srebrenicën, të gjithë e dimë se çfarë ka ndodhur atje, se ka pasur aq shumë viktima, por përsëri pak-ngapak në gazeta, përsëri dikush gjërë e gjatë e konteston. Do të thotë, pres të ndalen gënjeshttrat, falsifikimet, si dhe që ata që kanë bërë krime të fshehen pas nesh. Dhe që kjo të prezentohet se me faktin që do t'ia dorëzojmë Gjykatës së Hagës, ne pranojmë njëfarë humbjeje. Mendoj se është humbje të mos ballafaqohemi me to, të mos i nxjerrim para gjyqit. Këto përpjekje që të vazhdojmë të jetojmë në gënjeshtra dhe mashtrime përbëjnë për mua vazhdimësi me kohën e Millosheviqit. Mendoj se kjo është shumë keq. Mbi baza të tilla nuk mund të ndërtohet kurrfarë ardhmërie.

Çfarë pret nga kroatët, boshnjakët, shqiptarët?

Mendoj që edhe ata duhet të bëjnë të njëjtën gjë, që nuk duhet askush nga Beogradi t'ju thotë se kush janë kriminelët e tyre. Ajo për çfarë angazhohem dhe bëj kur i emërtoj gjërat me emrin e tyre të vërtetë, se krimi është krim, kurse ai që e ka bërë është i dyshuar ose kriminel, pres që e njëjta gjë të bëhet edhe në ato mjedise. E di që edhe punohet. Ky është një proces, i cili do të zgjasë, si këtu tek ne ashtu edhe atje. Mendoj se është detyra e çdokujt që të merret me atë çfarë ka ndodhur në shoqërinë e tij.

Cila prej palëve të përmendura është sipas teje përgjegjëse për atë çfarë ka ndodhur?

Nuk ekziston definitivisht një palë përgjegjëse. Të gjitha palët kanë pjesën e vet të përgjegjësisë. Fatkeqësisht, është dashur të ngritet Tribunali i Hagës që t'i gjykojë ata kriminelë. Me sa di, situata në Serbi nuk është e tillë, ta zëmë në gjykatë, që ata të gjykohen këtu, gjegjësisht që të kenë gjykim të ndershëm. Mendoj se e njëjta situatë ekziston edhe në Kroaci, edhe në Bosnjë, edhe në Kosovë. Edhe pse është kështu, atë që do të mund ta bënte cilido prej këtyre mjedisëve është që të flasin, të shkruajnë, që kjo të jetë e pranishme në opinion nëpërmes dialogut shoqëror, që kjo të jetë objekt i interesimit, të mos fshehet, të mos shtrembërohet, të mos shmanget... Definitivisht nuk mendoj se vetëm njëra palë është përgjegjëse. Për mua më e rëndësishmja është përgjegjësia e palës serbe. Thjesht, unë jam pjesë e këtij mjedisi dhe mendoj se për të gjithë ne duhet të jetë kjo më e rëndësishmja. Të mos merremi, gjegjësisht të mos përcaktojmë ne nga Serbia përgjegjësinë e të tjerëve. Sa i përket gjetjes së dëshmive dhe të gjitha gjërave përcjellëse, mendoj se gjithsesi duhet të ekzistojë bashkëpunimi. Nuk duhet ne, pra Serbia, të fshehë të akuzuarit e vet. Sa është e gatshme çdonjëra prej këtyre shoqërive që të investojë në bashkëpunimin për kapjen e njerëzve të dyshuar për krime lufte – kjo është baza për të ardhmen. Kjo është baza për llojet tjera të bashkëpunimeve të ardhshme. Është shumë e rëndësishme që bashkëpunimi ynë të mos reduktohet në shkëmbimin e koncerteve të artistëve të muzikës popullore apo çfarëdo muzike tjetër.

A mendon se ekziston faji kolektiv?

Definitivisht nuk mendoj se vetëm njëra palë është përgjegjëse. Për mua më e rëndësishmja është përgjegjësia e palës serbe. Thjesht, unë jam pjesë e këtij mjedisi dhe mendoj se për të gjithë ne duhet të jetë kjo më e rëndësishmja. Të mos merremi, gjegjësisht të mos përcaktojmë ne nga Serbia përgjegjësinë e të tjerëve.

Mendoj se nuk ekziston. Çështja e fajit dhe e përgjegjësisë ka qenë për mua e paqartë një kohë të gjatë. Shumë njerëz në Serbi nuk kanë vrarë askënd dhe në këtë aspekt ata nuk janë fajtorë për ndonjë krim. Por me disa sjellje dhe veprime të veta, kur e them këtë mendoj edhe për veten, janë përgjegjës që situata ishte ashtu siç ishte, që ai regjim ka mbijetuar... Kështu që këtu do të bëja dallim, faji dhe përgjegjësia nuk janë e njëjta gjë. Çdokush prej nesh nuk mban përgjegjësi të njëjtë, por mban një pjesë të përgjegjësisë në vete... Kur i dëgjoj njerëzit duke thënë “Kroatët janë popull i gjenocidit”, kurse ata vetë kanë qenë aty, nuk kanë marrë pjesë në asgjë, nuk u ka interesuar politika, natyrisht se mbajnë përgjegjësi.

Çfarë shpreson? Si e sheh të ardhmen e këtij rajoni apo shoqërisë në të cilën jeton?

Shpresat nuk janë gjithmonë të njëjta. Ndonjëherë kam qenë pak më skeptike sa i përket të ardhmes, gjegjësisht ndryshimeve pozitive, ndonjëherë më pak. Shpresoj se kjo shoqëri, flas vetëm për atë serbe, do të bëhet normale. Nuk e di se kur. Shpresoj se nuk do të ketë më luftëra. Do të doja që Serbia të mos jetë pjesë e Paktit NATO. Do të doja që të mund të udhëtonim pa pengesa, në mënyrë që shumë njerëz të mund të shohin sesi është jeta matanë kufirit, në atë pjesë që dikur ka qenë Jugosllavi, sepse shumë njerëz nuk kanë pasur rast ta shohin. Shpresoj po ashtu se nuk do të kemi kurrë më televizion, siç e kemi pasur, se do të mund të gjej informacionet e nevojshme, duke mos u dashur të lexoj midis radhëve.

Momentet kur kam më tepër shpresë janë ato kur shoh diku ndonjë lëvizje pozitive, e këto janë shpesh momentet kur unë kam bërë diçka ose kur e di se njerëzit nga mjedisi im kanë bërë diçka. Atëherë ndihem më mirë dhe e ardhmja më duket më afër. Ndihej më mirë kur e di se nuk rri ulur dhe pres

Thesqove se çfarë shpreson kur bëhet fjalë për të ardhmen. Por nga kush pret që ta bëjë këtë?

Thjesht, e ardhmja është çështje e ne të gjithëve. Kjo tingëllon si ndonjë parullë, por definitivisht besoj në të. Kush nuk e kupton këtë – shmanget nga përgjegjësia e vet. Kush do të na e sjellë të ardhmen – definitivisht është punë që na takon ne të gjithëve, çdokush mund të bëjë diçka. Për këtë nuk duhet të jetë posaçërisht aktiv, mund të punojë në vendin e tij të punës, në familjen e tij, ky është grumbull i gjërave të vogla... Kjo është ajo sesi sillemi çdo ditë dhe a do t'i kontribuojmë diskriminimit apo do të reagojmë, apo do ta kthejmë kokën në anën tjetër. Kjo është definitivisht çështje e të gjithë neve.

I. F.

Si ndihesh 10 vjet pas mbarimit të luftës?

Ndihem mirë, por jo i kënaqur. Mendoj që duhet bërë edhe më shumë, për ç'gjë do të na duhen edhe 10 vjet të tjera.

Për çfarë e kujton luftën?

Kam përjetuar vetëm një pjesë të luftës sepse nuk kam qëndruar tërë kohën në Bosnjë e Hercegovinë. Por, në kujtesë më kanë mbetur dy ngjarje. Kam qenë nxënëse, ishim të ulur në bankat shkollore kur filloi granatimi dhe mësuesja bërtiti "Ha-jde të gjithë nën banka". Kështu i kemi kaluar dy orë, pas të cilave erdhi nëna ime dhe më nxorri nga shkolla, megjithëse ende vazhdonte granatimi. Shkolla ndodhej afër kishës, që ishte objektivi i këtij granatimi. Ky është një kujtim personal i luftës. Në anën tjetër, luftën e kujtoj për diçka krejt të padobishme që nuk i ka sjellë asgjë askujt. Janë vrarë disa dhjetëra mijëra njerëz, është sulmuar pa pretekst një shtet... dhe në fund ndodhemi aty ku kemi qenë në vitin 1991.

Çfarë nevojitet që të zbuten apo të eliminohen pasojat e luftës?

Nevojitet përballja me krimin, që secili ta kuptojë se çfarë ka ndodhur e jo vetëm përballja me individualen, me atë që dikush e ka përjetuar, por përballja me atë çfarë kanë përjetuar të tjerët dhe vetëm në bazë të kësaj ne mund të lëvizim kah një lloj drejtimi të pajtimit.

Çfarë është për ty pajtimi?

Për mua fjala pajtim është vështirë të definohet, por ajo për mua do të thotë që ne mund të jetojmë bashkë në mënyrë normale, që kur unë si boshnjak të vij në Banja Lukë askush të mos më shikojë me sy të keq, që askush të mos thotë: "Shiko atë serbin". Me rëndësi është që ta çmojmë njëri-tjetrin, që të mos më shikojnë si pjesëtar të një grupi dhe që mua, si individ, të më ofrojnë mundësi të jetoj, thjesht, jetën time siç dëshiroj ta jetoj këtu. Unë personalisht veç e kam përjetuar pajtimin dhe e zbatoj atë maksimalisht në jetën time.

Çfarë përbën për ty parakusht për pajtim?

Duhet të dënohen ata që e kanë merituar këtë dënim në mënyrë që pala tjetër të mund po ashtu të pajtohet. Secili për vete duhet ta definojë këtë. Unë për vete veç e kam bërë këtë.

Në çfarë problemi mendon se mund të hasë procesi i pajtimit?

Njëri ndër problemet kryesorë është se nuk ekziston komunikimi, pra nuk ekziston fare dialogu. Në rastin e Bosnjë e Hercegovinës konkretisht, të tri palët e paraqesin veten si viktimë dhe nuk duan t'i shohin të tjerët. Mendoj se të gjithë duhet të përballen me atë se çfarë u kanë bërë të tjerëve, por edhe me atë se çfarë të tjerët të kanë bërë ty.

A mendon se njerëzit e duan pajtimin?

Mendoj se njerëzit e duan pajtimin. Çdo njeri që mendon me arsyen e vet të shëndoshë e din se vetëm përmes pajtimit mund të bëhet njëfarë përparimi në

Ajo për mua do të thotë që ne mund të jetojmë bashkë në mënyrë normale, që kur unë si boshnjak të vij në Banja Lukë askush të mos më shikojë me sy të keq, që askush të mos thotë: "Shiko atë serbin".

shoqëri, sidomos përparimi ekonomik, e përmes ekonomisë i përfitojmë të gjitha të tjerat. Njërezit sigurisht e duan pajtimin, por janë disa që ndikojnë tek ata, të cilët nuk iu lejojnë atyre ta shprehin këtë.

Çfarë mendon se mund të bëjnë “njerëzit e thjeshtë” për çështjen e pajtimit?

Gjëra të vogla. Që me fqinjtë tim të vendosi përsëri kontakt, që fqinjtë tim mos ta sulmojnë, por ta ftoj për kafe, t'i them: “Ja, ishte çfarë ishte, hajde të ulemi sërish bashkë” dhe natyrisht që të kyçemi në aktivitete. Natyrisht, nuk duhet të gjithë të bëhemi aktivistë, por së paku t'i mbështesim aksionet, seminarët, tribunat,... thjesht të përballemi me këtë nocion. Nuk guxojmë të jemi pasivë.

Si duhet të sillemi ndaj të kaluarës? Çfarë përben për ty përballja me të kaluarën dhe a duhet ta harrojmë?

Jo, ta harrojmë në asnjë mënyrë, duhet të falim, por jo edhe të harrojmë. Përballja me të kaluarën është për mua përballje me krimin. Duhet të përballem me atë që grupi im etnik u ka shkaktuar të tjerëve.

Në qoftë se do të ndodhte pajtimi, çfarë do të ndryshonte në jetën tënde dhe si do të ndikonte kjo në situatën në vend?

Në jetën time do të ndryshonte ashtu që unë do të mund të shprehja identitetin tim nacional, pa marrë parasysh se ku do të jetoja. Këtë gjë sot në një masë të madhe mund ta bëj në Sarajevë, por jo tërësisht. Shoqëria do të ndryshonte ashtu që në sipërfaqe do të dilnin gjërat e rëndësishme. Tek atëherë mendoj që do ta kuptonin se çfarë është e rëndësishme në tërë shoqërinë dhe se nuk duhet të merremi me disa banalitete.

A duhet ta kërkojmë fajin vetëm tek njëra palë dhe a është ai individual apo kolektiv?

Faji është individual. Unë nuk jam ihtar i përgjegjësisë kolektive.

A mendon se të gjithë ne mbajmë një pjesë të fajit?

Unë nuk kam faj pasi që kam qenë fëmijë kur ka ndodhur e gjithë kjo. Unë nuk mund të mbajë një pjesë të fajit sepse asokohe nuk e kam ditur dhe as kuptuar se çfarë po ndodhë, e as që kam mundur të bëj diçka kundër kësaj. Në anën tjetër, personat që në këtë kohë kanë qenë më të pjekur dhe që kanë mundur së paku ta kundërshtojnë gjithë këtë, të paktën duke mos shkuar në luftë, me siguri që bartin një pjesë të vogël të fajit individual.

Si e parashikon të ardhmen e këtij rajoni?

Mendoj se procesi i pajtimit ka nisur në rrugë të gabuar dhe se ai duhet të ndryshojë. Faljen e konsideroj një akt të mirë, sidomos nëse kërkon falje kryetari i një shteti, por ajo është e gabuar në qoftë se pas saj nuk qëndron i gjithë populli, sepse ajo është atëherë falje individuale dhe jo falje në emër të tërë popullit. Gjërat që na kanë ndodhur nuk duhet t'i harrojmë kurrësesi, sepse vetëm i fshehim gjërat që na kanë ndodhur. Një gjë të tillë e kemi pasur edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, ku përmes politikës komuniste janë fshehur shumë krime që kanë ndodhur. Mua më ka pëlqyer mënyra gjermane e përballimit me të kaluarën ku ata janë përballur me krimet e veta. Po të përballej çdokush singërisht me krimin e vet dhe ta krahasonte atë me krimin e palës së dytë dhe të tretë, çdo individ do të mund të krijonte foton se çfarë ka ndodhur vërtetë.

V. E.

Njëri ndër problemet kryesorë është

se nuk ekziston komunikimi, pra nuk ekziston fare dialogu. Në rastin e Bosnjë e Hercegovinës konkretisht, të tri palët e paraqesin veten si viktimë dhe nuk duan t'i shohin të tjerët. Mendoj se të gjithë duhet të përballen me atë se çfarë u kanë bërë të tjerëve, por edhe me atë se çfarë të tjerët të kanë bërë ty.

Së pari do të lutesha që të prezentohesh në mënyrën që e sheh të rëndësishme dhe relevante për këtë intervistë?

Do të thoja disa gjëra sesi unë e përjetoj veten si 30-vjeçare, e cila është tani drejtoreshë e një qendre strehimore-shkollore, domethënë ka një shkallë të lartë përgjegjësie për të cilën duhet të jetë e vetëdijshme, por e cila ka mbetur për shumë gjëra 15-vjeçare që me këmbëngulje shfaqet diku nga rebelizmi: “Mos u bën tani dembele dhe e pakujdesshme dhe mos e lë pas dore atë çka ke lënë gjatë këtyre pesëmbëdhjetë viteve”. E kjo është periudha kur ka filluar lufta – atëherë kam menduar të bëj çdo gjë që mund ta bëj maksimalisht, kurse tani kur kujtohem, shoh se vërtet kam mundur të bëj më shumë, bile edhe në disa imtësira. Këto janë disa gjëra që më shtrëngojnë dhe më dhembnin. Kanë kaluar pesëmbëdhjetë vjet, kurse unë akoma nuk jam dëgjuar me Natashën time. Dhe gjatë gjithë kohës pothuajse kam pritur diçka, ose kështu ose ashtu... E ajo është shoqja ime nga shkolla e mesme, kemi qenë shumë të afërta dhe Bajrami dhe Krishtlindja e fundit së bashku kanë qenë për ne takimi ynë i fundit. Ka qenë viti '92. Largimin e saj, edhe Diana edhe unë...njëra ka shkuar në Beograd, njëra në Zagreb, kurse njëra në Sarajevë... Dhe vërtet e ndiej veten keq, ndërsa në tre vitet e fundit ndoshta edhe më keq. Ndërsa sërish nuk kam bërë asgjë lidhur me këtë çështje. Kurse dëshiroj dhe më duket se ajo imtësi mund të ndryshojë ndoshta disa gjëra në jetën time. Ndoshta edhe në jetën e Natashës dhe në jetën e shumë të tjerëve, sikur ta kishim vënë atë kontakt. Diku jemi larguar ndoshta, njëra prej tjetrës.

Nëse kthehesh tani nga viti 2005 në vitet '91-92' dhe në ato vite lufte, çka është ajo që e kujton sot më së shumti? Cili është qëndrimi yt ndaj atyre viteve të luftës?

Unë jam vëzhguese, për fat të keq, më shumë sesa pjesëmarrëse e çdo gjëje tjetër, e cila tërë këtë e ka vëzhguar nga diku. Në çdo moment e gatshme për të marrë pjesë, por ja që, jam rritur dhe e kam pranuar në mënyrë të tillë, për fat të keq apo të mirë, nuk e di, atë: “Mos u përziej aty ku nuk je e ftuar”. Kam qenë e gatshme që të marr pjesë në luftë, në fund të fundit, kam qenë e gatshme edhe që të largohem nga Bosnja për të njëjtën arsye për të cilën e kisha marrë pushkën në dorë. Si, cili është më problemi, çfarë kemi të gjithë të përbashkët? Dhe edhe sot e kësaj dite nuk e kam të qartë se çka kemi ne të gjithë të përbashkët – në njëfarë kuptimi ndoshta një mosnjohje të plotë. Shoqëria, tërë jetën jemi bashkë, kurse shtrohet pyetja, absolutisht, sesa e kemi njohur vërtet njëri-tjetrin. Ndërsa prapë jemi dashur, kjo është e padiskutueshme dhe kjo është ajo që më bën edhe më shumë konfuzë. Kurse mendoj, natyrisht, se ato granata dhe snajperë dhe çdo gjë tjetër... po, mendoj se nuk do të mundem t'i harroj kurrë, pa marrë parasysh të gjitha. Kam pasur fatin që askush nga njerëzit e mi të afërt nuk ka humbur jetën kështu që ndoshta nuk mund të flas sa do të kishte folur dikush tjetër... Ndoshta nuk kam aq emocione, ndoshta e kam më lehtë të flas dhe të reagoj e punoj se ndokush që

Lufta ka bërë
vetëm atë
që të jemi
të gjithë të mbyllur.

Unë këtë e quaj
getoizim, edhe pse nuk
e di sesa është fare
shprehje e mirë. Dhe
të gjithë janë orientuar
kah vetvetja
pavarësisht sesa të
ndryshëm janë. Vetja –
mendoj nga identiteti i
vet i cili ndoshta është
imponuar në një
moment të caktuar,
kurse ne e kemi
pranuar si të tillë. Apo
është marrë nga
identitetet tona të tjera
dhe na është thënë:
“Ky është tani
vendimtar”. Mendoj në
identitetin nacional.

është i lënduar emocionalisht. Kurse tani, lufta ka bërë vetëm atë që të jemi të gjithë të mbyllur. Unë këtë e quaj getoizim, edhe pse nuk e di sesa është fare shprehje e mirë. Dhe të gjithë janë orientuar kah vetvetja pavarësisht sesa të ndryshëm janë. Vetja – mendoj nga identiteti i vet i cili ndoshta është imponuar në një moment të caktuar, kurse ne e kemi pranuar si të tillë. Apo është marrë nga identitetet tona të tjera dhe na është thënë: “Ky është tani vendimtar”. Mendoj në identitetin nacional. Unë jam nga ata njerëz që besojnë se ajo që ka ndodhur është dashur të ndodhë. Kurse tani hajde t’i shohim gabimet tona. E kam më lehtë disesi të jetoj ashtu, e kam zakon t’i them gjërat që të mos fitoj ndonjë kancer apo diçka tjetër. Me këtë edhe ngushëllohem. Por nuk do të dëshiroja që të përsëritet. Unë mendoj se ne jemi ata që do të bëjnë që gjërat të përsëriten ose jo. Kurse e kemi shansin që të mos përsëriten.

Ne jemi gjenerata e cila, të paktën, duhet të hapë rrugën që të mos ndodhë përsëri një gjë e tillë. Të njihemi me të vërtetë dhe të shohim nevojat e njëri-tjetrit.

Çfarë mendon kur e shikon situatën e tashme në Bosnje dhe Hercegovinë – a jemi si shoqëri më afër asaj që lufta të ndodhë apo të mos ndodhë përsëri?

Sikur të më kishit pyetur para dy muajve, unë do t’ju përgjigjesha se jemi më afër asaj që të ndodhë lufta përsëri. Nuk i kam ditur shumë gjëra të cilat i kam mësuar gjatë dy muajve të fundit. Kam shikuar TV-në, mediat japin vetëm pamje që çojnë kah lufta, së paku në atë aspektin si e kuptoj unë atë. Ndoshta unë nuk jam shikues e mirë, mund ta shikojmë këtë edhe nga ai aspekt. Por, domëthënë, i kam përjetuar të gjitha sikur mungon vetëm një pjesë e sekondës që përsëri të plasi lufta. Kam pasur një ndjenjë frike dhe kam qenë akoma ajo pesëmbëdhjetëvjeçarja e cila nuk ka ditur çfarë të bëjë, të cilës i duhet treguar se çfarë të bëjë. Kaq për përgjegjësinë. Kurse tani, kur shikoj, i jam dukur vetvetes disi e vetmuar dhe me të vërtetë nuk jam gjetur. Atëherë para dy apo tre muajve, nuk e di saktësisht, fillova të njoh disa njerëz të cilët nuk kanë qenë vetëm lart në krye, ata të paarritshmit, thënë kushtimisht, por që si individë, edhe unë në mesin e tyre, janë të gatshëm të punojnë në të gjithë këtë. Një djalosh i cili ka ardhur tek unë në zyrë më ka mbushur me vetëbesim, më vonë ju... Po, shiko, paska mjaft si ne domethënë! Mund të bëjmë shumë më tepër, prej diku kam fituar, po nuk e di si ta quaj, përkrahje për përpjekjet e mia. Kështu që tani nuk mendoj se lufta është aq afër siç më është dukur më parë.

Mundësia që tërë kjo të përsëritet ... megjithatë më duket se punohet shumë në këtë dhe se ekziston vullneti nga të tri palët së bashku. Nuk duhen të jenë vetëm tri palë. Ndoshta rrezja e parë e dritës ka qenë kur kam parë në TV intervisten e një shkrimtareje të kombësisë serbe, nuk mund të them përfaqësueseje, duke u shprehur qartë kundër krimeve përkatëse të bëra ndaj këtij apo atij populli. Kjo ka qenë surprizë për mua, sepse kam menduar, ja, shih, edhe atje qenka dikush... Pas dhjetë viteve... Mendoj se është turpi im personal që kam ditur aq pak. Vetë fakti se sot megjithatë flasim, që jemi më afër diçkaje, flet se në fakt kemi më parë shans për paqe sesa për luftë. Tani, ne duhet të bëjmë zgjedhjen – a do të vazhdojmë kështu apo do të jemi më tepër nga ata që mendojnë se paqen e kemi më afër... unë mendoj se paqja është më afër... Besoj në të dhe me të vërtetë jetoj me shpresë. Jam e bindur, e di – njëherë kemi jetuar bashkë dhe nuk jemi njohur mirë. Tani kemi rastin që të njihemi. Tani e dimë se ku e kemi pasur të metën.

Kur shikoj në TV gjëra të tmerrshme, unë nuk shoh askund shpresë për ne. Kurse kur zbres në botën reale, shoh se ka shpresë. Me të vërtetë ne njerëzit mund të bëjmë diçka, të gjithë së bashku, çdokush prej nesh mundet... Dikush më tepër, dikush më pak.

A mendon se e dimë? A mendon se një përqindje, një shumicë e njerëzve e dinë?

Po. Shoh njëfarë përpjekje ose unë sillem në një rreth të ngushtë njerëzish. Kohëve të fundit takoj vetëm njerëz që e kanë këtë përpjekje dhe dëshirë. Më duket disi se numri i tyre shtohet dita-ditës. Kjo është diçka që ka filluar të më gëzojë dhe që më jep dëshirë të vazhdoj dhe të besoj, të jem e bindur se kjo është e mundur. Kurse kjo pjesa tjetër mendoj se është vetëm në sipërfaqe dhe nuk është fare e vështirë të rregullohet saqë duket në shikim të parë. Ndonëse kërkon shumë punë dhe djersë nga të gjitha palët. Por përsëri them se unë e kam më lehtë të flas, ndërsa njerëzit të cilët kanë shumë emocione në kuptimin e humbjes, ata e kanë më vështirë se unë, shumë më vështirë të hapen, ata e kanë shumë më vështirë që t'i lënë anash plagët. Në këtë drejtim duhet të bëhet njëfarë depërtimi.

Pse mendon se marrja me çështjen e krimit që e përmende është në përgjithësi e rëndësishme në këtë kontekst?

Duhet për shkak të njerëzve të cilët i përmenda pak më parë, sepse ata nuk mund t'i tejkalojnë gjërat siç do të mundem ndoshta unë. Unë do të mundesha për 1001 shkaqe, sepse mua më mungon Natasha ime e cila ndoshta, le të kuptohemi, nuk është fare person i njëjtë... Mendoj se këto gjëra duhen të sillen në vend. Para disa netësh kam shikuar një intervistë me Bakir Izetbegovićin dhe ai thotë se „kemi qenë të detyruar t'i përdorim të gjitha mjetet për këtë apo atë shkak”. Ndërsa unë mendoj se edhe aty do të ishte më e ndershme të thonte – nuk është në rregull ajo që kemi bërë në disa situata të caktuara. Sepse edhe nëse don të përfaqësosh ndonjë ide, qëndroji asaj besnike deri në fund. E kam disi shumë të rëndësishme të shoh sesi ti e pranon që ke gabuar. Jo që ke gabuar në kuptim të pendimit religjioz (tani unë jam grua e mbuluar), por që ti ta ndiesh vërtet se ajo nuk është në rregull dhe se nuk do ta bësh më. Sepse unë kam frikë. Unë e di se tani do të më thonë, në qarqe të caktuara ku unë sillem, “e di çfarë, neve na ka ndodhur 1914, 1918, 1941–1945, 1991–1995, ne jemi naivë”. Kjo është e vërtetë kur shikon nga ajo anë. Kjo është e vërteta yte, por nga kjo anë, kur unë dëgjoj se ekziston dikush i gatshëm që të thotë: këto nuk ishin gjëra të bukura, janë bërë, por duhet të punohet që të mos përsëriten më etj. Edhe ne e pranojmë se nuk janë gjëra të bukura, kështu që atëherë edhe unë do ta pyes veten. Përgjegjësia ime mund të jetë më e vogël, por hajde mirë edhe unë ta llogaris atë, t'ia paraqes vetvetes – këtu, këtu dhe këtu qëndron përgjegjësia. Por aty ekziston përsëri ajo mbyllja e të gjithëve së bashku... Ndoshta jam edhe unë naivë që besoj se jemi më afër njëfarë paqeje. Por, fqinjët megjithatë janë të rëndësishëm, këta përreth, edhe të afërt edhe të largët. Gjendja e përgjithshme në Europë mund të ndikojë shumë tek ne, ashtu siç ka ndikuar gjithmonë. Për Bosnjen dhe Hercegovinën janë me rëndësi edhe Serbia, edhe Kroacia, edhe Franca, edhe Gjermania... Të gjitha tendencat globale... Kështu që duke i përmbledhur të gjitha kam pak më tepër frikë për këtë, sesa për vetë ne. Mund të mësojmë edhe nga gabimet e komunizmit – unë i shikoj gjërat si laik i cili i ka dashur të gjitha ato gjëra – megjithatë shumë gjëra kanë qenë të imponuara nga lart, kurse tani mendoj se duhet të punohet edhe nga poshtë përmes individit. Komunistët kanë pasur së paku një rreth të ngushtë njerëzish të vetëdijësuar dhe idenë pas së cilës shumë kanë shkuar mbrapa. Kurse vetë ideja nuk kishte kaluar nëpër ata njerëz. Ndërsa tani, më duket se ideja e ndërtimit të paqes kalon nëpërmes individit, por ekziston edhe diku lart. Ekziston, unë nuk mund të them se nuk ekziston. Sa është ajo e fortë apo e dobët, kjo është çështje tjetër, por unë e vërej.

Çka mendon se është e rëndësishme të punohet më në kontekstin e ballafaqimit me të kaluarën dhe ndërtimin e paqes, përveç asaj bisedës për krimet?

Nuk mendoj se duhet të humbet shumë kohë në këtë, por derisa individët që i kanë tani zemrat e mbyllura për njëri-tjetrin të mos fillojnë të bisedojnë... deri atëherë është e domosdoshme të flitet për krime, që kjo thjesht të mos harrohet. Çfarë duhet të punohet më? Unë mendoj se mediat janë ato ku duhet të veprohet në mënyrë të domosdoshme. Siç theksova, unë ndoshta nuk jam shikuese e mirë, por kur shikoj në TV gjëra të tmerrshme, unë nuk shoh askund shpresë për ne. Kurse kur zbres në botën reale, shoh se ka shpresë. Me të vërtetë ne njerëzit mund të bëjmë diçka, të gjithë së bashku, çdokush prej nesh mundet... Dikush më tepër, dikush më pak, por hajde të gjitha janë këtu në rregull. Do të thotë, këtu duhet të veprohet më tepër nga aspekti i mediave, në kuptimin e propagandës dhe të gjitha të tjerave. Nuk mendoj madje se as ato panotë e mëdha si “korra e armëve” dhe gjithë të tjerave, mendoj se më parë duhen të jenë për ndërtimin e paqes dhe me këtë njerëzve t’u shpërlahet truri. Të na futet të gjithëve kjo në mendje, e jo vetëm arma, arma, kudo që sillem vetëm arma. Mendoj se në fund edhe unë do të dëshiroj të kem armë, aq më lodhin me këtë.

Çfarë do të thotë për ty kur e dëgjon fjalën pajtim? Si të tingëllon në vesh?

Truri im është pak si shumë religjioz kundrejt nocionit të pajtimit dhe pastaj aty shikoj diçka... Mua shpesh shoqëria e afërt më thërret jezuite. Unë e shikoj këtë nga ajo ana “hajde të duhemi”, në këtë kuptim. Ndoshta unë nuk jam personi që duhet të flasë për të nga një aspekt më i dobishëm.

Kjo dëgjohej gjithmonë, por mua më intereson se çfarë mendon ti për këtë, kush duhet të jetë bartës i këtij procesi dhe kush me kë duhet të “pajtohet”?

Para së gjithash mendoj vetë me veten, kurse pastaj do të pajtohem lehtë edhe me të tjerët. Do të thotë pikërisht në kuptimin kur të shohim se ku janë mungesat tona personale, gabimet tona personale, por edhe mëkatet në njëfarë kuptimi ...

Mua më vjen mirë që fjala pajtim përsëritet, vetëm shpresoj që të mos mbetet në përsëritjen në formë papagalli, sepse edhe papagalli mund të mësojë një fond fjalësh e më pas t’i përsërisë. Por, ato fjalë zgjojnë shpresën tek unë, sidoqoftë! Ajo është si ajo Coca-cola, hyj në dyqan, e blej në mënyrë të pavetëdijshme, e më vonë do ta kisha kthyer me kënaqësi. Kështu është edhe kjo dhe mendoj se është mirë që përsëritet, të paktën edhe në atë mënyrë. Me këtë lloj shprese – ndoshta unë jam megjithatë vetëm pionieri i Titos në njëfarë kuptimi.

Mbi çfarë baze do ta dimë se në këtë shoqëri ka ndodhur pajtimi? Si duhet të duket ai?

Për momentin, unë do të them dhe e di se kjo fjali nuk do t’i pëlqejë njëqind për qind shumicës – ekzistojnë ende entitetet dhe shkollat njënacionale. Nuk jemi ne Zvicra që të ekzistojnë aq gjuhë të ndryshme që kjo të jetë e domosdoshme. Pra, ky është një proces që zgjat, e që kërkon atë që e përmenda, djersë, mund... Çfarë të bësh, kërkon shumë, por ia vlen. Njerëz, hajde atëherë të derdhim djersë! Ja si e shikoj unë këtë – ne jemi shtet të cilit i duhet ende autoriteti. Fatkeqësisht, fatmirësisht, e njëjtë është për mua sesi do të komentohet, por unë do të dëshiroja që të kemi një autoritet të tillë në vendin udhëheqës i cili angazhohet që shteti ta ketë të ndërtuar sistemin e vlerave kur të shikojmë lart dhe tërë kjo të delegohet në nivele më të ulëta. Të vendoset sistemi kualitativ i qëndrueshëm dhe të mos ndodhë pas vdekjes së atij ajo që ka ndodhur pas vdekjes së Titos.

Kohëve të fundit me këdo që takohem them “Por duhet të flasim për atë”, sepse më ka ndodhur që njerëzit të më thonë “Mos të flasim, të lutem, për politikë”. Por njerëz, kjo nuk është politikë, është realiteti ynë, çfarë keni. Flisni, duhet të flisni, madje me zë të lartë! Kjo nuk duhet të jetë gjithmonë me zë të lartë, por derisa të fillojnë të zgjidhen gjërat me të vërtetë në njëfarë mënyre.

A ke ndonjë ide sesi do të punoje ti për këtë?

Unë mendoj se vetë shkuarja ime kudo në vende publike, theksimi i nevojave, është shumë e rëndësishme... Do të dëshiroja të veproja në shumë nivele (ndoshta jam edhe tepër ambicioze)... Më intereson me të vërtetë edhe ajo sfera politike dhe mendoj se nëse don të bësh diçka, kjo duhet të kalojë disi edhe përmes këtyre poreve, se duhet të futesh aty. Mua më vjen vërtet keq që në vendin tonë ekziston një mendim i keq për politikanët, por mendoj se edhe ata vetë i kanë kontribuar shumë kësaj.

Cilat janë nevojat tuaja si boshnjake dhe muslimane, si grua e mbuluar?

Të jem e pranuar si qytetare e Bosnjes dhe Hercegovinës në bazë të të drejtave kushtetuese, siç do të thonin *elhamdulillah* (faleminderit prej Zotit). Nuk më nevojitet asgjë më tepër seç më garanton kushtetuta. Por të kuptohet se nevojat e mia janë në kuadër të saj. Në rasë duhet ndryshuar kushtetutën për shkaqe tjera, hajde ta ndryshojmë, nuk është asgjë e tmerrshme dhe e pandryshueshme. Në kuptimin që unë si individ, jo si Dika, një femër e mbuluar, por çdo individ, nëse jemi në njëfarë kontakti, siç jemi të gjithë ne në Bosnje e Hercegovinë, nuk mund t'i shmangemi kurrësi njëri-tjetrit, duam apo nuk duam. Po hajde të shohim se çfarë na pengon neve, çfarë ju pengon juve, hajde të shohim se çfarë mund të bëjmë krejt. Kjo është ajo, siç e kuptoj unë, theksimi i nevojave. Të vë në dukje se për mua edhe nevojat tuaja janë shumë të rëndësishme, ja kjo është ajo! Dhe se vërtet nuk dua, nëse mundem disi, që nevojat tuaja t'i trazoj apo prish me plotësimin e nevojave të mia, kurse atje ku na trazohen nevojat hajde të gjejmë njëfarë zgjidhjeje. Të shohim se çfarë mund të bëjmë. Dhe atëherë, tek e fundit, unë nuk e kam kurrë problem që të shkoj te psikiatri që të zgjidhë diçka, prandaj hajde të ftojme dikë, tek e fundit edhe atë përfaqësuesin e lartë, ndër thonjëza. Hajde të dëgjohemi. Unë shpresoj që këto nuk janë vetëm ëndrrat dhe fantazitë e mia. Unë tanimë i kam bërë disa gjëra në mjedisin tim. Ndoshta më vjen keq se nuk kam pasur rast të jetoj diku gjysëm viti apo një vit në mënyrë që të më shërbejë në këtë segment të punës paqësore.

Edhe diçka për fund të bisedës...

Kohëve të fundit me këdo që takohem them “Por duhet të flasim për atë”, sepse më ka ndodhur që njerëzit të më thonë “Mos të flasim, të lutem, për politikë”. Por njerëz, kjo nuk është politikë, është realiteti ynë, çfarë keni. Flisni, duhet të flisni, madje me zë të lartë! Kjo nuk duhet të jetë gjithmonë me zë të lartë, por derisa të fillojnë të zgjidhen gjërat me të vërtetë në njëfarë mënyre. Vetëm duhet të shikohet mirë realiteti.

T. S.

Nëse hesht, ai do të bërtasë,
kurse këta të gjithë do të dëgjojnë

Kur i vështron vitet '90 dhe çdo gjë që ka ndodhur, çfarë kujtimesh të përshkojnë, si je ndier atëherë në tërë ato ndodhi?

Mendoj se një pjesë të madhe i kam mbrapsur ato totalisht. Nuk kam kuptuar asgjë nga ajo çfarë ndodhte. Kam qenë 17-18 vjeç dhe ka filluar ashtu siç ka filluar, Plitvicet, diçka që dukej si e largët, pastaj kanë filluar alarmet, Spliti, anijet, gopsiqet, të gjitha ato...

Babai im ka qenë ushtarak deri në vitin 1974, pastaj është liruar nga shërbimi, ka fituar banesë nga ushtria, kështu që godinat ku jam unë janë godina ushtarake. Nuk kanë jetuar aty vetëm ushtarakë, me kohë gjërat kanë ndryshuar, çdo gjë ka ekzistuar aty. Qëndroj në katin 16, kanë filluar alarmet, jemi ulur poshtë në bodrum, unë kam ditur të marr vetëm kasetat e mia. E kam dashur muzikën, vetëm atë kam dëgjuar, nuk kam marrë asgjë me vete, as rroba, asgjë tjetër, përveç kasetash. Kur pas disa herave kam kuptuar se ato alarme nuk janë të kota dhe se kjo është vetëm futje e frikës, nuk kam zbritur më në bodrum. Qyteti ishte i errësuar... TV-në e kam shikuar pak, e kam kuptuar që e tërë kjo është një propagandë, a e din kur skenën e turmës nga Vukovari e përcjellë në sfond rekuemi i Mocartit. E tërë kjo është tragjedi, por kjo makineri ka punuar në atë nivel që kur e sheh ti këtë skenë në ditar, automatikisht i urren të gjithë serbët. Kjo ishte logjika.

Kemi qenë grup dhe e kemi mbrojtur njëri-tjetrin... Mendoj se i kam lënë të gjitha të kalojnë, nuk kam kuptuar fare se çfarë është duke ndodhur, më është dashur kohë që t'i kuptoj të gjitha. Ka ndodhur diçka iracionale që unë nuk e kam kuptuar, tërë ajo urrejtja, çmenduria...

Çfarë ka qenë, sipas teje, shkaku i kësaj?

Tani unë nuk do të banalizoj, por gjëja e parë që më vjen ndërmend është vargu i Ballasheviqit: të parët erdhën priftërinjtë, më pas topat, kurse në fund hajnat. Kjo është gjëja e parë që më shkon ndërmend... Mendoj se të gjithë politikanët kanë qenë pak a shumë mitomanë, të cilët i kanë zgjuar disa histori të tmerrshme dhe kanë ndezur epshet më të ulëta të cilët flejnë në një mitologji, në një popull, në një fe. Mendoj se nuk ka qenë në pyetje konflikti nacional, por fetar, se ka qenë luftë fetare.

Pse ka qenë e nevojshme lufta dhe çfarë ka dalur nga ajo?

Nuk e di, nuk e di se çka... dikush do të thoshte se ajo është diçka çka është mbledhur dhe se ka qenë e domosdoshme që të plasë sikur çibani. Nëse kjo është kështu, atëherë tani do të shërohem dhe më pas do të plasë prapë. Nëse kemi predispozita të tilla gjenetike për luftë për çdo 50 vjet... nuk jam në të vërtetë, nuk i favorizoj ato teori. Pse ka ardhur fare deri te kjo...?

Pse ka qenë, sipas teje, tamam luftë fetare, përkundër të gjitha kategorizimeve nacionale dhe kategorizimeve tjera të mundshme?

Sa i përket kombësisë, njerëzit në këto hapësira janë të përzier mjaft etnikisht. Unë jam po ashtu i përzier, babai im është serb i vjetër nga Bosnja, siç thuhet, nëna

Qyteti ishte i errësuar... TV-në e kam shikuar pak, e kam kuptuar që e tërë kjo është një propagandë, a e din kur skenën e turmës nga Vukovari e përcjellë në sfond rekuemi i Mocartit. E tërë kjo është tragjedi, por kjo makineri ka punuar në atë nivel që kur e sheh ti këtë skenë në ditar, automatikisht i urren të gjithë serbët. Kjo ishte logjika.

Kur i pyet, të gjithë do të thonë se kjo nuk ka rëndësi, se ai të gjithë njerëzit i shikon si qenie njerëzore, por kur e gërvisht pak sipërfaqen, dalin shumë fantazma dhe energji negative. Arrijmë në sferën, le të themi shpirtërore, ku të gjitha ato kisha më kanë dëshpëruar dhe në vend që të mundohen të bëjnë diçka në atë sferë, e kanë shtrirë atë në mënyrë të rafinuar.

kroate nga Neretva, por ka edhe gjak ilir. Sikur të hyja në këtë gjenezë, unë jam koktej i çdo gjëje të gjallë. Kur ka filluar e gjithë kjo, kishat kanë shfaqur dhe ato kanë mbrojtur kombësinë. Ajo që mua që në fillim më është dukur absurde ka qenë fakti se kisha, e cila është pronë e Zotit, për të cilën të gjithë njerëzit janë të njëjtë dhe të gjithë janë fëmijët e saj, nuk mund të lidhet për çështjen e kombësisë. Si p.sh. Zoti dhe kroatët, ne jemi popull i zgjedhur. Ajo ndoshta i përket disa besimeve fetare para Krishtit, disa kulteve, miteve, as vetë nuk kam ide. Me kohë e kam kuptuar se këto njerëz nuk janë të krizmuar fare, nuk i besojnë Zotit të cilit i falen sepse ai është Zot plot dashuri, mirëkuptim, falje dhe mëshirë, e ata akoma besojnë se Babai duhet të jetë i ashpër dhe i drejtë, e ai në të vërtetë është ai Zoti nga Dhjata e Vjetër, i cili është i ashpër dhe i drejtë dhe i cili në njërin dorë mban shpatën. Por prapë, ndoshta për të gjitha është fajtorë rakia...

Pse rakia?

Njerëzit nuk e pjekin mirë atë raki prandaj ajo u bjen në kokë. Dhe frika, njeriu është qenie sociale dhe duhet t'i takojë një grupi dhe kur ka filluar të ndodhë e gjithë kjo, duhet ndoshta shumë kurajo të thuhet se diçka nuk është në rregull. Siç ka ndodhur në Irak p.sh. tani me këto të burgosurit. Gjithçka ka ndodhur edhe tek ne, edhe gjëra më të këqija. Studimet shkencore tregojnë se ky është mekanizëm i vetëdijes njerëzore dhe se si pjesë e një grupi do të bëjë gjëra iracionale dhe që nuk mund të paramendohen dhe mund të jetojë me të. Besoj dhe shpresoj, ashtu siç po zhvillohen gjërat, se gjithmonë gjendet dikush që të thotë se kjo nuk është në rregull.

Kur e vështron situatën e sotme, mua më duket që ju në grupin tuaj jeni shumë të vetëdijshëm për situatën dhe gjendjen mendore të shoqërisë sonë. Si e përjeton ti këtë?

Mendoj se njerëzit nuk e kanë ndjenjën e sigurisë dhe perspektivës, ka hyrë tek ata frika për ekzistencë, ajo më banalja. Kanë frikë a do të kenë nesër punë. Sot njerëzit nuk e kanë atë lloj të sigurisë sikur në socializëm, ku punësohesh dhe aty punon deri në pension. Njerëzit nuk dinë të ballafaqohen me ato frika elementare të cilat ekzistojnë gjithmonë dhe ballafaqohen shumë vështirë me to. Tek ne ka ndodhur një koktej i çuditshëm dhe e gjithë kjo sjell një gjendje kaotike për një njeri normal. Çdokush gjendet në mënyrën e vet dhe më së lehti dhe më së thjeshti është të jetosh jashtë ligjeve. Shoqëria tek ne nuk e ka pasur atë zhvillimin evolutiv që ligji të shihet si diçka që është mbi të gjithë, diçka që garanton barazi për të gjithë. Por ligji është gjithmonë sikur ajo thënia – kadiu të padit, kadiu të gjykon. Për njerëz të ndryshëm, ligji i njëjtë interpretohet në mënyra të ndryshme dhe kjo pranohet si diçka normale; shembulli i njerëzve të cilët do të duhej të dalloheshin dhe të prezantohehin në opinion si njerëz të mëdhenj, si tipi i kësaj gjykatëses që e ka gjykuar Norcin, nuk ia di emrin... ajo është heroinë e kësaj shoqërie.

Pse nuk e përjetojnë njerëzit atë si heroinë?

Për arsye se nuk ka dalur në faqen e parë të revistës *Extra* apo *Gloria*....

Gjatë luftës kanë ndodhur shumë gjëra, edhe Norci, edhe Gotovina, edhe pastrimet etnike dhe shumë gjëra tjera për të cilat nuk flitet dhe të cilat janë tema tabu. Çka mendon ti, si duhet të sillemi ndaj të kaluarës së luftës dhe çdo gjëje tjetër që ka rrjedhur nga ajo...?

Nuk di çka të them. Nga të gjitha gazetatat lexoj *Feralin*, gazetatat ditore tek-tuk. Gjërat që i ka publikuar *Ferali* para dhjetë viteve po bëhen ngadalë gjëra publike. Në

kohën kur janë publikuar dhe kur kjo më ka munduar dhe okupuar, ato kanë qenë gjëra që i përkasin fantastikës shkencore, fikSION total. Mendoj se gjithmonë ekzistojnë njerëz që dëshirojnë të mësojnë dhe që dëshirojnë të ndërtojnë vetveten si njerëz, dëshirojnë të ngriten mbi kategoritë diskriminuese të tipit si kombi, feja, në mënyrë që kjo të mos përjetohet si konspiracion i masonëve. Mendoj se njerëz të tillë ka mjaft në Kroaci.

Përse nuk dëgjohet zëri i tyre?

Dëgjohen, dëgjohen, por nuk janë në plan të parë, sepse sipas natyrës kjo nuk mund të jetë në plan të parë. Plani i madh funksionon sipas zakoneve të spektakleve – grimi, tualeti, të rinj të bukur. Problemi qëndron në faktin se ne jemi treg i vogël dhe se të gjitha këto gjëra të karakterit komercial duhet të mbijetojnë në tregun e vogël dhe është krejt normale që ata merren me gjëra që mund të shiten. Mendoj se megjithatë ekziston ajo, si ta quaj, inteligjenca e ndershme.

Si mund të ballafaqohemi me të, si mund të luftohet kundër saj?

Me dituri, me lexim, dituria është kudo dhe të gjithë kanë internet. Librat dhe gazetatat, dhe kush dëshiron le t'i marrë e të mësojë, kurse kush nuk don, asgjë... Kur ka filluar lufta unë kam qenë i tmerruar. Kur një ditë kanë transmetuar në HTV (Televizioni Kroat) ato filmimet nga Srebrenica, unë të parën herë nuk kam mundur t'i shikoj, mendoj se kjo ka të bëjë me psikikën... Mendoj se psikika ime ka krijuar një mekanizëm mbrojtës për ato gjëra. Thjesht e kam përjetuar thuase nuk ndodhë fare. Tamam tmerr i madh dhe moskuptim i gjithë asaj. Sigurisht që çdo njeri normal, mendoj që bile edhe njerëzit që kanë qenë pjesëmarrës, nuk kanë mundur të jenë të pandieshëm ndaj kësaj. Nuk e di, nuk mund ta kuptoj këtë fare....

Si e ke ndier veten të vazhdash të jetosh në qytetin e Splitit, duke marrë parasysh prejardhjen tënde, pra se babai yt është serb i Bosnjes. A të kanë shikuar njerëzit përmes këtij prizmi? Nuk ke nevojë të përgjigjesh në këtë pyetje, nëse nuk ke...

Nuk i kam ndier pasojat e saj, sepse nuk e ndiej këtë në vete, nuk e kam atë ndjenjë e përkatësisë nacionale. Më parë kam qenë jugosllav dhe kam pasur njëfarë ndjenje për këtë. Jugosllavia, të gjithë së bashku jetojmë në paqë, nëse na sulmon dikush nga jashtë do të mbrohem, kështu ka qenë. Nuk jam unë tash një jugonostalgjik e as Titon nuk e kam Zot, por ajo ka qenë diçka e bukur. Një shtet, ku mund të udhëtosh, ku ka njerëz të ndryshëm, kam pasur në çdo vend mjaft miq, të gjithë njerëz normalë, çdo gjë ok, super... Ndoshta duhet ta kesh këtë në vete që të të lëndojë. Unë e kam kuptuar, e din, kur i them dikujt emrin Aleksandër, e sheh nga sjelljet e tij... por kjo nuk më ka prekur shumë. Njerëzit me të cilët jam shoqëruar gjithmonë kanë qenë normalë, na ka pëlqyer muzika dhe ajo ka qenë gjithmonë në vend të parë. Askush nga rrethi im, rrethi i kushërinjve apo familjes nuk ka qenë viktimë, as nuk ka vdekur.

Gjithmonë mendoj se çfarë do të kisha bërë sikur të kishte humbur jetën një i afërm i imi apo sikur të ndodhte diçka tjetër, sepse kjo do ta ndryshonte atëherë tërë situatën. Njeriu duhet të ketë gjithmonë fuqi të qëndrojë mbi situatën, por vërtet e jo vetëm me fjalë. Kur i pyet, të gjithë do të thonë se kjo nuk ka rëndësi, se ai të gjithë njerëzit i shikon si qenie njerëzore, por kur e gërvisht pak sipërfaqen, dalin shumë fantazma dhe energji negative. Arrijmë në sferën, le të themi shpirtërore, ku të gjitha ato kisha më kanë dëshpëruar dhe në vend që të mundohen të bëjnë diçka në atë sferë, e kanë shtrirë atë në mënyrë të rafinuar. Janë futur në politikë dhe

kudo sikur ato janë të obliguara apo përgjegjëse që t'u shpjegojnë njerëzve disa gjëra, ky është amalgam që për një njeri të paditur mund të jetë një lëmsh i madh. Sikur njerëzit të mësonin dhe sikur të mos ishin të kufizuar për çfarëdoqoftë, sikur të mësonin për traditën e tyre, për prejardhjen e tyre, do të mund të gjenin shumë gjëra që janë universale. Në ato tradita fetare dhe kombëtare që janë të njëjta për të gjithë njerëzit. Nuk është ndoshta mënyra më e mirë që të mos flitet për këto gjëra, por pikërisht që të futemi në tërë këtë, në vetë rrënjët dhe të kuptojmë se kjo është diçka që i bashkon njerëzit.

Si të futemi në tërë këtë?

Duke lexuar libra, duke njohur njerëz të tjerë përmes kulturës, muzikës, shoqërimit dhe artit. Këto janë disa gjuhë universale që i bashkojnë njerëzit. Duke shikuar *Discovery channel* ☺.

Çka është për ty pajtimi? Si e përjeton ti atë fjalë?

Pajtim do të thotë të pajtohesh me vetveten. Mendoj se kjo është si ajo puna e pajtimit të ustashëve dhe partizanëve... unë jam gjithmonë për paqe. Tani pajtimi paraqitet si diçka nga çfarë duhet të heqim dorë. Të heqim dorë, do të thotë të sakrifikojmë, hajde të themi le të hamë mut, të gjithë, këta-ata, që të jetojnë si në paqë. Ndoshta kjo është në njërin anë në rregull, kurse nga ana tjetër një rrugë e shkurtër, e cila nuk është aq e natyrshme. Mua personalisht nuk më duhet ky lloj i pajtimit, unë i shikoj njerëzit pa këto epitete, kurse njerëzit për të cilët do të duhej të pajtohemi janë të vdekurit. Ata njerëz që kanë qenë ustashë, partizanë, që kanë luftuar në atë kohë.

Ndërsa ky pajtimi i sotëm mendoj se po ndodhë në njëfarë mënyre. Njerëzit kanë qenë, më duket, të futur në një vorbull dhe kaos të asaj çmendurie. Ideologjia është bërë fe dhe kombësi dhe atëherë është shfaqur një politikë pa kurrfarë prapavije ideologjike, gjë që po dëshmohej vite me radhë. Që në fillim, asnjëherë nuk ka ekzistuar ndonjë ide – politike, ideologjike, në kuptimin që e majta është në parimet e revolucionit francez, që është një ideologji qytetare, kurse që e djathta ka të bëjë me kombësinë, traditën. Gjithmonë mund të arrihet pajtimi, ekzistojnë elemente të cilat mund t'i lidhin vërtet njerëzit në bazë të ideve, por ata nuk do të pajtohen në bazë të ideve, por do të pajtohen për arsye të pastra pragmatike, do të thotë pushtet i pastër, fuqi, përsëri disa gjëra sipërfaqësore dhe primitive.

Kur e vështron konkretisht shoqërinë kroate dhe situatën ekzistuese lidhur me kthimin, a mendon se na duhet pajtimi?

Unë do t'i fshija të gjithë kufijt, do t'i lejoja njerëzit të udhëtonin ku të donin dhe të qëndronin ku të dëshirojnë. Kjo është normale nga perspektiva ime e cila nuk ka lidhje me realitetin. E di se këtu ka shumë gjëra abstrakte që teoretikisht tingëllojnë ok, por në praktikë kemi një mijë probleme. Këto janë gjëra që përkufizohen në fund se me to duhet të merren komunitetet e vogla të njerëzve të tipit të atyre që quhen demokraci lokale, vetëqeverisje lokale që ndodhin sot në botë, por ne jemi larg atyre. Nuk ka vetëdije mbi atë se çdo njeri është i rëndësishëm, se ai vendos për gjërat, nëse dëshiron.

A e dëshirojnë njerëzit në Kroaci pajtimin, ballafaqimin me të kaluarën e luftës?

Besoj se njerëzit e dëshirojnë atë, çdo njeri normal dëshiron të jetojë në paqe dhe që fëmijët e tij të jetojnë po ashtu në paqe. Të ketë mundësi të punojë punën e vet, të jetë i kënaqur me atë punë, të mund të dashurojë dhe të realizojë disa ëndrra që janë mbi atë kuadrin material.

Ekzistojnë mënyra dhe mekanizma që këto të realizohen, siç janë zgjedhjet, angazhimi në iniciativa civile dhe joqeveritare. Ekzistojnë mekanizma, vetëm duhet të kemi vullnet. Kam frikë vetëm se shumica e njerëzve janë në një lloj pasiviteti dhe kënaqen me programin televiziv dhe me *shoppingun* e së dieles ku mund të blejnë shumë gjëra të lira, të panevojshme, të cilat do t'i hedhin brenda dy muajve dhe do të blejnë gjëra të reja, do të marrin borxh... kurse përsëri, është keq të flitet kështu sepse njerëzit kanë plot probleme dhe jetojnë me to.

Cilat janë ato frika lidhur me pajtimin në këtë shoqëri dhe a sheh ndonjë mënyrë për t'i tejkaluar ato?

Frika prej ballafaqimit me vetveten. Ekzistojnë njerëz të cilët kanë qenë të përfshirë në tërë këtë, të cilët janë aktorë dhe kjo është një barrë e madhe dhe mënyrat e zgjidhjes janë komplekse. Ekziston një rreth i njerëzve të cilët në bazë të një inercioni kanë mësuar pikërisht se kush është fajtor, se kjo është e kurdisur, se kjo është përsëri një lloj tjetër i përgjegjësisë, kurse në të vërtetë është një gjë shumë e thjeshtë. Gjërat duhet të përjetohen pastër dhe pa kufizime. Së pari, dikush është njeri, e më pas kroat, katolik, por së pari është njeri, kurse mendoj se këtu gjërat janë të rënditura ndryshe, ashtu që së pari je kroat, katolik, kurse më vonë shikohet se çfarë njeriu je. Unë nisem së pari nga ajo se çfarë njeriu je.

Çfarë mund të bëjnë njerëzit e thjeshtë, këta që tani shëtisin nëpër shëtitore?

Duhet të edukohen dhe të mësojnë të kyçen në dialog në situata banale. Unë nisem pikërisht nga rruga. Kur dëgjon se dikush flet marrëzira, si për shembull përhap urrejtje, njerëzit flasin gjithçka. Nëse hesht, ai do të bërtasë, kurse këta të gjithë do të dëgjojnë. Gjuha e urrejtjes e ka logjikën e vet dhe argumentimin e çmëndur, por ajo gjithmonë përfundon në një lloj mjegulle dhe abstraksioni, dhe nuk mund të jetë e qëndrueshme. Duhet të reagohet në situata të tilla. Të gjithë e dinë se kemi luftuar për demokraci, për dialog, sovranitet dhe ligj, ndërsa çfarë është ajo nëse s'është kjo. Ekziston ligji, dialogu, ekzistojnë mekanizmat përmes të cilave mund të ndikosh në pushtet, por kjo ekziston vetëm si ide, kurse në praktikë nuk funksionon.

Si i përjeton tekstet dhe muzikën që bën? A është kjo një mënyrë e reagimit ndaj gjendjes?

Kjo është diçka e brendshme, një lloj e marrjes së përgjegjësisë; unë tani nuk do të merrja përgjegjësi për shumicën, kjo është diçka jofamiljare për mua. Përgjegjësia shoqërore, angazhimi, këto gjëra janë në një mënyrë mosmirënjohëse nganjëherë. Angazhimi që të rregullohen gjërat nuk bëhet me tendencë. Unë me të vërtetë besoj se gjërat nuk mund t'i ndryshojë një njeri. Njeriu mund të punojë në vete, të ndryshojë veten dhe nëse ke ide dhe ideale të përpiqesh të mbetesh besnik ndaj tyre. Unë i shikoj në njëfarë mënyre gjërat nga ana, duke u larguar nga disa aktualitete dhe ngjarje shoqërore, por në të njëjtën kohë edhe i përjetoj. Ky është në të vërtetë një lloj konflikti i brendshëm për shkak të të cilit i shkruaj këto gjëra, ky është ndoshta njëfarë inspirimi. Një konflikt i imi i brendshëm i lidhur me atë shoqëror. Unë jam një qenie fort shoqërore, një tip që beson në paqen në botë. E ndiej se jam pjesë e një rryme, ideje. Në kuptimin e veprimtarisë praktike jam i angazhuar në mënyrë shoqërore. Dua ta punoj këtë dhe kjo është mënyrë sesi shprehemi.

S. D.

Duhet të edukohen dhe të mësojnë të kyçen në dialog në situata banale. Unë nisem pikërisht nga rruga. Kur dëgjon se dikush flet marrëzira, si për shembull përhap urrejtje, njerëzit flasin gjithçka. Nëse hesht, ai do të bërtasë, kurse këta të gjithë do të dëgjojnë. Duhet të reagohet në situata të tilla.

Çfarë do të ishte për ty pajtimi në këto suazat tona maqedonase, në këtë realitetin tonë?

Kjo është pak e gjerë... Pajtimi – do të thotë diçka i ka paraprirë. Ta konkretizojmë, do të thotë dikush ka qenë i grindur. Mendon në këtë që po ndodhë tek ne, maqedonët dhe shqiptarët, apo?...

Kjo tingëllon bukur teorikisht... Ekziston një libër nga një i krishterë, që titullohet “Mbi dinjitetin e krishterimit dhe mbi jodinjitetin e krishterëve” dhe kjo më ka ardhur tani si asociacioni i parë, cili do të ishte qëndrimi i tij... Mendoj, pyes veten, a jam unë e denjë të flas mbi disa ide të krishterimit kur bëhet fjalë për diçka kaq të madhe, gjithëpërfshirëse, kaq shumë... Nuk e di nëse mundem të flas diçka si duhet, mu në atë frymë, le të them. Dhe mu kjo është ajo që mund të ndihmojë më tepër në këto situata. Mendoj në frymën e krishterimit, në idenë themelore apo bazë të asaj që e ka sjellë Krishti kur ka ardhur në këtë botë. Diçka që Ai ka thënë. Në Dhiatën e vjetër është dhënë porosia “Puthe të afërmin tënd”. Dhe Ai kur vjen jep porosinë e re “Ju lejoj të puthni armiqtë”. Ndërsa tani, le të them, unë personalisht, individualisht, si një nevojë e imja e brendshme për disa përgjigje në jetë, njëra ndër pyetjet kryesore për mua është “Kush janë armiqtë e mi, kush është armiku im?” Në këtë pyetje, mendoj, nuk kam akoma përgjigje. Dhe këtë përgjigje e kërkoj ende në mënyrë aktive. Edhe përpjekja ime që të përcaktojë se cila do të ishte kjo forcë armiqësore, tani për tani, përfundon tek vetja ime. Mendoj se ky është disi vendi i parë dhe i fundit ku ndodhet armiku i njeriut, pra në veten e tij.

Çfarë do të nevojitej që të pajtoheshin apo që së paku të përmirësoheshin pasojat e kësaj ndarjeje gjithnjë e më të madhe?

Që populli të mos shikohet si një masë, kolektiv, si kope e deleve, por si një bashkësi e njerëzve, personaliteteve të gjalla ku të gjitha janë të veçanta. Secili është një histori në vetvete. Dhe tani secila nga këto histori të punojë në vetvete. Do të thotë, t'i kthehet vetes, të mendojë për përmirësimin e gjendjes së tij, situatës së tij, dhe të mos merret me të tjerët. Me të tjerët të kontaktojë vetëm kur mund t'i japë apo t'i ofrojë diçka të mirë apo nuk di çfarë tjetër. Për pajtim nevojitet që secili të shikojë veten dhe në vetvete të gjejë forcën, ta analizojë veten, të gjejë motiv për veten. Në këtë kontekst, është simptomatike se në këto situata faji kalohet gjithmonë tek tjetri. Ndërsa tani, ky kalim i fajit të orientohet kah vetja. Do të thotë, kur dikush veç duhet të jetë fajtor, atëherë le të jemi ne vetë e jo dikush tjetër. Nëse asgjë tjetër, atëherë ky faj të transformohet të paktën në atë ndjenjë e përgjegjësisë. Jo që dikush tjetër është fajtor, por që unë jam përgjegjës. Mendoj që kjo është ajo që duhet bërë me veten. Kjo nevojitet – t'i kthehesh vetes në këtë kuptim.

Në këtë kontekst, cili do të duhej të ishte raporti ynë ndaj të kaluarës, si të sillemi ndaj saj, ndaj luftërave dhe konflikteve? A është e mundur të kemi një jetë të ardhshme duke mos marrë parasysh atë që ka ndodhur?

Mendoj se këtu do të mund të më ndihmonte Ajnshtajni, që koha është disi katego-

Nëse ata kanë ndonjë problem, unë dua të shoh se çfarë mund të bëj unë dhe cila është përgjegjësia ime aty, si mund të ndihmoj unë. Unë nuk dua të shmangem që të di se pse ka ardhur deri te kjo situatë; do të doja të dëgjoja atë tjetrin, pse ndihen ata të kërcënuar dhe çfarë kam bërë unë që të jetë ashtu. Ne mund të supozojmë se si e ka pasur situatën ai tjetri apo si e ka, por vetëm ai mund të na thotë se si e ka vërtetë.



ri relative. Mendoj se ajo që është e rëndësishme, është e tashmja, edhe pse kjo e tashme është pasojë e njëfarë të kaluare dhe edhe pse këto konflikte apo ajo luftë në një moment të caktuar kanë qenë e tashme, apo jo? Tani, kjo ka kaluar ashtu siç ka kaluar. Duhet të përqendrohemi në të tashmen, në atë që po ndodhë në këtë moment. Të mos harrojmë, natyrisht, çfarë ka qenë apo të mos përpiqemi të ndryshojmë diçka, të falsifikojmë historinë etj.

Si e dimë se çfarë ka qenë?

Gjithmonë e dimë se çfarë është e vërtetë. Këtu nuk ka relativizime siç thashë për kohën, sepse ekzistojnë disa kategori absolute. Unë mendoj se ekziston njëfarë fotografie objektive e asaj që ka ndodhur. Do të thotë, ekziston njëlloj interpretimi, ta shikosh problemin nga lartë dhe ta tregosh historinë, kështu dhe kështu ka qenë, do të thotë të mos mbash anën, nuk je as shqiptar, as maqedon, as kjo, as ajo. Megjithatë nuk mundemi nëse jemi, le të themi, në bazë të identitetit maqedonë, sepse gjithmonë do të shikojmë që historinë ta tregojmë disi në favor të maqedonëve, edhe pse nuk e kam pasur këtë qëllim. Unë, për shembull, do të doja të qëndroja edhe në anën e palës tjetër. Në këtë rast, në qoftë se na kanë sulmuar shqiptarët dhe kanë kërkuar disa të drejta të tyre, unë dua ta di se pse e kanë bërë këtë, dua ta di se çfarë kërkojnë ata, si ndihen ata, pse e bëjnë këtë. Pse ndihen ata të frustruar dhe të lënduar? Më intereson. Nëse ata kanë ndonjë problem, unë dua të shoh se çfarë mund të bëj unë dhe cila është përgjegjësia ime aty, si mund të ndihmoj unë. Nëse tani thuhet, për shembull, se ka qenë luftë, ka qenë konflikt, se ata kanë sulmuar, unë nuk dua të shmangem që të di se pse ka ardhur deri te kjo situatë; do të doja të dëgjoja atë tjetrin, pse ndihen ata të kërcënuar dhe çfarë kam bërë unë që

të jetë ashtu. Ne mund të supozojmë se si e ka pasur situatën ai tjetri apo si e ka, por vetëm ai mund të na thotë se si e ka vërtetë. Nuk dua të shmangem nga problemi apo nga realiteti, përkundrazi.

Si do të mund të hapej hapësira për diskutim mbi nevojat e tjetrit, mbi ndjenjën e tij të kërcënimit?

Po, kjo varet praktikisht nga sinjeriteti ynë, varet nga ajo se sa ndihem unë e kërcënuar, sa kam frikë unë, sa e përjetoj unë atë si armik e sa si dikë që ma ka dhënë Zoti që përmes tij të arrijë deri tek Zoti. Këtu qëndron i gjithë dallimi – a e shikoj dikë si vrasësin tim potencial apo si shansin tim që të arrijë deri tek njëfarë dashurie, sepse nëse kemi mbërritur në situatë të tillë, është e qartë se kjo ndodh për arsye se unë nuk kam pasur dashuri ndaj dikujt, e jo për arsye se ka ardhur dikush dhe, thjesht, don të më vrasë. Mendoj se është në natyrën e njeriut që ta kalojë gjithmonë fajin tek tjetri, ndërsa ai vetë të paraqitet që është në rregull, që nuk është fajtor. Kjo ndodh disi mekanikisht, d.m.th. njeriu nuk është i vetëdijshëm për këtë transferim të fajit. Ndërsa kur të vetëdijësohesh, kur të shohësh se dikë nuk e ke armik, se të është imponuar si i tillë, atëherë ka shans për të dy.

A mendon se komunitetet fetare në Republikën e Maqedonisë i japin përkrahje të mjaftueshme apo aktive pajtimit?

Nëse gjykojmë duke u nisur nga ata që janë, le të themi, kokat e këtyre komuniteteve, ata, të paktën formalisht shfaqin njëlloj dëshire për këtë. Ekzistojnë kontakte, ekziston komunikimi ndërmjet tyre. Në thelb të çdo religjioni, çdo besimi, qëllim përfundimtar është gjithmonë jeta në bashkësi me Zotin, gjegjësisht qëndrimi në anën e të mirës. Besoj që së paku teorikisht, nëse jo edhe praktikisht, i përmbahemi kësaj (*qeshet*). Në mënyrë që tërë kjo të realizohet në praktikë, mendoj se nevojitet njëfarë periudhe që është para nesh.

Çfarë mbetet që të bëjnë të ashtuquajturit “njerëz të zakonshëm”? Çfarë mund të bëjmë ne?

Nuk ekzistojnë njerëzit e zakonshëm dhe të pazakonshëm. Ekziston gjithmonë vetëm një njeri dhe nga nga ai nis çdo gjë. Nga ajo masë e njerëzve, secili është i veçantë, ka personalitet të papërsëritshëm dhe në këtë kuptim nuk ka njerëz të zakonshëm. Ata njerëz të zakonshëm janë miliona personalitete të papërsëritshme. Çdokush mund të bëjë shumë, së pari në veten e tij. Unë insisto në këtë, jo në kuptimin e egoizmit, por në kuptimin e punës në vete, ta bësh veten më të mirë. Vetëm kur njeriu të bëjë diçka në vete dhe për veten, vetëm atëherë mund të drejtohet kah tjetri, të hapet për tjetrin.

A. B.

Urrejtja ka prodhuar urrejtje

A i ndien akoma pasojat e luftës, katër vjet pas konfliktit në Maqedoni?

Po, i shoh kudo, posaçërisht në vendet që kanë qenë më tepër të përfshira në luftë, si p.sh. në regjionin e Kumanovës. Atje e kam motrën dhe në të kanë ndikuar shumë tërë këto ngjarje. Gjatë luftës ajo ka qëndruar një kohë të gjatë nëpër bodrume dhe për këtë arsye ka trauma. Bile edhe sot e kësaj dite ndodh që të zgjohet në mbrëmje, të dalë jashtë, të bërtasë... gruaja e moshuar 40-vjeçare. Ndihet kjo edhe tek populli, në përgjithësi, edhe në bazë të sjelljeve menjëherë pas luftës. Tani ekzistojnë disa ndryshime të vogla, por pasojat ndihen akoma.

Si ka ndikuar në ty lufta?

Unë jam më ndryshe dhe ndryshe edhe i kuptoj gjërat. Për mua edhe atëherë lufta ka qenë e pakuptimtë sepse gjithçka mund të arrihet me bisedime.

Falë Zotit, ne njerëzit e kemi një dhunti, atë që mund të flasim, të komunikojmë dhe mund t'i kuptojmë disa gjëra dhe të gjitha t'i rregullojmë me bisedime. Nuk kemi nevojë as për pistoletë, as për bomba. Mendoj se edhe pa to mund të merremi vesh.

A ka situata të tilla ku ti je ndier e lënduar?

Ka shumë, bile tepër, por njëra edhe sot e kësaj dite më ka lënë përshtypje: para disa vitesh kam punuar edhe në Shtëpinë e Shëndetit, edhe në shkollën mjekësore; ka pasur mungesë kuadrosh dhe në atë kohë u kam dhënë mësim paraleleve në gjuhën shqipe. Ka munguar një kolege nga gjinekologjia, e cila ka bërë ushtrimet me nxënës. Unë i kam ofruar ndihmë drejtoreshës (tash ajo është shkarkuar) sepse nxënësit i kanë humbur orët. Pse t'i humbin orët, pse të sorollaten rrugëve, prandaj unë jam paraqitur për t'i marrë nxënësit, kurse ajo, më është përgjigjur, bile edhe me habi: "Kush? Ju? Të punoni në paralelen maqedonase?" Bile asaj i është dukur çudi, kurse unë jam ndier e lënduar, sepse kam menduar: si mund t'u japin mësim paraleleve shqiptare maqedonët, kurse ne nuk mund t'u japim atyre maqedonase? Sikur të ekzistonte problemi i gjuhës, hajde, të themi se nuk e di, edhe pse kjo nuk është e vërtetë, por ka qenë fjala për ushtrime praktike në klinikë, në repartin e kirurgjisë; ashtu sikur në paralelet maqedonase ashtu edhe në paralelet shqiptare tregohet sesi merret injeksioni ose si bëhet ndonjë ndërhyrje tjetër, kështu që nuk ka shumë për të folur.

Si je ballafaquar me këtë situatë dhe me situata tjera të këtilla që të prekin?

Mendoj se unë jam person i hapur. Dëshiroj të bisedoj kur ekziston hapësirë për bisedë. E dëshiroj edhe *feedback*-un, e kam kërkuar edhe nga drejtoresha sepse, para kësaj ngjarjeje, përmes *Megjash*-it kemi pasur mundësi të mësojmë më tepër për përpunimin e padhunshëm të konflikteve ose sesi gjërat mund të zgjidhen duke biseduar. Dhe kam dashur edhe në atë rast të provoj, të arrij ta bëj këtë, por në atë kohë ajo nuk ka pasur veshë, por duket se edhe koha ka qenë e tillë pas luftës, prandaj nuk e di se pse, ndoshta ka qenë e tronditur.

Mua shpesh më ka ardhur të qaj sepse më kanë urrejtur dhe vetë urrejtja ka prodhuar urrejtje; edhe unë në fillim kam qenë e frikuar dhe më pas deshe – s' deshe do të fillosh të urresh dikë që të fyen. Të gjithë jemi njerëz, të gjithë jemi të njëjtë. Ndoshta ka dallime në kulturë, gjuhë, por të gjithë marrim frymë, të gjithë jemi njerëz.

Kohën e fundit unë vërej që tek i njëjti person ka mjaft ndryshime. Bile edhe unë jam e befasuar – më drejtohet me respekt, shoh që konsultohet nganjëherë për di-sa gjëra.

Unë besoj se me vetëdijësimin ndaj dhunës dhe jodhunës, pastaj me teknikat e komunikimit të padhunshëm – atë çfarë bëjmë me nxënësit tanë në punëtori, mund të bëhen çudira, ta zëmë në arsim... mund të bëhet me të vërtetë shumë.

Çka paraqet për ty pajtimi?

Po në vend që jetën ta kalosh në grindje dhe urrejtje, pse mos ta shndërrosh në diçka të bukur? Kur ti duhet të jetosh në të njëjtën hapësirë, në vend që të grindesh, duhet ta pranosh atë dhe ta kuptosh. Duhet të flitet hapur për problemet, me besim, në mënyrë të lirë dhe të relaksuar, pa shtrëngime, ashtu siç bisedojmë në punëtori. Njerëzit mund të vihen në situatën tënde dhe të të kuptojnë, t'i sqaroni gjërat. Shpesh ndodh që dikush të bëjë diçka nga frika e jo me qëllim. Thonë që peshku qelbet nga koka, kurse pastrohet nga bishti. Pajtimi varet shumë nga qeveria. Edhe aty duhet të punohet shumë.

Çfarë për shembull?

Po pse të mos zhvillohen punëtori? Nuk e di sesi është puna tek politikanët, por pse të mos aplikohet kjo edhe tek ata? Edhe tek ata mund të ndikojnë punëtoritë. Kur kanë mundur të ndikojnë tek ne profesorët, pse nuk do të mundej edhe tek ata?

Mua shpesh më ka ardhur të qaj sepse më kanë urrejtur dhe vetë urrejtja ka prodhuar urrejtje; edhe unë në fillim kam qenë e frikuar dhe më pas deshe – s'deshe do të fillosh të urresh dikë që të fyen. Të gjithë jemi njerëz, të gjithë jemi të njëjtë. Ndoshta ka dallime në kulturë, gjuhë, por të gjithë marrim frymë, të gjithë jemi njerëz.

Çfarë mendon, a e don pajtimin populli në Maqedoni?

Po. Mendoj se edhe maqedonët e duan pajtimin. Normalisht që as atyre nuk u përshtaten këto situata konflikti. Edhe pse nuk merrem vesh në politikë, prapëseprapë do ta them këtë: kam dëgjuar në lajme se edhe maqedonët frikohen dhe se kanë dëshirë që të ekzistojë shteti i Kosovës. Nëse ka konflikte, ato do të barten edhe këtu. Mendoj se kanë të drejtë.

Çfarë mendon se mund të bëhet tjetër në këtë drejtim? Për shembull, si do ta ndihmoje ti personalisht procesin e pajtimit? A vëren se ti mund të bësh diçka?

Në shkollën e mjekësisë ka profesorë shqiptarë, por ka mjaft të tjerë të papunë, ka mjekë të papunë, kurse nevoja për kuadro ekziston. Pse nuk u jepet mundësia që ata të punësohen më shpejt, të kualifikohen më shpejt në mënyrë që të kemi kuadro për më gjatë? Shumë gjëra frenohen, ka frenime në punësim. Ekziston dikush që e bën këtë me qëllim.

E din pse mendoj se është kështu? Sepse unë mund ta dëshmoj këtë nga përvoja ime, që të mos dalë se gënjej ose nuk e di çka apo se shërbehem me dezinformata. Kur unë desha të kaloj në shkollë të mjekësisë, aty ekzistonte mungesë e kuadrove. Nga ambulanca në shkollë të mjekësisë më kanë mbajtur tri vjet pa më paguar. Kam punuar pa pagesë. Pas tre vjetësh mezi kam arritur që të transferohem prej Shtëpisë së Shëndetit në shkollë, gjë që ka mundur të bëhet edhe më heret dhe do të ishte më profesionale sikur të kisha dhënë mësim menjëherë që atëherë, e jo – vrapo në këtë punë, vrapo në atë punë. E kam pasur vështirë dhe përveç kësaj ka



pasur edhe obstruksiione. Nuk them se këtë e kanë bërë të gjithë maqedonët, por në atë kohë ka pasur pak si shumë maqedonë që më kanë bërë obstruksiione.

Si ke reaguar ti ndaj gjithë kësaj?

Unë kam provuar të flas me ata njerëz, por nuk kam arritur të flas me të gjithë sepse disa më kanë injoruar. Thjesht e kanë konsideruar nënçmim të flasin me mua. Kam provuar edhe përmes shefave të mi, por ata më kanë thënë vetëm “po, po, po” dhe asgjë nuk kanë ndërmarrë. Kam provuar edhe përmes eprorëve tanë të cilët kanë punuar në Ministri, përmes tyre kam bërë njëfarë presioni; kanë bërë diçka, por mezi, shumë pak. Aq shumë energji kemi shpenzuar për diçka që do të duhej të ishte normale.

Çfarë mendon se mund të bëjë populli të cilit i përket ti për arritjen e pajtimit në Maqedoni?

Ka edhe nga pala shqiptare politikanë që e mashtrojnë popullin, i premtojnë shumë gjëra të cilat nuk kanë arsye; nga këndvështrimi im, mendoj se për shumë gjëra keqpërdoret populli.

Përndryshe, sipas meje, ka shumë shqiptarë që duan të bashkëpunojnë, të jetojnë së bashku, dëshirojnë jetë të qetë dhe janë për tolerancë. Ka edhe të tillë që kërkojnë diçka për çfarë nuk ka shans. Sipas meje, përzierjet, dallimet janë më interesante. Mua më pëlqen më shumë që tash flas edhe maqedonisht, edhe serbisht, edhe turqisht ngapak, edhe shqip e edhe gjuhën rome. Kam miq në Shqipëri dhe ata ndoshta e dinë italishten dhe anglishten, por unë ndihem më e pasur pasi që edhe unë e flas pak gjuhën angleze. Dua të them: sa më tepër kombe, sa më tepër kultura të ndryshme – aq më interesante është jeta.

Por edhe nga lart duhet të ndryshohen disa gjëra. Përndryshe populli... populli nuk është i keq, as ai maqedon, as ai shqiptar. Por përmes mediave transmetohen disa gjëra të këqija, sidomos këtë e bëjnë disa televizione të pakontrolluara.

A e përjeton tani Maqedoninë si vend ku mund t'i realizosh të drejtat tuaja?

Po. Absolutisht që mundem. Edhe unë ndihem si shtetas maqedon dhe kur shkoj diku them se jam nga Maqedonia; bile edhe në Shqipëri, kur shkoj në det, na thërrasin shqiptarë, kurse unë i përmirësoj duke u thënë se ne jemi shqiptarë nga Maqedonia.

Cili është qëndrimi yt për parimin e 20 për qind të punësimit në institucionet shtetërore?

Çelësi sipas meje nuk duhet të jetë 20-30 përqindëshi, por bazë duhet të jetë cilësia. Unë nuk do të dëshiroja që nxënësve të mi t'u japë mësim dikush që sapo ka dalë nga bankat shkollore. Më me qejf do të kisha shkuar tek maqedoni profesionist sesa tek shqiptari joprofesionist. Duhet të punësohen sipas profesionit, sipas afiniteteve që i kanë; ndërsa normalisht të gjithëve t'u jepet mundësia të regjistrohen, sepse në këtë moment, tash për tash shqiptarët ndoshta nuk i kanë të gjithë kuadrot, të gjitha profilet për punësim. Çështja është e tillë sepse një kohë e kemi pasur të ndaluar të shkollohemi. Unë e di personalisht nga përvoja ime – kam qenë nxënëse e shkëlqyeshme dhe kam konkurruar në mjekësi dhe nuk më kanë pranuar, do të thotë, e kemi pasur të ndaluar të shkollohemi. Nuk kam dashur të regjistrohem askund tjetër, kam dashur mjekësinë dhe pikë. Edhe vitin tjetër kam konkurruar përsëri dhe edhe atë vit ka qenë situata e njëjtë sa i përket provimit pranues. Kam menduar se do të më pranojnë dhe sërish nuk më kanë pranuar për 0.3 pikë. Nuk kam mundur pra të regjistrohem as atëherë... ç'të bëj, jam regjistruar në fakultetin e kimisë.

Dua t'ju them se nuk më janë plotësuar dëshirat dhe as mundësitë dhe për këtë arsye tani ka mungesë të kuadrove. Duhet t'u jepet më shumë mundësi shqiptarëve dhe romëve, flas për cilindo komb; t'ju jepet mundësia të kualifikohen, specializohen në bazë të mundësive dhe nevojave.

Si mendon se duhet të sillemi ndaj të kaluarës, a duhet të harrohet ajo që ka ndodhur?

Gjërat e këqija gjithmonë kam dëshirë t'i harroj. Unë jam person i tillë, vetëm të mirën kam dëshirë ta kujtoj, sepse e keqja çon drejt të keqes, drejt më të keqes. Dhe për këtë duhet të kuptohen disa gjëra: ja, ajo ka qenë, ka kaluar, tani duhet të dimë disa gjëra, si të ecim më tej. Çdokush mund të ndryshojë. Nuk duhet të bazohemi gjithmonë në të kaluarën. E kaluara duhet të dihet, por ajo e keqja duhet të harrohet.

Edhe të falet?

Edhe të falet, kuptohet.

Po ata që kanë humbur kushërinjtë më të afërm, miqtë? Sa mund të harrojnë ata?

Po gjithmonë ka qenë dhe do të jetë kështu. Gjithmonë do të ketë edhe të vdekur. Përveç kësaj, edhe sipas fesë, edhe sipas njerëzores duhet të harrohet.

Ja, sikur mos të harrojmë, sikur të ruajmë... Për shembull, motra ime ka vdekur për shkak të maqedonit, i cili e ka vrarë atë. Dhe çfarë fitimi do të kem unë nga kjo, do të vrisja një maqedon dhe çfarë? Mua nuk do të më kthehet as motra, as kushdo

tjetër. Unë jam kundër kësaj, dua ta harroj të keqen; sa më heret që të harrohet, aq më mirë.

Çka mendon se do të duhej të bënin politikanët?

Po, sikur ata do të silleshin me dashuri ndaj popullit të vet, për shembull, shqiptari ndaj shqiptarit, do të ishin të vetëdijshëm se duhet të ndryshojnë. Disa gjëra shkojnë kah e mira, vetëm e mira të mbahet mend, por kjo nuk u përshtatet gjithmonë. Unë mendoj se duhet filluar me përmirësimin e statusit social të njerëzve, në përgjithësi, ekonomisë, e jo vetëm të jetë “ne shqiptarët”, “ne maqedonët”, të rrahin gjoks në atë stilin – duhet Shqipëria e Madhe, Maqedonia e Madhe. Çfarë të bëjmë me atë Shqipëri të Madhe, me atë Maqedoni të Madhe? Çka, kur nuk je askushi? Ti, së pari, duhet të arrish ta mbjellësh dashurinë tek populli yt, e jo të përhapësh urrejtjen, sepse urrejtja nxit vetëm urrejtjen. Përkundrazi, duhet ndërtuar bashkëjetesën e përbashkët, ndaj dashurisë të sillemi me dashuri. Nuk do të humbim asgjë.

Çfarë mendon, i kujt është faji për të gjithë këtë që na ka ndodhur?

Po unë mendoj se është tek të dy palët. Por mendoj se faji qëndron edhe tek fuqitë e mëdha. Ata, normalisht, krijojnë pengesa këtu që të mund të qeverisin.

Çfarë mendon për përgjegjësinë individuale, për fajin individual?

Gjithmonë është kështu – nëse lëvizet guri i vogël, pastaj i dyti, i treti, edhe mund të bëhet diçka. Nëse asgjë nuk lëvizet, atëherë nuk mund të bëhet gjë.

Normalisht se disa gjëra na janë imponuar edhe prej fuqive të mëdha, por nëse ne nuk jemi të fortë, nëse jemi të bindur në diçka, çdo guralec jep kontributin e vet, çdo individ, dua të them jep kontributin e vet. Unë, si person, ndoshta nuk jam askushi, por në rrethin tim, në rrethin tim të afërm kam kontribuar që të kemi raporte më të mira, disponim më të mirë dhe e ndiej këtë, e shoh në fytyrat e të tjerëve që më rrethojnë dhe çdokush mund ta bëjë këtë. Sipas meje, individ mund të ndikojë shumë në familje. Nëse kemi më tepër familje të shëndosha, shoqëria si strukturë duhet të jetë e shëndoshë.

Faji i takon edhe grupit. Ka disa grupe që kanë rënë nën ndikimin e fuqive të mëdha. Së dyti, pakënaqësia kolektive, edhe ajo kontribuon, si dhe mbisundimi kolektiv. Populli maqedon ka dashur të jetë mbi të tjerët – Maqedonia e maqedonëve dhe të tjerët në këmbët e tyre. Sikur të mos ishin ata të tillë dhe sikur shqiptarët të mos ishin ndier të shtypur, nuk do të kishte ndodhur kjo.

A ka vend apo hapësirë në Maqedoni për shprehjen e identitetit të vet?

Mundet, ka hapësirë, vetëm se ka shumë njerëz që duan të ndikojnë, duan të pengojnë. Përndryshe, ekziston mirëkuptim, vetëm me bisedime mund të zgjidhet çdo gjë.

A e shpreh ti lirisht identitetin tënd si shqiptare në Maqedoni?

Po, bile jam edhe krenare për këtë.

Më ka ndodhur derisa kam studiuar në fakultet në Manastir; kam qenë shqiptarja e vetme në fakultet dhe pasi që maqedonishtja në Shkup është ndryshe nga ajo në Manastir, nuk e kanë dalluar që jam shqiptare; dhe njëherë kur me shoqe isha mysafire tek një shoqe, më kanë pyetur se sa fëmijë kam. Unë ju thashë dy, kurse ato më thanë: “Po e re je, lind se do të humbim si komb. Ata mund të kenë nga pesë-gjashtë, kurse ne vetëm nga dy”. Nuk e kanë ditur se jam shqiptare dhe atëherë ju kam treguar se edhe unë jam shqiptare, por që lindja e fëmijëve nuk shkon sipas bazës nacionale, por sipas mundësisë. Nëse je e punësuar, nuk ke kohë dhe

Më ka ndodhur derisa kam studiuar në fakultet në Manastir; kam qenë shqiptarja e vetme në fakultet... Dhe njëherë kur me shoqe isha mysafire tek një shoqe, më kanë pyetur se sa fëmijë kam. Unë ju thashë dy, kurse ato më thanë: “Po e re je, lind se do të humbim si komb. Ata mund të kenë nga pesë-gjashtë, kurse ne vetëm nga dy”. Nuk e kanë ditur se jam shqiptare dhe atëherë ju kam treguar se edhe unë jam shqiptare, por që lindja e fëmijëve nuk shkon sipas bazës nacionale, por sipas mundësisë. Kur u kam treguar se jam shqiptare janë ndier keq.

normalisht se nuk do të lindësh. Ka lidhje edhe niveli i arsimimit, sepse ata që nuk e kanë mendojnë se sa fëmijë falë Zoti, aq duhet pasur. Kur u kam treguar se jam shqiptare janë ndier keq.

A të kanë kërkuar falje?

Po, po, më kanë kërkuar falje. Nuk qëndron problemi te kërkitimi i faljes, por pse duhet të kenë mendim të tillë. Të gjithë mendojnë se të gjithë shqiptarët janë njësoj. Nëse ekziston një që nuk është i mirë, ata mendojnë se të gjithë janë të tillë. Nuk ka nevojë për përgjithësim të gjërave.

Si e sheh të ardhmen e Maqedonis?

Po unë jam ngapak optimiste. Edhe nga natyra jam optimiste dhe mendoj se kemi filluar të shkojmë kah e mira dhe se do të ecë kah e mira.

Nxënësit maqedonë as që kanë dashur më heret ta dëgjojnë shqipen, jo më që ta mësojnë, kurse tash shoh që kemi tre grupe, edhe ato të mëdha dhe me këtë e kuptoj se ardhmëria mund të jetë më e suksesshme.

Unë mund të kem grindje edhe në familjen time, kjo është normale; do të vijë koha kur nuk do të dallohemi nga kombësia, por nga ajo se çfarë njeriu je, çfarë karakteri ke, e jo nga ajo nëse dikush është shqiptar, rom apo maqedon.

Sa kontribuon, sipas teje, Marrëveshja e Ramkovës në përmirësimin e situatës në Maqedoni?

Po jo aq shumë. Ka kohë që ajo është dashur të implementohet. Nuk dua të them se unë merrem vesh në këtë, por e shoh se rezultatet ecin disi shumë ngadalë. Disa gjëra ekzistojnë akoma vetëm në letër, por jo edhe në praktikë.

Dhe tani në fund, diçka që dëshiron të thuash e që unë nuk të kam pyetur?

Unë do ta kisha thënë si porosi: “bëj tjetrit atë që ke dëshirë ta bëjnë ty”. Çdo njeri është burim i pashterrshëm i energjisë pozitive.

G. P. Z.

Njeriu si qenie politike

Si ndihesh sot, 10 vjet pas luftës, kur i kujton ngjarjet e viteve '90? A i kujton ato ndopak pasi që atëherë ke qenë shumë i ri dhe sa janë ato kujtime intensive?

Sigurisht që i kujtoj, por emocionet nuk janë më aq intensive. Kjo është për mua diçka që ka kaluar, edhe pse tek të gjithë ne kanë mbetur pasojat, më së tepërmi në njëfarë aspekti ekonomik. Sa më përket mua personalisht, nëna e ka humbur punën në atë periudhë lufte, babai vazhdoi të punonte, por u bë invalid për shkak të keqësimit të sëmundjes si pasojë e stresit të përgjithshëm në atë kohë. Në këtë kuptim i ndiej pasojat, por nuk kam kurrfarë ndjenjash negative, posaçërisht ndaj një kombi tjetër; nuk ndiej kurrfarë urrejtjeje e as diçka të ngjashme.

Çfarë është e nevojshme që këto pasoja, për ty por edhe për të gjithë neve, së paku të zbuten, nëse jo edhe të eliminohen?

Do të paraqitem si marksist (*buzëqeshje*). Unë jam i bindur se së pari duhet të rregullohet situata ekonomike, sepse vetëm ekonomia e suksesshme mund t'i kontribuojë jetës më kualitative sociale dhe çfarëdo ndryshimi pozitiv. Sepse vetëm kur njerëzit ta mbushin barkun, kur janë të gjithë të ngopur, gjegjësisht të paktën masa më e madhe, atëherë mund të ecim më tej. Sepse nëse shumica e njerëzve janë të uritur, nuk mund t'i zgjidhin çështjet e tyre themelore ekzistenciale, atëherë për ndryshime pozitive as që mund të bëhet fjalë.

Çka është për ty pajtimi?

Pajtim i suksesshëm do të ishte bashkëjetesa e mirë. Ndërsa bashkëjetesën e përbën komuniteti tolerant i cili përfshin shumë kombe. Ky është komunitet ku kombet tjera nuk janë të shtypur nga popullata vendore, një komunitet harmonik multi-etnik, ku respektohen të drejtat e çdo individi.

Çfarë është e nevojshme që njerëzit në trevat tona të jetojnë në komunitete të tilla harmonike? Çfarë është parakusht për një pajtim të tillë?

Siç e përmenda më parë, parësore është përmirësimi i situatës ekonomike, pastaj vijon edukata civile, kurse në bazë të nivelit të kësaj edukate më duket se në Kroaci kjo për momentin jo që është e pamundur, por është shumë vështirë të arrihet.

Kush duhet të punojë në arritjen e pajtimit?

Tani do të them si ndonjë gjysho, natyrisht që të rinjtë; bota u mbetet atyre... Më duket disi se ne jemi ata që kemi një angazhim më të madh, më tepër energji, më tepër hapësirë, do të mund të kishim më tepër ndikim. Le të themi edhe mediat dhe sërish në to njerëzit e rinj të cilët nxisin qëndrimet më liberale dhe vlerat më humane. Intelktualët në çdo rast, si dhe njerëzit që dinë dhe munden.

Domethënë, sipas teje, të rinjtë duhet t'i kyçim më tepër në jetën aktive shoqërore si dhe në proceset e pajtimit apo ekzistojnë bartës të tjerë të këtyre proceseve?

Nëse do të vazhdojmë t'i urrejmë gjërat dhe njerëzit nga e kaluara, nuk do të mundemi të veprojmë normalisht as në të tashmen, as në të ardhmen.

Kur thuhet “duhet t’i kyçim”, kjo disi nuk më tingëllon mirë, tingëllon si ndonjë aparat i cili prej kohës në kohë ndizet e fiket. Mendoj se vetë të rinjtë duhet t’i njohin problemet e shoqërisë dhe të fillojnë të merren me ato. Mendoj se ekzistojnë mënyra, ekzistojnë iniciativa në të cilat njerëzit e rinj do të duhej të kyqeshin.

Cilat janë problemet që i sheh si pengesë në realizimin e progresit që çon drejt pajtimit?

Do të flas për problemet që ekzistojnë definitivisht në shoqërinë tonë. Këto janë, përsëri, më duket vlera të shtrembëruara të rrënjësura në vetëdijen e shumicës së njerëzve, të cilët, për shembull, e vendosin kombësinë, religjionin si njëfarë kriteri të rëndësishëm për vlerësimin e individit. Mendoj se kjo nuk duhet të jetë kurrsesi prioritare në marrëdhëniet ndërnjerëzore.

A mendon se janë të gatshëm për t’u pajtuar njerëzit e vendit tënd?

Më duket se ende ekzistojnë emocione të rënda, që edhe është e kuptueshme për njerëzit të cilët kanë humbur në luftë anëtarët e familjeve të tyre. Nga ana tjetër, tashmë ka kaluar mjaft kohë dhe mendoj se njerëzit duhen të jenë ngapak të gatshëm për këtë pajtim, por përsëri më duket se ende nuk janë.

A e dëshirojnë njerëzit pajtimin?

Po shikoni, të gjitha zonat e përfshira në luftë sipas rregullit nuk kanë qenë kurrë vende urbane. Pra, ato kanë qenë zona rurale në të cilat ka jetuar popullata me nivelin më të ulët edukativ, e kjo ka prodhuar sërish njëfarë mendimi të ndryshëm dhe vlera të ndryshme. Do të thotë, kjo është ajo që e theksova më parë; të dhënit prioritet kombësisë dhe religjionit. Unë nuk mendoj se njerëzit nuk e kanë tendencën për t’u pajtuar. Ata ndoshta edhe e shohin këtë si një gjë pozitive; ta zëmë në aspektin e të mirave të tyre bujqësore të cilat do të mund eventualisht t’i shesin në tregun boshnjak apo serb, gjë që për momentin është e vështirë në masë të madhe.

Çfarë mund të bëjnë për pajtimin “njerëzit e zakonshëm”? Çfarë duhet të ndërmarrim ne? A jemi ne “të vegjël” për hapa të mëdhenj?

Nuk e pranoj në asnjë mënyrë ndarjen: njerëz të vegjël dhe të mëdhenj, por, pajtohem se ekzistojnë ata që i fusin njerëzit në ato sirtare. Po, pa dyshim njerëzit mund të bëjnë shumë përmes veprimtarisë së tyre, kyçjes në iniciativa dhe mendoj se çdokush mund ta bëjë këtë pavarësisht se sa punon në ditë. Kurse baza e kësaj është entuziazmi dhe besimi në pajtim, ndërsa më vonë veprimtaria e njeriut si qenie politike.

Si duhet ta trajtojmë të kaluarën?

Për mua gjëja e parë është pajtimi; të kuptosh se kundër disa gjërave nuk ka më kuptim “të luftosh”, sepse ato thjesht kanë kaluar dhe kështu edhe duhet të kuptohen. Lufta është një punë e përfunduar e cila do të ketë ndikim në të ardhmen në atë masë sa do t’ia lejojë ne. Sepse nëse do të vazhdojmë t’i urrejmë gjërat dhe njerëzit nga e kaluara, nuk do të mundemi të veprojmë normalisht as në të tashmen, as në të ardhmen.

A duhet të harrojmë?

Mendoj se harresa si kategori nuk ekziston në qenien njerëzore, të paktën derisa të mos bëhet senile. Harresa ekziston, por për disa gjëra irelevante, ndërsa për ngjarje të tilla të mëdha që kanë pasur ndikim aq të madh tek ne, ato nuk mund të harrohen.

Po çfarë mendon se duhet të bëjnë politikanët dhe “bosët” tjerë që të arrihet sa më parë pajtimi? A angazhohen ata në masë të mjaftueshme në këtë fushë?

Për fillim, ata do të duhej të flisnin më tepër për pajtimin në kontekst pozitiv. Ata do të duhej të potenconin vlerat demokratike dhe vetëdijen për nevojën e pajtimit, natyrisht pa politizim patetik.

Cila nga palët e dikurshme në konflikt do të duhej të fillonte në mënyrë më intensive procesin e pajtimit?

Natyrisht se kjo është në interesin e të gjithëve, kështu që do të duhej të ekzistonte bilanci. Për të gjithë është e nevojshme që ky proces që çon kah normalizimi i gjendjes të përfundojë sa më parë, aq më tepër kur dëshirojmë të hyjmë në Bashkimin Europian. Të gjithë e dimë se parakusht i pashmangshëm është në mes tjerash edhe raporti i mirë me fqinjët.

Çfarë do të ndryshonte tek ti sikur të ndodhte pajtimi midis dy-tre kombeve/vendeve?

Do të jem praktik. Unë konkretisht do të mund të shkoja të studioj ndonjë semestër në Beograd apo Sarajevë. Ja pra, për mua... sikur të ekzistonin marrëdhëniet më të mira në mes vendeve tona, do të ishte mirë në atë aspektin edukativ.

A mendon se vetëm njëra palë është fajtores?

Jo, në asnjë mënyrë, faji nuk qëndron kurrësi vetëm tek njëra palë. Nuk dua të them se ai është proporcional, sepse faji nuk mund të matet, sikurse as dhimbja e shkaktuar prej tij. Por që faji ekziston tek të dyja anët, kjo është fakt. Po edhe sikur të ndiqnim atë tezën se kush e filloi luftën nuk do të fitonim asgjë. Njëra palë e ka filluar në një territor, tjetra në territorin tjetër dhe kështu mund të qarkullojmë në rreth.

A mund të individualizohet faji apo është kolektiv?

Unë jam gjithmonë për individualizimin e fajit. Nganjëherë dëgjoj terma të tipit “populli që ka bërë gjenocid ndaj popullit tjetër”. Këto janë marrëzira! Nuk ekzistojnë popuj të tillë.

A nuk të duket se të gjithë ne bartim një pjesë të fajit, ndoshta për shkak se kemi mbajtur qëndrim pasiv duke mos dënuar të keqen apo për shkak të ndonjë arsyeje të tretë?

Gjenerata ime dhe unë me të bashkë, konkretisht, nuk kemi mundur të bëjmë asgjë. Ne me të vërtetë kemi qenë shumë të rinj. Në anën tjetër, prindërit tanë kanë mundur definitivisht të bëjnë më tepër, por këtu duhet kuptuar edhe ata sepse janë rritur në një botë krejtësisht tjetër nga ne. Vetëm le të shikojmë literaturën që e kanë lexuar ata, gjërat për të cilat kanë mësuar... gjë që bie plotësisht në kundërshtim me atë që ka ndodhur më vonë. Ata në të vërtetë as që e kanë njohur opcionin se mund të ndodhë ajo që më në fund ndodhi. Prindërit e mi, konkretisht, sado që ka pasur shenja se lufta mund të fillojë, nuk kanë besuar se ajo mund të ndodhë derisa nuk kanë filluar të bëjnë granatat e para.

Cila është përgjegjësia e “njeriut të zakonshëm”?

Kjo është e vështirë të thuhet. Është vështirë të gjykosësh njeriun e “vogël” nëse nuk ka ndërmarrë asgjë, sepse njerëzit kanë qenë të frikësuar, tek ata ka ekzistuar frikë e madhe nga çfarëdolloj veprimi dhe çdokush ka shikuar si ta ruajë kokën e vet më së

Mendoj se harresa si kategori nuk ekziston në qenien njerëzore, të paktën derisa të mos bëhet senile. Harresa ekziston, por për disa gjëra irelevante, ndërsa për ngjarje të tilla të mëdha që kanë pasur ndikim aq të madh tek ne, ato nuk mund të harrohen.

pari. Por sidoqoftë, përgjegjësia e njeriut të “zakonshëm” është po ashtu e madhe, sepse ai është personi i cili vepron në mjedisin, komunitetin e vet.

Kush është në të vërtetë viktimë e luftës qytetare?

Mua më duket se të gjithë ne jemi viktimë, edhe nga njëra, edhe nga tjetra palë, nëse edhe më tej vazhdojmë të ndahemi në palë. Natyrisht, përveç elitës së atëherëshme politike e cila edhe sot jeton me standardin e nivelit të perëndimit, kurse shumica e popullit, shikuar nga aspekti ekonomik, jeton shumë keq.

A mendon se, sikur të kishte pasur vullnet tek njerëzit, ata kanë mundur t'i shmangen manipulimit të mediave?

Do të filozofoj pak, por më duket se njerëzit diku në instinktin e tyre dëshirojnë të jenë të manipuluar, dëshirojnë që dikush të qeverisë dhe sundojë me ta. Sepse nuk ekziston përgjigje racionale në atë se pse e kemi pranuar manipulimin. Këtu flas për shumicën, sepse është e qartë se disa nuk ishin dhe nuk mund të jenë të manipuluar, gjë që është e lidhur përsëri edhe me edukimin të cilin e potencoj gjithmonë.

Cilat janë parashikimet tuaja për të ardhmen lidhur me pajtimin e plotë të popujve që kanë luftuar në luftën qytetare të viteve '90?

Pajtimi do të ndodhë sigurisht. Gjithmonë pajtimet kanë ndodhur në histori dhe në të gjitha territoret, kështu që ai do të ndodhë edhe tek ne. Shembull për këtë është Gjermania. Ja, edhe ne vetë kemi vuajtur nga çizmet e tyre, kurse njerëzit jo shumë pas luftës kanë shkuar masovikisht të punojnë atje, apo edhe të jetojnë tek e fundit. Kjo është thjesht e domosdoshme dhe do të ndodhë.

E. P.

Vitet '90 i kujtoj me njëfarë zemërimi, hidhërimi dhe ndjenje turpi

Do të lutem për fillim të më tregosh diçka për veten, kush je, nga je, çfarë punon...?

Po, pyetje të vështira. Po, mirë – mund të prezantohem – unë quhem Dejan Iliq dhe kam lindur në vitin 1965 në Zemun. Kam një raport shumë të lirë ndaj jetës sime: e dua shumë atë që punoj, por sikur të duhej të them sesa është kjo e rëndësishme, mendoj se nuk është edhe aq. Kam diplomuar për letërsinë e përgjithshme në Fakultetin Filologjik e pastaj kam magjistruar në Universitetin Qendror Evropian – dega e kulturës, ku edhe shpresoj të doktoroj. Jam marrë pak me përkthime, një kohë të gjatë në mënyrë intensive kam shkruar kritikë letrare, e pastaj kam filluar të punoj si redaktor, punë të cilën e ushtroj që nga viti 1994. Të gjitha të tjerat, ajo që kam shkruar, përkthyer, mësuar, të gjitha janë në funksion të punës redaktuese.

Si i shikon këto vitet e luftës, çfarë të ka mbetur në kujtesë? Çfarë përjetimesh ruan nga vitet '90?

Kur i kujtoj vitet '90, së pari më shkon mendja tek Jugosllavia, e cila është shkatërruar. Nuk kam besuar se do të ndodhë diçka e tillë, se do të shpartallohet ky shtet i cili tash më mungon mjaft. Dhe sikur do të detyrohem të them se çka më ka pëlqyer dhe cilat janë kujtimet, do të thoja se kujtoj gjërat më të thjeshta, fëmijërinë, lojërat fëmijnore, shkollimin fillor, bashkëjetesën me prindërit, shoqërimin me njerëz, por tani të gjitha këto më duken si një parajasë e humbur, ndoshta për shkak se plakem. Vitet '90 i kujtoj me një zemërim, hidhërim dhe me ndjenjë turpi, për shkak se ajo që ka ndodhur në vitet '90 e shkatërruan këtë shtet, i cili më mungon kaq shumë; e kush e di, sikur të ishte, ndoshta nuk do ta doja. Jam i zemëruar për shkak që mendoj se, ndoshta, kam mundur të bëj diçka, të arrij diçka, e nuk e kam bërë; ndoshta pse kam qenë përtac dhe kokëtrashë, por ndoshta edhe sepse rrethanat kanë qenë ashtu siç kanë qenë; ndonëse nuk kam bërë pak. Dikush që është zemërzi do të mund të thoshte, sikur të mos kishin ndodhur kaq fatkeqësi, ajo çfarë ke bërë nuk do të kishte asnjë kuptim dhe nuk do të arrije asgjë. Kjo, megjithatë, kurrë nuk dihet. Mendoj se kam mundur të bëjë edhe më shumë, edhe më mirë, sikur edhe shumë të tjerë këtu. Dhe pikërisht për këtë jam i zemëruar dhe i hidhëruar: nuk e shoh se me çfarë të drejte dikush ka mundur të na pengojë në planet dhe dëshirat tona. Kam qenë kokëtrashë dhe egoist sepse kam shikuar vetëm veten. Më është dashur shumë kohë të kuptoj se edhe vetëm kam mundur të bëj diçka. Kjo më hidhëron. Më vjen turp për shkak se kur e them këtë, e them vetëm për vete dhe njerëzit këtu. Shumë vonë i kam kuptuar vështirësitë të cilat u kanë ndodhur njerëzve të tjerë. Sot e kësaj dite më vjen zor dhe disi provoj të arsyetohem për këtë mungesë të dhembshurisë elementare dhe për egoizmin vetanak, sepse e kam ruajtur atë farë jete time të vogël dhe nuk kam bërë asgjë për njerëzit e tjerë, jeta e të cilëve ka qenë krejtësisht e rrënuar. E tani sikur të isha përkulur para vetes do të thosha se jam sjellur sikur shumica e njerëzve, se është njerëzore të mbrosh jetën tënde të vogël dhe të mos kujdesesh për jetën e vogël të

Jemi përgjegjës, sepse si shoqëri kemi pasur rastin të zgjedhim, e kemi zgjedhur kështu siç e kemi zgjedhur, dhe ata që i kemi zgjedhur kanë bërë atë që kanë bërë, dhe pikë. Me këtë tani s'kemi çfarë të bëjmë. Për këtë çdo njeri prej nesh duhet të pyetet – çka kam punuar gjatë gjithë asaj kohe, a jam angazhuar t'i ndihmoj ndonjë partie? Unë jo, dhe tani më vjen keq për këtë.



të huajve, por shumë vështirë e arsyetoj veten në këtë mënyrë. Ne, njerëzit që jemi marrë me letërsi, tamam jemi turpëruar në vitet '90 dhe e gjithë ajo që tani bëj është një tentativë për të shpëtuar. E kjo është turp: çfarë tash pas kaq vitesh?

Si kanë ndikuar tek ju vitet '90?

Unë, megjithatë, jam i kënaqur me jetën time. Nuk kam problem për atë çfarë kam bërë dhe çka kam arritur. Nga njëra anë ndiej se kam mundur të bëj më shumë, nga ana tjetër nuk është pak as ajo që kam bërë. Por problemi qëndron në faktin se të gjithë ne që kemi qenë këtu dhe nuk kemi qenë drejtpërdrejt të goditur me luftëra - ne të gjithë kemi arritur diçka në jetë, kurse të tjerëve u është privuar kjo e drejtë. Me këtë kam problem. Nuk e di si t'ia dal në fund këtij problemi. Kësaj reviste *Reč* (Fjala), për të cilën jam shumë krenar dhe me të cilën me kalimin e kohës po bëhem i njëjtë, sepse gjithçka kam punuar si redaktor dhe gjithçka kam shkruar është e lidhur me të, çdo gjë buron nga ajo dhe gjithçka i kthehet. Tani kur shkoj diku, në qytetet tjera shumë afër kufirit me Serbinë, njerëzit atje më pyesin çka kemi punuar, e unë u përgjigjem: kemi përkthyer, kemi shkruar një revistë të bukur për letërsi, kurse ata më thonë – ne kemi shkruar për ujë, kemi ndrequr dritare, kemi ruajtur... nuk e di se çka, kemi siguruar bukën e kështu me radhë. Kam njohur një të ri në Sarajevë, i cili ka jetuar në atë shtëpi, në oborrin e së cilës ka qenë dalja nga tuneli i cili, nën pistën e aeroportit, i ka përcjellur njerëzit nga Sarajeva dhe për në Sarajevë. Derisa unë këtu përktheja libra dhe mbahesha paksa i rëndësishëm për shkak të punës redaktoriale, sepse njerëzit e repektonin punën që bënim, andaj edhe kishim arsye të mbahemi të rëndësishëm, ai në atë kohë e mirëmbante atë tunel dhe kur përfundoi lufta, ai e kishte lidhur jetën e vet për atë tunel, ashtu siç e kisha lidhur

unë me revistën time. Ai tani po ndërton atje muzeun, në kohën kur duhet ndoshta të mësojë diçka, ta orientojë jetën e vet, ta fillojë rishtas, ai vendos të ndërtojë muzeun dhe ta ndreqë dhe mirëmbajë tunelin. Për „çudi“ – edhe pse kjo nuk më çudit aq shumë, pushteti i atjeshëm nuk është i interesuar t'i ndihmojë dhe ai bredh, kërkon ndihmë në shumë anë. Dhe mundesh vetëm të turpërohesh kur qëndron pranë tij. Atë moment, kur qëndron pranë tij – ai me tunelin e tij e unë me revistën time – gjithçka kemi bërë, është turp. Dhe çfarë të bësh... Dhe përsëri, çfarë kam mundur të bëj, ja për këtë mendoj shpesh. Në një libër me titull *Askush nuk është i çliruar nga historia*, të autorit Helmut Dubil, që e kemi botuar, ku bëhet fjalë mbi analizën e debatit në parlamentin gjerman, që kishte të bënte me krimet masive të bëra nga regjimi nacist, gjendet diskutimi i një deputeti gjerman, i cili ka dalur para foltores dhe ka thënë: E vetmja gjë që ka qenë e drejtë të mësohet në kohën kur hebretë kanë qenë të deportuar në kampe është ajo që të vendoset shiriti i verdhë dhe të nisësh me ta, ose të shtrihesh para kamionit apo trenit, të cilët i bartnin ata. Vetëm kjo do të ishte në pajtim me parimet morale. Mirëpo, ne jemi vetëm qenie njerëzore, nuk mund të kërkohej nga ne që të udhëhiqemi denjësisht nga ato standarde kaq të larta. Prej nesh, për fat të keq, nuk pritet kjo shkallë e moralitetit. Pikërisht për shkak se nuk jemi sjellur ashtu siç është dashur, kjo na obligon më shumë që sot të flasim më shumë dhe në një mënyrë të lirohemi nga ajo që kemi lëshuar ta bëjmë; e këtë jo në kuptimin e larjes së fajit, por normat na obligojnë të sillemi ashtu siç duhet, në mënyrë që diçka e tillë të mos përsëritet më. Krahës kësaj kemi obligim që ata që i kanë organizuar tërë këto, e që janë përgjegjës të drejtpërdrejtë, t'i dërgojmë para organeve të drejtësisë. Përgjegjësia jonë, domethënë obligimi ynë si vëzhgues të atëhershëm dhe si njerëz të cilët nuk kanë reaguuar me kohë është që vazhdimisht të tërheqim vërejtjen se diçka e tillë nuk guxon të na ndodhë më, se ne si shoqëri kemi obligim të jemi të ndieshëm dhe të reagojmë në çdo paralajmërim se diçka e tillë mund të na ndodhë përsëri. Mendoj se nuk kam bërë gjithçka është dashur dhe çka kam mundur ta bëj dhe tani në një mënyrë dua të nxirrem për këtë dhe të sillem në pajtim me parimet themelore të moralit, sepse rrethanat e sotme janë më të mira, nuk kërkohej nga ne ai gjesti jonjerëzor, dhe, tani, ejani të provojmë të jemi të mirë.

Kur e përmend të kaluarën, çfarë duhet bërë me të? Disa thonë se duhet të ballafaqohesh me të, disa të tjerë mendojnë se duhet harruar. Ju si mendoni, çka duhet bërë me të kaluarën?

Unë nuk mund të pohoj se është absolutisht gabim që të harrohet e kaluara: ka shembuj kur kjo harresë ka qenë efektive. Harrimi i së kaluarës mund të jetë njëra nga zgjidhjet e mundshme. Mua personalisht, përkundrazi, më intereson shumë se çka ka ngjarë. Dhe nuk besoj se ekziston vetëm një e vërtetë. Unë vërtet kam mirëkuptim për sjellje të palës serbe gjatë viteve '90. Edhe pse turporëhem për atë që ka bërë pala serbe, mund t'i kuptoj motivet e njerëzve për të marrë pjesë në ato luftëra. Madje, gjithnjë e më shumë, mendoj që nëse këtyre njerëzve u privohet e drejta të sqarojnë shkaqet e tyre, nëse thuhet se nuk ka pasur asnjë shkak dhe as që ka mundur të ketë, atëherë ndërpritet mundësia e bisedimeve për atë se çfarë ka ndodhur dhe për mirëkuptim të këtyre ngjarjeve. Kërcënimet kanë ekzistuar me të vërtetë dhe unë e kuptoj frikën nga këto kërcënime, dhe kam simpati ndaj njerëzve që i kanë kërcënuar. Por, nga ana tjetër, kjo në asnjë mënyrë nuk mund t'i justifikojë krimet që janë bërë...

Nuk mund t'i kuptoj njerëzit që kanë bërë diçka për të cilën nuk mund të ketë

Sa njerëz i ka lutur të dalin në zgjedhje, sa njerëz i ka lutur të mos votojnë për Millosheviqin, sa herë ka qenë i gatshëm të pranojë debatin dhe të sqarojë pse nuk duhet votuar për Millosheviqin, dhe atë jo përkrahësve të tij të fortë, kjo është punë e kotë, por njerëzve që kanë qenë në mëdyshje, që kanë ndenjur në shteëpi, që ua ka mërzhitur të dalin në zgjedhje. Çka kemi bërë me njerëzit të cilët kanë menduar si ne, por që kanë pritur të dalin dhe të votojnë? Ose nuk kanë besuar se kjo ka kuptim.

Pse unë nuk jam lajmëruar të jam vëzhgues në ndonjë vendvotim, pse nuk kam ndarë asnjë fletushkë, pse nuk kam thirrur dikë në telefon për t'i thënë – eja, dil e voto? Pas vitit 1992, 1993 kemi ditur se ku na shpie ai pushtet dhe të gjitha pasojat kanë qenë të qarta, gjithçka është parë. E çfarë kemi bërë në këtë drejtim? Kjo është përgjegjësia e shoqërisë sonë në tërësi dhe e secilit prej nesh veç e veç.

arsyetim. Tani dëgjoj: i është privuar kjo e drejtë, pastaj ajo e drejtë, janë pushuar nga puna vetëm pse kanë qenë serbë, kanë qenë të goditur vetëm pse kanë qenë serbë, pastaj kanë qenë të detyruar të mbrohen. Por, përsëri mbrohesh brenda disa normave. Aq më tepër përpiqesh që mos t'i bësh të gjitha ato gjëra nga të cilat mbrohesh. Vetëm kështu mbrojtja ka kuptim. Në Bosnje e Hercegovinë janë bërë punë të këqija edhe ndaj serbëve dhe nuk është e vërtetë se vetëm pjesëtarët e një pale kanë qenë viktimat në këtë luftë. Por ç'të bëhet tash me këtë? Unë e kuptoj dhe dua të dëgjoj, të pranoj, të ngushëllohem me viktimat e cilësdo palë. Mirëpo, asgjë nga këto nuk mund ta justifikojë krimin. Kur shkon në Sarajevë dhe shikon si duken ato male përreth: po sikur t'i kishin gjuajtur me gurë do t'u shkaktonin mjaft dëme, e jo me të gjithë ato topa e snajperë; kjo nuk është njerëzore, nuk është normale. E tani, a duhet të mbajmë mend, a duhet të kujtohemi? Mendoj se për këtë duhet përgjigjur njësoj sikur në ato gjërat e tjera lidhur me shkeljet e ligjit... Nëse keni shkelur ligjin dhe për këtë duhet të përgjigjeni. Unë dua t'i dëgjoj të gjitha kallëzimet për pasojat, për shkaqet, për gjendjen e pavolitshme, për keqpërdorimet... por nëse keni shkelur ligjin, pastaj duhet të përgjigjeni. Pa marrë parasysh se jam i vetëdijshëm se edhe harresa mund t'i ketë përparësitë e veta. Për ne, mendoj, është shumë me rëndësi të dëshmojmë se megjithatë do t'u përmbahemi disa principeve universale të së drejtës, se e respektojmë ndonjë ligj: disa njerëz duhet të përballen me drejtësinë, duhet të kallëzohen edhe tregimet për shkeljen e ligjit, krahas tregimeve historike. Sepse mua historia më duket ndryshe sesa dikujt tjetër. Unë do ta tregoj në një mënyrë, të tjerët do ta tregojnë në mënyrë tjetër. Dhe për këtë ne nuk bisedojmë për histori, e veçanërisht jo për relativizmin historik, këtë duhet ta lëmë anash. Në ligj nuk ka mundësi, ta zëmë, nëse sqarimin historik e arsyeton krimin, shkelja e ligjit atëherë nuk është më krim por, për shembull, akt heroik.

Pak më parë përmendët se nuk ekziston vetëm një e vërtetë, në ç'kuptim? A do të thotë kjo që të dëgjojen palët e ndryshme? Çfarë do të thotë kjo për ty?

Shumë thjeshtë: ta zëmë, mund të flasim për ato libra që sqarojnë shkatërrimin e Jugosllavisë. Ekzistojnë interpretime të ndryshme për shkatërrimin e Jugosllavisë; dhe ato detyrimisht nuk mund të jenë kontardiktore, ato thjesht janë të ndryshme dhe fokusohen në disa faktorë të cilët kanë mundur të ndikojnë në shpërbërje. Këto do të ishin disa të vërteta, dhe, ashtu siç thashë, ato nuk duhet, por mund të jenë edhe kontradiktore. Pikërisht lexoj librin për atë se shqiptarët në Kosovë kanë organizuar shkollat e tyre gjatë viteve '90. Dhe nuk pajtohem me përshkrimin e rrethanave në Kosovë, por jam i interesuar të lexoj për këtë. Përnjëmend nuk kam problem me atë se çfarë mendojnë njerëzit në Kroaci, në Bosnje ose në Kosovë... Le të mendojnë çfarë të duan, dhe unë gjithmonë do të jem i gatshëm ta dëgjoj atë mendim. Problemi im është se çfarë mendojnë njerëzit në Serbi dhe si me ata njerëz – me të cilët thellësisht nuk pajtohem – e të cilët më nervozojnë dhe provokojnë, të reagoj në atë mënyrë që për mua është e papranueshme; ja e papranueshme është edhe kjo që e shqiptova tani – domethënë sesi të gjej mënyrën e të kuptuarit të përbashkët me ata njerëz me të cilët jetoj dhe ndaj ndonjë hapësirë publike. Problem im nuk është të kuptuarit e të tjerëve, me ta nuk jetoj në të njëjtin shtet; mundemi edhe t'i propozojmë diçka njëri-tjetrit, mund të ndihmohemi ose së paku të përpiqemi të mos pengojmë. Mirëpo, këtu jetojmë bashkë, ndajmë një hapësirë dhe në atë hapësirë ata i rrezikojnë interesat e mia kryesore, duke artikuluar marrëzisht interesat serbe. E tani, unë dua t'u dëshmoj se nuk i urrej, se i dëgjoj

me vëmendje, se më intereson ajo çka flasin edhe pse mendoj se kjo nuk është mequri, se më interesojnë shkaqet të cilat i nxisin për t'i thënë ato dhe t'u sqaroj se disa qëllime përfundimtare me të vërtetë nuk dallohen: edhe ata do të dëshironin një shtet të përshtatshëm, edhe ata do të donin të jetojnë një jetë të përshtatshme, ashtu siç do të doja edhe unë të jetoj në një shtet të përshtatshëm. Eja të shikojmë sesi do ta realizojmë këtë. Mendoj se pala në të cilën gjendem ideologjikisht ka rrugë efikase deri tek ky qëllim, për çfarë kam edhe argumente. Ja, ta zëmë, shikoni pesëmbëdhjetë vitet e kaluara dhe ku kemi arritur: ka qenë keq, keq kemi punuar, hajde tani të provojmë diçka tjetër, e të shohim se çka do të ndodhë... Për këtë rrugë tani jemi të sigurt se është qorrsoak, ejani atëherë të shikojmë rrugës tjetër.

Meqë e përmendët ligjin, normat, si e shikon përgjegjësinë për të gjitha këto që kanë ndodhur? A mund të flasim për përgjegjësi individuale, kolektive?

Për t'u përgjigjur në këtë pyetje do t'i referohem tekstit të Nenad Dimitrijeviqit. Ai ka shkruar shumë për këtë dhe unë kam botuar diçka nga ajo. Kam botuar sepse më ka ofruar mënyrën që t'i kuptoj disa çështje dhe të përgjigjem në to. Përgjegjësia individuale – këtë do ta vendosja në fushën e përgjegjësisë penale: ai i cili ka shkelur ligjin duhet të përgjigjet. Besoj se mund të flitet edhe për përgjegjësinë e paramenduar kolektive, e përmes saj, në një mënyrë drejtohen edhe përgjegjësitë individuale e të gjithë neve që i përkasim shoqërisë, interesat e së cilës i ka artikuluar dhe i ka përfaqësuar politika e caktuar, të cilën më së shpeshti e personifikojmë me Slobodan Millosheviqin. Nuk mendoj se Millosheviqi ka qenë diktator, nuk mendoj se kemi jetuar në regjim represiv. Ndoshta gaboj, por mendoj se zgjedhjet e viteve '90 kanë qenë atë që edhe ne duhet të pranojmë përgjegjësinë për rezultatet e tyre. Se këto rezultate nuk kanë qenë të imponuara dëshmon edhe situata politike në Serbinë e sotme. Mendoj se nuk mund të arsyetohemi me njëfarë frike, me qeverisje diktatoriale të vendit. Këto janë vetëm pretekste. Do të ishte mirë sikur do të mund të thonim – po, ja, nuk kemi pasur zgjidhje. Por, kemi pasur zgjidhje. Kemi mundur të bëjmë shumë.

Ja disa të dhëna: deri në vitin 2000 partitë politike nuk kanë qenë në gjendje t'i kontrollojnë të gjitha vendvotimet në Serbi. Pas zgjedhjeve, krerët e atyre partive janë ankuar se zgjedhjet kanë qenë të kurdisura. Thonë: kanë mashtur – e nuk kanë raporte nga vendvotimet, sepse atje nuk i kanë pasur njerëzit e vet. Dhe atëherë pyet? Ka shumë vjet që ekzistojnë dhe çka kanë bërë gjithë ato vite nëse nuk mund t'i mbulojnë të gjitha vendvotimet me kontrollorët e tyre. Dhe s'munden, prandaj atëherë fajin e kanë të tjerët. Jo, por ju nuk keni punuar sa duhet... Mendoj se mospuna e madhe, përtacia e madhe ka ndikuar në këto rezultate që i kemi pasur. Edhe unë jam pjesë e kësaj tabloje: nuk jam angazhuar politikisht deri në një moment dhe kjo gjithashtu është turp. Jemi përgjegjës, sepse si shoqëri kemi pasur rastin të zgjedhim, e kemi zgjedhur kështu siç e kemi zgjedhur, dhe ata që i kemi zgjedhur kanë bërë atë që kanë bërë, dhe pikë. Me këtë tani s'kemi çfarë të bëjmë. Për këtë çdo njeri prej nesh duhet të pyetet – çka kam punuar gjatë gjithë asaj kohe, a jam angazhuar t'i ndihmoj ndonjë partie? Unë jo, dhe tani më vjen keq për këtë. E nëse dikush është angazhuar, atëherë – për cilën parti, sa njerëz i ka lutur të dalin në zgjedhje, sa njerëz i ka lutur të mos votojnë për Millosheviqin, sa herë ka qenë i gatshëm të pranojë debatin dhe të sqarojë pse nuk duhet votuar për Millosheviqin, dhe atë jo përkrahësve të tij të fortë, kjo është punë e kotë, por njerëzve që kanë qenë në mëdyshje, që kanë ndenjur në shtëpi, që ua ka mërzhitur të dalin në zgjedhje. Çka kemi bërë me njerëzit të cilët kanë menduar si ne, por që

kanë pritur të dalin dhe të votojnë? Ose nuk kanë besuar se kjo ka kuptim. Pse unë nuk jam lajmëruar të jam vëzhgues në ndonjë vendvotim, pse nuk kam ndarë asnjë fletushkë, pse nuk kam thirrur dikë në telefon për t'i thënë – eja, dil e voto? Pas vitit 1992, 1993 kemi ditur se ku na shpie ai pushtet dhe të gjitha pasojat kanë qenë të qarta, gjithçka është parë. E çfarë kemi bërë në këtë drejtim? Kjo është përgjegjësia e shoqërisë sonë në tërësi dhe e secilit prej nesh veç e veç. Po çfarë të bëjmë tani? A duhet të gjuhem me hi? Dikush do të mund të thotë: unë s'kam punuar asgjë nga kjo, atëherë çka? Pse të flasim tani për këtë? Nenad Dimitrijeviqi është përgjigjur shumë bukur në këto pyetje – ne duhet të tregojmë se jemi pjesëtarë të kësaj shoqërie, secili prej nesh ndaras, të nxjerrim mësim, së paku derisa të mbajnë mend gjeneratat që ne u takojmë, që asgjë e ngjashme të mos ndodhë më, dhe kështu t'u ofrojmë garanci mjediseve tona se nga ne nuk do t'u kanoset më asnjë rrezik. Duhet të dëshmojmë se diçka kemi mësuar dhe se prej tash e tutje do të sillemi në mënyrë racionale dhe me përgjegjësi – kjo është për mua domethënia e bisedës lidhur me përgjegjësinë. Dhe këtë jo vetëm për shkak të fqinjëve tanë, por edhe për ne. Në çfarë shteti do të jetojmë nëse dikush sot apo nesër do të mund të thotë përsëri se në emër të grupit, në emër të njëfarë populli serb – për të cilin ende nuk di se çka është, nëse kjo nuk ka të bëjë me qytetarët e Serbisë, sepse vërtetë nuk din çka do të mund të ishte tjetër populli serb, dhe ndoshta dikush do të më thoshte se kjo është turp, shih idiotin, nuk e di se çka është populli serb, e pastaj ndoshta do të më tregonte, nuk di se çka, qirilicën, kishën ortodokse, shën Savën... E atëherë unë do të thoja se kjo nuk mjafton që pjesëtarët e një grupi të quhen popull, se aty duhet të ketë edhe njëfarë shteti, por mos ta zgjasim me këtë – domethënë se dikush do të ketë të drejtë të thotë se gjithësecili prej nesh interesat e veta personale duhet t'ia nënshtrojë interesit të grupit, e ky është problem serioz. Unë mendoj se ne mund të pajtohemi se çka është interesi i grupit, por ky duhet të jetë proces i cili është i definuar qartë përmes procedurave të caktuara se si të vihet deri tek programet që për një periudhë të caktuar janë obliguese për qytetarët e një shteti. Dhe tani dikush nga diku të deklarojë se cili është interesi serb, dhe unë nuk e di se me çfarë të drejte deklaron kështu. Ky interes bëhet përnjëherë i obligueshëm edhe për mua sepse njëfarë budalle në pushtet ka menduar se kjo është gjëja e vërtetë – nuk dua, nuk mundem, nuk dëshiroj. Dëshiroj të më garantohet ta jetoj jetën ashtu siç mendoj se është më së miri për mua. Kam të drejtë që të jam jolojal ndaj interesave që m'i kanë imponuar pa asnjëfarë procedure.

Si e sheh pajtimin, çka do të ishte pajtimi për ty?

Unë nuk e shoh pajtimin si diçka të domosdoshme. Aq më tepër mendoj se në rastin tonë nuk duhet të ketë fare pajtim. Duhet të jetojmë njëri pranë tjetrit dhe përgjithësisht nuk duhet të duhemi, të pajtohemi. Pajtimi nënkupton se dikë dikur e ke pasur të afërt, e pastaj jeni grindur, pastaj jeni pajtuar dhe përsëri jeni të afërt. Ne nuk kemi qenë, unë nuk kam qenë kushedi sa i afërt me askënd, andaj edhe s'kam pse të pajtohem. Unë mund t'u kërkoj falje njerëzve të cilëve u janë bërë të këqija në emrin tim, por ky nuk është gjest i pajtimit. Për fat të keq, kemi qenë larg dhe prej këtu ndoshta edhe ajo mungesë e ndjenjës së përbashkët në çastin kur është dashur ta shpreh, por si të pajtohemi tani? Ejani të jetojmë njëri pranë tjetrit dhe mos t'i pengojmë njëri-tjetrit. Nuk besoj se grupet mund të pajtohen, grupet munden vetëm përmes përfaqësuesve të vet të japin garanci se nuk do t'i pengojnë më njëra-tjetrës. Kur të arrijmë deri aty që mund t'i japim këto garanci, kjo është



shumë më tepër se pajtim. Pajtimi nënkupton edhe disa ndjenja, njëlloj sigurie e cila nuk është e nevojshme, nuk është e detyrueshme. Njerëzit që i kam dashur në Kroaci, që i kam dashur në Bosnje, ata i dua gjithnjë; edhe nëse jemi armiqësuar, jemi pajtuar. Pajtimi është çështje personale. Ne nuk duhet të pajtohemi, duhet vetëm të sillemi me arsye dhe në pajtim me disa rregulla. Pajtimi është një dukuri problematike... Nuk më pëlqen ky term i cili në rastin e grupeve është jopreciz dhe me të mund të manipulohet...

Cilin term do ta shfrytëzoje ti?

Domethënë, të jetojmë njëri pranë tjetrit dhe të mos pengojmë njëri-tjetrin. Njerëzit duhet të veprojnë në pajtim me ligjin, rregullat: nuk është i nevojshëm pajtimi për të kuptuar se nuk duhet të keqtrajtoj dikë që është shqiptar, nuk është i nevojshëm pajtimi për të mësuar se nuk duhet të largoj dikë që është hungarez, ashtu si dhe dikë që është serb.

Çka është e nevojshme?

Që të respektojmë në mënyrë konsekuente jetën njerëzore, të respektojmë në mënyrë konsekuente të drejtën e çdo personi që të jetojë në pajtim me dëshirat e veta, me nevojat, normat, principet, me kusht që ato të mos rrezikojnë personat tjerë. Çdonjëri të jetojë ashtu siç ka dëshirë dhe të mos rrezikojë të tjerët... Mundem, madje, ta kuptoj edhe atë logjikën e mbrapshtë të Ratko Mlladiqit, i cili për dikë është hero – a beson se ai është hero – beso, shkëlqyeshëm. Por, eja le ta gjykojnë për atë që akuzohet; kurse ti edhe më tutje beso. Ai për mua është kriminel. Ai është akuzuar se i ka shkelur disa ligje të cilat vlejnë edhe për mua, edhe për ty,

edhe për atë. Eja t'i respektojmë ato ligje. Të drejtat e njeriut janë definuar qartë, dihet sesi funksionojnë shtetet e rregulluara, nuk duhet ne të shpikim kurrgjë. Kjo vërtet nuk është çështje emocionesh. Njerëzit kanë të drejtë të urrejnë, është njerëzore të urresh dikë, urrej por mos torturo dikë për shkak se e urren. Kjo nuk është njerëzore. Paramendoje tash, shkon në Bosnjën e mjerë, atje njerëzit e vrarë, ti shkon atje, dikujt i është vrarë e tërë familja, i është djegur shtëpia dhe ti kërkon – eja të pajtohemi. Kjo është e turpshme... Mundesh vetëm të thuash – më vjen shumë keq; dhe të premtosh – s' do të bëjmë më kurrë. Dhe nëse mund ta mbash këtë premtim – shkëlqyeshëm. Unë nuk di çka do të thoja, nuk di, s'kam ide... Por gjithsesi nuk do ta shtrija dorën për pajtim, kjo do të ishte sikur do të doja t'i ofendoj, përsëri. Nëse dikush dëshiron të falë, shkëlqyeshëm, faleminderit; por sikur të kishim mundësi vetëm të premtojmë se kjo nuk do të përsëritet asnjëherë më, edhe kjo është shumë.

Ku qëndron përgjegjësia e “njerëzve të thjeshtë” në të ardhmen?

Kush tjetër do ta bëjë këtë përveç nesh që jemi këtu. Natyrisht se jemi përgjegjës. Dikush duhet t'i bëjë të gjitha ato gjëra që planifikohen, dikush duhet t'i bëjë të gjitha ato ndryshime, e ne jemi ata. Dhe dikush duhet të kuptojë se kjo është në interesin tonë dhe përsëri ne jemi ata. Përgjegjësia jonë është... a e di se cila është përgjegjësia jonë? Përgjegjësia jonë është të bëjmë gjithçka mirë e bukur, ngadalë dhe me mençuri. Që çdokush të punojë punën e vet sa më mirë që mundet dhe do ta kemi mirë. Ndërkaq, elitës politike, asaj të sotmes: sa më shumë hapësirë t'i merret, është më mirë për të gjithë ne. Unë vazhdimisht e përsëris – anëtarëshohuni në parti politike, bëhuni aktiv, punoni... artikuloni interesat tuaja dhe luftoni për to... Kjo është me rëndësi.

Dhe për fund a do të shtojë diçka...?

...Nëse ti thua se përpiqesh për pajtim vetëm sa për sy e faqe, atëherë ai nuk më intereson. Por nëse ti thua se përpiqem për pajtim sepse beson se me këtë do të jetojmë më mirë, sepse ky pajtim ka të bëjë me vlerat që duhet të jenë dominuese në shoqërinë tonë, atëherë kjo ka kuptim. Unë atëherë do të thoja, mirë, ndoshta ky nuk është pajtim, unë këtë nuk do ta quaja pajtim dhe ndoshta dakordohemi dhe mendojmë njësoj. Vetëm se ti thua pajtim e unë them të drejtat e njeriut. Fakti se po merremi me vitet '90 nuk është vetëm se jemi kurioz ose pse na bren ndërgjegjja, por edhe për faktin që besojmë se nëse merremi me këtë, krijojmë bazën që disa gjëra t'i bëjmë më mirë në të ardhmen. Kjo është ajo lidhja e cila më mundon...

H. R.

Koha dhe vullneti

Edhe pse ke qenë mjaft e re, a ka lënë lufta pasoja tek ti? Nëse po, çfarë pasojash ka lënë?

Kur ka filluar lufta unë kam qenë 7-8 vjeçe, por prapëseprapë më kanë mbetur të rrënjosura thellë në kujtesë disa ngjarje, si p.sh. diskutimet dhe grindjet në bazë nacionale, rrëfimet e mëvonshme të miqve për letrat kërcënuese etj.

Çfarë nevojitet që të zbuten apo së paku të mënjanohen pasojat e luftës?

Koha dhe vullneti.

Çfarë është për ty pajtimi?

Ecja përpara, por krahas kësaj mos-harrimi i asaj që ka ndodhur.

Pse është i rëndësishëm pajtimi?

Që jeta t'i kthehet sa më shumë normales.

Si mund të arrihet pajtimi?

Duhet çrrënjësuar shovenizmin dhe nacionalizmin, duhet përpjekur që njerëzit të shikojnë njëri-tjetrin në bazë të një sistemi tjetër vlerash.

Kush duhet të punojë për arritjen e pajtimit?

Absolutisht të gjithë.

Cilat janë problemet/frikat në të cilat mund të hasë procesi i pajtimit?

Sot, për fat të keq ekzistojnë akoma organizata politike, fetare dhe joqeveritare të bazuara në jotolerancën fetare dhe nacionale. Por shpresoj që duke iu falënderuar lirisë më të madhe të mediave dhe përvojës së para 10 viteve nuk mund të ndikojnë aq shumë.

Çka mendon se mund të bëjnë “njerëzit e zakonshëm”?

Shumë. Të fillohet me vlerësimin e njerëzve në bazë të disa karakteristikave individuale, të ndryshohet sistemi personal i vlerave,... e kjo nuk është pak.

A mendon se njerëzit janë të gatshëm për pajtim?

Për fat të keq, mendoj se një numër i madh i njerëzve të “helmuar” nuk është akoma. Kur them të helmuar, mendoj të helmuar me urrejtje, me paragjykime nacionale dhe fetare.

Si duhet ta trajtojmë të kaluarën dhe a duhet ta harrojmë atë?

Kurrresi. Ajo çka ka ndodhur nuk guxon dhe nuk mund të harrohet kurrresi. Ajo do të mbesë si një njollë e zezë në histori, duhet lënë pas vetes, por edhe mbajtur mend me qëllim që të mos përsëritet kurrë më.

A mendon se përgjegjësia për luftë është vetëm e njëres palë?

Në të vërtetë, për mua në tërë këtë nuk ekzistojnë “palët”, për mua janë në të njëjtën palë projektuesit politikë dhe organizatorët e gjithë kësaj (pa marrë parasysh

Ekziston një ndjenjë e përgjegjësisë morale të cilën e mbajmë të gjithë. Mua më ka ndodhur jo pak herë që të ndiej turp për gjëra që i ka bërë populli im dhe pas të cilave ka qëndruar shteti im në atë moment, edhe pse unë në atë shtet kam pasur vetëm rreth 7 vjet.

kombësinë) dhe së bashku me to (jo edhe me të njëjtën shkallë fajësie) ekzekutuesit e verbër të të gjithë kësaj. Ekzistojnë vetëm dy palë: fajtorët dhe viktimat.

A mund të individualizohet fajësia apo mendon se ajo është kolektive?

Po fajësia medoemos mundet dhe duhet të individualizohet (sepse përgjegjësia penale është vetëm individuale). Mirëpo, ekziston një ndjenjë e përgjegjësisë morale të cilën e mbajmë të gjithë. Mua më ka ndodhur jo pak herë që të ndiej turp për gjëra që i ka bërë populli im dhe pas të cilave ka qëndruar shteti im në atë moment, edhe pse unë në atë shtet kam pasur vetëm rreth 7 vjet.

Çfarë mendon, kush ka qenë viktimë e luftës?

Emrat e viktimave të vërteta të luftës tashmë janë përpunuar diku në mënyrë statistikore. Por për mua janë viktima edhe ata njerëz të cilët nuk kanë pësuar humbje të drejtpërdrejtë fizike dhe materiale, viktima të luftës janë të gjithë ata që i ndiejnë pasojat e luftës në këtë apo në atë mënyrë.

A mendon se njerëzit i janë nënshtruar shpesh manipulimit mediatik dhe a kanë pranuar ata, në të vërtetë, në mënyrë të pavetëdijshme të jenë të manipuluar? A kanë mundur t'i rezistojnë kësaj?

Dihet se me masën është shumë lehtë të manipulohet, posaçërisht nëse manipulohet mbi bazën fetare apo nacionale – mbi diçka që ka në themel emocionet. Libra të tëra janë shkruar për psikologjinë e masës dhe mediat si mjet të fuqishëm të manipulimit.

Për fund, si e sheh të ardhmen e rajonit tonë?

Kur bëhet fjala për Ballkanin, çdo parashikim afatgjatë është vërtet absolutisht i pasigurt. Ajo çka unë shpresoj është shkalla më e lartë e demokracisë në kuptimin e sundimit të së drejtës, lirisë së mediave, të drejtave të njeriut etj.

E. H. Ç.

Fqinjët i përshëndes ende me “Bok!”, kurse komshinjtë me “Zdravo!”

A i ndien ende pasojat e luftës?

Pasojat e luftës, ashtu sikurse edhe pjesa më e madhe e atyre 22.4 milionë banorëve të Jugosllavisë “së shkatërruar”, i ndiej medoemos akoma. Të gjithë neve, sidomos atyre nga zonat e përfshira në luftë, jeta u është ndryshuar në mënyrë dramatike dhe është orientuar në kahje tjetër.

Çfarë duhet të ndodhë që të ndryshojë kjo?

Vetëm as që mundem të veproj ndryshe, përveç asaj që bëj çdo ditë në shtëpinë time, jashtë saj, në shoqëri me njerëzit, në punë. Përmes punës time të përditshme tregoj për pasojat devijuese të lindura si pasojë e tmerreve të luftës. Në mjedisin ku jetoj, fqinjët ende i përshëndes me “Bok!” (“tungjatjeta” kroatisht), kurse komshinjtë me “Zdravo!” (“tungjatjeta” serbisht), bisedoj me secilin prej tyre, respektoj atë çka janë, do t’i ndihmoj dhe do të pres që edhe ata të më ndihmojnë mua.

Sa i përket rrethit dhe mjedisit tim ku jetoj duhet të rrjedhë edhe shumë ujë që të vendoset jeta normale, e kënaqshme dhe kualitative për secilin prej nesh. Gjithmonë them se, përveç pasojave të luftës dhe humbjeve që ajo ka sjellur, situata më e mirë materiale, satisfaksioni dhe kënaqësia e çdo njeriu personalisht kushtëzon edhe raportet më të mira ndërnjerëzore, por edhe një pamje tjetër, më pozitive të mikro-botës në të cilën jetoj.

Si ta trajtojmë të kaluarën? Si të ballafaqohemi me të?

Nëse ka pasur diçka pozitive, e besoj se ka pasur, duhet ta shikojmë me një respekt të plotë. Të gjitha të tjerat duhet harruar sepse disa ngjarje të caktuara janë turp për llojin njerëzor.

Në përkufizimin themelor për ne shkruan se jemi “qenie të vetëdijshme”, prandaj duhet të jemi të vetëdijshëm për të gjitha gjërat dhe ngjarjet nga e kaluara, qofshin të mira apo të këqija. Të them sinqerisht, është vështirë të harrohet, sidomos diçka e keqe. Sidoqoftë, kohëve të fundit dëgjojmë shpesh fjalinë: “Të falim, por jo edhe të harrojmë!”, kështu që ndoshta duhet t’i përmbahemi asaj.

Çfarë është për ty pajtimi?

Gjithmonë e kam pamenduar këtë nocion si momentin kur prijësit e dy fiseve, deri dje në konflikt, ulen dhe pijnë “llullen e paqes”. Pasi që prijësit e fiseve tona nuk kanë qenë në luftë, por një numër i madh i individëve nga fiset e tyre, d.m.th. populli, “pirje të llullës” nuk ka pasur kurrë. Megjithatë, as ndërmjet qytetarëve të zakonshëm nuk është arritur kurrë ndonjë lloj pajtimi, në stilin: të ulemi, të pijmë, të përqafohemi dhe të themi – PAQE! Pajtimi në mes fqinjëve dhe komshinjeve, posaçërisht në Vukovar, është duke ndodhur dhe duhet të zhvillohet në mënyrë spontane, pa fjalë të mëdha e të rënda, pa ofendime dhe përluje, akuzime e fjalosje. Andaj, pajtimin e shoh si avancim të përditshëm në komunikim, shkëmbim të mendimit dhe përvojave, ofrimin e çdo lloji të ndihmës dhe mbështetjes, pa obligim të hyrjes në disa marrëdhënie më të thella ndërnjerëzore.

Parakushti... Kur dikujt i dëshironi “Mirëmëngjes!” ta mendoni këtë sinqerisht, kurse ai tjetri t’ju përgjigjet në të njëjtën mënyrë – me qëllim të mirë dhe sinqerisht.

Çfarë nevojitet për pajtim? Çfarë është parakusht për një pajtim të tillë?

Tregimi i të vërtetës së plotë mbi ngjarjet e luftës, sinqeriteti dhe mirëkuptimi, respekti i ndërsjellë, përmirësimi i raporteve, të menduarit me mendje të ftohtë, përmirësimi i situatës në shtet, sigurimi i “kulmit mbi kokë” dhe i ekzistencës së sigurt. Parakushti... Kur dikujt i dëshironi “Mirëmëngjes!” ta mendoni këtë sinqerisht, kurse ai tjetri t’ju përgjigjet në të njëjtën mënyrë – me qëllim të mirë dhe sinqerisht. Çdo gjë tjetër vjen vetvetiu.

Si të arrihet kjo?

Edhe pse që prej ndalimit të vuajtjeve të tmerrshme të luftës kanë kaluar dhjetë, e ndoshta edhe më shumë vite, kurse nga fillimi i procesit të kthimit dhe ballafaqimit të sërishëm të “fqinjëve” dhe “komshinjve” pak më pak, ende nuk ekziston formula e saktë dhe konkrete sesi të arrihet pajtimi. Me kalimin e kohës, ndoshta. Me ardhjen e gjeneratave të reja, të ndryshme, më të mençura, më të matura dhe pa ngarkesa.

Kush do të duhej të punonte në procesin e pajtimit?

Përgjigjja më e lehtë do të duhej dhe mund të ishte – ata që tërë këtë edhe e kanë përzier. Në të vërtetë, disa nga ata janë “në vendet e përjetshme të gjuetisë”, të dytët pa hekurave të burgut, kurse të tretët “dridhin” ende skenën politike. Kur edhe këta “të tretët” të shkojnë në histori, dhe në skenë, siç thashë më parë, të parqiten të rinjtë, më të mençur, më të matur, pa ngarkesa, ndoshta çdo gjë do të jetë ndryshe. Një ditë...

Cilat janë frikat tuaja lidhur me pajtimin?

Frika primare është ajo se pajtimi i plotë nuk do të arrihet kurrë. Këto parashikime të errëta sigurisht se do të vërtetohen, por është njerëzore të shpresohet.

A mendon se janë të gatshëm për pajtim njerëzit në shtetin ku jeton? A e dëshirojnë ata pajtimin? Cilat janë frikat e përgjithshme lidhur me pajtimin në shtetin ku jeton?

Në masë të caktuar individët nuk janë të gatshëm për pajtim ose nuk e dëshirojnë. Disa prej tyre kanë shkaqe të forta dhe duhet t’i kuptojmë. Por, ekziston një trend në aspektin se ata që kanë pësuar humbje mendojnë më shëndoshë dhe më logjikisht sesa pjesa tjetër e komunitetit, pavarësisht nga vuajtja dhe dhimbja që kanë përjetuar. Për njerëz të tillë duhet të kemi mirëkuptim të plotë, kurse atyre të cilëve lufta iu ka sjellë privilegje të shumta, leverdi materiale dhe leverdi tjera, nuk duhet as të mendojmë. Të tillëve, gjendja e konfliktit, të qetë dhe të përhershëm, u shkon gjithësesi përshtat, sepse funksionojnë shumë mirë në kohëra të tilla, të trazuara. Është fat se ka shumë pak të tillë. Sa i përket frikës, frika është çështje iracionale, kështu që pajtimi shpesh vihet në lidhje me bashkimin dhe formimin e një shteti të ri të përbashkët. Ky shtet është krijuar dy herë në shekullin e kaluar dhe shkatërrimi i tij ka rezultuar çdoherë me gjakderdhje të tmerrshme. Njerëzit i frikësohen më së shumti kësaj dhe përsëritjes së historisë, por për këtë as që duhet menduar.

Si mendon, çfarë është e nevojshme që të arrihet pajtimi? Ndoshta, midis tjerash, kërkimi i faljes nga dikush?

Kërkimi i faljes nga udhëheqësit, para së gjithash politikanët, është vetëm demagogji e zbrazët dhe tek ata nuk besoj aspak. Më në fund, sa falje të tilla kemi pasur deri tani e edhe sa do të kemi, kështu që kam frikë se me ata edhe faljet mund të humbin peshën dhe kuptimin e vet.

Çfarë duhet të bëjë për pajtimin vendi në të cilin jeton, e çfarë vendi me të cilin kemi bërë luftë? Çfarë duhet të bëjmë ne e çfarë duhet të bëjnë ata?

E kam shumë vështirë të përgjigjem në këtë pyetje. Dihet se në Kroaci kurrë nuk është shpallur gjendja e luftës përkundër faktit se ky shtet kishte gati katër vjet luftë në territorin e vet, por edhe në oborret përreth. Përveç kësaj, nga perspektiva personale, familjare, farestnore, fqinjësore dhe relacionet tjera, nuk e di vërtet sesi të jap përgjigje precize dhe kualitative.

Kush do të duhej ta fillonte më intensivisht procesin e pajtimit? Dhe pse?

Ata që e kanë përgatitur sepse ky është obligim i tyre moral. Pasi që ata nuk janë më në skenë apo nuk kanë moral, nëse janë ende këtu, u mbetet barra vetë qytetarëve, individëve, të veprojnë me hapa të vegjël dhe iniciativa, sepse ndoshta pikërisht nga fjolla e vogël mund të krijohet orteku.

Çfarë mund të bëni Ju personalisht që ta ndihmoni procesin e pajtimit?

Punën time duhet ta bëj në mënyrë profesionale, t'i respektoj të gjithë njerëzit, pavarësisht nga kombësia, feja, raca, gjinia, ta eliminoj „gjuhën e urrejtjes“, të ndërtoj kështu mjedisin tolerant dhe të krijoj parakushtet për jetë normale. Pasi besoj se punën time e bëj në mënyrë korrekte, sipas postulateve të gazetarisë bashkëkohore, besoj se mund të kontribuoj shumë në krijimin e besimit, pajtimit dhe tolerancës ndërnacionale. Mirëpo, për përgjegjësinë time apo edhe për fajësinë eventuale, gjykim më objektiv do të japin të tjerët.

Kush është fajtor që vitet '90 kanë qenë të përgjakshme dhe të trishtueshme?

Është e qartë se faji nuk qëndron vetëm tek njëra palë, as që për tmerret e luftës është fajtor i tërë populli. Faji është individual dhe për këtë arsye çdokush duhet të përgjigjet “në bazë të meritave”.

A mund të individualizohet faji apo ai është kolektiv dhe shpërndahet në masë të barabartë tek të gjithë ne?

Nuk do ta hedhja fajin tek të gjithë ne, siç bën një poet dhe kantautor bashkëkohor. Nëse themi të gjithë, atëherë në të njëjtën kohë mendojmë në një kolektiv të caktuar, atëherë nuk mendojmë për një, por për të gjithë popujt. Kjo është ashtu. Pra, nuk ekziston faji kolektiv, por vetëm ai individual. Në të vërtetë, individë të veçantë kanë ditur të bashkohen në organizata kriminale, por edhe për raste të tilla ekziston e drejta dhe drejtësia. E ngadalshme, por e arritshme.

A ekziston ndonjë gjë që ka mundur ta bëjë cilido “njeri i zakonshëm” dhe me këtë të shmanget nga përgjegjësia, “të mbetet i pastër”?

Do të marr vetëm shembullin tim – kam dashur të shkoj në fundin tjetër të botës, në Australi apo Zelandë të Re, por kam qenë i ri, pa para dhe pa kurrfarë përkrahjeje. Sigurisht që në atë mënyrë do të mbetesha i izoluar nga e gjitha që ndodhi këtu, por vetëdija ime atëherë nuk do të ishte e pastër dhe shpesh do të zgjohesha me pyetjen – pse nuk kam qëndruar dhe përpjekur të ndryshoj dhe të ndihmoj diçka. Për këtë arsye mendoj se çdo gjë është individuale.

Cila është përgjegjësia e mediave (manipulimit mediatik)?

Shumë e madhe. Pikërisht mediat janë fajtorë për një pjesë të vuajtjeve gjatë luftërave në territorin e ish-Jugosllavisë. Askujt nuk ia dëshiroj të keqen, por “pendat e helmuara” do të dëshiroja t'i shoh në gjyq duke vërtetuar pafajësinë e vet, nëse një gjë e tillë ka ndodhur në punën e tyre të ndytë.

Kam dashur të shkoj në fundin tjetër të botës, në Australi apo Zelandë të Re, por kam qenë i ri, pa para dhe pa kurrfarë përkrahjeje. Sigurisht që në atë mënyrë do të mbetesha i izoluar nga e gjitha që ndodhi këtu, por vetëdija ime atëherë nuk do të ishte e pastër dhe shpesh do të zgjohesha me pyetjen – pse nuk kam qëndruar dhe përpjekur të ndryshoj dhe të ndihmoj diçka.

Në çfarë mase kanë qenë të nënshtruar ndaj manipulimit mediatik njerëzit në vendin tënd dhe cila është përgjegjësia e tyre për këtë nënshtrim?

Për fat të keq, qytetarët edhe sot kur shohin diçka në televizion, dëgjojnë në radio ose lexojnë në gazetë, e besojnë pa vërejtje dhe pa e verifikuar. Kjo është pasojë e të konceptuarit të çuditshëm të mediave gjatë dekadave të kaluara kur nuk ka ekzistuar gazetaria objektive, por kemi pasur gazetari raportuese, në të vërtetë gazetari megafonike. Në atë kohë është transmetuar ajo që thonin shokët “me ndikim” apo “zotërinjtë” dhe kjo është besuar. Manipulimi mediatik ka gjetur tokë të frytshme, sidomos tek popullata e paarsimuar. Megjithatë, nuk do të doja të hyja më thellë në këtë analizë sepse po del se njerëzit tanë janë “dele”, kurse unë kritik i çdokujt dhe i çdo gjëje.

Cilat janë parashikimet tuaja për të ardhmen lidhur me pajtimin e plotë të popujve pjesëmarrës në luftën qytetare?

Nuk janë popujt në konflikt, por individët apo grupet e caktuara militariste. Populli është bërë peng i luftës dhe viktimë e saj tragjike. Fatkeqësisht, qindra mijëra kanë humbur jetën, më shumë se qindra mijëra është dashur t'i lëshojnë shtëpitë dhe banesat, familje të shumta janë shkatërruar apo janë zhdukur. Thënë sinqerisht, mendoj se pajtimi i plotë dhe jeta më e mirë vështirë se mund të arrihen.

E. P.

Nacionalizmi është një gjë ngjitëse

Do t'Ju lutesha në fillim të thoni diçka për vete: kush jeni, nga jeni, sa vjet keni, ndoshta disa të dhëna për cilat mendoni se janë të rëndësishme...

Atëherë kështu: jam gati 60 vjeçe, jam femër – këto janë gjërat e para që më vijnë ndërmend. Me profesion jam psikologe, aktualisht merrem me politikë dhe jam aktiviste në OJQ të ndryshme. E dua aktivizmin... Formalisht punoj në Institutin e Shkencave Shoqërore dhe merrem me hulumtimin e opinionit publik. Në këtë periudhë, numri më i madh i hulumtimeve ka të bëjë me tranzicionin. Çka është më e rëndësishme? Jam e martuar, kam tre fëmijë, kam mbesën. Këtë e them për arsye se, desha apo nuk desha, i përcjelli segmentet e ndryshme ku takohen interesat e njerëzve dhe ku shikohet me vëmendje sesi jeton cila shtresë, cila gjeneratë... Kam lindur dhe tërë kohën jetoj këtu në Beograd, në fakt në Zemun.

Si i shikoni vitet '90, sidomos ato vitet e luftes, cilat janë kujtimet Tuaja?

Kujtimet e para të viteve '90... kjo për mua ishte njëkohësisht koha e hyrjes në politikë sepse politika ishte diçka më së paku e afërt për mua deri atëherë. Politikanët i konsideroja burokratë politikë, por ngaqë në atë kohë nuk ka ekzistuar diçka që do përbënte angazhim civil ose ka ekzistuar në qarqe shumë të ngushta të cilave unë nuk u kam takuar, për mua ajo ka qenë diçka që nuk ka kurrfarë lidhjeje me jetën time. Ajo që mua më ka frikësuar ka qenë ajo që ka ndodhur në Lidhjen Komuniste të Serbisë, pra mënyra sesi u ndërrua ajo struktura udhëheqëse. Pse më ka frikësuar kjo? Sepse e kam parë se ata janë përgatitur që njëra gjeneratë ta zëvendësojë tjetrën, sepse kjo ka qenë e organizuar, e dhunshme dhe e paskrupullt. Sidomos ato fjalimet e para, kanë paralajmëruar se ato do të jenë programorë, sidomos ai fjalimi në Gazimestan, që kur frika ime kaloi tashmë në panikë.

Ka ndodhur në të njëjtën kohë diçka edhe në jetën time personale. Nipi im, që është fëmija më i vjetër në familje, do të thotë objekt i vëmendjes i të gjithë neve (edhe pse i kam tre fëmijët e mi, D. është për mua diçka krejt i veçantë), ishte atëherë në shërbimin ushtarak, si rekrut në paqe, në një shtet relativisht stabil. Mirëpo, atëherë është parë menjëherë se çdo gjë po ndërron me shpejtësi dhe se kërcënimi me luftë po bëhet krejt serioz, se ajo nuk ishte më vetëm luftë politike brenda Lidhjes Komuniste, por diçka që do të përfshinte tërë shoqërinë dhe do të godiste çdo individ. Unë jam frikuar para së gjithash se çka do të ndodhë me D., me djaloshin i cili si 18-19 vjeçar ka shkuar në ushtri, kurse para kësaj i është dërguar mëngjesi në shtrat dhe ka mbajtur dëgjueset në vesh, ka shkuar në shkollën e vet dhe ka pritur të punësohet një ditë... nga një familje ku të gjithë ishim njerëz të arsyeshëm, pa maskë para syve, kemi biseduar haptazi për gjërat që ishin duke ndodhur. Djaloshi për nga natyra ka qenë paqëndrueshëm. Dhe papritur ai është ndodhur në luftë, diku afër Karlovcit. Kjo situatë ka qenë e tmerrshme – prindërit gjashtë muaj nuk kanë ditur a është fëmija gjallë apo vdekur, nuk kanë mundur të fitojnë asnjë lloj informate. Atëherë babai vendosi ta vizitojë dhe kur ka arritur atje, ia kanë nxjerrë fëmijën me rrip të hequr që ai të mos dezertojë dhe largohet... Të gjitha i ka përjetuar duke

Disa viteve të fundit, flitet "kur ka ndodhur ajo që ka ndodhur", madje as që thuhet se ka pasur krime lufte, se ka qenë luftë, se ajo e ka emrin e vet të vërtetë, por kur flasim për ndonjë periudhë tjetër apo kur flasim për ndonjë mjedis tjetër, njerëzit i përmendin ato fjalë, mirëpo, këtu i përdorin këto eufemizma që të mos shprehen në terma vlerë, për të mos thënë se krimi ndaj civilëve është diçka e papranueshme dhe se është e papranueshme të mos mbrojmë të gjithë viktimat nga cilado palë.

shkuar atje dhe duke u kthyer prapa, të gjithë i kanë marrë para, të gjithë kanë manipuluar diçka, ka parë urrejtjen, ka parë si duket lufta në terren. Kur është kthyer me këtë histori të përjetuar, tashmë kam qenë e tmerruar se pse lufta kishte nisur, e kam ndier veten të pafuqishme ndaj D. dhe ndaj asaj që po afrohej – kam parë që kam energji të tepërt. Më është dashur ta vë në lëvizje atë energji për të mbetur mentalisht e shëndoshë, bëhej fjalë për çështjen e mbijetesës, nuk kam mundur të funksionoj pa e shndërruar këtë energji në njëfarë britme kundër luftës. Atëherë kam filluar të angazhohem politikisht dhe të marr pjesë në çdo gjë që hyn në angazhimin paqësor, aktivizmin.

Më së shumti më ka shkuar përshtat në ato vite të takohem me njerëz në rrugë, të nënshkruajmë peticione, të bëjmë diçka që nga njëra anë duket si provokim, kurse nga ana tjetër është efektive. Kur flisni me dikë në rrugë, sikur edhe ai të ketë qëndrime krejtësisht të kundërta, ju i thoni sinqerisht, si person që beson në diçka: “unë besoj në këtë dhe unë punoj për këtë”. Nëse ju përkrah, atëherë i bëj pyetjen “pse nuk bën diçka?”, kurse ajo thotë “për arsye se jam femër”. Po, organizatat që janë kundër luftës pranojnë edhe femra! Pse nuk bën atë çka mendon? Ose i shtyej ata njerëzit me të cilët flas të ballafaqohen me dyfytërsinë e vet, e atëherë ai diku shi thotë “unë këtë nuk e punoj, ka shumë vite, jam i moshuar...”. Po organizatat i pranojnë në radhët e veta të gjithë, pa marrë parasysh moshën. Atëherë ai fillon të ballafaqohet me vetveten. D.m.th. qëndrimet janë në njërën anë, ndërsa gatishmëria në anën tjetër, kurse fëmijët i ka jashtë shtetit ose diçka e tillë... Ky ishte angazhimi im më i rëndësishëm, ai aktivizmi i drejtpërdrejtë në rrugë.

Ku ndodhemi ne tani si shoqëri?

Mendoj se jemi ndaluar si shoqëri në tranzicion. Mendoj se janë bërë hapa të mëdhenj pas vitit 2000, ka qenë një energji e madhe. Mirëpo, pas 6 tetorit është bërë lëshim i madh. Në koalicionin DOS (Opozita Demokratike Serbe) kanë qenë ato parti të cilat kanë dashur të bëjnë shkëputje simbolike dhe reale me regjimin e mëparshëm, do të thotë, ato të cilat kanë dashur të miratojnë kushtetutën e re, të bëhet lustrimi, të promovohen vlera tjera, kështu që në këtë shoqëri çdokush do të mund të krijonte identitetin e vet. Ne tani kemi bërë një humultim... ne ende tani kemi dy Serbia. Humultimet tregojnë se kemi tradicionalistët që janë ksenofobikë, të cilët frikësohen nga shtetet fqinje, kanë frikë për të ardhmën e vet; kanë frikë edhe këto të tjerët, por e dinë se kah duhet të shkojmë, por po kështu nuk shihet as drejtimi kah po shkon shteti. Do të thotë, tranzicioni i ndaluar, dyfytërsia e madhe politike dhe ajo që mua më frikëson tani është kthimi në retorikën nacionaliste dhe pas kësaj perdeje të mjegullt të retorikës nacionaliste-patriotike zhvillohet privatizimi i ndërmarrjeve publike, pra njëjtë si në kohën e Millosheviqit.

Vetëm kur u ndalen luftërat e kemi parë se çka është devastuar nga ekonomia dhe çka e ka gjetur pronarin privat. Në lidhje me NIS-in (Industria Serbe e Naftës) apo me ndonjë ndërmarrje tjetër të madhe ndodhin këto gjëra, marrëveshjet, e nëse diçka fillon të thuash, çdokush do të të thotë: “Po ku e gjete tani, kur po diskutohet për Kosovën?” ose në një mënyrë të tillë patetike. Ajo që e konsideroj shumë të rëndësishme është se kur flisni me cilindo prej fqinjëve tuaj, me kusht që të jeni të relaksuar gjatë bisedës, apo flisni me ndonjë të panjohur në lokal pasi jeni ulur me të sepse nuk ka vende të lira, atëherë ai do t’ju thotë se Kosova nuk është më e Serbisë. Këtë e tregojnë tashmë edhe humultimet e opinionit publik dhe atëherë keni atë retorikën e elitës politike, sunduese, dhe kam frikë se kjo çon në një traumë serioze. Sepse nëse njerëzit e shohin se Kosova nuk është më e Serbisë, natyrisht

nuk është as e pavarur, sepse as nuk e ka merituar që të jetë e pavarur në kuptimin e plotë të fjalës, sepse shumë gjëra duhet të ndryshojnë, ashtu si edhe në Serbi; ne në Serbi mund të flasim më së paku për atë sesi duket demokracia, por ata vërtet nuk kanë demokraci dhe nuk kanë demokraci konsensuale. Ndërsa tani, nëse njerëzit besojnë se Kosova do t'i takojë Serbisë pas bisedimeve dhe se ky është rishikim i Marrëveshjes së Kumanoves, atëherë kam frikë se do të përjetojmë traumë serioze si shoqëri. E nëse ky ballon retorik shpohet rregullisht dhe nëse arrijnë ta kuptojnë njerëzit të cilët e shohin realitetin, atëherë ndoshta do të luftojnë kundër kësaj mjegulle e cila ua mbulon sytë si në fillim të viteve '90.

Përmendët nacionalizmin. Çfarë duhet bërë me të kur ai kthehet vazhdimisht?

Nacionalizmi është një gjë ngjitëse. Ai ngjitet lehtë dhe nëse njeriu nuk mendon se ku gjendet, se para tij është personi tjetër i cili ndoshta nuk është i të njëjtit komb apo i cili ka ardhur nga mjedisi tjetër, nëse është tërësisht i relaksuar dhe nuk kontrollon çfarë flet, ai grumbullon nga atmosfera mjaft fjali të gatshme që mund ta ofendojnë dikë. Nacionalizmi është i pranishëm kudo rreth nesh, jo vetëm në media, por edhe në opinionin publik dhe njeriu mund ta marrë një pjesë të tij duke thithur ajrin. Mirëpo, nëse është i vetëdijshëm në vetvete, nëse është i vetëdijshëm për qëndrimet politike, nëse është i vetëdijshëm për praninë e personit në anën e tij të kundërt dhe nëse është i singertë, ai me të vërtetë nuk do të jetë nationalist, respektivisht nuk do të flasë në atë mënyrë.

Po sa jemi të vetëdijshëm për veten si shoqëri?

Mendoj se nuk jemi të vetëdijshëm sepse e kemi humbur shansin që më 5 tetor ta arrijmë konsensusin e ri. Do të thotë, shkëputje dhe konsensus i ri ku thuhet qartë: ne kemi pasur regjim kriminal i cili ka shkaktuar luftën, na ka futur në sherr me fqinjët, ka shkatërruar ekonominë e vendit, ka shkatërruar institucionet kulturore, si dhe ato politike etj. Kur t'i pranojmë të gjitha këto, të nisemi nga kjo pikë në anën tjetër, të nisemi kah Europa, me vlera dhe me sjellje, si në ndërmarrje ashtu edhe në mbrojtjen sociale, ta njohim rrugën tonë dhe të dimë se çka duhet të bëjmë. Dhe atëherë themi – të shohim se çka kush mund të bëjë: “hajde, ti ke kapital, çka ke ti nga resurset tuaja, çfarë ndodh me arsimin, çfarë duhet të dinë fëmijët tanë përmes këtij sistemi të arsimit, çfarë sistemi vlerash duhet të marrin që të jenë konkurrentë me moshatarët për pesë vjet”... Thjesht si në shtëpi, në vjeshtë kur përgatitet turshia, ashtu edhe ne ta rregullojmë shtetin sipas vlerave, ta rregullojmë në drejtim të arritjes së këtyre qëllimeve. Mendoj se Gjingjiri e ka bërë këtë shumë mirë. Ai u ka folur njerëzve edhe si person dhe retorika e tij ka qenë e hapur dhe njëkohësisht plot optimizëm. Ka thënë se problemet e vështira janë para nesh, se nuk mund të presin mbrojtje nga shteti, se për familjen e tyre duhen të kujdesen vetë sepse të gjitha fondet janë zbratur, por edhe u ka ofruar kredi, u ka thënë “merre atë”, “bën diçka për vete!”, “fillo!”, “mos e shiko shtetin, derën e fabrikës, ajo është lopë e ngordhur, atë askush nuk mund ta kthejë në jetë!”, “qëndro në këmbët tuaja, mos prit që fati yt të varet nga fabrika yt”... I ka nxitur mjaft njerëzit dhe mendoj se atëherë ka pasur edhe mjaft optimizëm....

Po çfarë duhet bërë me të kaluarën? Kam përshtypjen se ajo ende disi mënjanohej anash dhe mbështillet në një lloj celofani...

Po, kohëve të fundit, disa viteve të fundit, flitet “kur ka ndodhur ajo që ka ndodhur”, madje as që thuhet se ka pasur krime lufte, se ka qenë luftë, se ajo e ka emrin e vet

Ne duhet të vihem në pozitën e viktimës, ta përjetojmë sa mundemi, ta kuptojmë çfarë u ka ndodhur viktimave, edhe familjarëve të atyre viktimave dhe prej asaj pike të nisemi më tej, ta dënojmë edhe atë krim, edhe atë politikë.

C dokujt që shkon nga ky shtet në Bosnjë, konkretisht në Tuzëll, duhet t'i kujtohen të rinjtë të cilët i kanë goditur forcat serbe nga ajo kodër duke vrarë dyzet prej tyre që kanë qenë në atë moment në shëtitore. E gjithë Tuzlla e ruan këtë dhimbje. Duhet t'ju thotë njerëzve që i takon atje se çfarë qëndrimi ka ndaj kësaj, se i dënon kriminelët, sepse nga ne, nga tatimi ynë, nga paratë tona ka ardhur ajo mbështetje, jo vetëm materiale, por edhe kadrovike dhe çdo lloj tjetër. Do të thotë ne jemi përgjegjës për atë që ka shtënë dhe ka vrarë dyzet njerëz. Këtë duhet thënë në komunikim në mënyrë që të ndihesh përgjegjës, pa marrë parasysh tërë atë që ke bërë për ta parandaluar apo ndaluar luftën, por që nuk e ke ndaluar...

të vërtetë, por kur flasin për ndonjë periudhë tjetër apo kur flasin për ndonjë mjedis tjetër, njerëzit i përmendin ato fjalë, mirëpo, këtu i përdorin këto eufemizma që të mos shprehen në terma vlere, për të mos thënë se krimi ndaj civilëve është diçka e papranueshme dhe se është e papranueshme të mos mbrojmë të gjithë viktimat nga cilado palë. Ne duhet të vihem në pozitën e viktimës, ta përjetojmë sa munde-mi, ta kuptojmë çfarë u ka ndodhur viktimave, edhe familjarëve të atyre viktimave dhe prej asaj pike të nisemi më tej, ta dënojmë edhe atë krim, edhe atë politikë. Këtu ekziston po ashtu gatishmëri në mesin e politikanëve që të thonë “atë e bëri Millosheviqi..., ai ka përfunduar në Hagë...”. Mirëpo, ajo çfarë ka ndodhur gjatë luftës dhe krimet e luftës, ato nuk i ka bërë vetë Millosheviqi, as që u ka dhënë instruksione ai vetë njerëzve. Një numër i madh i njerëzve kanë punuar për Millosheviqin dhe kjo është ajo “godina” e cila mund të shihet përsëri, e cila ende ekziston...

Kur flasin për politikanët, shpesh dëgjojmë nga njerëzit se ata janë ekskluzivisht përgjegjës për atë që ka ndodhur. Si i vlerësoni Ju si politikane këto qëndrime?

Më së lehti është të themi “të gjithë janë përgjegjës”. Mirëpo, absolutisht nuk janë. Përgjegjëse është gjithmonë elita politike dhe intelektuale, do të thotë jo vetëm politike. Përgjegjës janë edhe shkrimtarët, të gjithë nëpunësit publikë, të gjithë individët e dalluar të cilët shfaqen në media; edhe ata duhet të thonë diçka konform peshës dhe rëndësisë së momentit dhe duhen të jenë përgjegjës në radhë të parë ndaj të ardhmes. Mua më kujtohet një hulumtim i cili është realizuar në fillim të viteve '90, bëhet fjalë për një hulumtim evropian që ka përfshirë Hungarinë dhe disa vende në tranzicion. Njëra nga pyetjet ka qenë: “A mendoni se territoret e shteteve fqinje të banuara nga bashkëkombasit tuaj duhet t'i përkasin shtetit tuaj?”. Rreth 70% e qytetarëve të Hungarisë kanë thënë “po, natyrisht”. Mirëpo, përgjegjësia e elitës së tyre politike dhe intelektuale, e të gjithë atyre që përbëjnë substancën shoqërore, e cila është më e rëndësishmja në shoqëri, do të thotë njerëzit prej të cilëve pritet ta përcaktojnë drejtimin – dhe ata e kanë përcaktuar drejtimin kah Evropa. Ata kanë thënë: “këto gjëra me të vërtetë duken bukur, por ky mendim i përket shekullit të kaluar apo fillimit të shekullit XIX. Ne jemi në prag të shekullit XXI dhe ne do të veprojmë në këtë mënyrë”. E kanë marrë përgjegjësinë për këtë. Atje ka mundur dikush ashtu si edhe këtu, ta shtrijë bajrakun, do të kishte pasur përkrahje të madhe dhe do të kishte qenë në pushtet. Por ekziston përgjegjësia e politikanëve dhe e elitës. Normalisht, ekziston njëfarë përgjegjësie, jo e vogël, e çdonjërit që ka votuar apo ka përkrahur regjimin e atëhershëm, edhe pse e ka ditur se çfarë është duke ndodhur, ku shkojnë komshinjtë e tij çdo fundjavë dhe sjellin atë çfarë sjellin dhe për ç'arsye përhapet retorika e luftës, për ç'arsye ai prifti e mban kupën e kokës së fëmijës dhe çfarë do të ndodhë pas saj. Njerëzit i kanë ditur të gjitha këto. Ndërsa, kanë mundur, ta zëmë, në dyqan të zgjasin dorën pesë centimetra më larg që të lexojnë gazetata tjera. Ka qenë e lehtë për ta kuptuar se çka është vërtet duke ndodhur dhe mendoj se të gjithë e kanë ditur se çfarë po ndodh, por e kanë përkrahur sepse kanë menduar se për ta është më mirë ashtu.

Si e shihni pajtimin, çfarë mendoni në përgjithësi për të? Pajtim ndërmjet kujt...?

Unë mendoj se pas çdo lufte arrihet spontanisht pajtimi. Forma e parë është ajo që e kërkojnë afaristët, pra bashkëpunimi ekonomik; ne i hapim fabrikat këtu, ju atje, njerëzit kërkojnë pasaporta, takohen, udhëtojnë. Kjo është diçka që i ngjan pajti-

mit, por në të vërtetë nuk është pajtim. Pajtimi ka të bëjë me emocionet dhe traumat që mbesin akoma tek njerëzit dhe në një situatë tjetër mund të aktivizohen. Mendoj se është shumë e rëndësishme që njerëzit të pajtohen vërtetë. Ta zëmë, çdokujt që shkon nga ky shtet në Bosnjë, konkretisht në Tuzëll, duhet t'i kujtohen të rinjtë të cilët i kanë goditur forcat serbe nga ajo kodër duke vrarë dyzet prej tyre që kanë qenë në atë moment në shëtitore. E gjithë Tuzlla e ruan këtë dhimbje. Duhet t'ju thotë njerëzve që i takon atje se çfarë qëndrimi ka ndaj kësaj, se i dënon kriminelët, sepse nga ne, nga tatimi ynë, nga paratë tona ka ardhur ajo mbështetje, jo vetëm materiale, por edhe kadrovike dhe çdo lloj tjetër. Do të thotë ne jemi përgjegjës për atë që ka shtënë dhe ka vrarë dyzet njerëz. Këtë duhet thënë në komunikim në mënyrë që të ndihesh përgjegjës, pa marrë parasysh tërë atë që ke bërë për ta parandaluar apo ndaluar luftën, por që nuk e ke ndaluar...

Domethënë, përgjegjësia për pajtimin qëndron tek “njerëzit e zakonshëm”, pra tek secili prej nesh?

Po, mendoj se çdokush kur të takojë disa njerëz mund të flasë për gjëra që kanë qenë traumatike për njërin apo tjetrën palë. Kjo është vërtet vështirë sepse ai mund të thotë “të gjithë ju jeni kriminelë”, kurse ti atij “nuk jemi të gjithë, ashtu si edhe tek kombi yt, disa janë, disa nuk janë, por nga shteti im është udhëhequr ajo politika kriminale”. Këtë mund ta thotë çdokush që nuk ka qenë shumë i lidhur për atë politikë, kurse ai që ka qenë, mendoj se ai nuk do të duhej të udhëtonte shumë përreth.

A mund të flasim për përgjegjësi, për faj, individual apo kolektiv, për tërë atë që ka ndodhur?

Po zakonisht thuhet se nuk ekziston përgjegjësia kolektive, as faji kolektiv. Sipas mendimit tim, përgjegjësi kolektive ka sepse kolektivi siç është shoqëria politike, gjegjësisht të gjithë qytetarët e këtij shteti kanë përgjegjësi të përbashkët për diçka që nuk e kanë parandaluar, edhe sikur të mos kenë marrë pjesë në të, edhe sikur të kishin bërë diçka që ta parandalojnë. Pra, ne kemi përgjegjësi për këtë dhe tani ne duhet të flasim lirisht për këtë.

Si e shihni të ardhmen?

Po, nuk e di. Mua më duket se pasi që jetojmë në mesin e vendeve të cilat me ritëm të shpejtuar po hyjnë në Europë, ndikimi i kësaj ndjenje se të gjithë në rrethin tonë jetojnë në Europë, jetojnë në mënyrën europiane dhe me vlerat europiane, do t'i stimulojë edhe më tepër të gjithë njerëzit në Serbi që të dëshirojnë të jemi pjesë e Europës, që të kenë motivim të ndryshojnë diçka. Kjo është natyrisht përgjegjësi e atyre që e udhëheqin shtetin dhe e atyre që flasin për integrimet europiane. Ata, për shembull, nuk mendojnë për vlerat europiane sepse nëse bëhet fjalë për një vlerë themelore, siç është antifashizmi, atëherë çdo shfaqje e fashizmit duhet të dallohet, të quhet me emër të vërtetë, të sanksionohet dhe opinioni të dëgjojë se në këtë vend kjo nuk guxon të bëhet, se ai nuk përkrahet. Në të njëjtën kohë, nuk guxon të miratohet ligji i cili i barazon partizanët dhe gjermanët, gjegjësisht fashistët dhe antifashistët. Nëse e keni këtë ligj, atëherë aty nuk është diçka në rregull. Ose nuk mund t'i përcillni kriminelët, gjegjësisht të akuzuarit për krimet më të mëdha ndaj të drejtës humanitare, ose madje të akuzuarit për gjenocid, nuk mund t'i përcillni me nderimin më të madh sepse në këtë mënyrë inkurajoni të gjithë të tjerët që të vazhdojnë atë projekt, i cili edhe më tutje ka mjaft ndikim në Serbi, atë projektin e

Milloseviqit dhe Sheshelit, në të cilin ka marrë pjesë një numër i madh i njerëzve e që sërish do të merrnin pjesë në atë projekt...

Dhe në fund, a keni edhe diçka që do të kishit dëshirë të thoni, diçka që nuk ju kam pyetur...

Do të thoja se cili është shqetësimi im. Përveç asaj që është fundamentaliste, kryesisht në kontakt apo nën ombrellën e Kishës Ortodokse, pastaj organizatat e djathta ekstreme të të rinjve, ekziston edhe diçka që është fryma djathtiste tek rinia dhe kjo është ajo që më shqetëson më së shumti. Sepse ata janë njerëzit që do ta drejtojnë këtë shtet në të ardhmen e afërt, por edhe në këtë çast ata vendosin me sasinë e tyre të madhe dhe votën e tyre se kush do të qeverisë nesër në Serbi. Kjo valë e djathtë nuk është diçka endacake. Zakonisht në vendet në tranzicion ndodh që të fitojë pak e majta, pak e djathta, pastaj pak nostalgji për kohën e kaluar, pastaj përsëri pak qeveria liberale, mirëpo ky vend ka përjetuar luftë dhe dhunë të tmerrshme, praninë e së djathtës, asaj ekstreme, kështu që përhapja ndër të rinj mund të thotë kthim në kohën e urrejtjes dhe projekteve dhe ideve të tilla.

Si t'i rezistojmë kësaj?

Mendoj se duhet të flasim shumë me njerëz, duhet të jemi krejtësisht të hapur, duhet të bisedojmë me secilin dhe kështu të përhapim njëfarë "oaze të normalitetit", sepse askush nga ne nuk do të shkojë vetë në ardhmëri. Kemi përgjegjësi për të gjithë ata që janë rreth nesh. Të diskutohet me njerëzit rreth nesh, të orientohen drejt vlerave, t'ju tregohen disa përmbajtje të reja, të polemizohet me ta, të dërgohen në ndonjë vend. Do të thotë, të luftohet me çdo njeri në mënyrë individuale. Mendoj se për të rinjtë është më lehtë që ta bëjnë këtë në rrethin e moshatarëve sepse nëse vjen dikush që ka 60 vjet dhe fillon t'ju flasë për këtë, ekziston hendeku i gjeneratave. Pra, njëfarë edukimi ndërmjet gjeneratave dhe interesimi i të gjithëve që e djathta ekstreme të mos jetë e pranishme ndër të rinjtë...

H. R.

**Për dhunën janë thënë kudo shumë gjëra,
kurse këtu do të themi diçka për padhunën**

T'i pyesësh njerëzit se çfarë mendojnë për pajtimin 15 vjet nga fillimi i luftërave në territorin e ish-Jugosllavisë kërkon gatishmëri për vështrim paralel në të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e këtij rajoni, ku “të shikosh” do të thotë të përfshihen këndvështrimet dhe qëndrimet e ndryshme, të merren parasysh perceptimet e ndryshme mbi shkaqet e konfliktit dhe diapazoni i tërë i “recetave”, dëshirave dhe shpresave të llojllojshme për të ardhmen. Shikuar në mënyrë të pastër faktografike dhe pa u futur në analizë, të paktën sipërfaqësore, të shkaqeve dhe pasojave, gjendja e tashme nuk lë shumë dilema – është viti 2005, rajoni i ish-Jugosllavisë është i ndarë në shumë shtete dhe territore të cilat kanë statuse dhe raporte të ndryshme (brenda vetvetes dhe në raport ndaj të tjerëve), ndaj, kryesisht, të kaluarës së përgjakshme gjatë të cilës janë përcaktuar fatet, si të shteteve, ashtu, në masë edhe më të madhe, edhe të individëve.

Pas luftërave të zhvilluara në Slloveni, Kroaci dhe Bosnje e Hercegovinë gjatë periudhës 1991-1995, lufta e fundit në këto hapësira ishte në Kosovë, në vitin 1999, ndërsa ajo që ndodhi në Maqedoni në pranverë dhe verë të vitit 2001 quhet “konflikt”, kurse ndonjëherë edhe “konflikt i armatosur”, me çka në mënyrë të pavetëdijshme apo të vetëdijshme tentohet të shmanget etiketimi i luftës si diçka që është, ndoshta, më afatgjate dhe me më shumë humbje njerëzore e materiale dhe që në vetëdijen e njerëzve mbetet më gjatë dhe më me dhimbje. Problemi qëndron në faktin sesa mund të fshijë përdorimi i deminutivit, në këtë kontekst, të vërtetën e qartë të dhimbshme se çdo pëllëmbë e tokës, e cila dikur është quajtur RSFJ ka qenë e goditur në mënyrë direkte apo indirekte nga *lufta*, dhe se, edhe sot e kësaj dite luftërat (në nivele të ndryshme dhe të kuptuara në mënyrë metaforike) trondisin shoqëritë në të cilat *mundohemi* të jetojmë. Vetë përzgjedhja e termave të cilët përdoren për të shënuar dhe përshkruar ngjarjet e përmendura (ngjarje rrëqethëse, tragjedia, konflikte të armatosura, luftëra, agresione...) flet shumë edhe për pikënisjen tonë, edhe për raportin ndaj të kaluarës, edhe për kuptimin e kategorisë së përgjegjësisë... Por, cilindo term ta zgjidhni nuk mund t'i shmangeni faktit të dhunës së tmerrshme që është bërë dhe pasojave të së njëjtës dhunë për shkak të së cilës pjesa jonë e botës është bërë vend i pashmangshëm në numërimin dhe analizën “e pikave të zeza” në hartën botërore.

Më tepër se 15 vjet pas fillimit të luftërave për shtete, kufij, identitete, liri, ne, qytetarët dhe qytetaret e kësaj pjese të botës, të cilën qëllimisht nuk do ta quajmë Ballkan, nuk e dimë *suma sumarum* se sa është në të vërtetë numri i viktimave të luftërave të udhëhequra në emrin tonë, sa njerëz janë vrarë, sa njerëz janë zhdukur, sa njerëz janë shpërngulur dhe dëbuar... Pra, as ajo e ashtuquajtura e vërtetë *forenzike* nuk është ende në dispozicion, sikurse edhe përgjigjet, në të njëjtën masë të ndieshme, por edhe më të ndërlikuara në pyetjet se pse ndodhi tërë kjo, si dhe kush dhe në çfarë mënyre e bart fajin dhe përgjegjësinë për shpërthimin e dhunës dhe gjakderdhjes prej të cilave, si shoqëri, mundohemi akoma të shërohem.

Atë që përkundër kësaj e dimë dhe mund ta dimë (me vullnet ose pa vullnet, me zemër të hapur apo me skepticizëm dhe frikë) është se nuk mund të shmangemi prej gjithë kësaj (pavarësisht sesa dëshiron dhe mundohet dikush), kështu që duhet të mësojmë të jetojmë me të, si ta ndriçojmë këtë të kaluar, si ta kuptojmë, kurse më vonë edhe si ta tejkalojmë dhe mos ta lejojmë që të na brejë përbrenda dhe të sundojë plotësisht me ne dhe botën tonë... Dhe që krahas kësaj mos të harrojmë se ajo e kaluar (ashtu si edhe as e tashmja, as e ardhmja) nuk ekziston jashtë dhe pranë nesh, në një sferë në të cilën ne nuk kemi kurrfarë ndikimi, as kurrfarë përgjegjësie. Jemi të vendosur pra, apo jemi vendosur vetë, para një detyre të vështirë (shumë njerëz do thonë të pamundshme) e cila, varësisht nga pozitat e ndryshme, për dikë do të thotë kalim i sërishëm përmes traumës, vuajtjes dhe dhimbjes, ndërsa për të tjerët i përngjan procesit të pakëndshëm të futjes së hundës në qelbësirën e vet. Edhe qelbet, edhe dhemb...

Njëra prej recetave shumë të lavdëruara në këto situata është edhe *pajtimi* (eng. reconciliation) i famshëm, i cili tanimë është studiuar dhe analizuar në shembujt e territoreve tjera të pasluftës dhe postkonfliktit, siç janë Afrika e Jugut, Guatemala, Argjentina, Kili etj., kurse neve na është rekomanduar me gjithë zemër kryesisht nga “ekspertët” e huaj, diplomatët, ndonjë politikan vendor, i cili këtë koncept e ngushton zakonisht deri te kufiri “paqe, paqe, paqe, askush nuk është fajtor”, punonjësit e mediave të cilët me konotacionet gjuhësore dhe pluralitetin e kuptimit edhe ashtu merren rrallë...

Duke shfaqur rezervë se nuk ekziston asnjë qasje universalisht e zbatueshme, si dhe që çdo shoqëri duhet të hulumtojë vetë mënyrën e pranueshme sesi do të zhvillohet procesi i pajtimit, kjo tingëllon si zgjedhje krejtësisht korrekte dhe do të promovohet nga anë të ndryshme, e shoqëruar me mënyra të ndryshme të sqarimit, shpjegimit dhe nga pozicione të ndryshme teorike, si dhe të vlerave. Problemi, jo i vetmi por sigurisht më i madhi, në tërë këtë histori, është se promotorët e pajtimit më së shpeshti nuk janë bartësit e tij (të vërtetë dhe të dëshiruar), ose të paktën nuk janë të njohur si të tillë.

Pikërisht në këtë aspekt është e dukshme rëndësia e këtij publikimi – nëse nisemi nga supozimi që dimë mjaft se çfarë mendojnë-flasin për pajtimin personalitetet ndërkombëtare dhe vendore nga jeta kulturore – politike – joqeveritare – qeveritare, na mbetet të shohim

se çfarë mendojnë për këtë dhe çfarë ndiejnë rreth kësaj njerëz të ndryshëm nga pjesë të ndryshme të rajonit tonë (të cilët me këtë rast me qëllim nuk do t'i quajmë të zakonshëm duke mos dashur që me këtë etiketim t'ju ngjeshim edhe ato shenjat përcjellëse të padukshme, siç janë: të mërzitshëm, të paarsimuar dhe pa fuqi reale që të bëjnë – ndryshojnë diçka).

Pa qëllim që konceptin e “pajtimit” ta hedhim poshtë ose ta prezentojmë si qasjen më adekuate për situatën tonë, kemi dashur vetëm të shfrytëzojmë hapësirën publike për prezentimin e zërave autentikë dhe mendimeve të njerëzve nga rajoni mbi nocionin e “pajtimit”; kemi dashur të vëmë në dukje një spektër të gjerë të qëndrimeve, botëkuptimeve dhe emocioneve të ndryshme, të cilat e shoqërojnë bisedën rreth kësaj teme. Që nga marrja si e mirëqenë e faktit se pikërisht pajtimi është ai që na nevojitet, përmes dekonstruksionit dhe shqyrtimit kritik të nocionit dhe kufijve të tij, e deri tek refuzimi i konceptit, por jo edhe i vlerave që ai duhet të përmbajë – përcëptimet janë me të vërtetë laramane, ashtu siç është edhe të kuptuarit e asaj se kush është përgjegjës për t'i nisur dhe bartur këto procese...

Ajo që është e përbashkët tek pjesa më e madhe e përgjigjeve dhe vlera më e madhe e këtyre intervistave është ndërlidhja e këtij nocioni me një sërë procesesh të thella dhe të vështira (madje edhe pandashmëria e tij nga ato), siç janë hulumtimi i të vërtetës mbi atë se çfarë në të vërtetë ka ndodhur dhe kush është përgjegjës për këtë, ekzaminimi i nocionit të drejtësisë dhe arritja tek e drejta konkrete në rrethana konkrete, çështja e faljes, fajësisë dhe përgjegjësisë... E gjithë ajo që, në kuptimin më të gjerë, hyn në kategorinë e “ballafaqimit me të kaluarën”. T'i pyesësh sot njerëzit se çfarë mendojnë dhe si sillen ndaj “pajtimit” do të thotë të hapësh edhe një fushë të frikave, shpresave, frustracioneve të gërshetuara, e cila nuk lejon të futet aq thjeshtë në asnjë kategori apo koncept në pamje adekuate. Në lidhje me këtë, intervistat e zhvilluara tregojnë, në mes tjerash, se është e tepërt dhe e pavend frika se gjërat që lidhen me të kaluarën do të kuptohen lehtë dhe se pajtimi do të përjetohet si diçka që është në vetvete rruga dhe qëllimi i vetëm. Sepse sasia e përvojës së përjetuar në luftë dhe të jetuarit e realitetit të urrejtjes dhe dhunës, në mënyrë direkte apo indirekte, është pikërisht në kundërshtim në proporcion me gatishmërinë që gjërat të kuptohen lehtë dhe që të pranohen disa rugë të shkurtra të imagjinuara, të cilat do të na çojnë tek gjendja e dëshiruar e paqes.

Hapja e hapësirës për histori njerëzore jopretencioze mbi pajtimin i kontribuon edhe një gjëje, shumë të rëndësishme për radhitjen e mozaikut për gjithçka që ka ndodhur në këto treva, e ky është shënimi i historive dhe kujtimeve personale, prej të cilave burojnë nëse jo përgjigjet dhe zgjidhjet, atëherë të paktën aluzionet çfarë është ajo që dhemb dhe djeg, dhe ku jemi “të brishtë”.

Madje edhe nga thënia naive se dëshirohet “kthimi në kohën siç ka qenë më parë” mund të nxirren shumë udhëzime të dobishme për punë në këtë fushë – që prej asaj se nuk ekziston një shikim unik, as teori unike e cila do të mund të përshkruajë as marrëdhëniet

midis njerëzve nga i njëjti qytet (e lëre më shtet apo rajon) ndaj shoqërisë-shtetit në të cilin kanë jetuar deri në vitin 1991, sikurse edhe që aty nuk lejohen kurrfarë thjeshtëzimesh, qoftë për vëllazërim-bashkimin e “sinqertë dhe të ndieshëm” apo për urrejtjet ndëretnike të vjetra pesë shekuj.

Sikurse pajtimi që përjetohet si një gjë ekskluzivisht personale, ashtu edhe shpjegimet e mëdha për kohën para, gjatë dhe pas luftës duhen të marrin parasysh, në njëfarë kuptimi, edhe këto histori personale. Ndërkaq, nëse tanimë gjurmohet për disa udhëzime më universale, njëri prej udhëzimeve më të rëndësishëm mund të jetë gjithsesi ai se as “atëherë”, sikurse as tani, përgjegjësia personale nuk është diçka që vlerësohet lartë në shoqërinë në të cilën jetojmë. Që të mos gënjehemi, kurrë dhe askund ky lloj i përgjegjësisë nuk është diçka që njerëzit do ta bartnin me qejf në supet e veta, por mungesa e habitshme e vetëdijes për atë se edhe ne duhet të pyetemi diçka dhe se kemi një lloj fuqie, duhet të jetë gjithsesi njëri nga prioritetet kryesore në ndërtimin e shoqërive tona.

Sepse në situatën kur disa nocione (të tipit të interesave nacionale dhe kujdesit për to) i shtrijmë deri në përmasa të papara duke përfshirë me to çdo gjë që ekziston (interesi nacional në hortikulturë, interesi nacional ekologjik, interesi nacional artistik), deri në atë masë jemi të gatshëm ta përkrahim ngushtimin e nocionit të përgjegjësisë, deri në mikro-dimensione të atilla, sa që në fund askush nuk e ka më ndjenjën se përgjegjësia është diçka që ekziston fare si vlerë në rrethin tonë. Përgjigjet e përmbledhura në këtë publikim nxisin reagime të ndryshme dhe në një mënyrë mjaft specifike, në të vërtetë, japin një pamje objektive të shoqërisë, me variante dhe drejtime të ndryshme të mendimit dhe veprimit. Ato jo vetëm se tregojnë për disa drejtime themelore në të cilat kuptohen proceset e ballafaqimit me të kaluarën e vështirë, por tregojnë shumë qartë edhe për ndikimet dhe burimet sociale të këtyre pamjeve. Po ashtu përkujtojnë se pa shqyrtimin serioz të këtyre pikëpamjeve, pa marrë parasysh se ndonjëherë na duken të njohura, nuk mund të ekzistojë pamje e qartë sesi do të veprojmë në këtë fushë, as sesi duam që frazës se “potencialet për ndërtimin e paqes janë kudo rreth nesh” t’i japim më në fund pak jetë.

Dhe në fund, sigurisht që do të ketë shumë nga ata të cilët do të vënë re se në këtë publikim nuk ka intervista me një numër jo aq të vogël të atyre të cilët nuk e duan (ose të paktën fjalët dhe veprimet e tyre japin mesazh të tillë) as ballafaqimin me të kaluarën, as pajtimin, as bashkëjetesën. Edhe ne themi, po, është e vërtetë, biseda të tilla nuk ka, sepse nuk duam t’u japim hapësirë, të cilën edhe ashtu e kanë me shumicë. Ndërsa në pyetjen se a dëshirojmë që realitetin e hidhur ta tregojmë me lule, ne i përgjigjemi “jo!”. Vrazhdësia është vetëm njëri prej atyre elementeve të realitetit, ashtu sikurse janë shpresa, njerëzia, dhembshuria, ndërsa praktika e gjatë e punës paqësore na ka mësuar që në mënyrë të qëndrueshme të kërkojmë dhe të krijojmë hapësirë për këto histori pak të ndryshme. Ose me fjalë të tjera *“për dhunën janë thënë kudo shumë gjëra, kurse këtu do të themi diçka për padhunën”*.

Tamara Shmidling

CIP - Каталогизација у публикацији
Народна библиотека Србије, Београд


159.923.5(035)
316.647.3/.5(035)

**NE može meni bit dobro, ako je mom
susjedu loše** = As unë nuk mund të ndihem
mirë nëse fqinji im ndihet keq = Не може
мене да ми биде добро, ако на мојот сосед му е
лошо / uredile, redaktuan, уредиле Helena
Rill, Ivana Franović ; [prevod s albanskog
na b/h/s , përkthyen nga gjuha shqipe në
gjuhën boshnjake, kroate, serbe Edina
Hasanaga-Çobaj, Bernard Çobaj ... et al.;
fotografije, fotografitë, фотографии Nenad
Vukosavljević, Nedžad Horozović]. – Beograd
: Centar za nenasilnu akciju, 2005
(Beograd : Standard 2). – 612 str. :
fotogr. ; 30 cm

Uparedo srp. alb. i mak. tekst. – Tiraž
1.500. – Str. 11–16 : Predgovor / Ivana
Franović = Parathënie / Ivana Franović =
Предговор / Ивана Франовиќ.

ISBN 86-902539-4-7
1. Уп. ств. насл. 2. Рил, Хелена 3.
Франовић, Ивана
а) Ненасилно понашање – Приручници б)
Међуљудски односи – Приручници
COBISS.SR-ID 127935756

ISBN 869025394-7



97886901253944